



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË  
MBAJTUR MË 19 MAJ 2011

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE  
19. MAJA 2011. GODINE

MAJ – MAJA  
2011

**E enjte, 19.5. 2011, ora 10:00**

**Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,  
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.  
Konstatoj se në sallë janë prezentë 74 deputetë, andaj i fillojmë punimet e mbledhjes plenare.

E fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

**1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Në pajtim me nenin 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupit parlamentar zgjatin deri në 5 minuta, ndërsa diskutimet e deputetëve deri në 3 minuta.

Ju paralajmëroj që kjo kohë është e rezervuar për deputetët dhe nuk ka replika.  
Askush s'është lajmëruar me shkrim ose më herët.  
Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,  
Unë do të deklaroj për një çështje e cila ka të bëjë me avazin e keqpërdorimit të buxhetit të Kosovës, i cili po vazhdon në mënyrë të njëjtë, ta quaj sistematike dhe në mënyrë të organizuar. Konkretisht, fjala ka të bëjë me gjendjen në shëndetësinë e Kosovës, e cila shumë herë kemi dëgjuar se për shkak të buxhetit të mangët, nuk mund t'i arrijë synimet apo t'i realizojë ato të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me jetën e qytetarit, sidomos në qendrat të cilat kanë të bëjnë me shërimin e njerëzve që për xhepin e tyre akoma vazhdojnë të jenë shumë të shtrenjta.

Ne jemi mësuar apo kemi dëgjuar vazhdimisht, si nga kryeministri i Republikës së Kosovës, ashtu edhe nga ministri i Shëndetësisë, se nuk do të kemi pardon për ata që e keqpërdorin buxhetin apo ta quajmë zero tolerancë ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, por këto si duket akoma po vazhdojnë të mbeten vetëm në letër apo më mirë të them vetëm deklarata publike.

Konkretisht do të ndalem në atë që tek ne vazhdimisht po sillet gjithmonë problemi me furnizim nga lista esenciale, furnizimi i spitaleve dhe konkretisht i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

Të nderuar deputetë, qytetarë dhe opinion publik,  
Para pak kohësh ne e kemi parë në mënyrë publike se si shpallet fitues për një kategori, për penj kirurgjikë tenderi i cili është 400 mijë euro më i shtrenjtë se tenderi më i lirë. Prandaj, unë sot kërkoj nga kryeministri i Kosovës, nga ministri i Shëndetësisë, por edhe duke ftuar publikisht edhe organet hetimore, siç janë prokuroria dhe Agjencioni Antikorrupsion, le të merren me tenderin me furnizim për penj me numër reference 7130010647111.

E dyta është që ne vazhdimisht gjithë Qeveria kërkon rritje të buxhetit për shëndetësi, ndërsa tenderi i cili është më i shtrenjtë fiton në mënyrë të paligjshme dhe kjo linjë e fitimit të tenderit:

prokurim, OSHP, APP, po funksionon në mënyrën ” shumë më të mirë” në aspektin e keqpërdorimit të buxhetit të Republikës së Kosovës. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

E kam marrë fjalën lidhur me vendimin e djeshëm të Qeverisë për themelimin e Ministrisë, si është quajtur, të Diasporës. E konsideroj çështje imediate që s’kam pasur mundësi si ta shtroj ndryshe, kurse kjo që do të propozoj po ashtu është imediate, prandaj edhe konsideroj se si e tillë ajo mund të shtrohet në këtë rend dite për dallim nga do çështje që mendoj mund të shtrohen edhe në procedurë të rregullt.

Jam njëri nga ata që ka propozuar më se një herë themelimin e kësaj ministrie, prandaj edhe e përshëndes më në fund këtë hap të rëndësishëm të Qeverisë, sado që nuk mund t’i kundërshtoj edhe vërejtjet që i bëhen Qeverisë për numrin shumë të madh të ministrive. Ministrinë mund të shkrihen e të reduktohen, por fakti që ne kemi çdo të tretin banor jashtë, mendoj që imponon nevojën e një kujdesi të veçantë edhe institucional për mërgatën tonë.

Megjithatë, vërejtja ime e parë ka të bëjë me emërtimin dhe meqë është në proces, mendoj se mund të rishikohet. E konsideroj të papërshtatshme emërtimin shprehimisht për diasporë. Ne kemi diasporë, por jo gjithë të mërguarit tanë mund të futen në kallëpin e diasporës. Prandaj, mendoj që do të duhej rishikuar emërtimi dhe së paku sikur në shumë vende të tjera do të duhej shtuar edhe për migracion, që përfshin edhe emigracionin edhe imigracionin në vend.

Vërejtja e dytë ka të bëjë me praktikën tonë që është unike dhe mendoj është paprecedencë e ndarjes së kategorisë së njëjtë të atyre që jetojnë jashtë Kosovës në baza etnike. Një komunitet është në Ministrinë për Kthim dhe Komunitete, komuniteti tjetër tani në një ministri tjetër, kurse të dëbuarit nga Presheva e Bujanovci nuk janë askund. Konsideroj se një strukturim tjetër do të duhej t’i përfshinte të tretë dhe ky është propozimi im i dytë.

Çështja e Preshevës, mendoj se nënkupton dhe të mërguarët nga Presheva, nënkupton një kujdes të veçantë dhe nuk do të duhej të lejonim që ata të futen në kategorinë që shkrimtari ynë i njohur këto kohë të fundit i ka quajtur me “ bijtë e askujt”.

Unë përshëndes edhe një herë vendimin e Qeverisë për të themeluar këtë ministri, i uroj suksese dhe pres që në fillim të përcaktohen si prioritete zgjidhja e problemeve të shumta me të cilat përballet mërgata jonë, duke përfshirë të drejtën për votë të cilën ata shpesh nuk e kanë as në vendet ku jetojnë, as në Kosovë dhe përsëri mbeten “bijtë e askujt” dhe në këtë kuadër besoj se do t’i kushtohet kujdes imediat edhe çështjes së vështirësive të shumta ....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Ndoshta në emër të Grupit Parlamentar, fjalën e ka kërkuar deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Po e kam marrë fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe do të flas sot për kontratën mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Kompanisë Bechtel&Enka.

Kjo kontratë, të cilën e zbuluam të hënën, ministri i infrastrukturës Fehmi Mujota e vlerësoi si dokument anonim, ndërkohë që ministri i Kulturës, po e përsëris, Ministri i Kulturës, Memli Krasniqi, e quajti atë njërin prej drafteve të mëhershme që ishin diskutuar. Nëse i bashkëdyzohet këto dy deklarata, atëherë e kuptojmë se qeveria e vlerëson këtë kontratë të zbuluar si draft- kontratë anonime. Por, sipas Ministrit të Kulturës, një dokument anonim të cilin ai jepte përshtypjen se e kishte parë dhe diskutuar më herët, sepse e quajti njërin prej drafteve. Unë nuk e di se cilit prej këtyre dy ministrave mund t’i besohet më shumë, mbase të dyve, meqenëse duke e pasur parasysh reagimin e parë që erdhi në ditën e zbulimit të kontratës, pra të hënën, reagim ky nga ministri i Infrastrukturës, dhe deklaratës së dytës që na u shfaq në ekrane të nesërmen, tregon që Qeveria ka pasur kohë që ta mendojë më mirë përgjigjen. Dhe, ky mendim i Qeverisë e ndryshoi karakterin e dokumentit nga dokument anonim në njërin prej drafteve të kontratës. Pra, është për t’ju besuar të dyve, ngase që të dy po e shpërfaqin mendimin e tjetërkujt dhe procesin e këtij të menduari.

Por, është interesant se përkundër kontestimit që Qeveria ia bëri autenticitetit të dokumentit, ata ishin shumë aktiv në arsyetimin e çmimeve të njërive brenda kontratës, disa prej të cilave të analizuar i bëmë publike po të hënën. Këtë prapë e bëri ministri i Kulturës, e jo ai i Infrastrukturës. Ai i arsyetonte çmimet për njësi në kontratë duke thënë se aty përfshihen cilësia më e lartë, përgatitja profesionale dhe testimi që i bëjnë këto çmime të dallojnë nga ato të tregut. Pra, nuk tha se këto çmime të publikuara nuk janë të sakta, por se janë të arsyeshme. Ne prapë u themi kryeministrit dhe ministrave se vërtet shpresojmë që kjo kontratë e zbuluar nga ne të mos jetë ajo origjinalja. Pra, vërtet shpresojmë se kontrata origjinale është shumë më e favorshme dhe më e drejtë për Kosovën se sa ajo që e kemi zbuluar ne. Por, për sa kohë që kjo Qeveri nuk publikon kurrfarë dokumenti, atëherë kjo mbetet e vetmja kontratë publike në të cilën keni hyrë ose në të cilën ka hyrë kjo Qeveri me kompaninë Bechtel&Enka. Publikimin e kësaj kontrate Qeveria e ka obligim jo vetëm kushtetues, por edhe qytetar e moral. Nëse vërtet këta besojnë në ato që i thonë se jeni qeveri legjitime e këtij vendi, atëherë gjëja më e vogël që mund ta bëjnë është ta informojnë burimin e këtij legjitimiteti që është populli. Nëse jo, atëherë kjo nënkupton që kjo Qeveri konsideron që legjitimiteti i tyre rrjedh nga diku tjetër. Atëherë, ju lutem, na tregoni prej nga e merrni ju legjitimitetin, a e merrni prej Bechtel&Enkës?

E ky version i kontratës, të cilën e zbuluam të hënën, është tejet i pafavorshëm për Kosovën dhe buxhetin tonë të varfër. E tërë kontrata është e bazuar në nevojat, dëshirat dhe interesat e Bechtel&Enkës dhe askund aty nuk e gjen interesin e Kosovës. Është kontratë e njëanshme, ku njëra palë i merr të gjitha obligimet e tjetra të gjitha përfitimet. Sikur të mos kishte qenë kontratë e lidhur në mes të dy palëve të barabarta dhe me vullnet të lirë. Ju Qeveri e Kosovës, do të vazhdoni të na akuzoni se kundërshtimi ynë ndaj padrejtësisë dhe pabarazisë së kontratës, është kundërshtim ndaj Rrugës së Kombit. Por, ne u themi prapë shumë thjeshtë: kundërshtimi ynë është kundërshtim ndaj keqpërdorimit dhe abuzimit me paratë e kombit në emër të kombit.

Ne jemi për rrugën e kombit, por jemi kundër kësaj kontrate të nënshkruar mes Qeverisë dhe Bechtel Enkës.

Ne e kemi zbuluar këtë kontratë dhe do të zbulojmë edhe në të ardhmen çfarëdo dokumenti tjetër në interes të publikut që fshihet nga publiku, sepse ne e kuptojmë rrënjësisht emërtimin

Republikë, dhe angazhohemi që vërtet të kemi një pushtet të popullit dhe për të, e Republika është e qytetarëve, është e publikut, dhe ajo tërë qenien e vet e ka në funksion të së mirës së përgjithshme që është e mirë kolektive e qytetarëve. Republika është ajo çfarë e bën Republika, ndërsa kjo qeverisja që po e ndërtoni ju është në kundërshtim me publikun dhe e sheh atë si të rrezikshëm. Prandaj edhe i fsheh kontratat nga ai. E kjo mënyrë e sjelljes së qeveritarëve dhe qeverisë na e pamundëson Republikën. Prandaj edhe nuk duhet ta pranojmë. Ne e kemi zbuluar kontratën dhe me këtë rast i ftoj të gjithë deputetët që janë të interesuar ta marrin një kopje....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, Visar!

Për fjalë është lajmëruar edhe deputetja Donika Kadaj - Bujupi, në emër të Grupit.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Në emër të Grupit, kryetar, faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të gjithë ata që vinë sot në këtë parlament nga komunat. si Drenasi, Skenderaj, Malisheva, Istogu, Deçani, Gjakova edhe komunat tjera anembanë Kosovës, e dinë që në dy javët e fundit e kanë përjetuar edhe një herë periudhën e territ apo reduktimet e stërzgjatura në mungesë të rrymës. Dhe, të gjithëve, pa përjashtim na është kujtuar ai premtimi i madh i kryeministrit Thaçi i vitit 2007, domethënë 4 vjet më parë ku ai vetë thotë: Kosova brenda vitit të parë të qeverisjes Thaçi do të ketë rrymë 24 orë. 4 vjet, pas këtij premtimi një nga ministrat e Thaçit del dhe e demanton shefin, duke deklaruar se rrymë do të kemi në vitin 2017, sepse do të ndërtohet deri atëherë Termocentrali Kosova e Re. Prej vitit 2007 deri në vitin 2017 janë dhjet vjet apo një dekadë e tërë.

Të nderuar kolegë,

Në vitin 2007 projekti i Termocentralit Kosova e Re si prioritet për Qeverinë asi kohe i hartuar me planin strategjik zhvillimor të kryeministrit Haradinaj ka qenë para tenderimit, i gatshëm me të gjitha parakushtet dhe standardet që Kosovën do ta poziciononin si faktor energjetik në rajon dhe dihet se çfarë përfitime do të kishim edhe në fushën apo në lëmin politik.

Ardhja e Hashim Thaçit, kryeministër, mungesa e vizionit nga ana e tij, mungesa e strategjisë zhvillimore për vendin, ka bërë që sot, kur projekti do të duhej të ishte në fazën e përfundimit, Qeveria e tij deklaroi se s'ka asgjë nga ky projekt deri në vitin 2017. Çka ka humbur Kosova gjatë kësaj kohe? Vonesa e këtij projekti ka bërë që Kosova të humbë mbi një miliardë euro nga buxheti i saj shumë i varfër. Nga xhepat e qytetarëve të Kosovës janë marrë para për import të energjisë elektrike e cila në shumtën e rasteve është bërë përmes Serbisë. Kosova ka humbur mundësinë e gjenerimit të mijërave vendeve të reja të punës. Vonesa ka degraduar dhe devalorizuar resurset natyrore të Kosovës. Janë tërhequr investitorë serioz dhe kompanitë e vendeve të fuqishme siç janë: Gjermania, Anglia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe sot janë parakualifikuar 4 kompani, njëra e cila vjen nga India. Nuk është se kemi diçka kundër shtetit, mirëpo pikërisht ky shtet nuk e ka njohur ekzistencën e Republikës së Kosovës. Prandaj, po jepet përparësi në raport me vendet të cilat e kanë përkrahur, e kanë mbështetur dhe vazhdojnë ta mbështesin zhvillimin e Republikës së Kosovës, do të thotë, të punosh në dëm të vendit dhe në dëm të vetvetes, ose më mirë të themi se Qeveria Thaçi punon në dëm të shtetit dhe për vetveten.

Projekti sot, siç thotë Qeveria e rikonstruktuar, parasheh që Kosova B, domethënë infrastruktura ekzistuese energjetike t'i japim investitorët në pako me projektin e ri, dhe kjo, të nderuar, do të krijojë monopol energjetik në duart e një investitori privat.

Qeveria po heq dorë edhe nga resurset natyrore të vendit, sepse është aksionare vetëm në 25% të aksioneve, e kjo në praktikë do t'i ketë pasojat si në vijim. Qytetarët e Kosovës do të paguajnë rrymë të shtrenjtë, do të prodhohet dhe eksploatohet pasuria e vendit sipas nevojave të kompanisë dhe jo të Kosovës me ç'rast do të fitojë investitori dhe jo ekonomia e vendit.

Nga injoranca e kësaj Qeverie dhe lufta që me çdo kusht të fitojnë pushtetarët e ka sjellë gjendjen në këtë shkallë, ku shfrytëzohen pasuritë e Kosovës, përfiton Qeveri dhe investitori, ndërsa Kosova dhe qytetarët e saj mbesin në terr, në pluhur dhe të varfër.

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Po bëhen 12 vjet prej përfundimit të luftës çlirimtare dhe prej se Kosova është e lirë, duke qenë se jemi përcaktuar për krijimin e një shteti mbi baza ligjore, etike, humane, të ndërtuar në principe të ligjshmërisë dhe drejtësisë, dua ta ngre një shqetësim të shumë qytetarëve të atyre që dhanë më së shumti për lirinë e këtij vendi, familjet e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve e UÇK-së, të familjeve e të vrarëve, të invalidëve civilë të luftës, të familjet e të zhdukurve, statusi i të cilëve ende nuk është zgjidhur me ligj.

Edhe në këtë legjislaturë të katërt ka filluar të na rrëmbej rutina, andaj duhet ta tërheq vëmendjen tuaj, të nderuar deputetë, se ne sot ndodhemi këtu, në këto ulëse të Parlamentit, falë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe sakrificës së popullit tonë për liri, dhe ende nuk e kemi miratuar Ligjin për statusin, të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Për mua është e pakuptueshme se si ky ligj për vlerat e luftës sillen nga zyrat e Qeverisë në zyre të Kuvendit që nga legjislatura e parë dhe anasjelltas, herë këndeje e herë andej dhe ende nuk ka marrë zgjidhjen e duhur dhe përfundimtare. Për veten time konsideroj që çështja e parë që na takon të zgjidhim është të miratojmë Ligjin për vlerat e Luftës të UÇK-së. Një gjë e tillë është e domosdoshme jo vetëm për të zgjidhur statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve të UÇK-së, familjet e të vrarëve, të zhdukurve në luftën e fundit, por edhe për faktin se këto vlera kanë filluar barbarisht të goditen nga qasjet e caktuara antishqiptare si nga jashtë Kosovës, rasti i shpifjes të Dick Martit, por edhe nga individë dhe medime të caktuara edhe për brenda Kosovës, disa mini Dick Martave, të cilët po shkelin mbi sakrificën e popullit për përfituar materialisht dhe politikisht. Mijëra familje të të vrarëve, të zhdukurve, invalidë të luftës, veteran, invalidë të UÇK-së, familje të dëshmorëve i kanë sytë të drejtuar nga ne dhe presin zgjidhje ligjore.

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Dua të tërheq vëmendjen tuaj se është mirë që në kohë më të shkurtër të na vijë në Parlament për miratim Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, ngase asnjëri prej nesh nuk do ta ndjenin veten mirë derisa ky ligj të mos miratohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Sali Asllanaj.

SALI ASLLANAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Më lejoni që në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës të ngre çështjen e sportit në Kosovë. Që në fillim po konstatoj që është e vështirë të thuash diçka të re për gjendjen e sportit në Kosovë. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se është në gjendje tepër të rëndë. Të gjithë do të dëshironim që ajo të përmirësojë, por në anën tjetër sikur të gjithë strukturat stagnojnë që kjo gjendje të përmirësohet.

Unë kisha dashur se qeveria aktuale ta marrë seriozisht këtë problematikë të sportit, ta rishqyrtojë qasjen plotësisht, si nga ana e ndryshimit të Ligjit për sportin, ashtu edhe nga ana e kryerjes së obligimeve ligjore që i ka edhe në ligjin aktual për sportin ku në nenin 65.1 thuhet se bazën e financimit të sportit dhe nevojave publike kombëtare i bën buxheti i Kosovës. Rishkrimi i ligjit duket se është i domosdo më së shumti për faktin që tash gjen metoda tjera të financimit të organizatave sportive e me këtë edhe të sportistëve duke krijuar lehtësi tatimore për biznese të cilat sponsorizojnë sporte dhe me këtë do të kontribuojnë që krahas pasionit që kanë për sportin, do të jenë shumë më të motivuar që sportin ta ngrehin në një nivel më lartë dhe ta bëjnë konkurrentë me sportin ndërkombëtarë.

Ligji i ri do të duhej që në mënyrë të qartë të caktonte mënyrën e mbështetjes së sportistëve kulminant si dhe kriteret e përcaktuara qartë se kush mund të ketë shkallën e një sportisti me rezultate botërore, kush evropiane dhe ata me rezultate kombëtare, sepse aktualisht këtë do të duhej ta përcaktojë një ekip profesional, i caktuar nga ministri, për të cilin nuk kam njohuri se çka ka bërë, sa sportistë kemi të kategorive të ndryshme dhe cilat me stimulime i kanë marrë nga Ministria. Pra, kërkoj që të gjitha kriteret të jenë të përcaktuara me ligj dhe koeficient i stimulimit të jetë një standard permanent i cili nuk do të varej nga ndryshimet qeveritare dhe nga vullneti i ministrave përkatës, për caktimin e komisioneve eventuale.

Krahas gjetjes së mundësive ligjore për stimulimin e sportistëve në përgjithësi, kurse atyre kulminant në veçanti, mendoj se edhe përkujdesja e veteranëve të sportit, ata të cilët një kohë të gjatë kanë bërë që ne të mburremi me ta, do të duhej të marrë një zgjidhje ligjore meritore, që ka kuptimin e një mbështetje materiale të formës së pensioneve meritore për sportist kulminant, është trishtuese kur sot shoh shumë njerëz me të cilët është krenuar Kosova në lëmin e sportit të jenë në një gjendje të rëndë sociale dhe të pashpresë se dikush po brengoset për ta.

Aspekti tjetër i kësaj mbështetje do të ishte ai mesazhi që do t'i shkonte atyre që sot merren me sport se shteti i tyre do t'i trajtojë drejt dhe do t'i kenë motiv shtesë për rezultate edhe më të mira.

Qeveria e Kosovës do të duhej të vazhdonte me përmirësimin e infrastrukturës sportive në Kosovë duke ndërtuar fusha dhe terrene me standarde ndërkombëtare, sepse ato janë një ndër

parakushtet për cilësi më të mira në sport. Është absurd kur edhe sot në tërë Kosovën nuk kemi stadium futbollit i cili plotëson kriteret e UEFA-s apo të FIFA-s, dhe ndodhin paradokse të tilla si një ndeshje e kombëtares së Shqipërisë e cila do të duhej të luaj në Prishtinë, vihet në pikëpyetje për shkak të stadiumit të qytetit në Prishtinë, i cili nuk i plotëson ato kushte.

Me këtë rast kisha dashur ta lus Qeverinë e Kosovës, komunën e Prishtinës që së bashku të bëjnë krejt çka është e mundur që të mos dështojë ajo ide dhe Kosova së paku të ketë një stadium cilësor, sepse edhe ai edhe ashtu do t'u duhej futbollistëve të Prishtinës dhe kombëtares nëse pretendojnë që të integrohemi në asociacionet ndërkombëtare sportive. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Siç u pa dje përfundoi rrethi i katërt dyditor i negociatave mes delegacionit të Kosovës dhe atij të Serbisë. Për shkak të jo transparencës së Qeverisë për këto negociata ato ende po zhvillohen larg syrit të qytetarëve e bile edhe shumë nga ne këtu po mund të informohemi vetëm nga mediat.

Negociatat po vazhdojnë të mbahen edhe përkundër ardhjes së Stefanoviqit në Kosovë, prej nga ku ai tha se ka ardhur në Kosovë që ta mbrojë Kushtetutën e Serbisë, duke iu referuar nenit që e definon Kosovën si pjesë të Serbisë. Këto qëndrime dhe pretendime pushtuese e nxitën revoltën e arsyeshme të qytetarëve të Kosovës në ditën e vizitës së Stefanoviqit, kurse Qeveria i përdori institucionet tona shtetërore si skenë për performansën antishqiptare të zyrtarit të Serbisë. Në anën tjetër policia u përdor për rrahjen e qytetarëve shqiptarë dhe në mbrojtje të Borisllav Stefanoviqit.

Këto negociata u mbajtën po ashtu ditën që zëvendëskryeministri i Serbisë, Ivica Daçiç nga SPS-i i Millosheviqit deklaroi se strategjia e shtetit serb duhet të jetë ndarja e Kosovës. Zëvendëskryeministri Kuçi deklaroi se Serbia nuk ka ndryshuar nga ajo e Millosheviqit, por ishte po ai që i priti në Qeveri përfaqësuesit e kësaj Serbie të Millosheviqit. Kësaj i thonë dyfytirësi.

Në këto negociata që përfunduan dje, u fol për: të pagjeturit, trashëgiminë kulturore, lirinë e lëvizjes, tregtinë, komunikacionin dhe njohjen e diplomave të Republikës së Kosovës.

Sa i përket të pagjeturve, Qeveria e Kosovës ka negociuar me Serbinë për 11 vjet, por ata nuk janë kthyer me negociata. Të pagjeturit nuk janë kompromis për kthimin e të cilëve ne duhet t'i japim Serbisë diçka. Të pagjeturit janë krimi i Serbisë. Për këtë krim ajo duhet të jep llogari dhe të kushtëzohet. Fakti që Qeveria e Kosovës po i negocion të pagjeturit do të thotë që ajo po i trajton ata si kompromis.

Sa i përket trashëgimisë kulturore, siç dihet Qeveria fillimisht në negociatat e Vjenës pat ofruar vetëm një zonë eksterritoriale, Beogradi i kërkoi 40, kurse plani i Ahtisarit i dha 45 e me këto u pajtua edhe Grupi i Unitetit edhe Qeveria e atëhershme. Ajo që është trashëgimi historiko-kulturore e popullit të Kosovës iu dhurua Kishës Ortodokse Serbe, me seli në Beograd. Pastaj vetë fakti që Qeveria po i negocion madje edhe eksponatet e vjedhura kulturore nga Beogradi, tregon se tash Qeveria e Kosovës po negocion duke e pasur për pozicion Planin e Ahtisarit, sepse

edhe vetë plani i Ahtisarit thotë që eksponatet e plaçkitura duhet të kthehen. Pra, Qeveria jo vetëm që moti është larguar nga vullneti i popullit, por tash po e negocion edhe vetë kompromisin, pra planin e Ahtisarit. Ajo që është e obligueshme për Serbinë, Qeveria jonë po e bën të negociueshme me të....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Afërdita Berisha – Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA – SHAQIRI: I nderuar kryetar,

Zoti kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Si deputete e komunës së Sharrit dëshiroj të shprehë një shqetësim të qytetarëve të kësaj komune, lidhur me arrestimin e 6 zyrtarëve të komunës së Prishtinës në mesin e tyre edhe një qytetar nga komuna e Sharrit zotit Halil Fejziut, për dyshimet siç thuhet shpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit. Duke pasur besimin e plotë në pafajësinë dhe në pastërtinë e tij.

Qytetarët e komunës së Sharrit presin nga organet e drejtësisë që sa më parë të zbardhet kjo e vërtetë lidhur me këtë rast dhe këta zyrtarë të kthehen në familjet e tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Veç Kuvendin mos e shndërroni në organ që ndanë drejtësinë. Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit!

I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Javën që shkoi e po ashtu edhe një javë para saj, i shtrova një pyetje kryeministrit në lidhje me autostradën - Cila është vlera e saktë monetare e kontratës së lidhur mes Qeverisë së Kosovës dhe konzorciumit Bechtel& Enka. Pyetja nuk erdhi si pasojë e ndonjë kurioziteti personal, por sepse është thelbësore që qytetarët e këtij vendi të dinë se ku shkojnë paratë që ata paguajnë dhe ja kanë besuar kësaj Qeveria për t'i menaxhuar.

E drejta për tu informuar është nga ato kategori që është zhvilluar në vendet më demokratike të cilët gjithnjë më shumë përfshin qytetarin në vendimmarrje, qoftë nëpërmjet dhënies së informacionit, diskutimeve publike, debateve të gjëra e deri tek forma më demoraktike dhe më legjitime që është referendumi.

Mungesa e informacionit për këtë kontratë, që prej se është nënshkruar, e shndërroi një pyetje që do të duhej të ishte e thjeshtë, në një pyetje një milionë dollarësh ose për të qenë krejtësisht e saktë në një pyetje qindra milionë dollarësh. Mungesa e transparencës rriti në mënyrë të ndjeshme dyshimet për korrupsion, ndërsa përgjigja që morëm këtu vetëm sa e shtoi mjegullën për kontratën pa na treguar nëse në shumën prej rreth 700 milionë eurosh bënte pjesë edhe zbritja prej 350 milionë eurosh me të cilën u justifikua ndërrimi i drejtimit nga do të kalonte autostrada. Një ministër u hodh dhe tha, por kur Lëvizja “Vetëvendosja” publikoi kontratën e famshme, reagimi i Qeverisë ishte sa nervoz aq edhe infantil. Një ministër u hodh e tha se ishte një sulm ndaj institucioneve, e një tjetër duke nxituar të manipulojë publikun sërish tha se askush nuk ishte kujtuar deri tani për ta kërkuar kontratën, se përndryshe do t’ia kishin dhënë. Por,

kryeargumenti i këtyre reagimeve vazhdon të mbetet akuza se ne jemi kundër Rugës së Kombit, merreni me mend. Singerisht, spindoktorët në të cilët mbështetet kryeministri, janë për të ardhur keq. A ka njeri në Kosovë, me inteligjencë mesatare që i beson këto gjëra, se ne që kërkojmë informacion të dimë koston e autostradës jemi kundër saj? Po të ishte punë dëshirash dhe patriotizmi Kosovën sot do ta bënim si Nju Jorku .

Pra, është koha që publiku të kursehet nga këto marrëzira dhe në vend të tyre të respektohet e drejta e tij për t’u informuar. Vetë mbërritja jonë te kjo kontratë e cila vazhdon të trajtohet si një dokument tepër sekret edhe pse nuk ka asnjë institucion që e ka shpallur të tillë deri tani, është produkt i vetëdijesimit të qytetarëve, njerëz të tillë anonim që kryejnë shërbime të tilla për vendin janë patriotët e vërtetë të kohës sonë dhe duhet t’i çmojmë.

Unë dua t’ ju kujtoj se bërja publike e kontratës është vetëm një hap i vogël për të hedhur dritë në terrin e madh që ka përfshirë .....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Po i trajtoni disa tema që mund t’i kërkonit të trajtohen në debat, prandaj koha është harxhuar. Qeveria kohën e vet e ka.  
Urdhëro kryeministër e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit!

I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Fillimisht më lejoni që të përsëris se Qeveria e Republikës së Kosovës respekton plotësisht dhe ndihet shumë krenare për punën e mrekullueshme e cila është duke u bërë në fillimin dhe punën jashtëzakonisht intensive që po bëhet për përmbylljen e punimeve të autostradës Vërmicë – Merdare.

Gjithashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës plotësisht respekton kontratën me konzorciumin Bechtel&Enka, përfshirë edhe nenet përkatëse të kontratës që specifikon edhe konfidencialitetin dhe mbrojtjen e biznesit të kontraktuesit, në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare të papraktikuara ndonjëherë në historinë e Kosovës, në këtë fushë. Kjo tregon para së gjithash seriozitetin e Qeverisë si partner i sigurt me investitorët e huaj.

Gjithsesi cilado palë e interesuar ka pasur mundësi që të kërkojë qasje në dokumentin zyrtar. Sipas ligjeve në fuqi dhe institucionet kompetente e kanë theksuar se kontrata finale mund të shihet, të studiohet, por nuk mund të bëhen kopjet e saj për shkak të limitimeve të sipër cekura. Duhet theksuar se dokumenti i publikuar apo drafti që një nga draftet që janë negociuar gjatë procesit të arritjes së marrëveshjes për ndërtimin e autostradës Morinë – Merdare, nuk është versioni final i kontratës. Ajo që është i rëndësishme të thuhet është se projekti për ndërtimin e autostradës paraqet projektin më madhor në historinë e Kosovës, një investim strategjik për zhvillimin infrastrukturor dhe ekonomik të Republikës së Kosovës.

Është një projekt integruar që Kosovës dhe qytetarëve të saj do t’ u ofrojë mundësitë më të mira për qarkullimin e lirë të njerëzve dhe kapitalit.

Procesi i ndërtimit të autostradës ka qenë procesi më transparent i mundshëm, për të cilin ka pasur një konkurrencë të hapur dhe lojale ndërkombëtare, ku kanë konkurruar 7 kompani dhe konzerciume me remone globale dhe ku procesi i vlerësimit udhëhequr nga kompania Eurocheck, ka rezultuar me përzgjedhjen e konzerciumit Bechtel&Enka, si ofertuesi më i mirë, më i lirë dhe më i favorshëm për Kosovën.

Pas këtij procesi Qeveria e Republikës së Kosovës e ka negociuar kontratën finale me kontraktuesin e përzgjedhur gjatë një periudhe të gjatë dhe ka arritur të finalizojë një kontratë shumë të favorshme në interes të vendit dhe të qytetarëve, realizimi i së cilës është paraparë të bëhet nga kapacitetet financiare të Republikës së Kosovës, pa pasur nevojë për hyrje në obligime kreditore ndërkombëtare siç ndodh rëndom me zbatimin e kontratave të kësaj natyre kudo në rajon.

Duhet thënë se është e palogjikshme që të krahasohen kontratat e këtij niveli ndërkombëtar dhe është shumë naive dhe shumë jo profesionale të krahasohen këto kontrata ndërkombëtare, pra të nivelit ndërkombëtar me kontratat lokale të cilitdo shtet, përfshirë edhe Republikën e Kosovës. Pra, duhet bërë dallimin mes kontratave në nivel lokal dhe atyre të standardeve ndërkombëtare.

Dallimet janë evidente në të gjitha aspektet, qoftë në kapacitetet implementuese, standardet e kualitetit, përvojën profesionale të cilën mund ta shihni çdo ditë ju që udhëtoni apo të gjithë ne që udhëtojmë përgjatë rrugës që po ndërtohet, pastaj referencat e punëve të ngjashme, kohëzgjatjen e punimeve e kështu me radhë.

Autostrada Merdar – Morinë do të jetë autostradë e kualitetit më të lartë jo vetëm në Kosovë, por në gjithë rajonin e ndërtuar sipas standardeve Transeeuropean otorlejt. Përveç kësaj, kontrata me këtë konzercium është kontrata më e favorshme krahasuar me cilëndo kontratë të ngjashme në rajon dhe për këtë mund të ju ofrojmë shembuj të shumtë, për çka do t'ju ftoja në një debat të gjerë nëse dëshironi të diskutojmë sa i përket ndërtimit të autostradës. Po ashtu, transparencia financiare e projektit është e plotë dhe të gjitha shpenzimet deri në detajin më të vogël janë të përfshira në ligjet përkatëse për buxhetin, si dhe në raportet periodike për shpenzimet të cilat bëhen publike për të gjithë dhe po ashtu diskutohen edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Na vjen keq, dhe unë besoj çdo qytetari të Republikës së Kosovës, i vjen shumë keq, që janë bërë keqinterpretime të qëllimshme, me motive të ulëta politike, ose nga padituria e plotë dhe nga mungesa e përvojës për çështje të tilla, shembuj që janë marrë nga çmimet e njësive të caktuara nuk qëndrojnë, sepse ato nuk mund të interpretohen jashtë kontekstit të përgjithshëm të punimeve.

Pra, nuk mund të krahasohet vetëm një element i kostos me koston e përgjithshme. Një qasje e tillë krijon konfuzion të panevojshëm dhe flet për mungesë të ekspertizës nga ana e atyre që deklarojnë diçka të tillë. Edhe çështje tjera edhe çështje tjera pra që specifikohen në nene të veçanta të kontratës, nuk mund të interpretohen si të ndara nga kontrata e plotë e cila është e bazuar me standardet, pra të Federatës Ndërkombëtare të inxhinierëve konsultues, në të cilat bazohen të gjitha kontratat serioze për ndërtimet e nivelit superior ndërkombëtar dhe jo lokal.

Mund të konfirmoj, të nderuar deputetë, qytetarë të dashur të Republikës së

Kosovës, se qeveria e Republikës së Kosovës, do të vazhdojë të jetë krejtësisht transparente duke e respektuar të gjitha dispozitat kushtetuese dhe ligjore si dhe projektin e autostradës ashtu edhe për të gjitha projektet tjera kapitale të cilat janë në shërbim të zhvillimit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve tanë.

Unë nuk dëshiroj të hyj në detale, ju ftoj për debat kurdo që dëshironi si Parlament dhe ju inkurajoj sa i përket ndërtimit të autostradës tash për të hyrë në raport të krahasimit të çmimeve, sepse edhe krahasimi i çmimit të betonit është një absurd në vete,

është sikur të flitet për çmimin e mollës me dardhë, por nga ata që refuzuan apo kundërshtuan marrëveshjen e lirisë së Kosovës në Rambuje, nga ata që refuzonin dokumentin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës që thoshin që nuk do të vijë pavarësia, por që erdhi dhe që e shpallëm po në këtë Kuvend, nga ata që e sollën gjuhën e ulët të rrugës në Parlament dhe gjuhën e kërcënimit dhe të dhunës në Parlament e instaluan, nga ata që ushtrojnë dhunë çdo ditë ndaj institucioneve legjitime të vendit, pra, nuk duhet pritet diçka tjetër, autostrada do të vazhdojë punimet, individët e paudhë politikë të Kosovës do të dështojnë, por do ta kenë kënaqësinë për të udhëtuar në mënyrë shumë komode si në të gjitha autostradat e botës. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë.

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Në pajtim me nenin 45.1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrajnë më së shumti 2 pyetje parlamentare.

Po fillojmë me pyetjen e parë dhe pastaj edhe të dytën. Deputetja Donika Kadaj-Bujupi dhe deputetja Teuta Haxhiu kanë bërë pyetje për zëvendëskryeministrin Behxhet Pacolli dhe përgjigje kanë marrë me shkrim. A doni t'i lexoni pyetjet?.

Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Me që pyetja ime është bërë para dy jave dhe javën e kaluar kamë marrë një përgjigje që sot do të jetë zëvendëskryeministri, shpresoj që të mos ngatërrohet në punët me ministrin e Jashtëm e të mos na sjellin asnjë njohje. Pyetja ime është kështu: “Ju zoti Pacolli keni thënë po që se vij në pushtet, do të ndikoni në uljen e numrit të ministrive në 8 shosh”. A keni ndryshuar bindjen në lidhje me formën e qeverisjes në Kosovë, a ndieni keq tani kur ju si forcë politike po ndikoni në rritjen enorme të ministrive, rritje e cila nuk është në asnjë shtet të rajonit: në 19 ministri, në 6 zëvendëskryeministra që shpresoj të paktën vetë i dinë detyrat çfarë i kanë, në rreth 30 zëvendësministra, në rreth 120 këshilltarë. Dhe, për t’ia rikujtuar përgjigjes me shkrim që kam marrë sot para pakë kohësh që zoti Pacolli se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, nuk është kundër themelimit të Ministrisë të Diasporës, sepse mbi të gjitha ka qenë dhe është në vizionin e Aleancës dhe më vjen mirë që kanë marrë diçka nga vizioni i Aleancës, por jemi kundër pazareve politike që buxhetit të varfër të Kosovës i kushtojnë shumë. Vetëm për paga ju lutem janë rreth 2 milionë euro, mos të flasim për shpenzime tjera.

Dhe, krejt në fund, para neve si deputetë janë të planifikuar në këtë sallë 21 ulëse dhe unë bëj një pyetje. Po që se një ditë gjithë Kabineti qeveritar, sepse është shumë e udhës të jetë prezentë, a thua ku do të ulen, janë 21 ulëse dhe janë rreth 30 këshilltarë? Faleminderit!

KRYETARI: Këshilltarët nuk vijnë në seancë.

Deputete Donika Kadaj- Bujupi, nuk do ta lexojë pyetjen. Faleminderit!

Vazhdojmë, deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Ferid Agani. Deputete, e ke fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Në seancën e kaluar unë pata pyetjen për ministrin e Shëndetësisë për barërat pa afat. Dihet se në Kosovë ekziston një sasi e madhe e barërave me afat të skaduar, prandaj pyetja ishte: “A ka planifikuar konkretisht diçka në grumbullimin e barërave me afat të skaduar dhe në asgjësimin e tyre”? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër Agani, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

E nderuar deputete,

Faleminderit, për këtë pyetje!

Është një çështje e cila ka rënduar këtë ministri me vite të tëra, daton që nga viti 2002. Problemet vetëm janë akumuluar nëpër vite edhe nuk kanë pasur zgjidhje konkrete. Për të mos hyrë në mënyrë detaje t’i elaboroj shkaqet që kanë sjellë deri në këtë situatë, po parashtoj vetëm atë që ne kemi bërë në këtë periudhë të mandatit tim qeveritar.

Deri më tani prej qindra tonëve të produkteve farmaceutike dhe materialit sanitar janë shkatërruar rreth 90 tonë material sanitarë këto janë asgjësuar, ndërsa jemi në procesin e elaborimit të një plani të përbashkët me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për asgjësimin e tërë sasisë së produkteve farmaceutike që kanë mbetur.

Asgjësimi i produkteve farmaceutike është mjaft problematik, kërkon standarde të larta, sepse ka të bëjë drejtpërdrejt me ndotjen e mjedisit, mundësinë për ndotjen serioze të mjedisit dhe duhet zbatuar në bazë të standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Ministria e Shëndetësisë e ka aktin nënligjor i cili i ka të inkorporuar këto standarde, punojnë në bazë të tyre. Këto ditë, deri në fund të këtij muaji, do ta shprehim interesimin publik për kompanitë e interesuara të marrin pjesë në këtë proces.

Dhe, unë po ashtu jam i bindur se brenda këtyre 2 javëve të tashme do ta nënshkruajmë marrëveshjen edhe me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, që në mënyrë të përbashkët t’i qasemi donatorëve të mundshëm për sigurimin e mjeteve të nevojshme për të realizuar këtë qëllim. Sipas planit të punës këto produkte farmaceutike dhe materiali sanitar ishte dashur që të eliminohen nga depoja në Mazgit, në muajt e parë të vjeshtës, pra në muajin shtatorë ose tetor varësisht prej dinamikave të tenderimit të cilat janë të domosdoshëm për

procesin e seleksionimit të kompanisë e cila duhet të bëjë për zhdukjen e këtij materiali. Faleminderit!

KRYETARI: A ke pyetje shtesë, deputete?

Faleminderit! Vazhdojmë.

Deputetja, Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ferid Agani.

Deputete, e ke fjalën.

TIME KADRIJAJ: Zoti kryetar,

Unë pyetjen e kam bërë javën e kaluar, ministri nëse ka ndonjë përgjigje ka qenë rasti për spitalin privat që është afër Qendrës Klinike Universitare.

MINISTRI FERID AGANI: Po faleminderit, edhe për këtë pyetje!

Unë javën e kaluar isha jashtë vendit dhe nuk pata mundësi që menjëherë t'iu përgjigjem. Kjo është një çështje e cila po ashtu e ka një histori të saj shumëvjeçare. Pra, ndërtimi i të ashtuquajturës Qendrës Kardiale të Kosovës, ka filluar në periudhën kur në Kosovë nuk ka pasur fare shërbime kardiokirurgjie, dhe është arsyetuar në mënyra të ndryshme dhe nevoja për këtë lloj të institucionit shëndetësor ka qenë shumë e madhe. Tërë procedura është përcjell me mospajtime në nivelin komunal dhe qeveritar. Por, ajo që është tash me rëndësi është të thuhet se ndërtimi i këtij objekti ka filluar në bazë të një leje ndërtimore të lëshuar nga komuna e Prishtinës, e cila është valide dhe për të cilën edhe Qeveria e Kosovës, pas procedurave të zbatuara në të e ka dhënë miratimin dhe aty që unë si ministër i Shëndetësisë mund të them tash përkitazi me këtë qendër është se ajo do të bëhet subjekt i interesimit tim si prioritet në momentin kur të aplikojë për licencim si institucion shëndetësor, pra kur të shihet se me çka do të aplikojë, për çfarë shërbime konkrete mjekësore, a janë plotësuar standardet e nevojshme apo jo? Dhe, me këtë rast dua të theksoj kështu para Kuvendit të Kosovës se definitivisht gjithmonë duhet pasur parasysh se ai objekt është ndërtuar në tokë publike dhe se përgjegjësia për këtë objekt është po ashtu shoqërore e jo ekskluzivisht private, dhe se nuk flasim për një pronësi ekskluzivisht private në këtë situatë dhe do të mundohem që zgjidhja përfundimtare, pjesë e së cilës do të jetë edhe licencimi i këtij objekti, të jetë në kuadër të një partneriteti publiko-privat, pra ta provojmë ta sjellim tërë këtë situatë brenda kornizave ligjore të cilat e mundësojnë një bashkëpunim ndërmjet investitorit privat dhe institucioneve publike. Dhe, pas skadimit të kontratës të cilën ky institucion e ka me komunën e Prishtinës për qiradhënie, këtë objekt ta kthejnë në pronësinë e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, aty ku edhe e ka vendin. Pra, ky është synim politik imi si ministër i Shëndetësisë, si do të zhvillohen proceset e ardhshme ne do t'i shohim. Por, mendoj se një objekt i tillë brenda hapësirës së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës nuk mund të jetojë dhe të ekzistojë si një institucion i veçantë dhe izoluar nga tërësia e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë?

Regjia fjalën deputetes Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti ministër!

Fjala është se është bërë një shkelje ligjore e udhëzimit administrativ 08/2007 edhe në të gjitha çështjet që ju po deklarohej ju thirrreni në atë se e keni trashëguar gjendjen edhe të barërave, edhe citostatikëve edhe tash shkeljet ligjore. Atëherë edhe sa kohë do të ju duhet që ju të merreni me problemet e akumuluar dhe kur do të filloni që të merreni me probleme prioritare që i keni thanë vetë? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, a ke përgjigje?

MINISTRI FERID AGANI: Unë kam filluar të merrem me prioritetet që nga dita e parë e punës, realiteti nuk mund të mohohet, realiteti është tash ai i cili është, dhe natyrisht se në qoftë se dikush tenton që ta zbkurojë atëherë nuk është në rrugë të drejtë për t'i zgjidhur ato probleme.

Konkretisht po e përmend udhëzimin i cili e ndalon që pranë një institucioni publik shëndetësor të funksionojë një institucion privat në diametrin prej 1.5 kilometra, në distancën prej 1.5 kilometra.

Unë po ju garantoj që në momentin kur ky institucion shëndetësor të aplikojë për licencim, licencimi i tij do të bëhet në pajtimin me legjislacionin që do të jetë në fuqi në momentin kur ky aplikim të ndodhë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Lutfi Haziri, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj, deputeti s'është këtu. Deputeti Arsim Bajrami, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar. Deputet, e ke fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Pyetja ime adresohet në një projekt shumë të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës, projekt që është miratuar në vitin 2008, projekti i qeverisjes elektronike që është parë si një rrugë shumë e mirë e modernizimit të administratës dhe ofrimit të shërbimeve sa më profesionale, sa më të lira dhe sa më të shpejta. Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar përpos kësaj strategjie dhe planin e veprimit dhe pyetja ime ju adresohet juve që të na informoni se si po shkon ky projekt, cilat janë të arriturat, cilat janë sfidat dhe cilat janë planet, në mënyrë që administrata jonë publike të bëhet e pajtueshme dhe e krahasueshme me administratën publike të vendeve të Bashkimit Evropian?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministra dhe ministra,

I nderuar deputet zoti Bajrami,

Duke falënderuar për pyetjen dëshiroj t'ju informoj se Ministria e Administratës Publike, bazuar në objektivat e Qeverisë së Republikës së Kosovës për avancimin dhe modernizimin të administratës publike në institucionet e Republikës së Kosovës, rëndësi e veçantë i ka kushtuar qeverisjes elektronike. Me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve fokusim kryesor i Ministrisë së Administratës Publike është realizimi i projekteve të përfshira në planin e veprimit.

Duke shfrytëzuar kapacitete qeverisjes elektronike është arritur ngritja e cilësisë së shërbimeve në tri fusha kryesor: zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit shtetëror, i cili mbulon tërë territorin e Republikës së Kosovës e që është parakusht bazë për realizimin dhe funksionalizimin e shërbimeve të qeverisjes.

Qendra e të dhënave e cila mundëson grumbullimin ose centralizimin e të dhënave elektronike të gjithë institucioneve të Republikës së Kosovës. Qendra e të dhënave është ndërtuar në dy lokacione në atë primare dhe sekondare. Elementi më me rëndësi është realizimi i projekteve përmes së cilave ofrohen shërbime në tri fushat kryesore të qeverisjes elektronike, shërbimet për qeverinë, shërbimet për qytetarët dhe shërbimet për biznese.

Në fushën e shërbimeve për Qeverinë janë realizuar si ristrukturimi i domenit qeveritar, sistemi për monitorimin dhe siguri të dhënave si pasuria, arkiva dhe menaxhimi i projekteve.

Sistemi i menaxhimit të shpenzimeve të automjeteve, sistemi i vijueshmërisë në punë, sistemi telefonik qeveritar, sistemi i video konferencave, aplikacion për Policinë e Kosovës, sistemi i regjistrimit të automjeteve e shkollat.

Në fushën për shërbimet e qytetarët janë realizuar si shërbime gjendja civile dhe sistemi i aplikimit online për patentë shoferë.

Në fushën e shërbimit të biznesit janë realizuar regjistrimi dhe licencimi i bizneseve.

Në të gjitha këto që i përmenda më lartë mund të themi se portali qeveritar është porta kryesore për hyrje në aplikacione dhe shërbimet elektronike. Sigurisht ekzistojnë edhe sfidat si mjetet e kufizuara buxhetore, pa marrë parasysh për këtë vit ekziston një buxhet 3 milionë afër 3 milionë. Resurset profesionale njerëzore për përdorimin e teknologjisë së informacionit, ngritja e kapaciteteve dhe trajnimet e nëpunësve civile, sistemi elektroenergjetik, por do të ishte mirë të krijohet edhe një kulturë, por edhe një aftësi edhe qytetarëve për aplikime përmes internetit.

Planet për të ardhmen janë: pritjet miratimi i kornizës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ministër!  
Deputet, ke pyetje shtesë?

ARSIM BAJRAMI: Në fakt nuk kam pyetje shtesë, por kam një koment shtesë të inkurajoj ministrin që të vazhdojë në implementimin e këtyre projekteve dhe të informojë sa më shumë opinionin për përparësitë që sjell aplikim onllaj. Dhe, çështja e dytë inkurajoj që të fillojë implementimin e projektit të prokurimit elektronik, sepse ky projekt është pjesë e strategjisë, në anën tjetër ne marrëveshjen që e kemi nënshkruar me Bankën Botërore dhe që ka ratifikuar Kuvendi është paraparë një donacion i madh, një donacion bukur i konsiderueshëm që do të mundësojë që Kosova sikur edhe vendet tjera të rajonit të fillojë me praktikumin e prokurimeve elektronike.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Pas ratifikimit të marrëveshjes me Bankën Botërore sigurisht do të jemi në kontakt edhe më shumë me Bankën Botërore për zhvillimin e projekteve si Qendra nacionale e të dhënave e prokurimi, sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore, por, gjithashtu jemi në bashkëpunim edhe me institutin ENA nga Franca por gjithashtu edhe me DIFI-tin, edhe besojmë që do të krijohet një shërbim ose një administratë publike moderne dhe bashkëkohore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Rita Hajzeraj, i ka dy pyetje, pasi ministri Hoxhaj nuk është, mund ta pyetni ministrin , zotin Ferid Agani.

RITA HAJZERAJ – BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Si deputete personalisht kam jashtëzakonisht konsiderata të larta për ju, megjithatë kemi detyrim për qytetarët e Kosovës t' ju bëjmë pyetje parlamentare. Ju keni premtuar se Ligji për sigurim shëndetësor do të vijë- shumë shpejtë për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pra, zoti ministër- a e keni gati Ligjin për sigurim shëndetësor dhe nëse po kur do të vijë? Dhe, a keni menduar që fondi për sigurime shëndetësore duhet të formohet para se të vijë Ligji për sigurim shëndetësor, apo e keni paraparë që ky fond të formohet pasi që të miratohet Ligji për sigurim shëndetësor?.

KRYETARI: Ministër.

MINISTRI FERID AGANI: Ju faleminderit, për këtë pyetje!

Projektligji për sigurime shëndetësore është gati. Unë kam premtuar se ai do të vijë në Qeveri deri më 1 qershor, ai është dorëzua në Qeveri në procedurë tash qeveritare qysh para dy dite. Është duke ju punuar deklarata financiare, Qeveria do të ngritë dhe grupi qeveritar tash për elaborimin e tij edhe një herë. Dhe unë mendoj që ky projektligj do të vijë në procedurë parlamentare me siguri në dy javët e parë të qershorit.

Kur është në pyetje Fondi i Sigurimeve Shëndetësore këtu dua të theksoj se edhe me vlerësimet e ekspertëve ndërkombëtar, Kosova për momentin fatkeqësisht nuk disponon me kapacitete teknike, profesionale për të themeluar menjëherë një fond të pavarur të sigurimeve shëndetësore, prandaj ne do të fillojmë ndërtimin e sistemit të sigurimeve publike shëndetësore nëpërmjet fuqizimit të Agjensionit të Sigurimeve Shëndetësore, brenda Ministrisë së Shëndetësisë në dy vjetët e para dhe më pastaj edhe nxjerrjen e këtij Agjencioni jashtë kontrollit politik dhe themelimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Kjo është një zgjidhje e cila nga ana e grupit të punës së Ministrisë së Shëndetësisë është parë si më e arsyeshme dhe mendoj se reflekton kapacitetet që i kemi dhe synimet të cilat i kemi përpara.

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë?

RITA HAJZERAJ – BEQAJ: Zoti ministër, a konsideroni që ky ligj për sigurime shëndetësore sipas vlerësimeve të mëhershme dhe të ekspertëve e kemi parë që arrin vlerën rreth 300 milionë euro, faktikisht, ndërsa kjo shumë është e papërballueshme. E në anën tjetër kur kemi raste jashtëzakonisht të mëdha që po vazhdojnë keqpërdorimet e buxhetit në Ministrinë e Shëndetësisë, e dimë që gjendja nuk është e mirë për momentin, por neve presim hapa konkret nga ju, sepse keqpërdoren do të thotë mjete jashtëzakonisht të mëdha nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë duke pasur parasysh që është një buxhet jashtëzakonisht i vogël për këtë resorë dhe neve kemi jashtë frikë të madhe që Ligji për sigurim shëndetësorë kur të vijë, po që se nuk është Fondi i gatshëm nuk mund të implementohet në tërësi.

KRYETARI: A ishte pyetje, a koment, apo të dyja nga pak?

Ministër, përgjigju.

MINISTRI FERID AGANI: Parakusht për sistemin e sigurimeve shëndetësore në esencë nuk është fondi, ne mund të gjejmë alternativë siç e kemi gjetur Agjencionin e Sigurimeve Shëndetësore në fazat e para, por është sistemi i informimit shëndetësor, i cili nuk ekziston në Kosovë. Ky është parakusht dhe këtë jemi duke punuar tash në veçanti. Unë pajtohem me ju plotësisht dhe e vetmja mënyrë për parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme në sistemin e sigurimeve publike shëndetësore nesër është mu ky sistem i informimit shëndetësor, sepse në qoftë se nuk ka përcjellje elektronike definitivisht mundësitë për keqpërdorime janë të mëdha.

Unë e dëgjova edhe në fillim të seancës, e dëgjova paraqitjen e deputetit Zemaj dhe po them jam i informuar për rastin dhe të jeni të bindur se në procedura të mëtutjeshme të legalizimit të atij tenderi, unë do të respektoj në tërësi ligjin dhe do të kërkoj sqarime, sepse ky tender është përfunduar në një procedurë ligjore, edhe me mendimin përfundimtar të organit të shqyrtimit të prokurimit publik dhe kërkon, do të thotë një ndërhyrje edhe mëtutjeshme. Jam shumë i ndjeshëm ndaj këtyre ndryshimeve, por natyrisht edhe fjalën e ligjit do ta respektojmë.

KRYETARI: faleminderit!

Deputeti Lutfi Haziri, nuk është këtu, ka pyetje për ministrin Blerand Stavileci. Dhe pyetja e fundit është, deputeti Arsim Bajrami, pyetje për ministren Vlora Çitaku.

Deputet e ke drejtën për pyetje, prit ministre pak, se deputeti e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryetar!

E nderuara zonja ministre, Vlora Çitaku,

Pyetja ime ndërlidhet me pritjet që ka Qeveria e Republikës së Kosovës për raportin e ardhshëm të progresit. Siç dihet në Raportin e progresit për vitin 2010 janë adresuar shumë sfida por ndër sfidat kryesore apo kriteret kryesore politike jo vetëm në Raportin e progresit për Kosovën, por për gjitha shtetet që janë në raporte kontraktuale me Bashkimin Evropian ka hyrë reforma e Administratës Publike, si një proces shumë i rëndësishëm i cili pretendon të sigurojë administratë profesionale dhe sistemin e qeverisjes së mirë. Ne kemi parë angazhimet shumë serioze të Qeverisë së Republikës së Kosovës në këto dy vjetët e fundi, jo vetëm në legjislacion i cili po thuaj se është i përmbyllur, por edhe në hapa shumë të rëndësishme. Pyetja ime ka të bëjë zonja ministre cilat janë pritjet e juaja duke pas parasysh edhe 2 – 3 muaj do të kemi një draft të Raportit të progresit, cilat janë pritjet e juaja si ministre e resorit në këtë fushë, si e vlerësoni progresin dhe a mendoni se raporti i ardhshëm i progresit do të jetë më mirë në këtë lëmi? Faleminderit!

KRYETARI: Ministre, e ke fjalën.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Faleminderit, shumë i nderuar zoti kryetar!

Ministria për Integrime Evropiane, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë një varg masash për t'i adresuar sfidat e ngritura në Raportin e progresit, në raport me reformën e administratës publike dhe ky angazhim i shumanshëm mund të kanalizohet në katër shtylla, në: harmonizimin e kornizës ligjore, kornizës strategjike, planifikimit strategjik dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale.

Në vitin 2010 janë miratuar ligjet kornizë për shërbimin civil, për pagat e shërbyesve civilë, për kontestet administrative dhe ai për administratën publike. Me qëllim të implementimit të legjislacionit, deri më tani është miratuar legjislacioni sekondar, si në vijim:

Rregullorja për procedurat e regrutimit,

- Rregullorja për përshkrimin e vendeve të punës,
- Rregullorja për orarin e punës,
- Rregullorja për përfaqësim të drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë në shërbimin civil të Republikës së Kosovës,
- Rregullorja për transferimin e nëpunësve civilë,
- Rregullorja për emërimin e nëpunësve civilë,
- Rregullorja për ndërprerjen, pezullimin dhe përfundimin e marrëdhënieve të punës në shërbimin civilë,
- Rregullorja për punë provuese,
- Rregullorja për dosjet mbi regjistrin qendror të nëpunësve civilë,
- Rregullorja për procedurat e emërimit në pozitat e larta drejtuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Për më tepër në drejtim të zbatimit të Ligjit për administratën publike, është miratuar Rregullorja për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së kryeministrit dhe ministrive tjera.

Ndërkohë në kuadër të Kornizës strategjike në shtator të vitit 2010 është miratuar strategjia e rishikuar për reformën e administratës publike, kurse po punohet intensivisht për finalizimin e planit të veprimit për këtë strategji.

Gjithashtu në planin e veprimit për partneritet evropian 2011 parashihet miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për menaxhimin e resurseve humane. Në anën tjetër si rezultat i përfundimit të rishikimit funksional, vertikal dhe horizontal, janë miratuar planet strategjike zhvillimore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Administratës Publike, Institutin Kosovar për Administratë Publike, Ministrisë së Infrastrukturës, ndërkohë që Ministria e Drejtësisë është në fazën finale të hartimit të një plani të tillë.

Për më tepër Instituti i Kosovës për Administratë Publike, ka miratuar Planin operacional të trajnimeve për vitin 2011, që tashmë është duke u implementuar.

Në periudhën e parë të vitit 2011, janë organizuar kurse trajnimi në fushën e prokurimit publik, administratës së përgjithshme, teknologjisë së informacionit si dhe çështje të integritetit evropian.

Në fondin e planifikimit strategjik gjatë vitit 2010 është themeluar dhe funksionalizuar Zyra për planifikim strategjik në ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, a ke pyetje shtesë?

ARSIM BAJRAMI: Zonjusha ministresh e përmend rishikimin funksional dhe përmend që ka filluar implementimi. A jeni ju si ministresh duke e mbikëqyr këtë proces, a keni vendosur afate për ministri tjera që të implementojnë gjetje të rishikimit funksional, sepse siç e dini rishikimi funksional është një pozicion jashtëzakonisht i vëzhguar nga Bashkimi Evropian dhe është një kërkesë për të implementuar këtë ekspertizë që ka autorizuar Qeveria.

KRYETARI: Ministre, mund ta vazhdosh.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Faleminderit, shumë zoti deputet!

Ne kemi kërkuar nga të gjitha ministratë e linjës që deri në afatin e fundit për dorëzimin e imputit në Komisionin Evropian, përkatësisht brenda muajit shtator të finalizohen të gjitha planet sektoriale për rishikimin e administratës publike.

KRYETARI: Kjo ishte edhe pyetja dhe përgjigja e fundit.

Por, konsideroj që deputetja Time Kadrijaj, pyetjen që ia ka drejtuar ministrit për ndërtimin e spitalit privat në pronë publike, nuk është për Kuvendin, ajo është për Prokurorinë e Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e tretë:

### **3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 6 maj 2011**

Të nderuar deputetë,

Pyes, a keni vërejte në procesverbalin e përmendur? Nuk ka. Atëherë konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 6 maj 2011.

Në sallë kemi 72 deputetë.

Pra, fillojmë me pikën e katër të rendit të ditës.

### **4. Shqyrtimi i Raportit financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010**

Qeveria e Republikës së Kosovës i ka paraqitur Kuvendit Raportin financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010. Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin e Financave, zoti Bedri Hamza, ta marrë fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë numër 03L-048 kam kënaqësinë e veçantë të paraqes Raportin financiar për buxhetin e vitit 2010.

Përveç të arriturave përmbajtjesore në strukturën e buxhetit të aprovuar në muajin dhjetor të vitit 2009, veçanta e këtij raporti është se prezanton performancën e pakontestueshme të institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës në fushën e menaxhimit të parasë të taksapaguesve kosovarë.

Në dhjetor të vitit 2009, Kuvendi i Kosovës aprovoi Ligjin nr. 03/L177 për ndarjet buxhetore të vitit 2010, si dhe në korrik të vitit 2010 rishikoi Ligjin nr. 03/L218 për ndarjet buxhetore.

Plani vjetor i pranive për vitin 2010 ka qenë 1.230.400.000 euro, plani vjetor i pagesave ka qenë 1.348.701.000 euro, duke i përfshirë të hyrat vetjake të bartura nga viti 2009, të cilat nuk janë planifikuar me Ligjin për ndarjet buxhetore.

Veçoritë kualitative të këtij raporti janë: ngritje substanciale në të hyra, tejkalim i planit të hyrave për disa kategori, ngritje kualitative në kategorinë e investimeve kapitale dhe ngritje simbolike të shpenzimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve përkundër zgjerimit të dukshëm të fushëveprimtarisë të institucioneve të reja.

Në vazhdim, të nderuar deputetë, më lejoni të paraqes një përmbledhje të raportit për t'i pasqyruar të dhënat në formë analitike dhe krahasuese për periudhën në fjalë.

Të hyrat. Të hyrat e grumbulluara gjatë vitit 2010 duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve kanë qenë një miliard 178 milionë e 589 mijë euro dhe paraqesin 95.8% të planit të përgjithshëm vjetor. Kjo tregon se realizimi ka qenë në nivel të planit vjetor, ndërsa kemi një rritje prej 2.8% krahasim me vitin paraprak, do të thotë me vitin 2009.

Të hyrat e mbledhura në kufij arrijnë në 59% të hyrave të përgjithshme dhe kapin shumën prej 700.657.000 euro apo 99.8% të planit vjetor për vitin 2010, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 10.3%.

Të hyrat e brendshme të mbledhura nga Administrata Tatimore e Kosovës arrin në 16% të hyrave të përgjithshme dhe janë në shumë prej 221.234.000 euro ose 2% më tepër se sa plani vjetor për vitin 2010 dhe në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një rritje prej 7.2%.

Të hyrat komunale në totalin e përgjithshëm të hyrave marrin pjesë me 4%, janë në shumë prej 52.028.375 euro, në krahasim me vitin paraprak kemi një rritje prej 7.7%.

Të hyrat vetjake të nivelit qendror janë në shumë prej 48.451.000 euro, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 63.4%.

Të hyrat jo tatimore qeveritare janë në shumë prej 47.412.000 euro.

Grandet për përkrahje të buxhetit të dhuruara nga Komisioni Evropian janë në shumë prej 30 milionë euro. Gjatë vitit 2010 është pranuar kësti i parë nga huaja e fondit Monetar Ndërkombëtar në shumë prej 22.093.000 euro.

Të hyrat e arketuara nga dividenda janë në shumë prej 85 milionë euro, nga këto 80 milionë euro janë nga PTK-ja dhe 5 milionë euro tjera janë nga Aeroporti.

Gjatë vitit 2010 kthimet nga të hyrat kanë qenë një milion e 272 mijë euro nga Doganat e Kosovës dhe 27.017.000 euro nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Të dalat. Të dalat gjatë vitit 2010 duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve si dhe fondet në mirëbesim kanë qenë 1.271.842.000 euro dhe paraqesin 94.3% të planit të përgjithshëm vjetor. Krahasuar me vitin paraprak shihet një rritje kualitative vjetore e të dalave prej 3.2%, kryesisht në kategorinë e investimeve kapitale në atë pjesën ku më së tepërmi përfitojnë taksapaguesit kosovarë dhe krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një ngritje prej 13.7%.

Shpenzimet nga kategoria e pagave dhe mëditjeve janë 311.497.000 euro ose 24% e të dalave të përgjithshme, ndërsa krahasuar me planin vjetor për këtë kategori ato janë realizuar në masën 98.6%.

Shpenzimet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë 162.635.000 euro ose 13% e të dalave të përgjithshme buxhetore dhe janë realizua në masën 90.4% të planit vjetorë.

Shpenzimet nga kategoria e shërbimeve komunale janë në shumë prej 19.515.000 euro, 2% të dalave të përgjithshme buxhetore, realizimi në raport me planin është 77.7%.

Subvencionet dhe transferet janë 252.679.000 euro ose 20% e të dalave të përgjithshme buxhetore plani është realizua 98.2%.

Shpenzimet kapitale janë në shumë prej 455.344.000 euro ose 36% e shpenzimeve të përgjithshme vjetore. Realizimi vjetor në krahasim me planin për këtë kategori është 90.6%, ndërsa krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, domethënë me vitin 2009 kemi një ngritje prej 13.7%. Nga buxheti i konsoliduar i Republikës së Kosovës janë bërë edhe disa pagesa tjera, siç janë:

- pagesa për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në institucionet financiare ndërkombëtare, kuota e përcaktuar për t'u paguar në Fondin Monetar Ndërkombëtar, që janë në shumë prej 168.907 euro, pagesa në emër të borxhit të Kosovë për Bankën Botërore, në shumë prej 10.082.000 euro. Kur jemi këtu, është me rëndësi të theksohet se në formë të donacionit për këtë qëllim direkt nga Qeveria Amerikane janë paguar 9.786.705 euro, nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, gjatë vitit 2010 janë bërë pagesa në emër të kredisë së dhënë KEK-ut, në shumë prej 60 milionë euro.

Grandet e përcaktuara të donatorëve. Fondi i përgjithshëm i grandeve të përcaktuarve të donatorëve për vitin 2010, duke përfshirë edhe bartjen nga viti 2009, është në shumë prej 28.297.000 euro. Nga ky fond, gjatë vitit 2010 janë shfrytëzuar 18.422.000 euro dhe 114.000 euro kemi pasur kthime të donacioneve. Gjendja e fondeve ë pashpenzuara nga grandet e përcaktuar të donatorëve më 31 dhjetor 2010, është 9.741.000 euro, të cilat fonde do të jenë bartur në vitin 2011.

Gjendja e fondeve me 31 dhjetor 2010. Gjendja e fondeve më 31 dhjetor 2010, është 290.838.000 euro. Nga kjo gjendje rrjedhin detyrimet, si në vijim:

- Fondi i donatorëve 9.741.000 euro,
- të hyrat vetanake 29.691.000 euro dhe
- fondet tjera në mirëbesim 7.295.000 euro.

Nga kjo shihet se gjendja e fondeve të buxhetit të Republikës së Kosovës, më 31 dhjetor 2010, e cila është e lirë për shpërndarje, është 244.112.000 euro.

Në fund, më lejoni të them se raporti është edhe një tregues lehtësisht i matshëm për suksesin e institucioneve të Republikës së Kosovës në këtë periudhë raportuese, si dhe një dëshmi e pakontestueshme për potencionet e tyre në rrugëtim të sforcimit të shteti të Kosovës dhe të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve tanë. Raporti i cili është tek ju, deputetë të nderuar, është i

punuar mbi bazën e obligimeve dhe kërkesave që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe mbi bazën e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit për raportim në bazë të parasë së gatshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputet,

I nderuar ministër i Financave,

Ministër Mujota

Unë do të flas në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Në bazë të nenit 46 të Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ministri i Financave përgatit dhe dorëzon në Kuvend për miratim një raport përfundimtar përmbledhës të buxhetit për vitin e kaluar fiskal dhe dy vitet paraprake fiskale.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 04. 05.2011, shqyrtoi raportin vjetor financiar të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010 dhe vlerësoi se i njëjti përmban obligimet ligjore për raportim që dalin nga neni 46 i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Ligji nr. 03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Në këtë raport, të hyrat dhe shpenzimet për vitin 2010, në Buxhetin e Republikës së Kosovës, janë paraqitur në mënyrë analitike, por edhe në mënyrë të përmbledhur të gjitha të hyrat dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike. Në fillim të raportit janë pasqyruar buxheti vjetor fillestar, buxheti në rishikim dhe buxheti përfundimtar. Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bazë të nenit 69.5 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 04. 05, shqyrtoi raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit që të miratojë raportin vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010, që Ministria e Financave, në raportet e ardhshme vjetore të prezantojë në përqindje strukturën dhe dinamikën e realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore.

Për të nxitur diskutime të lira që do të kontribuojnë në transparencën e shpenzimeve të parasë publike, Komisioni për Buxhet dhe Financa ia ka rekomanduar Kryesisë së Parlamentit që ta radhitë në këtë seancë që të diskutohet tani. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani, sipas Rregullores, përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, a është paraqitur dikush? Hasime Krasniqi.

HASIME KRASANIQI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Vërtet Raporti financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës është shqyrtuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe është përkrahur si rekomandim për Kuvend.

Po ashtu, ky raport është shqyrtuar edhe nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës lidhur me menaxhimin dhe realizimin e buxhetit për vitin 2010, i cili është përgatitur

me një performancë të mirë, ku janë paraqitur atë gjitha të dhënat e nevojshme, si ka qenë ndarja buxhetore, si është menaxhuar, ku është realizuar dhe, mbi të gjitha, duke treguar trendet e rritjes pozitive.

Raport i përpiluar është bazuar në standardet e raportimit dhe metodën e krahasimit, duke na ofruar të dhënat edhe për vitet paraprake. Në përgjithësi, raporti i përmbush të gjitha kriteret, me qenë se ofron shifra ku mund të bëhet vlerësimi i saktë si për të hyrat, po ashtu edhe për shpenzimet sipas njësive dhe organizatave buxhetore. Marrë në përthithësi, të hyrat për vitin fiskal të vitit 2010, janë realizuar 95.8% të të hyrave të përgjithshme vjetore të planifikuara dhe kemi një rritje vjetore të të hyrave prej 2.8% krahasuar me vitin paraprak. Në veçanti, të hyrat e grumbulluara nga tatimet kufitare janë dominuese, që ndikojnë në plotësimin e buxhetit të Kosovës, që krahasuar me vitin paraprak, kemi një ngritje prej 10.3% edhe përkundër mosfunksionimit të doganave në veri të Kosovës.

Po ashtu, edhe të hyrat nga tatimet e brendshme kemi një trend pozitiv të rritjes së të hyrave prej 7.2%, gjithashtu të hyrat vetanake të komunave, kemi trend të rritjes pozitive të të hyrave, ku për shembull vetëm në komunat më të mëdha kemi një rritje të të hyrave vetanake prej 7.7%.

Vlen të theksohet se Qeveria e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2010, ka treguar një performancë të mirë në të gjitha segmentet e veta, si në nivelin qendror, edhe në nivelin lokal, ku kemi një rritje të të hyrave, po ashtu edhe një mbikëqyrje më të lartë sa i përket realizimit të projekteve që janë zotuar komunat.

Shpenzimet gjatë vitit fiskal 2010, paraqesin 94.3% të planit të përgjithshëm vjetor. Krahasuar me vitin paraprak, shihet një rritje vjetore e shpenzimeve rreth 3.2%, ku sipas kategorive ekonomike, pjesa më e madhe e shpenzimeve ka të bëjë me ngritjen e pagave prej 17.8%, si dhe kemi një rritje të shpenzimeve kapitale prej 13.7%. Nga ky raport shihet qartë se Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2010, në projeksionet buxhetore prej vitit në vit ka shënuar një ngritje kualitative në kategorinë e investimeve kapitale, që është inkurajuese për një zhvillim më të mirë, i cili ndikon drejtpërsëdrejti në ngritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mirëqenien e tyre.

Të nderuar deputetë,

Me lejon që në fund të potencoj se ky Raport financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010 pasqyron realizimin e plotë të objektivave dhe të programeve të Qeverisë. Po ashtu, në bazë të të dhënave mund të flasim për një kualitet qeverisës që bazohet në planifikim të mirëfilltë, koordinim institucional dhe përgjegjësi në menaxhimin e parashë publike.

Duke u bazuar në angazhimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për përmirësimin e jetës së qytetarëve të republikës së Kosovës, ju ftoj që ta mbështetni këtë raport financiar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI:

I nderuari kryesues,

Të nderuar ministra

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju qytetarë të Kosovës,

Grupi Parlamentar i LDK-së ka shqyrtuar raportin financiar të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010. Ne sot kryesisht do të flasim me shifra, e ju qytetarë të dashur duhet të vlerësoni se a keni marrë shërbime për kostot e parave të taksave tuaja. Të hyrat totale për vitin 2010, kanë qenë 1.194.000.508 euro, por shpenzimet kanë qenë për 93 milionë euro më të mëdha, duke zvogëluar bilancin bankar për të njëjtin shumë.

Raporti nuk është shumë i kuptueshëm për ata që nuk janë pjesë e strukturave qeveritare. Kështu, për shembull, në pasqyrën e konsoliduar ku bëhet krahasimi i buxhetit me realizimin e buxhetit, në mesin e zërave si rroga dhe paga, mallra dhe shërbime, kemi edhe një zë ku thuhet - të tjera, e theksoj, për të tjera buxheti fillestar ka qenë 85 milionë, buxheti përfundimtar është 70.2 milionë dhe realizimi 70,2 milion. Në raport nuk ka kurrfarë shpjegimi se çka përfshinë kjo - të tjera.

Sa i përket strukturës së të hyrave nga administrata tatimore dhe doganat, struktura është alarmuese. 699.3 milionë euro apo 78.2% janë të hyra nga Doganat, duke vërtetuar edhe një herë se ne jemi një shtet importues dhe importojmë çdo gjë. Importojmë edhe gjërat të cilat me pak masa stimulative do të mund t'i prodhonim vet.

Një tregues i tillë, ku 78.2 e të hyrave tatimore vijnë nga Doganat, nga kufiri do të thotë, nga dikush mund të merret edhe si tregues i dobët i përeformancës së ATK-së. Përformancë kjo që çuditërisht në mënyrë automatike po përmirësohet këtë vit.

Te pagat dhe mëditjet, edhe pse fondi i përgjithshëm rritet, kemi vërejtur disa shkurtime të cilat duhet të justifikohen nga ana e Qeverisë. Pagat për punë jashtë orarit, kategori në të cilën përfshihen edhe kujdestaritë e mjekëve dhe motrave medicinale, kanë pësuar rënie drastike, nga 4.9 milionë në vitin 2009, në 75.000 euro në vitin 2010. Kjo tregon pse ne kemi protesta të mjekëve pothuaj në çdo të dytin muaj. Sasia e parave që është shpenzuar për mallra dhe shërbime është 162.6 milion. Këtu gjithsesi duhet t'i theksojnë disa gjëra. Qeveria e Kosovës, në vitin 2010, vetëm për udhëtime jashtë shtetit apo shpenzime të udhëtimit, ka shpenzuar 7.6 milionë euro, derisa subvencionet për sektorin e bujqësisë, gjatë vitit 2010, kanë qenë më pak se 4 milionë euro. Kjo Qeveri e cila po lavdërohet këtë vit se ka subvencione 7.4 milion euro dhe don ta zhvillojë me këto para sektorin e bujqësisë, vitin a kaluar vetëm për bileta aeroplani ka harxhuar 7.6 milionë euro, dhe a e dini se këto bileta janë shoqëruar edhe me hotelet e klasit të lartë e mëditje të majme. Cili është benifiti i gjithë kësaj: sasia e investimeve të huaja të sjella në Kosovë, numri i njohjeve të pavarësisë apo imazhi i Kosovës gjatë vitit 2010?! Udhëtimet jashtë vendit nuk do të duhet të krahasoheshin me subvencionet në bujqësi, por ja që ndarjet buxhetore në Kosovë ta japin një mundësi të tillë. Mandej, Qeveria gjatë vitit 2010, ka shpenzuar 3.8 milionë euro për telefona dhe internet. Kjo është shumë për një buxhet çfarë e ka Kosova.

Shpenzimet e qirasë janë ngritur për 17.5% në krahasim me vitin 2009, duke arritur shumë 6.5 milionë euro, pavarësisht premtimeve të Qeverisë qysh në vitin 2008 se këto shpenzime do të zvogëlohen. Gjatë vitit 2010, po ashtu janë shpenzuar 18.5% për derivate dhe lëndë djegëse. Ky shpenzim është i tepërt dhe duhet t'ia përkujtojmë Qeverisë nxjerrjen e një urdhërese

administrative në vitin 2008, për monitorim të veturave zyrtare, e cila duket të jetë harruar në sirtarë po të nesërmen e kësaj dite. Shpenzimet për blerjen e veturave të shtrenjta, gjithashtu janë të pajustificueshme para qytetarëve të Kosovës.

Po te mallrat dhe shërbimet, kemi disa kategori të shpenzimeve që në vete grumbullojnë disa shpenzime, e këto janë:

- shërbimet e kontraktuara, në shumë prej 33.4 milionë,
- shpenzimet tjera, në shumë prej 44 prej 9 milionë, dhe
- mirëmbajtja e riparimi, në shumë prej 27.5 milionë

Këtu patjetër duhet të cekim se në të dy kategoritë apo në të dy zërat, edhe në ato të shpenzimeve të tjera, edhe në kategorinë e mirëmbajtjes dhe riparimit, kemi shpenzime për mirëmbajtje të teknologjisë informative dhe mirëmbajtje të softuerëve, që ne mendojmë se këtu duhet të ishin të përfshira në njërin prej kategorive e jo në të dy kategoritë, sepse kjo po e bënë të vështirë vlerësimin.

Në raport kemi edhe shpenzimet e marketingut në vlerë prej 5 milionë euro. Ju rikujtoj se Qeveria nuk bën marketing, Qeveria bën reklamë dhe shpenzimet reklamuese në shumën e cekur janë shumë të mëdha për një buxhet çfarë e ka Kosova, por mbase këtu janë përfshirë edhe shpenzimet reklamuese të fushatës zgjedhore që ndodhi gjatë vitit 2010. Në raport kemi edhe shpenzimet kapitale, ku vlen të përmendet që përpos që kishim në shërbimet kontraktuese, kishim mirëmbajtje të softuerëve dhe në shpenzimet e tjera, mirëmbajtje të teknologjisë informative, tani te shpenzimet kapitale kemi blerje të pajisjeve të teknologjisë informative në shume prej 26.6 milionë euro dhe sikurse kjo nuk ka mjaftuar. Në zërin tjetër, kapital tjetër që kap shumën prej 54 milionë euro, në shpjegim përpos tjerave thuhet se këto para kanë mundur të përdoren edhe për blerje të kompjuterëve dhe zhvillim të softuerëve. Tani pyetja është: A janë blerë kompjuterët me para për pajisje të teknologjisë informative, që janë shpenzuar 26 milionë euro, a janë lerë me 54 milionë euro, e kategorizuar si kapital tjetër, apo janë blerë një herë dhe paguar dy herë, sepse në këtë pikë raporti është shumë i paqartë, për të mos thënë spekulativ.

Edhe një pyetje tjetër dhe një shqetësim gjithashtu shumë i madh. Në raport kemi edhe letrat me vlerë. Gjatë vitit 2010, Qeveria ka blerë letra me vlerë në Portugali dhe në Itali në shumë prej 84.5 milionë euro. Këtu mungon informacioni se në cilat institucione në Itali dhe në Portugali janë investuar paratë nga ana e Qeverisë, me çfarë norme të rrezikut, çfarë ka përfituar Qeveria nga ky transaksion, për sa janë rritur paratë e investuara dhe çka ka ndodhur me rritjen, sepse këto të hyra, do të thotë dividenda nuk figuron as në Buxhetin e vitit 2010 dhe as në raportin, në buxhetin e vitit 2011. Mandej, depozitat e afatizuara, ku thuhet se janë depozituar dy herë nga 50 milionë euro në Bankën e Francës, një herë 50 milionë për 15 vjet, hera tjetër 50 milionë për 8 vjet dhe 40 milionë në Raiffaizen bankë për 8 ditë. Edhe këtu nuk e dimë se a janë tërhequr këto depozita, çka ka ndodhur me interesin e akumuluar, sepse këto nuk figurojnë në buxhetin e vitit 2010.

Qeveria e shpenzimeve, përveç që po shpenzon, tani ka filluar të bëhet edhe organizatë biznesi, vetëm se nuk po e deklaroi fitimin. Ky parlament, gjithashtu duhet të ketë informata të hollësishme për pagat e minoriteteve për mirëbesim. Sa kohë do të mbahen këto para në këtë llogari të mirë besimit dhe a ka ndërmend Qeveria që të paracaktojë një afat ku këto të holla mund të tërhiqen ose përndryshe të lëshohen në qarkullim për shpenzime të tjera. Ne jemi të

vetëdijshëm që kemi qenë në koalicion gjatë vitit 2010, por ju përkujtoj se ne nuk e kemi pasur as Kryeministrinë e as Ministrinë e Financave dhe nëse ministrinë e udhëhequra nga LDK kanë bërë shpenzime të panevojshme, atëherë fajin e ka dikush tjetër që nuk ka marrë masa ndëshkuese.

Ne, si Grup Parlamentar i LDK-së, nuk do ta miratojmë dhe ky raport nuk do ta ketë votën tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Hamiti, e ka fjalën për Rregullore, për çështje procedurash. Nënkryetarit të Kuvendit, Hamiti, fjalën!

SABRI HAMMITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë e mora fjalën, unë e di që e kanë detyrë grupet parlamentare të flasin për këtë temë, por unë e mora fjalën për Rregullore, zbatimin e Rregullores. Nuk ka kurrfarë kuptimi, edhe me Rregulloren e Kuvendit, që të bisedohet për Raportin vjetor të financave të Republikës së Kosovës, pa qenë ose kryeministri ose ministri i resorit. Unë propozoj, zoti kryetar, që të jepet pauzë derisa njëri prej tyre ose eventualisht zëvendëskryeministri, edhe ashtu janë 6 a sa janë, njëri le ta marrë atë detyrë. Nuk ka kuptim Kuvendi i Republikës së Kosovës, të diskutojë më tutje as një minutë pa praninë e tyre. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit për sugjerimet! Sidoqoftë, Rregullorja nuk e përcakton saktë këtë çështje, por unë mendoj se në qoftë se ministrat dhe kryeministri nuk janë, është e dëmshme për ata vetë, sepse nuk mund t'ju japin përgjigje çështjeve që po debatohen këtu. Do të thotë, ata e dinë të gjithë, Qeveria e dinë që është ky debat. Në qoftë se i kryejmë deklaratat e kryetarëve të grupeve parlamentare, mendoj, dhe tani në qoftë se kërkohet një pauzë, qoftë dreke, qoftë për të kryer ata ndonjë obligim që e kanë dhe nuk janë këtu, të kthehen.

(reagim nga salla)

Vazhdojnë grupet parlamentare. Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar të vetëvendosjes, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Ju faleminderit!

Lëvizja “Vetëvendosje” i ka bërë një analizë të kujdesshme Raportit që na është paraqitur përballë, pra raportit vjetor të shpenzimit të mjeteve të buxhetore, por po ashtu të ndërlidhur edhe me raportin e shpenzimeve të tremujorit parë të vitit 2011, planin ... të Qeverisë për zhvillim ekonomik si dhe vendimeve të fundit të Qeverisë në fushën e ekonomisë dhe financave dhe pas kësaj analize, kemi arritur në përfundim që kjo Qeveri nuk është asgjë tjetër përveç Qeveri e shpenzimeve, pra nuk është Qeveri që e drejton vendin kah zhvillimi ekonomik, por është Qeveri që e shpenzon vendin dhe që e shpenzon mundësinë për zhvillim ekonomik dhe ky raport i shpenzimit të buxhetit për vitin 2010, flet më së qarti për këtë punë.

Unë do t'i përmend disa raste këtu, çka mendoj se kanë qenë shpenzime të paarsyeshme dhe të panevojshme të Qeverisë, madje edhe të tejkaluara. Shumë prej këtyre u përmendën edhe nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, por të gjitha këto janë përmendur para një jave e gjysmë në një konferencë për shtyp të organizuar nga Lëvizja “Vetëvendosje” ose më saktësisht nga Shpend Ahmeti.

Por, po filloj së pari nga Qeveria. Pra, u tha këtu edhe më herët se Qeveria për çdo ditë e më shumë po rritet me numër të zëvendëskryeministrave dhe të ministrave. Në vet një rishikim funksional që e kishte bërë, një studim që e kishte bërë Qeveria më herët, me ndihmën e Organizatës së Mbretërisë së Bashkuar DFID, aty rekomandimet kanë dalë që Qeveria e Kosovës, domethënë Qeveria Thaçi I, ka qenë shumë e madhe krahasuar me disa shtete me numrin e njëjtë të banorëve, siç janë marrë për t'u krahasuar Estonia, e cila i ka 11 ministri, pastaj Sllovenia, e cila i ka vetëm 16 ministri, Finlanda me 12 e kështu me radhë. Kosova atë botë i kishte 18 ministri. N vend se kjo të ndryshohej në Qeverinë Thaçi II, pra duke u bazuar në rekomandimet e një raporti që vetë Qeveria e ka bërë, kjo ka shkuar, ka ndryshuar faktikisht, por ka ndryshuar në drejtimin e kundërt, pra në vend të zvogëlimit të Qeverisë, është rritur Qeveria dhe është shndërruar domethënë në një Qeveri me 19 ministri dhe me, siç u përmend pra këtu, 6 zëvendëskryeministra.

Të gjitha këto natyrisht i kushtojnë qytetarëve të Kosovës, me afro 2 milionë euro në vit vetëm paga, duke i përjashtuar këto shpenzimet tjera që çdo ministri dhe çdo dikaster i ka. Por, kjo Qeveri shihet se e ka keqkuptuar këtë termin që përdoret në politikë, pra një qeveri e madhe apo në anglisht Big Gaverment për shkak se aty, ajo e ka kuptimin e ofrimit të shërbimeve sa më të mira publike, pra rritje të sektorit publik, rritje dhe financim më të mirë të sektorit të shëndetësisë publike, të arsimit publik, të të mirave tjera publike që i ofron Qeveria e ajo nuk nënkupton rritje të Qeverisë dhe numrit të zyrtarëve qeveritar, siç po vepron kjo Qeveri.

Në vitin 2008, kryeministri Hashim Thaçi kishte premtuar se do të ketë reduktim të hapësirave për zyra që janë me qira. Në vitin 2010, këto shpenzime, siç u tha, pra, kanë arritur në 6.5 milionë euro, që janë të barabarta me 14.444 pensione të qytetarëve të Kosovës. Së pari, kemi renovuar ndërtesa me çmime marramendëse, koston e të cilave edhe sot po e paguajmë, koston financiare, por fatkeqësisht edhe politike, e më pastaj as ato nuk i dolën Qeverisë, nuk i mjaftuan, më falni Qeverisë, sa që është dashur të shkohet në Banjsko për ta përpiluar një Power point prezantim për kinse një zhvillim ekonomik, çfarë këta ia garantojnë Kosovës.

Në vitin 2010, janë shpenzuar më shumë se 7 milion euro në udhëtime zyrtare, edhe pse rezultatet nga këto vizita kanë qenë të mangëta, të mos them të padukshme. Sa për krahasim, në vitin 2010, Buxheti i Kosovës ose qytetarët e Kosovës kanë paguar diku rreth 4 milionë euro subvencione për bujqësi, pra dy herë më shumë para për shpenzimet e udhëtimit. Në vitin 2010, sipas raportit janë shpenzuar më shumë se 3.5 milionë euro në shërbimet e telekomunikimit, pra në telefona dhe në shërbime tjera të telekomunikimit për administratën e gjithmbarshme qeveritare.

Dhe, për fund, e kemi lënë luksin qeveritar dhe atë që shprehet përmes veturave të shtrenjta të zyrtarëve qeveritar të Kosovës. Duket që sa më i varfër që po bëhet qytetari i Kosovës, aq më luksoze po bëhen veturat e qeveritarëve. Në vitin 2010, janë shpenzuar rreth 18 milionë euro në derivate dhe në lëndë tjera djegëse. Natyrisht, kjo nuk është e tëra karburante, mirëpo një pjesë e madhe e saj është. Në vitin 2008, Qeveria Thaçi I, pati lëshuar një urdhëresë administrative për të monitoruar përdorimin e veturave zyrtare. Ky mbeti vetëm edhe një premtim tjetër dhe vendim në letër, i cili nuk u zbatua kur. Edhe sot e kësaj dite asnjë institucion qeveritar nuk e di saktësisht se sa vetura në total i ka e gjithë Qeveria e Kosovës. Kjo madje i ka tejkaluar tash edhe përmasat e çfarëdo kufirit të racionales ku edhe secili këshilltar tash e ka veturën e vet në përdorim thuaja se privat. Për më shumë, veturat janë mjete të transportit, qëllimi i vetëm i të cilave duhet të jetë përdorimi për të transportuar zyrtarët qeveritarë nga një vend në tjetrin për

arsye zyrtare. Prandaj, vendimet për të blerë makina luksoze të tipit AUDI Q7, BMW X5, Mercedes 350 e tjera, çmimi i të cilave nuk është nën 70.000 euro për copë, janë veç se një ofendim për qytetarin e varfër të Kosovës.

Cilësia e makinave nuk e bën më të fortë funksionalitetin e një shteti. Përkundrazi, veturat e shtrenjta, të blinduara me xhama të zi, veç se e forcojnë bindjen se kjo Qeveri e ka humbur kontaktin me qytetarin dhe realitetin dhe se kjo Qeveri ka nevojë për t'u fshehur dhe po fshihet.

Lëvizja "Vetëvendosje", megjithatë do ta votojë këtë raport të pasqyrave financiareve për shkak se ky është pasqyrim i qartë i asaj se çfarë po bën Qeveria me paranë publike, mirëpo absolutisht e kundërshtojmë këtë mënyrë të shpenzimeve të parasë publike, për shkak se kjo mënyrë e shpenzimit të parasë publike nuk rezulton me zhvillim ekonomik dhe nuk po rezulton me ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët, por kjo po rezulton vetëm në vetëkënaqësinë dhe pasurimin e qeveritarëve, krerëve të institucioneve e kështu me radhë. Prandaj, konsiderojmë që një model krejtësisht tjetër i shpenzimeve të parasë publike dhe një model krejtësisht tjetër i ekonomisë i nevojitet Kosovës për ta zhvilluar vendin dhe për ta rritur mirëqenien e qytetarëve dhe dinjitetin e qytetarëve. Me këtë Qeveri, ne jemi vetëm duke shkuar në dëm dhe ky raport e pasqyron qartë këtë dëm që kjo Qeveri po ia shkakton vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Mendoj se para se të kaloj te ajo që mund të shihet në raportin për shpenzime buxhetore të vitit 2010, qoftë në mënyrën e raportimit, qoftë në përmbajtjen e shpenzimeve, dua të them se kultura shtetformuese në Kosovë nuk ekziston për shkak të Qeverisë aktuale. Duhet thënë që plotësisht të drejtë pati deputeti Sabri Hamiti, kur kërkoi që të paktën ministri i Financave të jetë këtu kut diskutohet për shpenzimet që i ka bërë kjo Qeveri, të parasë publike, edhe një herë po them, të parasë publike, nuk kanë qenë të vetat, këto para nuk kanë qenë as të ministrit, as të kryeministrit, por të popullit të Kosovës.

Duhet për të qenë këtu për të mos i ngatërruar investitorët me kontratktorë, duhet për të qenë këtu për të treguar se dikush po do të krijojë shtet në Kosovë e jo të ketë një sallë me vetëm 20 deputetë të koalicionit qeverisës në kohën kur diskutohet për shpenzimet buxhetore. Po ju them edhe një herë, kjo Qeveri po e shkatërron atë pak kulturë shtetformuese që e ka Kosova, po e shkatërron shtetin e Kosovës, po e shkatërron demokracinë e Kosovës për shkak se po e fyen Kuvendin e Kosovës, ku me telekomandë nxirren jashtë ministrat të cilët duhet të raportojnë. Po ju them edhe një herë, me telekomandë nxirren jashtë ministrat që janë të detyruar të rrinë këtu dhe të raportojnë. Kryeministri duhet të jetë këtu për të na treguar neve sa bëjnë dy molla e tri dardha, e jo të flasë e të ikë, se edhe ajo është çështje e shpenzimit të vitit të kaluar.

Tani, po kthehem pak te mënyra e raportimit dhe te përmbajtja.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Kjo është e tëra, vetëm kjo faqe, çka na dërgon Qeveria e Kosovës për t'i shpjeguar 459 milionë euro shpenzime kapitale, domethënë 459 milionë euro shpenzime, Kuvendit të Kosovës që është pronar i këtyre mjeteve, ka qenë, se tash janë shpenzuar, i ofrohet vetëm një faqe pa asnjë

shpjegim. Kjo është thyerje e Ligjit, po dua t'ju thënë që është edhe thyerje e ligjit, përpos tjerave.

Ligji për menaxhimin financave publike dhe përgjegjësitë kërkon që raporti për shpenzimet buxhetore të jepet për çdo projekt kapital veç e veç, ndërsa ne këtu, thotë: ndërtesat - kaq milionë, ndërtimi i rrugëve - kaq milion, nuk shpjegohet asnjë element më i vogël se ku kanë shkuar këto mjete, cilat janë projektet, edhe pronarit të mjeteve i jepet një faqe me një tabelë të turpshme, po duhet ta përdorë këtë fjalë - të turpshme. Po ju them se një kioskë i cili qarkullon 1000 euro në muaj, prodhon për këtë Qeveri më shumë dokumentacion, sesa që prodhon Qeveria dokumentacion për 459 milionë euro të shpenzuara. Kjo është forma e raportimit të Qeverisë, do të thotë, formë po e shini edhe vetë, është thyerje e ligjit. Ligji kërkon që Qeveria t'ia dërgojë Kuvendit raportin e shpenzimeve, pikë për pikë për shpenzime kapitale.

Përbërja, do të thotë përmbajtja, tregon shumë çka tjetër. Përmbajtja tregon se Qeveria e Kosovës, u përmend këtu më përpara, e ka rritur sasinë e mjeteve që e ndanë për qira, edhe u tha shumë saktë që kryeministri i Kosovës, ka ardhur këtu dhe na ka thënë neve që nuk ka për të pasur më objekte me qira për institucione të Kosovës. Kur e kanë ndërtuar Rilindjen, bashkë me zëvendësin e vetë të parë, 15 milionë euro, e ka rindërtuar në fakt, ia ka shtuar fasadën 15 milionë euro, na ka thënë po e bëjmë këtë punë për të mos pasur më institucione me qira. E tash, çka ka ndodhur? Përpos që ka institucione me qira, edhe këtij objekti që e ka bërë për ta hequr qiranë, edhe këtij i paguan qira. Kjo është çka bënë kryeministri Thaçi, me ministrat e vet të financave, duke na ikur këtu edhe prej sallës.

Kanë shpenzuar edhe më tepër për orendi në vitin 2010, se në vitin 2009. Njëfarë logjike ekziston, kur ndërrohen qeveritë, ndërrohen disa orendi. Po, ajo Qeveri nuk është ndërruar në vitin 2010. Ka shpenzuar më tepër për telefona, u përmendën veturat. Çështje tjetër e brendisë është se nuk janë përmendur askund bartjet buxhetore, asnjë bartje buxhetore nuk është përmendur. Ju e dini që gjatë vitit ndodhë që një ministri nuk mund t'i shpenzojë në të njëjtën kohë të gjitha mjetet ose një projekt vonohet për shkak të ankesave dhe kërkojnë që të barten mjetet, është e ligjshme. Mirëpo, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë kërkon që ato bartje të paraqiten në Kuvend. Asnjë nuk është paraqitur. Sipas të gjitha gjasave, i kemi diku një 140 milionë euro bartje, sipas disa kalkulimeve dhe askush nuk e di ku janë bartur, ku kanë shkuar.

I kemi 80 milionë euro shpenzime jashtëbuxhetore, 80 milion euro shpenzime jashtëbuxhetore domethënë që Qeveria e Kosovës e ka shti dorën në kacë të popullit, ka marrë para dhe ka shpenzuar, kështu domethënë për shkak se Qeveria në demokraci, Qeveria demokratike që i përgjigjet popullit, nuk guxon ta shpenzojë asnjë cent që nuk është paraparë në buxhet ose që nuk parashihet me ndryshime buxhetore në Kuvend të Kosovës, veç Kuvendi vendos për këto shpenzime. Do të thotë, 80 milionë euro i ka shpenzuar jashtë parashikimeve buxhetore. E keni edhe një raport që tregon për dividendën që e ka marrë prej PTK-së. Thotë kështu: i ka marrë 280 milionë euro në vitin 2009 dhe 2010 dhe 31 milionë euro në vitin 2008, domethënë më 2008, 2009, 2010 i ka marrë 311 milionë euro dividendë, do të thotë profit prej PTK-së edhe po donë ta shesin 300 milionë euro.

Kuvendi i Kosovës, ky Kuvendi i juaj, deputetë të nderuar, kemi këtu kolegët që janë në sallë, nuk po mundet të punojë, po duhet të lyp 5000 euro donacion prej USAID-it për ta kryer një punë që ia ka ngarkuar vetes, se nuk ka mjete.

I kemi çështjet tjera, të cilat mendoj se duhet t'i përmend edhe një herë, te letrat me vlerë. Në vitin 2009, për një shumë gati dyfish më të madhe të mjeteve që kanë dal jashtë, interesi për Kosovën ka qenë përgjysmë më i vogël se në vitin 2010, kur kemi pasur përgjysmë më pak mjete jashtë. Pra, dikën duhet ta pyet dikush -qysh bën? Qe tri vjet Grupi i Aleancës po kërkon ta dijë ku kanë shkuar 266 milionë euro fillimisht, në cilat institucione financiare dhe sa ka qenë interesi për Kosovën? Qysh mundet në krizën më të madhe financiare, në 50 vjetët e fundit, Kosova të eksportoje kesh, të holla të popullit më të varfër në botë dhe të marrë interes 0.1%. A është ky shteti që po duam ta ndërtojmë ne, a janë këta përfaqësuesit e shtetit të Kosovës? Dhe, për fund, po ju them, kur po i dëgjoj duke folur, më ka shkuar mendja që e kanë mësuar ta sakatojnë edhe poligrafin. Nuk po mundet të besojë njeriu çka po dëgjon, qysh po guxojnë para qytetarëve të Kosovë të flasin kështu? Krejt deputetët që janë sot në sallë, që ndiejnë se çka po bën Qeveria, kanë për ta votuar raportin për shkak se prapë disa votojnë këtu me telekomandë, e prek pullën, me SMS, unë i them telekomandë, dhe ju kallëzon çka të bë bëjnë dhe e bëjnë, e votojnë.

Nuk janë këtu as nuk ndiejnë çka jemi duke folur ne dhe e kanë sjellë edhe popullin, edhe shtetin e Kosovës në pozitë që të thonë - folni çka të doni, mendoni çka të doni, nxirrni çfarë dokumentesh të doni, ne kemi ardhur në pushtet dh bëjmë ka të duam derisa ta rjepim edhe shtetin, edhe popullin deri në pikë të fundit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Zoti kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Mendoj se është mirë që tash e kemi zëvendëskryeministrin këtu, përndryshe intervenimi i zotit Hamiti ishte shumë me vend dhe mendoj se Qeveria duhet të organizohet në atë mënyrë që kur të diskutojmë për një çështje kaq të rëndësishme, duhet të jetë prezent edhe Ministria e Financave, edhe Kabineti qeveritar, pjesa më e madhe e Kabinetit qeveritar. Përndryshe, mendoj se nuk do të kishte shumë kuptim debati.

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re mbështet Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa nga fakti se vërtet ky raport përmban shumë të dhëna, përmban mjaftë informata, mjaftë shuma, që po të investohet mjaftë kohë, mund të gjendet deri diku e vërteta se si po lëvizë edhe puna në grumbullimin e të ardhurave për buxhetin e Kosovës dhe shpenzimet lidhur me këtë buxhet.

Megjithatë, siç është biseduar edhe në Komision, ne dëshirojmë të theksojmë se duhet të avancohet metodologjia e përgatitjes së këtyre raporteve, në mënyrë që përdorimi i tyre të jetë më i lehtë dhe përfundimet nga këto raporte më lehtë të nxirren, sepse për të nxjerrë përfundimet e këtij raportit, duhet vërtet deputeti të jetë i ekipuar me dije kontabiliteti, por gjithashtu edhe të investojë mjaft kohë. Në këtë drejtim, ne kemi sugjeruar që në të ardhmen, domethënë, të përparohet metodologjia e raportimit, në mënyrë që krahas shumave absolute që prezantohen për pozicione të caktuara dhe për tri vitet e kaluara, të prezantohet edhe lëvizja në përqindje si në strukturë, ashtu dhe në dinamikë, sepse kjo e bën shumë më të lehtë që të

ndjekim realizimin e qëllimeve që po i arrijnë lidhur me politikën fiskale dhe politikën buxhetore, e kjo është esenciale për Kosovën, sepse mos të harrojmë se Qeverisë së Kosovës dhe këtij Kuvendi, politika fiskale dhe buxhetore është i vetmi instrument për ndjekjen e qëllimeve zhvillimore. Ne nuk kemi mundësi që të intervenojmë në politikën monetare, pra ajo që bëjmë me politikën buxhetore, është shumë, shumë esenciale, prandaj ne duhet të kemi analiza, të them ashtu më lehtë të përdorueshme dhe më udhëzuese që të ndjekim se si po realizohen qëllimet dhe sa janë arritur caqet e caktuara në politikat ekonomike.

Prandaj, edhe Kuvendi, edhe Qeveria duhet, pra, t'i kushtojnë rëndësi shumë të madhe këtij raporti dhe mu për këtë mendoj që ishte me vend edhe intervenimi për prezencën këtu të përfaqësuesve të Qeverisë. Unë e di se ministri mund të jetë ndoshta në biseda me Fondin Monetar Ndërkombëtar, por edhe Kuvendi e ka peshën e vet dhe duhet të sigurohet prezenca e caktuar.

Dy gjëra, sa iu përket politikave, unë dëshiroj t'i theksoj këtu. E para, politika për uljen e informalitetit, një politikë shumë e mirë që është proklamuar, por prej asaj që shihet në raport, shihet se ka vështirësi apo ka probleme të mëdha në uljen e informalitetit. Vetë fakti se ne kemi një rritje më të ngadalshme të të ardhurave nga akciza, në kohën kur akciza në shumë absolute është rritur dhe kur kemi rritje më të ngadalshme të tatimeve, në pagesa të tatime, në fitim të tatimeve, në fitimin e paragjykuar dhe në tatimin e paragjykuar e tjera, kjo tregon se ende nuk kemi arritur që të hyjmë me sukses në procesin e zvogëlimit të ekonomisë informale apo ekonomisë e cila punon jashtë rregullave dhe jashtë ligjeve dhe kjo e dëmton shumë konkurrencën dhe është shumë e dëmshme për klimën investuese në Kosovë.

Çështja tjetër, një politikë po ashtu e mirë e proklamuar, për të cilën u fol këtu, është se kjo Qeveri ka marrë zotime që t'i zvogëlojë shpenzimet të ashtuquajtura që tregojnë një racionalitet dhe shprehin një përgjegjësi, një kulturë përgjegjësie për përdorimin e parasë publike, siç janë: udhëtimet zyrtare, shpenzimet e telekomunikimit, shpenzimet e qirasë, karburantet e tjera, për të cilat këtu u fol, por diçka që bie në sy shumë, është vërtet rritja shumë e madhe e shpenzimeve kontraktuese. Këtu u përmend, por po e theksoj edhe një herë, prej 19.1 në 33.4 milionë në kokën kur edhe punësimi është rritur edhe pagat janë rritur.

Vërtet këto janë probleme të cilat duhet të analizohen më thellë në Qeveri dhe ndoshta edhe në komisionin përkatës që shihet se çka është duke ndodhur në këtë situatë.

Në këtë mënyrë, ne duhet të kemi pra një raport i cili i shpjegon këto. Raporti ka mjaft fakte, por nuk është analitik, nuk merret me politika, zbatimin e politikave. Pra, duhen shpjegime, si për shembull, qysh u përmendën letrat me vlerë ose kjo, raporti duhet të japë sqarimet, nuk duhet të japë vetëm numrat. Ky raport është një qasje thjeshtë teknike kontabiliste. Ne këtu duam raporte analitike, raporte mbi politikat dhe zbatimin e këtyre politikave. Gjithashtu, ajo që meriton kujdes, është përqindja e buxhetit në subvencione edhe transfere. Kjo pjesë e buxhetit po rritet shumë dhe ndoshta është e arsyeshme kur rritet për disa kategori sociale, siç janë këto nga lufta ose ata njerëz që duhet t'i mbështesim, që të kenë një ekzistencë, të mbijetojnë në këto kushte të vështira ekonomike dhe sociale, megjithatë ne duhet të shohim sa po përdoren racionalisht këto dhe cilat janë kapacitetet tona që ta menaxhojmë në shumë kaq të madhe të buxhetit në transfere dhe kjo sigurisht do të ishte një temë që duhet Kuvendi të merret me te në të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputetja Jelena Bontiq e ka fjalën.

JELENA BONTIĆ: Hvala gospodine predsedavajući!

Poslanička grupa Samostalna liberalna stranka glasaće za godišnji Izveštaj budžeta Kosova za 2010. godinu. Mi smo ovaj izveštaj razmatrali kao grupa, ali i kroz Komisiju za budžet i financije. Podržaćemo ga uz napomenu da u budućim izveštajima je neophodno procentualno uskladiti strukturu i dinamiku realizacije budžetskih prihoda i rashoda. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Duda Balje, në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

DUDA BALJE: Zahvaljujem se, predsedavajući!

Uz prethodno analiziranje svih finansijskih pokazatelja, Izveštaj budžeta Republike Kosova za 2010. godinu, smatramo da je isti prihvatljiv jer donosi brojne pozitivnosti u odnosu na prethodnu godinu, koje se automatski pozitivno odražavaju na tekuću godinu. Podržavamo Izveštaj jer predstava depo mnoštva informacija koje se ako malo pogledaju, analiziraju i povežu, daju odgovore na sva postavljena pitanja. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani në emër të grupeve parlamentare nuk ka më diskutues, nuk ka as të paraqitur të tjerë. Zëvendëskryeministri ka ardhur. Në qoftë se Grupi Parlamentar i LDK-së, do të paraqitet, unë e kam një kërkesë, një lutje nga ministri që t’ju kërkoj falje, meqenëse është në një takim me përfaqësuesit e Komunitetit Evropian, bashkë me kryetarin e Parlamentit.

Të tjerë nuk ka të paraqitur, pra, për të diskutuar. N sallë janë 75 deputetë. Nuk e di, Qeveria a dëshiron ta marrë fjalën për këtë çështje në fund? Jo. Atëherë, po vazhdojmë sipas rregullës me votimin e Raportit financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

Siç thashë, në sallë janë 76 deputetë tash. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, tani. 81 deputetë janë në sallë.

Konstatoj që me 50 vota “për”, 28 “kundër” dhe një abstenim, Kuvendi miratoi Raportin financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

Po vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

##### **5. Debati parlamentar lidhur me masakrën në burgun e Dubravës, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, në mbështetje të grupit të deputetëve nënshkrues**

Deputeti Nait Hasani dhe grupi i deputetëve nënshkrues ka parashtruar kërkesën për debat parlamentar për masakrën në burgun e Dubravës, që ka ndodhur më 19 deri 25 maj ’99 gjatë luftës në Kosovë. Ftoj deputetin Nahit Hasani, në cilësinë e propozuesit, të paraqesë arsyetimin e kërkesës për debat.

NAIT HASANI: Përshëndetje, për zëvendëskryeministrin, ministrat,  
Përshëndetje kryesues,  
Kolegë deputetë,

Në debatin e sotëm për masakrën në burgun e Dubravës, të thirrur nga unë e të mbështetur nga grupi i deputetëve, kemi kërkuar të trajtojmë një nga masakrat më të tmerrshme të ndodhura më 19 dhe 24 maj 1999, në burgun e Dubravës në Istog nga gardianët, policët dhe ushtarët serbë mbi të burgosurit shqiptarë.

Të nderuar deputetë,

Ne mendojmë se qëllimi i masakrës ka qenë i planifikuar dhe i përgatitur mirë që nga udhëheqja qendrore e Serbisë e deri te gardianët e burgut në Dubravë. Këtë e dëshmon mbledhja e të burgosurve në burgun e Dubravës që na solli aty mua dhe 63 të tjerë nga burgu i Mitrovicës së Sremit, nga burgu i Nishit, nga burgu i Prizrenit, nga burgu i Gjilanit, nga burgu i Pejës dhe të zënë robër nga Suhareka, Gjilani, Gjakova, e tërë Kosova, na mbledhën nga 29 prill '99 deri kah mesi i prillit 1999 në burgun e Dubravës.

Mbledhja e të burgosurve shqiptarë në Dubravë ishte mish për top, sepse në këtë kohë Serbia kishte vendosur sistemin e komunikimit të radarëve ushtarakë dhe pistën e avionëve në burgun e Dubravës. Pas tërheqjes së të burgosurve shqiptarë nga ky burg, në burgjet tjera në Serbi, sa kishte qenë i zbrazët, aty ishin vendosur policia dhe ushtria serbe, me qëllim për të mbrojtur këtë infrastrukturë raketore e të radarëve të ushtrisë së Serbisë dhe kur NAT-o të sulmojë këtë burg, që ishte lajmëruar se aty ka policë e ushtarë serbë, që ndërkohë ushtria dhe policia serbe kishin dalë jashtë oborrit të burgut dhe brenda na kaishin vendosur neve, të burgosurit shqiptarë, 960.

Të nderuar deputetë,

Në datën e sotme, kur ne debatojmë për masakrën e burgut të Dubravës, pikërisht në këtë datë, para 12 viteve filloi bombardimi i burgut nga avionët e NATO-s, të pikave raketore dhe të radarëve të ushtrisë serbe në burgun e Dubravës dhe fillimi i bombardimeve ka qenë i ditur nga drejtuesit e shtetit serb se do të ndodhë në këtë burg dhe ne duhet të jemi ata që do të jemi vrarë, pra vrasje me paramendim në këtë burg, për mbrojtjen e sistemit të tyre kundërzbulus që ishte instaluar në burg dhe ne do të ishim viktimat e kësaj plobe makabre.

Ajo që ka ndodhur ato ditë në burgun e Dubravës, nuk ka mundësi ta imagjinojnë as skenarët e filmave horror të Hiçkokut. Por, kjo masakër u realizua, ashtu siç ishte edhe planifikuar, duhet të vriteshin shqiptarë dhe të burgosurit sa më shumë që ishte e mundur dhe fajtor të ishte NATO-ja për këtë masakër. Por atë që nuk mundën ta realizojnë me djallëzinë që krimin t'ia linin NATO-s, e realizuan vet, më 19 deri më 24 maj 1999.

Të nderuar deputetë,

Këtë që po e them, po e trajtojmë këtu, që e dëshmojmë me kalëzim penal, që është bërë në Prokurorinë e Pejës, më 19 janar 2007, ka për qëllim të nxjerr në shesh një masakër të tmerrshme që ka ndodhur në kohën e luftës në Kosovë, në fund të shekullit XX, e cila as që mund të krahasohet as me krimet e nazi-fashizmit në Luftën e Dytë Botërore, e as me Mathuazenin e Aushvicin, që Serbia terrorizoi mbi shqiptarët në burgje të saj mbi ndërgjegjen evropiane. Kjo ndërgjegje u vra nga ushtria dhe policia serbe, së basku me gardianët e burgut vranë mbi 130 të burgosur dhe plagosën mbi 300 të tjerë.

Vrasjet u bënë nga ata që kishin marrë përgjegjësi t'i mbrojnë në bazë të konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të burgosurve dhe pengjeve të luftës. Por, këta

kriminelë na sulmuan dhe na vranë pa pyetur për konventa e ligje lufte, gjë që kjo është një masakër e shtetit serb kundër të burgosurve shqiptarë.

Të nderuar deputetë,

Jo vetëm kaq. Policia sekrete e njohur si UDB-a, arrestoi dhe rrëmbeu Hafir Shalën, mjek, humanist dhe njeri i të drejtave të njeriut dhe ende nuk dihet për fatin e tij. Nuk dihet a është apo jo i vrarë, nuk dihet ka apo nuk ka varr, nuk dihet asgjë për të, por vetëm një gjë dihet, se policia e shtetit serb e ka arrestuar dhe askush asnjëherë nuk është përgjigjur për këtë krim kundër humanistit, doktorit Hafir Shala. Por jo vetëm kaq.

Në Prishtinë u arrestua Xhavit Haziri, ish i burgosur politik, anëtar i Këshillit për të Drejtat e Njeriut, ende asgjë nuk dihet për të. Dihet se e arrestoi policia sekrete, UDB-a në Prishtinë, por nuk dihet se ku është, a është gjallë apo i vdekur dhe ku i ka eshtrat. Por, këtë e dinë ku është punëtorët e sigurimit serb dhe shteti serb, ata duhet të përgjigjen për këtë krim.

Unë dhe Lëvizja popullore e dimë se Xhavit Haziri ka qenë një nga drejtuesit kryesor politik në Kosovë, të Lëvizjes popullore, ka qenë njëri ndër ata që ka kërkuar dhe ka vendosur të krijohet sektori ushtarak pranë Lëvizjes popullore të Kosovës dhe në bazë të këtyre vendimeve më vonë është krijuar edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Pra, jo vetëm kaq. Krimi është edhe më i rëndë dhe më tmerrues kur kujtojmë ditën e burgut të Dubravës dhe tmerrin e asaj ngjarjeje. Nuk mundesh të tejkalosh masakrën në Burgun e Dubravës pa e ditur se ku është profesori Ukshin Hoti. Të gjithë të mbijetuarit e masakrës së burgut të Dubravës e dinë se në këtë burg ka qenë Ukshin Hoti dhe të gjithë e dinë se Ukshin Hotin e ka marrë nga dhoma e burgut gardiani Branko Komatina. Të gjithë e dinë se në këtë burg ka qenë përgjegjës drejtori Aleksandar Rakoqeviq Aca, ka qenë drejtor dhe në CZ apo në burgun qendror të Beogradit pas luftës.

Të gjithë e dinë se komandat burgu ka qenë Miodrag Vidiq Miki, që këta të dytë, Aca dhe Miki, së bashku me mbikëqyrësin e burgut Branko Komatina e dinë se ku është dhe cili është apo ka qenë fati i Ukshin Hotit, pas daljes nga burgu, më 16 maj 1999. Këta janë përgjegjës të drejtpërdrejtë për jetën e Ukshin Hotit. Këta kriminelë sot shëtisin të lirë nëpër Serbi. Këta edhe sot janë të lirë, kanë marrë pozita në burgjet e Serbisë. Dikush është bërë drejtor, dikush gardian e komandant burgu. Këta kanë marrë shpërblim për krimet që kanë bërë në burgun e Dubravës. Pra, nxjerrja e Ukshin Hotit nga burgu, nga gardianët e burgut, të zhduket dhe të mos të përgjigjet askush nga këta, ky është një krim që ndëshkohet me të gjitha ligjet ndërkombëtare dhe konventat mbi të drejtat e të burgosurve dhe pengjet e luftës. Andaj, këta kriminel duhet të arrestohen, të gjykohen, të marrin dënimin e merituar sepse, këta, duke u shëtitur të lirë nëpër Serbi, përbëjnë rrezik për qytetarët e Kosovës dhe të Serbisë.

Të nderuar deputetë,

Me këtë dua të them se deri me sot askush nuk ka qarë kokën për këtë masakër në burgun e Dubravës, asnjë Qeveri nuk ka bërë asgjë, kanë heshtur, me qëllim apo pa qëllim kanë heshtur qeveritarët tanë, kanë kërkuar kush apo jo nga ndërkombëtarët që të heshtin këtë, s'e dimë, por e dimë se nuk kanë bërë asgjë që të zbardhet kjo masakër në burg.

Për këtë masakër në burgun e Dubravës nuk ka qarë kokën as Prokuroria e Qarkut në Pejë. Që katër vite, që kur e kemi bërë publike kalëzimin penal në emër të Shoqatës së të Burgosurve

Politikë të Kosovës, më 19 janar 2007. Për katër vite u hesht kjo masakër dhe ky kallëzim penal në këtë prokurori dhe kërkoj nga ministri i Drejtësisë të japë shpjegim pse u hesht kallëzimi penal i bërë nga Shoqata e të Burgosurve Politikë në Prokurorinë e Qarkut në Pejë dhe nga kush u hesht, kush ka ndikuar që të heshtet ky krim. Kjo heshtje, do të thotë të bësh krim. Kush është kriminelë që e ka heshtur që 4 vite këtë masakër. Prandaj, mua dhe Shoqatës së të Burgosurve Politikë na intereson - cili ka qenë qëllimi që për këtë kallëzim penal nuk është ngritur aktakuzë kundër kriminelëve për krime lufte në burgun e Dubravës, kundër të paditurve nga Shoqata e të Burgosurve Politikë. Pse kryeprokurori i Pejës nuk i ka parë të udhës as që të ngrëjë aktakuzë kundër të pandehurve, nga ky kallëzim penal i datës 19 janar 2007, e kjo dëshmohej me fakte e faktografi, të fotografuar në vendin e krimit të kriminelëve dhe me dëshmitë mbi 40 të burgosurve. Pse edhe shumë pse ka, pse deri më tash për 4 vjet është bërë kjo heshtje dhe kujt i ka interesuar kjo heshtje, prokurorit të Qarkut në Pejë, UNMIK-ut atëherë, tash EULEX-it apo Serbisë që kjo masakër në burgun e Dubravës të heshtet.

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj se edhe ish-prokurorëve dhe kryeprokurorëve në Pejë dhe UNMIK-ut, dhe tash EULEX-it i duhet të heshtet ky krim e kjo masakër e tmerrshme. Kjo tregon se kryeprokurori i Pejës nuk ka parë të arsyeshme që masakrën në burgun e Dubravës, ku u vranë mbi 120 e u plagosën mbi 300 të tjerë në forma të ndryshme, që të ngrëjë aktakuzë dhe ta kërkojnë që të vihen para drejtësisë këta kriminel. Kjo tregon përgjegjësinë morale, politike të Prokurorisë së Qarkut në Pejë. Kjo tregon papërgjegjshmërinë e tre prokuroriale dhe njerëzore.

Të nderuar deputetë,

Këtë debat e kemi kërkuar që është një mundësi, që opinionin dhe qytetarët tanë dhe ndërkombëtarët të njihen me këtë ngjarje të dhimbshme në luftën tonë për liri që ka ndodhur në Kosovë, në burgun e Dubravës. Kjo që kam kërkuar unë, është që të bëhet me dije se çfarë krimesh, çfarë masakrash ka bërë Serbia ndaj të burgosurve në burgje dhe ndaj civilëve në Kosovë.

Ky debat për të kërkuar përgjegjësi nga institucionet tona dhe për të dëshmuar edhe një herë me faktografi para ...

KRYESUESI: A ke edhe shumë? Shtoja edhe pak, derisa ta kryej ekspozenë, regjia!

NAHIT HASANI... kjo që kam kërkuar unë dhe që është bërë me dije është se çfarë krimesh, çfarë masakrash ka bërë Serbia ndaj të burgosurve në burgje dhe ndaj civilëve në Kosovë. Ky debat për të kërkuar përgjegjësi nga institucionet tona dhe për të dëshmuar edhe një herë me faktografi para Ministrisë së Drejtësisë sonë dhe Bashkësisë Ndërkombëtare, te ambasadat e ambasadorët e shteteve të BE-së në Kosovë, dhe te Ambasada e ambasadori Amerikan në Kosovë, zoti Dell, se çdo masakër në Kosovë i ka kriminelët e vet që kanë vrarë e prerë shqiptarë, masakra e Reçakut, masakra e Likoshanit, masakra e Qirezit, masakra e Izbicës, masakra e Celinës, masakra e Bella Cërkës, masakra e Krushës së Madhe, masakra e Krushës së Vogël, masakra e Rugovës, masakra e Lubenikut të Pejës, masakra e Qyshkut, masakra e Studimes të Vushterrisë, masakra e Obrisë dhe e familjes Deliu dhe vrasja e fëmijës dyvjeçar, masakra e Korishës, masakra e Suharekës, familjes Berisha, ku janë vrarë gra e fëmijë dhe gra shtatzëna. Kjo tregon se secila masakër i ka kriminalët e vet dhe kjo kërkon dënimin e kriminelëve në çdo vend, e jo të heshtet para krimit.

Kriminelët serbë sot janë të lirë dhe në pozita të ndryshme në Serbi dhe të kamufluar në institucione të policisë dhe të drejtësisë në Kosovë. Prokuroria jonë ka heshtur deri më tash, ashtu mendoj unë, me sugjerimet e miqve ndërkombëtarë, duke u besuar të krijojnë pajtim mes shqiptarëve dhe serbëve, duke harruar atë çka ka ndodhur në Kosovë, por pajtimi nuk mund të krijohet, nëse nuk dënohet ai që ka bërë krim dhe kriminelët që kanë bërë krimin.

Dhe, në këtë drejtim, mund t'i bëj pyetjen ministrit të Drejtësisë dhe të Punëve të Brendshme se sa kriminelë janë dënuar për krimet dhe masakrat që janë bërë në Kosovë, sa kriminelë janë dënuar për masakrën e burgut të Dubravës? Pra, mund të them, asnjë. Në këtë masakër në burgun e Dubravës ka marrë pjesë drejtpërdrejtë shteti serb, me ushtrinë e policinë, kanë marrë pjesë gardianët e burgut, komandantët e tyre, sepse shteti serb na kishte marrë në izolim, në burgje duhej të garantonte jetën tonë në bazë të konventave ndërkombëtare për trajtimin e robërve të luftës, por shteti serb na vrau, na masakroi neve në burgje.

Të nderuar deputetë,

Ne kemi bërë kalëzim penal, kemi bërë publik emrat e kriminelëve, kemi prezantuar me fakte e fotografi krimet me armë, me pushkë dhe marrjen në shënjestër duke vrarë shqiptarë në burgun e Dubravës. Kemi bërë atë që mund të bëhet në një shtet ligjor. Kemi prezantuar dëshmitë, sepse besojmë në drejtësi.

Sot duke folur në këtë debat, në kokën time me dalin skena e ngjarje të tmerrshme, pamje të frikshme të të burgosurve duke bërtitur dhe duke kërkuar ndihmë, por ka qenë qëndrim në ndërgjegjen time që nuk bën për t'u ligështuar. Mjerë ai që nuk qëndron!

Të nderuar deputetë,

Ne kërkojmë nga institucionet tona që të përdorin çdo mundësi që kriminelët të dalin para drejtësisë. Kërkojmë nga zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, që në bisedime me Serbinë të kërkojë të sillen para drejtësisë në Pejë e të dënohen kriminelët që bënë masakrën në burgun e Dubravës.

Në fund, kërkoj që në bazë të debatit që zhvillohet, të miratohet rekomandimi që Kuvendi i Republikës së Kosovës të kërkojë nga organet e gjyqësisë që të përshpejtojnë veprimet ligjore, duke ndërmarrë veprime të hetimeve ndaj atyre kryerësve të krimeve dhe të ngritin aktakuzë me qëllim të gjyqimit të kriminelëve të luftës në rastin e masakrës dhe të masakrave në burgun e Dubravës.

Falënderoj ministrin e Drejtësisë, zotin Kuçi që ka mundësuar botimin e këtij libri për masakrën e Dubravës. Ky libër do t'i shërbej gjeneratës sonë, brezave të ardhshëm, studiueseve, artistëve dhe skenaristëve për të krijuar filma, drama, romane. Do t'i shërbej kujtesës së popullit tonë që ka kaluar në luftën me Serbinë 1999-98. Ky libër, besoj, prek ndërgjegjen e institucioneve tona dhe ndërkombëtare për luftimin e krimit dhe vënien para drejtësisë të kriminelëve që bënë këtë ployë mbi të burgosurit shqiptarë dhe masakrat në Kosovë.

Shumë familje që iu kanë vrarë fëmijët në masakrën e burgut të Dubravës, sot kur dëgjojnë këtë debat, kërkojnë të dënohen kriminelët që ju kanë vrarë djemtë në këtë burg. Dhe, krejt në fund, një fjalë e urtë: "Po mos të ishte nata, nuk do të kishte kuptim dita"!

Këtu përpara nesh kemi edhe kallëzimin, edhe të akuzuarit, të gjitha që janë bërë. Kemi edhe kallëzimin penal, që është bërë më 19 janar 2007. Pra, të gjitha janë dokumentacionet e faktuara dhe të dëshmuara që Prokuroria e Pejës dhe institucionet tona deri më tash nuk kanë bërë asgjë për këtë masakër.

Kërkoj që edhe një herë drejtësia të hedh në zbatim Ligjin për të ... Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani, sipas radhës, kryetarët e grupeve parlamentare e kanë fjalën ose përfaqësuesit. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Ju Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, zoti Haliti!

I nderuar zëvendëskryeministër Kuçi,

Ministra të Qeverisë të Republikës së Kosovës,

Të respektuar kolegë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike mbështet fuqishëm deputetin, zotin Nait Hasani në angazhimin e tij për të zbardhur krimet e kryera nga shteti serb në institucione, siç është burgu i Dubravës, institucione të cilat në bazë të të gjitha konventave ndërkombëtare kanë pasur për obligim që t'i mbrojnë të burgosurit dhe të mos i përdorin si mburojë për të krijuar siguri për veprimet e tyre skajshmërisht çnjerëzore dhe antihumane deri në shkallën e një masakre barbare.

Krimi dhe kriminelët duhet hetuar, zbuluar dhe në fund ndëshkuar. Të gjithë ata të cilët i kanë planifikuar, organizuar dhe realizuar të gjitha këto krime, duhet të ballafaqohen me organet e drejtësisë. Së pari, për hir të të gjithë atyre të cilët e kanë pësuar me jetë, për hir të familjeve të tyre, të cilët janë bërë pre e lukunive dhe çmendurive të një shteti, i cili ka qenë një bandë e organizuar dhe e kontrolluar mirë.

Krimi dhe kriminelët duhet nxjerrë para gjyqit dhe argumentuar fajësinë e tyre edhe për arsye që kur më të mos përsëriten veprimet e tilla, të cilat kanë lënë pasoja të rënda dhe të pariparueshme, që ne i shohim edhe sot, shumë vite pasi që kanë ndodhur.

Duke mbështetur këtë nismë, ne duhet të angazhohemi që në të ardhmen të thellojmë hulumtimet dhe hetimet rreth të gjitha veprave kriminale, të kryera me dirigjimin e shtetit serb, duke filluar që nga periudhat më të hershme historike.

Mendoj se detyrë e jona, si anëtarë të këtij Kuvendi, është që të ndërmarrim nisma me peshë, si rrjedhojë e të cilave do të pasonte angazhimi i ekspertëve përkatës, hulumtimi në arkivat e ndryshme, institucionet të cilat me profesionalizëm janë marrë me hulumtimin dhe zbërthimin e krimit, historianë, juristë të denjë dhe njohës të rrethanave të kohës, të cilët më pastaj do të kishin si një mbështetje të fuqishme të pasqyruar në konkluzionet dhe rekomandimet pas tërë debatit që pritet të zhvillohet këtu lidhur me këtë çështje sa të ndjeshme, aq edhe të dhimbshme.

Për të dal me rekomandime sa më të qëndrueshme dhe të sakta, duhet përfshirë edhe së pari Institutin e sapo themeluar për hulumtimin e krimeve të luftës, organizata joqeveritare, kryesisht vendore, veçanërisht Këshillin për mbrojtjen e të drejtave, lirive të njeriut, organizatat tjera të cilat kanë vepruar në rajon dhe të cilat janë marrë me hulumtimin e krimeve të kryera nëpër

periudha të ndryshme kohore, asociacionet të cilat kanë hulumtuar fatin e të përndjekurve, të zhdukur e të vrarë jashtë dhe brenda vendit.

Është momenti që nga ky Kuvend të dalë një nismë serioze rreth zbardhjes së fushatave deceniale të krimeve të kryera ndaj jetës dhe pronës së qytetarëve të këtij vendi, duke prodhuar dokumente me vlerë të mbështetura me të dhëna, shifra, fakte, deklarata e detaje. Heshtja e temave të tilla dhe mos marrja e dënimit të merituar po i jep kohë dhe hapësirë atyre të cilët i kanë planifikuar, organizuar dhe realizuar këto krime që të vazhdojnë fushatën antishqiptare, por sot me një mënyrë më të sofistikuar dhe të adaptuar me rrethanat e krijuara, duke fabrikuar e prodhuar akuza të pabaza e të trilluara kundër institucioneve dhe bartësve të këtyre institucioneve.

Grupi Parlamentar i PDK-së si gjithëherë do të jetë shumë i hapur, bashkëpunues dhe këmbëngulës që ky Parlament, i cili ka dalë nga vota e lirë e qytetarit, të shërbejë si vend ku do të hapen të gjitha çështjet e mbetura si tabu. Të ketë debat, polemika dhe kundërshtime racionale, por me një gjuhë dhe kulturë me nivel, e cila pasqyron nivelin dhe edukatën tonë, si dhe përgjegjësinë që kemi para qytetarëve të këtij vendi, të cilët kanë dëshmuar një pjekuri dhe kulturë gjatë të gjitha fazave të krijimit dhe zhvillimit të shtetit tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Reçica!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka kryetari i grupit, zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht që edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës përkrah këtë iniciativë të deputetit dhe të mbijetuarit nga kjo masakër, zotit Hasai, dhe sigurisht shfaq shqetësimin tonë për mos mundësinë e gjertanishme të zbardhjes së gjithë asaj çka ka ndodhur në këtë burg shumë vite më parë.

Masakra e burgut të Dubravës, e datës 22 maj 1999, me ç'rast humbën jetën të paktën 150 të burgosur dhe rëndë e lehtë dhe të plagosën rreth 200 të tjerë, paraqet një krim i cili nuk ka ndodhur asnjëherë, pothuaj se në asnjë burg dhe në asnjë shtet gjatë luftërave që janë bërë. Kjo ka qenë një shkelje e rëndë e zakoneve të luftës, e së drejtës humanitare dhe shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut, e një kategorie të qytetarëve e cila, sipas ligjeve ndërkombëtare, gëzon mbrojtje të veçantë edhe gjatë luftës. Masakra ka filluar që në datën 16 maj, për të vazhduar më 17, 18, dhe data tjera, për të mos elaboruar, sepse u thanë edhe më herët dhe, në mesin e shumë figurave, secili e ka pasur peshën dhe rëndësinë e vet të personalitetit, përmenden emrat që kanë qenë edhe nderë për kobin.

Padyshim që me datën 22 dhe 23 maj, gardianët e të burgosurit serbë, të udhëhequr nga Drejtoria e burgut, i rreshtojnë, siç flasin faktet, të burgosurit e mbijetuar dhe mbi ta bëjnë masakrën më të madhe të organizuar, të njohur ndonjëherë në historinë e burgjeve. Vetëm organizimi dhe sakrifica e të burgosurve shqiptarë ka ndihmuar që numri i të vrarëve të mos jetë edhe më i madh. Nga fillimi i masakrës dhe mënyra e zbatimit të saj, shihet se kjo masakër ishte planifikuar dhe orkestruar nga sistemi totalitar serb. Në ushtrimin e kësaj masacre kanë marrë pjesë një rrejt i tërë komandues, duke filluar nga ministria serbe e Drejtësisë, e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme, të cilët përmes të Drejtorisë së

burgut, gardianëve dhe të burgosurve serbë kanë ekzekutuar dhe kanë vepruar me urdhrat e tyre.

Rasti i masakrës në burgun e Dubravës nuk është zbardhur deri në fund. Realisht, mund të thuhet as nuk ka filluar ose nuk është hyrë në zbardhjen e kësaj masakre. Përgjegjësia bie mbi të gjithë, para së gjithash tek organet vendore, por edhe ato ndërkombëtare, prezentë këtu në Kosovë dhe jashtë Kosovës.

Jemi të vetëdijshëm se institucionet përgjegjëse gjer më tani, edhe ata që kanë qenë ose janë në një formë edhe tash, UNMIK-u, EULEX-i, por edhe institucionet, po e përsëris, vendore, nuk kanë bërë pothuajse ose fare pak në këtë drejtim. Është paradoks që institucionet tona ende nuk e kanë shtruar këtë rast në institucionet e drejtësisë ndërkombëtare ose së paku ne nuk jemi të njoftuar se diçka e tillë është bërë. Ende nuk ka ndonjë padi e cila do të trajtonte, përpos kësaj që u përmend, masakrën e burgut të Dubravës. Nuk mjafton vetëm të bëhet padia, e pastaj kjo të heshtet edhe nga ne, që të gjithë.

Si rezultat i mos angazhimit të duhur të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, rasti është lënë, po shihet anash, përveç angazhimit të Shoqatës së të Burgosurve Politikë, Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe ndonjë individi që ka mbijetuar këtë masakër, nuk ka ndonjë angazhim të akterëve tjerë rreth kësaj çështjeje. Padyshim që rasti i burgut, gjegjësisht masakrës së burgut të Dubravës është rasti i cili mund të jetë objekt trajtimi i shumë konventave dhe akteve ndërkombëtare, duke filluar nga Konventa e Gjenezës për rregullat në kohë lufte, Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, Karta e OKB-së e tjera.

Është paradoksale që, si përkujtim, përpos një pllake, ne edhe në këtë drejtim nuk kemi bërë asgjë rreth rastiit masakrës së Dubravës.

Institucionet e Kosovës nuk duhet ta heshtin në asnjë mënyrë këtë rast. Ato duhet që këtë rast ta trajtojnë përveç të një padie të veçantë, me të cilën do të kërkohej llogari, përgjegjësi nga Serbia dhe kriminelët e saj. Rasti padyshim e bën përgjegjës shtetin e Serbisë për arsye se të gjitha të dhënat dhe rrethanat flasin se përgjegjësia e saj është direkte e institucioneve të tyre më të larta, aq më parë që dihet zinxhiri komandues në atë kohë në burgun e Dubravës, ka dëshmitarë okularë që e kanë mbijetuar masakrën, dëshmitë faktografike, foto të gardianëve, të policëve, të burgosurve, serbë të armatosur duke ekzekutuar të burgosurit shqiptarë.

Padyshim që nga aseptik i përkujtimit duhet, përpos zbardhjes së faktit të atyre që ende nuk dihet fati i tyre, vënies para drejtësisë të gjithë përgjegjësve edhe në anën humanitare përkujtimore, së paku duhet të kemi edhe një memorial, i cili do të ishte një memorie kujtimi për të gjithë ata që kanë dhënë jetën atje, por e dhe ata që kanë mbijetuar. Mënyra më e mirë për të mos harrur asnjëherë këtë masakër, është mbledhja, studimi dhe prezantimi i fakteve për krimet e luftës, mënyra më e mirë do të ishte që krahas vendimit dhe punëve tjera, të bëhet edhe themelimi i Institutit për hulumtimin e krimeve të luftës, të sillet vendimi për themelimit e Muzeut të krimeve të luftës, e në të gjitha këto një vend të veçantë do të zinte masakra e burgut të Dubravës.

Dhe, fare në fund, duke mbështetur edhe një herë këtë nismë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkon nga institucionet që të gjithë fajtorët për këtë krim të dalin para drejtësisë dhe të marrin dënimin e merituar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Liburn Aliu

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Masakra e Dubravës është njëra nga ngjarjet e shumta të tmerrshme në historinë e përpjekjeve të popullit tonë për liri. Nga pushtuesit serb populli ynë përjetoj tmerre në vazhdimësi, që nga pushtimi i vitit 1912. Shumë tmerre të tilla janë përsëritur në periudha të ndryshme kohore dhe në këtë aspekt, masakra e Dubravës iu ngjason masakrave të tjera, si në luftën e fundit, po ashtu edhe në përgjithësi të vuajtjeve të popullit tonë.

Po ajo që masakrën e Dubravës e bën të veçantë kur e trajtojmë, është përfshirja e drejtpërdrejtë e një zinxhiri tejet të gjatë komandues politik dhe ushtarak, nga ushtari i thjeshtë, nga roja e burgut e deri lartë në ministri. Pasi kemi të bëjmë me një masakër që ndodhi në një burg dhe që ishte drejtpërdrejtë nën kontroll të Ministrisë të Drejtësisë së Serbisë, respektivisht të kreut të shtetit dhe ku ishin të burgosur, që ishin të dënuar ose në paraburgim.

Para se të flasim për masakrën e Dubravës, është e domosdoshme që të flasim për të burgosurit politikë si një kategori. Sot më bie shpesh të dëgjoj edhe nga politikanë në pozita të larta, të flitet me nënçmim për të burgosurit politikë, sikur janë ata që u zunë të gjallë, ranë në duar të armikut dhe shpesh madje thuhet se edhe në trajtimin në burg, kanë ndryshuar, kanë humbur logjikën e kështu me radhë. Zakonisht, kështu flasin ata që lavdërohen se si vetë nuk ranë në burg e që kryesisht i bie të jenë ata që ia mbathën me kohë. Ata sigurisht që lavdërohen për shkathtësitë e tyre dhe harrojnë se lufta pati sukses në saje të shumë të tjerëve që qëndruan me pushkë në dorë dhe shumë prej tyre u vranë dhe shumë të tjerë arritën edhe të mbijetojnë.

Sidoqoftë, duhet theksuar se në burgjet e ish-Jugosllavisë e të Serbisë më vonë, u përgatit dhe u kalit Lëvizja e shqiptarëve për liri nga pushtuesi. Atje në burgje bëhej qëndresë dhe nga atje dilnin më të përgatitur ata që do të vazhdonin përpjekjet për liri. Ky cikël i vazhdueshëm i lëvizjes e forcoi organizimin, e bëri atë më të sofistikuar, bëri ngritje të vetëdijes dhe bëri të pamangshme luftën e organizuar si fryt të punës shumëvjeçare të brezave.

Lufta, pra, u bë nga ata që qëndruan, që qëndruan në luftë dhe që qëndruan edhe në burgje dhe këtu, pra, kemi të bëjmë me një kategori dhe jo me kategorinë e të shkathtëtëve. Mendoj se masakra e Dubravës ndodhi jo rastësisht, sepse aty kishte të burgosur shqiptarë të cilët kishin potencial për organizim të mëtejshëm dhe për mos ndaljen në gjysmë të përpjekjeve. Aty në burg ishte edhe Ukshin Hoti, për të cilin duhej një përkujdesje e veçantë e pushtuesit për eliminimin e tij, dhe jo thjeshtë që eliminimi i tij të lihej për ditën e masakrës. Edhe pse gjatë masakrës Ukshin Hoti nuk gjendej në burg, mendoj se çështja – rasti i Ukshin Hotit nuk duhet asnjëherë të shkëputet nga ngjarja e përgjithshme e masakrës së Dubravës.

Ukshin Hoti ishte në burg gjatë tërë luftës, edhe gjatë zhvillimit të negociatave në Rambuje. Do të mund të ishte madje edhe në delegacionin e bisedimeve po të kushtëzohej, siç ishte rasti me udhëheqësin algjerian, në negociatat me Francën, tragjedinë në mes Algjerisë dhe Francës. E vërteta është se ai do të mundej ndoshta të rrezikonte negociatat pasi ishte i pa parashikueshëm aso kohe nga të gjithë, e edhe nga ndërkombëtarët. Kështu që do të duhej një trajtim i veçantë i rastit të Ukshin Hotit dhe mospërfshirjes e tij në grupin negociator të Kosovës në Rambuje. Si u bë që ai të mos gjendet atje, si nuk u kushtëzuan negociatat me pjesëmarrjen e tij, kur dihej fare

mirë niveli i dijes, i përgatitjes politike dhe dihej mirë se i pa zëvendësueshëm ishte ai. Madje, ai as negociatat e Vjenës, e si duket, as në këto të Brukselit nuk do të përmendet.

Kam pasur rastin ta njoh, ta dëgjoj e të mahnitem nga karakteri i tij dhe ligjërimi i tij dhe kam pasur rastin ta shoh të pa përkulshëm përball torturave nga autoritetet e burgut. Pra, ishte një veprimtar i kompletuar, me të gjitha tiparet e veprimtarit.

Pak ditë pasi Ukshin Hotin e ndanë nga të burgosurit e tjerë, filloi të ndodhte ajo që e quajmë sot – masakra e Dubravës.

Në rrjedhën e ngjarjeve në hollësi, në detalet e masakrës unë nuk do të thellohem shumë, që mendoj se deputeti Nait Hasani e trajtoi, me të cilin kemi qenë bashkëvuajtës dhe dëshmitarë të kësaj masacre. Por, sidoqoftë, masakra filloi me bombardimin e NATO-s më 19 maj, me goditjen e pavijoneve që sot njihen si pavijoni 5 dhe 4, ku u vranë 3 të burgosur shqiptarë dhe vazhdoi me sulmin e NATO-s me datën 21 maj, ku u bombardua i tërë kompleksi i burgut, me ç'rast mbetën të vranë edhe 16 të burgosur shqiptarë të tjerë.

Në ditët 22 dhe 23 maj në mënyra të ndryshme u vranë edhe shumë të tjerë, e që numrin e tyre unë nuk mund ta them dhe shifrën 150 e besoj plotësisht, po ashtu edhe shifrën për 250 të plagosur. Aty u thyen hekurat që të shpëtojnë nga vdekja, e cila gjendej prapë jashtë hekurave. Aty të burgosurit futeshin në puseta që të gjenin shpëtim nga NATO-ja dhe gjenin vdekjen aty nga granatat serbe. Goditeshin nga të gjitha anët nga karakollët e burgut, nga ajri, në puseta dhe bodrume kudo që ishin. Aty gjetën vdekjen të burgosurit shqiptarë në forma të ndryshme, deri te ekzekutimi nga afër. Dhe nuk përfundon me kaq!

Dua të përmend edhe dy raste të tjera të vrasjes. Ali Gashi, i plagosur, i mbijetuar nga Dubrava, i cili u vra në spitalin e Prishtinës pasi që u mor si i plagosur pas transferit që ndodhi në burgun e Lipjanit dhe aty u dërgua në spitalin e Prishtinës, si i plagosur. Më vonë, trupi i tij është gjetur në varrezat e Prishtinës.

Bujar Hima, i plagosur, i mbijetuar nga Dubrava dhe i cili u vra në torturë, ashtu i plagosur në burgun e Pozharevcit. Pra, me transferin në burgun e Pozharevcit, ai nuk mund, meqenëse ishte i plagosur, nuk mund të lëvizte dot, dhe në torturë e sipër ai dha shpirt sikur shumë të tjerë të burgosur, që plagoseshin e torturoheshin. Pra, rrahjet e të plagosurve në spitale edhe nga mjekët serbë.

Pra, kudo që kishte strukturë të organizuar, kishte krim. Në krim merrnin pjesë gardianët, merrnin pjesë ushtarët, merrnin pjesë policët, merrnin pjesë mjekët, merrte pjesë drejtori i burgut e deri te ministri dhe kreu i shtetit serb asokohe.

Ky pra ishte shteti i Serbisë, që me tërë aparatën e tij shtetëror ishte vënë në lëvizje për zhdukjen e një populli. Masakra e burgut të Dubravës është njëra nga dëshmitë që shpërfaqë karakterin e shtetit serb në raport me shqiptarët, planifikimin dhe veprimin sistematik të terrorit ndaj tij. Çdo gjë pra ishte planifikuar, ishte sistematike dhe kishte qëllim të qartë: Kosovën pa shqiptarët, ku një pjesë do të vriteshin dhe një pjesë do të dëboheshin.

U tentua që ky krim të bëhej fshehurazi dhe të fshehej mbrapa sulmeve të NATO-s. Pra, u keqpërdor sulmi i NATO-s që të bëhej krimi. Kjo tregon se po të mos ishte opinioni

ndërkombëtar dhe po të mos ishte rreziku nga përgjegjësia para mekanizmave ndërkombëtarë, ata pa përjashtim do të pushkatonin të gjithë, që do të mund ta realizonin këtë teknikisht, si në burg e po ashtu edhe jashtë, kudo nëpër Kosovë.

Në lidhje me Masakrën e Dubravës, po ashtu, me të gjithë terrorin e bërë nga serbët në Kosovë, nga ushtria serbe, shteti serb në Kosovë, duhet vazhduar të grumbullojmë faktet edhe më tutje, si edhe për të gjitha krimet tjera dhe të bëhet vazhdimisht presion kudo në lidhje me këto krime. Do të duhet që këto ngjarje të jenë temë çdoherë, kudo, në raport ndërkombëtar, me ndërkombëtarët dhe në raport me Serbinë. Këto ngjarje e shpërfaqin karakterin gjenocidal të shtetit të Serbisë në raport me shqiptarët në të gjitha kohët që nga viti 1912. Cilido pushtet në Beograd, në raport me shqiptarët ka qenë i njëjtë. Kjo është dëshmi themelore për lirinë tonë, për të drejtën e vetëvendosjes, e cila na takon, shikuar edhe nga ky aspekt.

E kemi të domosdoshme që krahas demaskimit të shtetit të Serbisë dhe të krimeve sistematike të tij në Kosovë, të promovojnë gjithnjë e në rritje luftën çlirimtare të popullit tonë nëpër gjenerata. Heroizmat dhe betejat e zhvilluara, ato janë themeli i lirisë së popullit tonë, i lirisë së vërtetë që synojmë e që buron nga populli, liri kjo e ndryshme prej gjendjes së sotme, e ku kjo e sotmja e ka burim më tepër kompromisin dhe ku vlerat kombëtare ka hapësirë që të sulmohen vazhdimisht.

Lufta çlirimtare, si vlerë, është e popullit, e shtetndërtimit dhe e moralit, të forcimit të moralit të qytetarëve. Prandaj, ajo duhet të ngrihet vazhdimisht.

Pajtohem me deputetin Nait Hasani në lidhje me presionin për ngritjen e aktakuzës për paditë drejtuar prokurorisë, edhe organeve ndërkombëtare në lidhje me masakrën e Dubravës.

Nuk pajtohem që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdojani edhe pak!

... nuk pajtohem që kërkesat e drejtuara zonjës Edita Tahiri që kjo çështje të trajtohet në negociatë, pasi ne jemi për ndërprerjen e negociatave me Serbinë dhe konsiderojmë që në negociatë nuk demaskohet Serbia. Përkundrazi, relaksohet marrëdhënia me Serbinë që nuk ka ndryshuar fare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës për Ardhmërinë, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën!

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po flasim pas 12 vitesh të ndodhjes së njërës nga shumë masakra që kanë ndodhur në Kosovë dhe po debatojmë për diçka që është dashur të debatohet për rezultatet e atyre dënimeve që është dashur t'u shqiptohen kriminelëve të cilët e kanë bërë këtë vepër. Janë njerëzit e gjallë të cilët i kanë shpëtuar kësaj masakre, janë fotografitë që tregojnë edhe kriminelët e armatosur, janë edhe dokumentacionet të cilat do të duhej të ishin sistemuar dhe të ishin dërguar atje ku e kanë vendin, si padi në të gjitha mekanizmat të cilët e kanë për detyrë t'i zbulojnë rastet dhe ta kryejnë punën e tyre, edhe gjykatat tona, por edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

Ne mund të botojmë libra, mund të mbajmë debate, mund të vazhdojmë edhe 12 vjet tjera ta vajtojmë masakrën e Dubravës, por nuk do të lajmë borxhin të cilin e kemi, as atë njerëzor, moral, institucional para gjithë atyre viktimave që kanë pësuar në masakrën e Dubravës dhe në masakrat tjera.

Konsideroj se duhet të bëhet veprimi praktik, në mënyrë që të mblidhet dokumentacioni i tërë, të mblidhen të gjitha dëshmitë, Ministria e Drejtësisë, Qeveria të marrë rolin e dorëzimit të dosjes, të faktuar, dhe në mënyrën e tillë ta kryejmë obligimin që e kemi duke pasur parasysh se në Kosovë ka ndodhur masakër, ka ndodhur gjenocid, ka ndodhur edhe gjithë ai krim që nuk mund edhe të përshkruhet me fjalë.

EULEX-i, drejtësia në Kosovë, vendorë e ndërkombëtarë duhet të angazhohen në këtë temë sepse ka të bëjë me një gjendje e cila ka ndodhur dhe nuk mund të anashkalohet. Prandaj, konsiderojmë se duke pasur parasysh që kemi një rekomandim të iniciuar nga deputeti Nait Hasani, të bëhen veprimet konkrete dhe të mos kemi nevojë vetëm të flasim dhe vetëm të humbim kohë rreth këtyre gjërave. Të tjerët po trillojnë dosje për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, po trillojnë dosje për njerëzit tanë dhe po arrijnë që në mekanizmat e drejtësisë ndërkombëtare ta qesin Kosovën si një pamje e cila në të vërtetë nuk është, ndërsa ne kemi masakra të tëra të cilat kanë ndodhur, që i kemi përjetuar vetë dhe nuk po jemi në gjendje ta kryejmë obligimin tonë, prandaj mendoj se, pa e zgjatur më shumë, Qeveria duhet të obligohet me një rekomandim nga ky Kuvend, të marrë materialin, ta kompletojë dhe ta dorëzojë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, të angazhojë ekipin e ekspertëve e cila do të mundësojë që jo vetëm e drejta të dalë në shesh, por të dënohen të gjithë ata që kanë bërë krime në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit Kosova e Re, deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Debati për njërën nga masakrat më makabre serbe në Kosovë, edhe pse i vonuar, është i një rëndësie të veçantë sepse po fillon trajtimi institucional i veprimeve antinjerëzore të shkaktuara nga shteti i Serbisë në Kosovë. Dhuna e sforcuar dhe e institucionalizuar e pushtetit serb në Kosovë, gjatë dhjetë vjetshit të fundit të shekullit të kaluar në të gjitha fushat e jetës, që mori përmasa gjenocidale më të theksuara gjatë vitit 1998 dhe në pjesën e parë të vitit 1999, u zhvesh nga të gjitha normat më elementare njerëzore, kur ajo dhunë mori dimensionin e hapur shfarosës kundër shqiptarëve. Vrasjet dhe masakrimet më monstruoze e më barbare që bëri Serbia kundër popullit shqiptar në Kosovë, me synim plotësisht të qartë e transparent, shfarosjen totale të një popullate të tërë në një territor, demaskoi plotësisht politikën dhe karakterin shovinist, fashistoid dhe gjenocidal të pushtetit e të shtetit serb. Vrasjet, masakrimet, dhunimet, dëbimet e deportimet masive të shqiptarëve, plaçkitjet, rrënimet e djegiet e shtëpive e të vendbanimeve të tëra të tyre, para dhe gjatë periudhës së bombardimeve të forcave të NATO-s, ishin në të vërtetë vazhdim i programit gjenocidal të regjimit serb të Beogradit për spastrim etnik të Kosovës dhe zhdukjen e popullsisë shqiptare nga trojet e veta etnike.

Tema e sotme e debatit paraqet vetëm një episod të krimeve gjenocidale të Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës. Për shumëçka masakra e Dubravës është e veçantë.

Prandaj, ky debat në mënyrën më të mirë ndërpret heshtjen tonë ndaj ndriçimit të së vërtetës për kampin e përqendrimit dhe të shfarosjes së shqiptarëve në Dubravën e viteve '90 të shekullit të kaluar. Pikërisht, me mënyrën e masakrimit të rreth 150 pengjeve shqiptare dhe me plagosjen e mbi 350 pengjeve të tjera, u manifestua tendenca e krimit më të rëndë të organeve të pushtetit serb ndaj shqiptarëve, sepse nga të gjitha tipet e masakrave ndaj shqiptarëve, masakra e burgut të Dubravës e dëshmon plotësisht projektin e shtetit serb për krime dhe gjenocid ndaj shqiptarëve të Kosovës. E dëshmon, sepse “mëshira” e kundërshtarit të shqiptarëve ka humbur kuptimin e së drejtës humanitare në luftë, sepse duke ndryshuar destinimin e objektit të burgut të Dubravës dhe duke mos përdorur simbole ndërkombëtare për objekte të burgosurish, ushtria dhe policia serbe ka gënjyer forcat ndërkombëtare të paqes, sepse tendenca e krimit kundër njerëzimit dhe gatishmërisë për gjenocid ndaj shqiptarëve nga ana e organeve të pushtetit serb u tregua e pranishme dhe e qëndrueshme si gjithmonë.

Masakra e Dubravës e majit të viti 1999 është hallkë përforcuese e zinxhirit të pandërprerë të krimit të rëndë e cila po qe se nuk ndriçohet në pikëpamje juridike e politike, i dëmton keq virtytet e lirisë, të humanizmit e të paqes në këtë vend.

Për fund, të nderuar kolegë, po i referohem një pjese të një kumtese të një të mbijetuarit të masakrës së Dubravës.

Më 23 maj të vitit 2004, në kumtesën e tij i mbijetuari i masakrës së Dubravës, zotëri Besim Kamberi, pati thënë, citoj: “Duhet të thuhet qartë se për sa kohë që masakra e Dubravës nuk do ta thyej heshtjen politike dhe për sa kohë që kjo masakër nuk do të institucionalizohet juridikisht në përmasat dhe përmbajtjen reale të saj, bota nuk do të marrë vesh kurrë se çfarë loje përbindëshi ka luajtur shteti serb në Ballkan, veçanërisht në tokat shqiptare në 50 vjetët e fundit të Jugosllavisë”.

Të nderuar kolegë,

Krijimi i një komisioni të veçantë për të ndriçuar të vërtetën rreth krimit të dyfishtë në Dubravë, është obligim edhe moral, edhe politik, edhe juridik. Është obligim sepse zbardhja e kësaj të vërtete dhe sjellja para drejtësisë së të gjithë atyre që urdhëruan dhe ekzekutuan pengjet, do të ishte edhe satisfaksion për të mbijetuarit dhe familjarët e viktimave.

Zbardhja e kësaj të vërtete do të dërgonte mesazh se kriminelët kudo që janë nuk do të mund të fshihen përjetësisht nga drejtësia. Krimi i masakrës së Dubravës ka adresë dhe ka emër.

Është shumë i nevojshëm themelimi i një instituti për hetimin e krimeve të luftës, për të ndriçuar të gjitha krimet e luftës në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk ka të paraqitur.

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli e ka fjalën!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar i Parlamentit!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Grupi Parlamentar “6+” e përkrah dhe mbështet iniciativën e deputetit, zotit Nait Hasani lidhur me masakrën e të burgosurve shqiptarë në burgun e Dubravës dhe kërkon zbardhjen e këtij krimi dhe ata që e kryen këtë masakër dhe përgjegjësit e këtij akti kriminal, sa më shpejt të dalin para drejtësisë dhe të njëjtit të marrin dënimin e merituar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani fillojmë me debatin. Në emër të Qeverisë, fjalën e ka zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, zoti Hajredin Kuçi!

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,  
Anëtarë të Qeverisë,  
Zonja dhe zotërinj,  
Më lejon që të shpreh solidaritetin për këtë debat në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës e njëkohësisht të shpreh dhimbjen për të gjithë ata të cilët kanë humbur jetën në atë masakër, që është një prej masakrave që kanë ndodhur në Republikën e Kosovës, dhe njëkohësisht ngushëllime për familjet e të vrarëve, por edhe respekte për të mbijetuarit, që dy prej tyre i kemi edhe në sallë sot, zotin Hasani dhe zotin Aliu.

Qeveria e Republikës së Kosovës shpreh gatishmërinë e saj që të marrë pjesë në zbulimin e të vërtetës për krimet dhe gjenocidin që ka ndodhur anekënd Republikës së Kosovës dhe në këtë drejtim mendojmë që masakra e Dubravës është një pikë dalluese jo në kuptimin e dhembjes apo të numri të të vrarëve, që është dhimbje për të gjithë ata që kanë rënë në Republikën e Kosovës, por në kuptimin e menaxhimit fizik jo vetëm të hierarkisë politike dhe institucionale që ka pasur Serbia anekënd Kosovës dhe përgjegjësinë që mund ta kenë, por në rastin konkret ka pasur menaxhim fizik të të burgosurve në atë kohë, që kanë qenë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës ka qenë dhe mbetet vazhdimisht e gatshme të ofrojë ndihmën e saj në kuadër të kompetencave. Kompetencat e Qeverisë dhe Ministrisë që udhëheq unë, janë në dy drejtime: e para, në ofrimin e ndihmës adekuate për prezantimin e drejtpërdrejtë dhe mbledhjen faktike të masakrës që ka ndodhur në atë rast, që përmes Zyrës që e kemi për përfaqësim të institucioneve ta bëjmë një gjë të tillë, për çka i kam ofruar edhe zotit Hasani dhe, e dyta, me një shkresë të drejtpërdrejtë në Ministrinë në Republikën e Serbisë dhe të mekanizmave ndërkombëtarë për të dhënë informatë adekuate për atë masakër, kur dihet se burgjet janë në menaxhim të drejtpërdrejtë nga qeveritë, respektivisht nga ministrinë e drejtësisë.

Në rastin tjetër, që ka të bëjë edhe me Institutin që e kemi themeluar për hulumtimin e krimeve të luftës, mund të jetë dhe do të jetë një prej objekteve të trajtimeve që do t'i ketë ky institut, që qëllimin final e ka përgatitjen e padisë së Republikës së Kosovës ndaj Republikës së Serbisë për krimin dhe gjenocidin që ka ndodhur në Kosovë.

Nuk dua të përmend shumë angazhimet që mund të jenë teknike në këtë rast, po më shumë edhe në kuptimin e memories kolektive që e kemi për këtë masakër dhe për tjerat, por dua të them që edhe në këtë drejtim kemi marrë hapa konkretë, edhe më herët si Qeveri, por edhe në muajt që kaluan.

Unë nuk e krahasoj asnjëherë financimin e një libri, me një trajtim të një të vërtete, po unë them se memoria kolektive ka nevojë të vihet edhe në libra, edhe në memoriale, edhe në aktpadi, edhe kudo tjetër. Dhe në këtë drejtim, unë i kam ofruar zotit Hasani, besoj se është edhe prezent, që edhe memoriali që gjendet jashtë perimetrit të burgut, të vendoset në vendin ku ka ndodhur masakra. Dhe këtë do ta bëj edhe të dielën, që do të shkojë në emër të Qeverisë së Kosovës dhe do ta kem premtim publik.

Në anën tjetër, u përmend edhe rasti që ka të bëjë me të pagjeturit, përfshirë edhe profesor Ukshin Hotin që është pjesë, do ta quaja, e kësaj masacre. Ne i kemi premtuar opinionit publik, edhe familjes së nderuar të profesor Ukshin Hotit që përveç masakrës së Kralanit, të Mejës dhe të shumë vendeve të tjera, çështja e profesorit Ukshin Hoti të jetë pikë e veçantë. Dhe unë ju them që Qeveria e Kosovës, unë respektivisht kam nënshkruar një platformë që në Bruksel rasti i profesor Ukshin Hotit të trajtohet në dialogun Kosovë-Serbi si i veçantë dhe ky është jo vetëm për rastin që do të thosha për trajtimin dhe kapacitetin e tij që ka pasur edhe si politikan, edhe si intelektual, por për rastin e zhdukjes së tij, që është në një menaxhim të drejtpërdrejtë të përgjegjësive shtetërore. Masakra e Dubravës tregon që përgjegjësia shtetërore e Republikës së Serbisë ka qenë dhe mbetet ndaj çdo masacre që ka ndodhur në Kosovë, por lufta më e madhe në këtë drejtim, në kuptim juridik po them, është që të vërtetohet ajo përgjegjësi dhe këtu Ministria e Drejtësisë dhe Qeveria e Kosovës do të japë maksimumin në kuadër të kompetencave të veta.

U përmendën dy raste – roli i Ministrisë në raport me kallëzimin penal. Unë kam mundësi që kallëzimin penal t’ua ofrojë zyrën ligjore timen, ekspertët më të mirë që ka Qeveria, që ta bëjnë më të efektshëm, me prova, me fakte, por nuk kam mundësi që t’i them prokurorit për hir të pavarësisë së gjyqësorit dhe të prokurorisë, të përshpejtojë apo jo, por unë i kërkoj atij edhe sot publikisht, edhe në takime zyrtare që të ketë prioritet zbulimin e një të vërtete në këtë rast, por Ministria e Drejtësisë ka kompetenca të kufizuara në raport me prokurorinë dhe me gjyqësinë. Faleminderit për vëmendjen!

**KRYETARI:** Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar edhe deputeti Albin Kurti!

**ALBIN KURTI:** Deputetë, të Kuvendit të Kosovës,

“Demokracia autentike niset nga bindja se asnjë lloj demokracie nuk mund të eksportohet, sepse me atë rast do të duhej ta ruanin xhandarët dhe asnjë ndryshim thelbësor nuk do të ndodhte”. Kjo është një fjalë prej librit Filozofia politike e çështjes shqiptare, të Ukshin Hotit.

Ne këtë gjë e kemi parë shumë shpesh në Kosovën e pasluftës, pra vetë jemi dëshmitarë se si demokracia e importuar, pra demokracia jo autentike, duke mos qenë autentike, s’është as demokraci. Ose, siç e ka thënë vetë Ukshin Hoti “kjo është demokraci që e ruajnë xhandarët, pikërisht që të mos ndodhë asnjë ndryshim thelbësor”.

Më tutje, “Politika serbe ishte fare e vetëdijshme se Republika e Kosovës nuk do të ishte zgjidhje definitive e çështjes shqiptare”. Edhe kjo është prej të njëjtit libër të Ukshin Hotit.

Pra, neve Serbia nuk na e ka luftuar republikën për shkak se na e ka luftuar republikën, por na e ka luftuar republikën për shkak se na e ka luftuar bashkimin kombëtar, se e ka ditur që Republika e Kosovës nuk do të ishte një çështje definitive, në kuadër të zgjidhjes.

Më tutje, “Disa, si duket, kujtojnë se demokracia është pronë e tyre private. A thua, demokracia doemos duhet të ngritët mbi mohimin total të së djeshmes, apo është fjala për tentimin që të vazhdohet e djeshmja nën vallon e demokracisë”. Edhe ky është një citat tjetër, prej të njëjtit libër.

Pra, kur demokracia ngritët mbi mohimin e historisë, atëherë kemi përsëritje të historisë nën vallon e demokracisë.

Dhe, e fundit, “Qëllimi politik i popullit shqiptar, nuk mund të jetë tjetër pos bashkimit të tij në një shtet të vetëm shqiptar. Me argumente të shumta që nuk mund të kontestohen, historia e ka vërtetuar se shtetet nuk janë vetëm pikësynim historik i çdo populli, suazë më e mirë për ruajtjen dhe ngritjen e identitetit kolektiv kombëtar që përfshin gjuhën, kulturën e të tjera, por edhe instrument i pa zëvendësueshëm dhe absolut për zhvillimin e tij, konform me shpirtin dhe me traditën e vet, por edhe konform me kërkesat që ia parashtron koha.

S’ka shtet për vete dhe për hir të vetes. Në qoftë se kjo është kështu për të gjithë popujt e civilizuar të botës dhe me siguri se është, dhe në qoftë se jemi popull i civilizuar dhe me siguri se jemi, atëherë nuk mund të jetë ndryshe as për ne shqiptarët. Në rrethanat demokratike për të cilat u luftua me gjak e me mund, nuk ka ndonjë arsye që kjo të mos thuhet”.

Pra, unë dua ta shpalos me këto pak citate për një kohë të shkurtër që kam këtu në dispozicion, edhe këtë dimensionin politiko-teorik të Ukshin Hotit, i cili mendoj se e ka bërë atë të pa përshtatshëm për të gjitha bisedimet që janë bërë gjatë luftës, para luftës e pas luftës, sepse idetë e tij, qëndrimet e tij, gjendja e tij shpirtërore e intelektuale ka qenë në kundërshtim me idetë, qëndrimet apo mungesat e ideve dhe të qëndrimeve dhe me gjendjen shpirtërore të delegacioneve të ndryshme që kanë qarkulluar në bisedime me Serbinë.

Liburni e krahasoi me Ahmed Ben Bellën e Algjerisë dhe vitin 1962 kur Algjeria është çliruar përfundimisht prej Francës. Edhe atëherë ka pasur bisedime, po bisedimet kanë qenë pasi që Franca e ka pranuar të drejtën për vetëvendosje të Algjerisë, duke përfshirë këtu edhe dekolonizimin. Pra, bëhet fjalë për biseda krejtësisht tjera, për biseda me kushte të plotësuar nga ana e Francës dhe është interesante se atëherë Delegacioni Algjerian e ka kërkuar lirin e Ben Bellës dhe Franca e ka liruar atë.

Por, ku është dallimi me neve? Dallimi është që idetë, qëndrimet, pikëpamjet e Ben Bellës janë përputhur me ato të Delegacionit Algjerian, ndërsa këtu, ky nuk ka qenë rasti. Domethënë, ju e dini shumë mirë që profesor Ukshin Hoti nuk lëshojke pe në burg, e këta që ishin në liri, lëshonin pe.

Pra, ai atje nën tortura mbahej, e këta në liri bënë koncesione e kompromise. Prandaj, këtu është ajo shpërputhja elementare e cila ka bërë që të mos përmendet Ukshin Hoti, sepse kur përmendet Ukshin Hoti, nuk përmendet vetëm një veprimtar i thjeshtë, por përmendet një pikëpamje e caktuar politike, teorike, çlirimtare e cila ka qenë në përputhje me ecjen politike e cila është bërë në Kosovë në vitet e fundit të okupimit, por edhe pas luftës.

Kur na kanë transferuar prej burgjeve të Kosovës në Serbi, kemi qenë 2050 veta gjithsej dhe 3000 të pa gjetur. Prej këtyre 2050 vetave, një e treta ka përfunduar në Pozharevc. Aty në Pozharevc kemi qenë në tri pavijone, në pavijonin IV, VI dhe VII dhe të njëjtit gardianë të

burgut, të cilët i kanë pushkatuar shqiptarët dhe i kanë masakruar në Dubravë, kanë qenë në këto pavijonet IV, VI dhe VII. Të gjithë ne të burgosurit atje, diku rreth 600 kemi qenë, i dimë një pjesë të konsiderueshme të tyre me emra e mbiemra, sikur që i përmendi Naiti, do me thënë Rakoçeviçin, Vidiçin, Komatina, pastaj ka qenë njëfarë Dragan Millanoviçi, ka qenë një Kosigin Jolliç, dhe të gjithë ne do të ishim të gatshëm të jemi dëshmitarë në procese gjyqësore kundër tyre. Secili prej neve ka aq shumë për të thënë për të gjithë këta kriminelë dhe janë pikërisht këta gardianë të cilët e patën plagosur Bujar Himën në Dubravë dhe mandej në Pozharevc të njëjtit gardianë e kanë rrahur për vdekje njeriun e plagosur, të cilin e kanë plagosur paraprakisht një muaj më herët ata vetë.

Po, unë jam interesuar për këtë çështje edhe menjëherë kur u pata liru prej burgut, përgjigja që e pata marrë në atë kohë nga institucionet e sistemit të drejtësisë, që kanë qenë nën UNMIK-un, ka qenë se UNMIK-u e ka marrë një qëndrim sipas të cilit nuk ke të drejtë ta gjykos dikë në mungesë. Pra, nëse kriminelin mungon, ti kot bën padi, sepse konsiderohet që ai nuk është këtu dhe rasti kundër tij nuk ka prioritet.

Janë me mijëra kallëzime penale që i kanë bërë shqiptarët pas luftës. Nuk është që shqiptarët kanë qenë pasivë. Shqiptarët kanë bërë kallëzime penale, por prokurorët nuk i kanë përfillur ato kallëzime penale sepse kanë thënë që, me gjasë, kriminelët e këtyre kallëzimeve penale ose të dyshimit për kriminelë nuk janë këtu. Dhe, prandaj, gjatë këtyre viteve të pas luftës janë marrë ekskluzivisht me pjesëtarë të UÇK-ës, me këtë makinacion të vogël që duket vetëm teknik, për shkak se është thënë që – nëse dikush ka kallëzim penal ndaj UÇK-së, atëherë konsiderohet që ai pjesëtar i UÇK-së me gjasë është këtu dhe le ta persekutojmë, le ta ndjekim, le ta gjykojmë, le ta dënojmë. Ndërkaq, kur bëhet fjalë për ndonjë kriminel serb, e po ai me siguri nuk është këtu, prandaj ky rast s'postohet dhe nuk është më prioritet.

Pra, kjo padrejtësi themelore, me një detaj teknik, është ajo që ka bërë që përplot sirtarë të UNMIK-ut, po edhe të institucioneve tjera të drejtësisë në Kosovën e pas luftës, të jenë me kallëzime penale të cilat nuk aktualizohen asnjëherë.

Kroacia e ka bërë të kundërtën. Janë me qindra, në mos edhe me mijëra kriminelë serbë të cilët janë dënuar në mungesë në Kroaci. Edhe Serbia vazhdimisht ankohet që kjo po e pengon kthimin e serbëve në Kroaci. E Kroacia i thotë, po nëse s'janë kriminelë, nuk kanë pse të frikohen.

Në Kosovë ka ndodhur e kundërta. Ai Dragan Millanoviçi, unë e kam dëgjuar vet duke biseduar me atë Komatinën, kur e pyeti, tha: ku po ndodhesh? - tha, prej Beogradi deri në Mitrovicë. Për shkak se një ditë ose dy ditë në javë kanë shërbyer në Mitrovicë ata. Përveç se kanë qenë gardianë në Pozharevc, kanë shërbyer në Mitrovicë. Dhe, domethënë, ata edhe kanë mund të kthehen në Kosovë. Kurrkush nuk i ka penguar. Pse? Pse ne kthimin e serbëve nuk e kemi lidhur as me historinë e serbit që po kthehet, e as me historinë e pronës së tij. Ai po thotë – po kthehet te prona. Po duhet ta këqyrim pak, mos ia ka dhënë atë pronë Rankoviçi, bën vaki. Bën vaki ia ka dhënë Millosheviçi. Ndoshta e ka marrë në kohën e reformës agrare midis dy luftërave botërore. Duhet të këqyret. Ai kthimi te prona, atë pronë kur e ka marrë ai. Dhe, duhet me këqyrë historinë e vetë serbit.

Prandaj, po them, këto janë të gjitha gjëra të lidhura me njëra tjetrën dhe masakra e Dubravës është një si pikë neuralgjike në këtë rrjetin e madh të padrejtësisë ndaj popullit tonë, se një drejtësi e cila është e mohuar, është padrejtësi e vazhdueshme.

Mendoj që e vetmja mënyrë që të bëhet diçka për këtë çështje, është që përveç se të krijohet një lloj institucioni i llojit, le të themi, të Simon Wiesenthall, atij jevreit, i cili e ka pasur qendrën e vet në Vjenë dhe ka arritur t'i identifikojë dhe të mundësojë kapjen e deri 1000 nazistëve. Ai ka vdekur para disa viteve. Njëkohësisht, shteti i Kosovës të shqyrtojë mundësitë se çfarë kanë bërë shtetet në të kaluarën për t'i kapur kriminelët nazistë gjermanë dhe kësisoj ata mandej t'i gjykojnë nëpër vendet e tyre ku sigurisht që rasti më i shquar për këtë gjë, është vetë Izraeli. Domethënë, ne nuk mund të presim që Serbia do të na i dorëzojë kriminelët, aq më pak nëse kjo çështje ngritët në bisedime me Serbinë, sepse në ato bisedime është e qartë, në njëfarë mënyre ti nëse flet për krimet, ti po ia falë pa kërkuar falje. Po e bën pjesë të pazarit, jo çështje të drejtësisë dhe mendoj se është shumë e gabueshme nëse ngritët asisoj. Si kusht, po! Por jo si temë. Nëse e bën si temë, ti po ia falë. Në momentin që po e bën temë, ti ia ke falë. Nëse ia bën kusht, atëherë kjo ka kuptim, sepse është përbrenda zonës së drejtësisë e jo të pazarit politik.

Pra, shteti i Kosovës, përveç një institucioni të tillë të llojit të Simon Wiesenthall-it, do të duhej që të shqyrtojë përvojat e shteteve të tjera në ndjekjen, kapjen, gjykimin dhe dënimin e kriminelëve nazistë.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ia vazhdoni edhe pak!

ALBIN KURTI: Faleminderit! Sepse, drejtësia për neve nuk mund të vijë prej dikujt tjetër. Sikurse te çdo gjë në jetë, edhe këtu mund të na ndihmojnë të tjerët, por bartës kryesor dhe sidomos iniciues të drejtësisë ndaj popullit tonë jemi ne dhe vetëm ne. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Fatmir Limaj!

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe nga diskutimi i propozuesit të rendit të ditës, po edhe të kolegëve tjerë, konkretisht u përshkruan ngjarjet e Dubravës dhe masakrat tjera dhe unë do të mundohem po ashtu me një qasje tjetër të përfshijë nga një kënd tjetër edhe disa elemente, të cilat besoj do t'i shërbenin këtij diskutimi.

E dëgjuam edhe fjalën e ministrit të Drejtësisë dhe zëvendëskryeministrit. Për çdo vit ne flasim për masakrën e Dubravës dhe masakrat tjera kur vjen përvjetori i tyre, mirëpo nuk kemi asnjë veprim konkret të asaj që në realitet të vijmë deri te tentativa për të zbardhur të vërtetën për atë që ka ndodhur.

Mendoj se ne duhet të shikojmë në dy plane. E para, e vërteta na duhet për neve brenda, të përkujtohen qindra – mijëra njerëz të cilët janë masakruar nga terrori shtetëror serb, vend përkujtimi për ne për të tashmen e për të ardhmen, vend përkujtimi për atë se si ka ardhur deri te liria, që shpesh e harrojmë dhe, në anën tjetër është krejt ajo pjesa legale për të cilën më së paku duhet të kërkohet nga ata të cilët kanë përjetuar që ata ta ndjekin anën legale. Sepse, ata e kanë përjetuar, kanë luftuar, kanë sakrifikuar për të pasur shtetin dhe shteti është ai që duhet të përkujdeset më tutje për të vërtetën legale, ndjekjen legale të çështjes.

Të nderuar kolegë deputetë,

Memoria e kujtimit të historisë nuk shkohet vetëm me përkujtimin e librave dhe të bartjes së gjeneratës pas gjeneratës, sepse ne po e bëjmë gabimin e pafalshëm. Ne shqiptarët jemi mësuar të themi që për 2000 vjet na kanë munguar, na kanë munguar shënime faktike kontesti, kontestimi prej prejardhjes tonë, e gjithë historia jonë kombëtare, si rezultat dhe dobësia jonë kryesore ka qenë se s'kemi pasur të shkruar. Pas 100 viteve, në këtë vend vjen një moment kur pasardhësit tanë do të shohin dhe do të gjykojnë për të kaluarën e tyre mbi bazën e proces-vendimeve gjyqësore, jo mbi bazën e atyre librave, përkujtimeve dhe ditarëve, por do të shihen sa procese gjyqësore ka pasur për krimet në Kosovë nga serbët, sa nga shqiptarët dhe mbi bazën e saj pas 100 viteve ata do të vijnë në përfundimin se kush ka qenë agresori, kush ka qenë terrori, kush e ka bërë terrorin. Nga ajo që jemi deri sot, unë ju them se këtu në këtë drejtim ne jemi ata që kemi bërë terror, ne jemi ata që kemi bërë krime, ne jemi ata që kemi sulmuar Serbinë, gjendja qysh është sot: Për së dyti është Ramush Haradinaj në Hagë, ju e dini, e këtu qindra e qindra djem duke u ndjekur, kështu që nëse i shohim nesër aktgjykimet, do të del që ne shqiptarët jemi ata që e kemi sulmuar Beogradin dhe kemi bërë masakrat. Po them, për pjesën legale.

I nderuar, zoti ministër, zëvendëskryeministër,

Për gjërat të cilat dihen, për rregullat të cilat dihen dhe nuk kanë nevojë të shpiken, përvojat që u thanë këtu nga Kroacia, po edhe nga vet Serbia, nga Bosnja – duhet të aplikohen në Kosovë.

Prokuroria e shtetit, zëvendëskryeministri paska dalë, Prokuroria e shtetit ka obligim ex-officio... Ex-officio të marrë veprime, të hapë procedura penale për çështje të caktuara. Ex-officio! Jo t'i thuhet Nait Hasanit dhe Liburn Aliut edhe shumë djemve atje mbrapa që po i shoh, që janë përjetues të masakrës të Dubravës: bini ju dëshmi, tani na këqyrim a ka prova! Po flasim për një terror shtetëror. Po flasim për një kryetar të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës e Metohisë, për një këshill ekzekutiv. Po flasim për një kryetar komune Prishtinë. Po flasim për një ministër të drejtësisë, po flasim për një drejtor burgu, i cili saktë dihet dhe këtu duhet të fillojë ndjekja penale, pastaj vijmë te ata akterët konkretë. Dhe, kjo fillon me ex-officio! Prokurori i shtetit duhet të fillojë hetimet ose ndjekjen penale për të gjitha rastet, jo vetëm për masakrën e Dubravës. Dhe këtu nuk duhet dëshmi. Është prokuroria e shtetit që i thirr dëshmitarët, iu thotë: urdhëroni, ne kemi filluar, çka keni për të dëshmuar ju? Nëse duam vërtet të shkojmë deri te ndjekja reale, ashtu siç bëjnë të tjerët.

U tha këtu – gjykime në mungesë. A e dini, besoj se deputeti tjetër, më duket është në rend dite, zoti Lladrovci e ka këtë çështjen e INTERPOL-it, më duket është në rend dite. Me qindra-qindra qytetarë të Kosovës shqiptarë janë nën hetime dhe janë në kërkim nga INTERPOL-i pikërisht nga Prokuroria e Serbisë, ani që s'ka pasur rast për t'i gjykuar, por i ka hapur procedurat penale, vetë shteti serb. Çka kemi bërë ne!?

Memoriali përkujtimor! Jemi dëshmitarë që kemi parë duke u shtyrë ish përjetuesit e masakrës së Dubravës, njerëzit e gjallë, duke u shtyrë me forcat e policisë që të mund të hyjnë të bëjnë një tufë lule, ose ta bëjnë një vend memorial. Shpresoj, dhe e përshëndes këtë iniciativë të ministrit dhe besoj se është momenti i fundit që të jetë memoriali atje brenda ku ka ndodhur ngjarja. Mirëpo, do të doja që iniciativës së zotit Hasani t'i bashkëngjitemi ne të gjithë, që ta bëjmë një memorial përkujtimi edhe ne në Prishtinë. Ta bëjmë në Prishtinë, sepse është nevojë për të gjitha viktimat. Ta bëjmë një memorial, një vend ta caktojmë në qytetin tonë – kryeqytetin e Kosovës, ashtu siç kanë bërë vendet – popujt të cilët kanë qenë viktimë të terroreve në të kaluarën, të kemi

një vend ku në një datë të caktuar të gjithë së bashku të shkojmë e përkujtojmë terrorin, jo vetëm të luftës së fundit, por prej 1945 sepse ne këtu i kemi babagjyshërit e stërgjyshërit, të cilëve nuk ua dimë ku i kanë eshtrat, dhe e dimë që kanë qenë të terrorizuar edhe nga Serbia e parë, edhe nga e dyta, e kështu me radhë dhe ne s'kemi pasur asnjëherë rastin – mundësinë për të shkuar e t'i përkujtojmë ata. Të paktën, për këtë të fundit ta bëjmë një memorial të këtij terrori dhe spastrimi etnik.

Të lypim për pastrim etnik, përgjegjës... Po e marr një shembull, çka do të lyp Prokuroria e Kosovës tjetër, përveç që dihet që kryetar i komunës së Prishtinës kush ka qenë në kohën kur është bërë spastrimi etnik në kryeqytetin e Kosovës. Ai duhet të na tregojë kush e ka bërë. Ai ka qenë udhëheqës shtetëror, kur janë bartur me trena njerëz, me trena i kanë çuar drejt Billacës. Çka do të kërkojmë tjetër?

Dua të shtoj vetëm edhe dy fjalë... Besoj se e keni parë një kronikë para disa dite në televizionin tonë publik – RTK, e cila më ka inkurajuar dhe bëj apel, ju bëj apel të gjitha grave, grave tona të cilat në një mënyrë apo tjetër kanë qenë të ekspozuara nga dhunimet e ushtrisë – policisë dhe forcave serbe: të mos heshtin! Të mos heshtin! Dhe, kërkoj nga ky shtet që të caktojë një fond të veçantë për mbrojtjen e tyre, për inkurajimin e tyre, për ndihmën e tyre për të zbardhur këtë të vërtetë. Kjo është një nga të vërtetat më të dhembshme e cila për shkaqe të shumta ka mbetur e pa folur deri më tani. I inkurajoj ato gra që të dalin dhe ta thonë të vërtetën e tyre. Por, njëkohësisht inkurajoj edhe familjet e tyre, sidomos bashkëshortit të mos bëjnë krimin e dytë ndaj bashkëshortëve të tyre, sepse askush nuk ka faj për atë që iu ka ndodhur atyre. Që ata si qytetarë të distancohen, të largohen nga bashkëshortet e tyre, është një krim edhe më i rëndë ndaj grave, motrave, vajzave tona të cilat kanë qenë të ekspozuara dhunimit masiv, e ne e dimë që ka pasur dhunim masiv në këtë vend.

Ky shtet, përfundimisht, besoj se duhet të shkojë deri në fund. Të shkojmë deri në fund, të shohim kush çka ka bërë dhe kështu përfundimisht t'i japim fund kësaj gjëje, sepse mendoj që është koha dhe momenti që të shkohet deri në fund. Instituti gjyqësor është një gjë që duhet përsëritur, por Instituti gjyqësor është vendi ku mbledh fakte, mirëpo pres që Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Kosovës të aktivizohet ex-oficio lidhur me të gjitha masakrat dhe spastrimin etnik që ka bërë nëpër qytetet e Kosovës regjimi shovinist serb. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri e ka fjalën!

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: I nderuar, kryetar!

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Një nga masakrat më të rënda të luftës ishte edhe ajo në burgun e Dubravës, qendra më e madhe e paraburgimit në Kosovë, ku pas bombardimit të NATO-s të burgosurit u masakruan nga forcat serbe të sigurimit.

Nga burgu i Prizrenit, 80 të burgosur nga Suhareka dhe komunat përreth u transferuan në natën e 30 prillit të vitit 1999. Më 15 tetor 2010, Prokuroria serbe pohon se masakra ndaj të burgosurve është kryer me urdhër të Qeverisë së Serbisë. Sipas urdhrit të dhënë nga Qeveria e atëhershme serbe, të burgosurit serbë për krimet më të rënda janë transferuar në burgun e Dubravës për të

qëruar hesapet me të burgosurit shqiptarë. Menjëherë pas krimit, rreth 90% të burgosurve serbë marrin 15 deri 20 ditë pushim për të mos u kthyer më kurrë në vendin e vuajtjes së dënimit.

Material të dhembshëm për këtë ngjarje të tmerrshme mund të gjejmë në librin e të mbijetuarit Ukë Thaçi, të përcjella me fotografi origjinale, si dhe me dëshmi të dëshmitarëve të mbijetuar nga kjo masakër. Duke e lexuar, ndjen një keqardhje nga shpirti dhe tmerrohesh edhe vetë si lexues. Dhe, pyet veten: Përse aq pak është debatuar për këtë ngjarje të dhembshme? Më së miri mund ta përshkruajnë të mbijetuarit që gjenden edhe këtu në mesin tonë.

Sipas autorit, zinxhiri komandues i shtetit serb – skenarist të kësaj masakre të planifikuar nga kriminelë profesionistë, fillon që nga ministri i Drejtësisë, i cili urdhëron transferin e të burgosurve shqiptarë në Dubravë, si dhe skenari realizohet nga drejtori i burgut dhe bashkëpunëtorët e tij. Këta kriminelë – realizatorë të masakrës, tani shëtisin të lirë nëpër Serbi, bile edhe të graduar edhe nga Serbia e pasluftës.

Edhe pse sipas autorizimeve të Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës kallëzimi penal është paraqitur nga avokati Ruzhdi Gashi, nga Suhareka, dhe është dorëzuar në Prokurorinë e Qarkut të Pejës, në qarkun ku është bërë krimi, sipas bisedave me autorin Ukë Thaçi dhe sipas dëshmive – faqe 381, lënda është dërguar më datë 19 janar 2007, mirëpo ende për këtë çështje nuk është thirrur asnjë i mbijetuar për të vërtetuar dëshmitë. Bile edhe më keq, ditën që është dorëzuar kallëzimi penal në prokurori, iu është thënë: sikur të lejonte UNMIK-u, menjëherë do të fillonim hetimet. Ato, ende nuk kanë filluar, prandaj çfarë dëshmie duhet ofruar për t'i bërë hetimet që të fillojnë e të besojnë UNMIK e EULEX?

Të gjithë ata që i shpëtuan masakrës, u transferuan në burgjet e Serbisë, deri në momentin e përfundimit të luftës, kur të burgosurit u liruan. Ironia më e madhe është kjo e ditëve tona, që gjatë qëndrimit të tij në Prishtinë, Borko Stefanoviq u mundua të na bindë se Beogradi ka ndryshuar. Vetë deklaratat e tij lidhur me atë se Serbia nuk e shkelë kushtetutën e saj, na bën të kuptojmë se Serbia është ajo e vjetra, ajo e burgut të Dubravës. Si mund të mendojmë se ka ndryshuar, kur ky zotëria personalisht nuk iu kërkoi falje kosovarëve për viktimat që ia shkaktoi shteti i tij gjatë luftës së fundit. Si po e gjykojnë familjet e viktimave të luftës këtë vizitë të tij dhe pritjen që iu bë këtij duke e takuar edhe përfaqësuesit më të lartë shtetërorë.

Të nderuar deputetë,

Mbiemri im është Berisha. Vendlindja ime është Suhareka! Kur sot po diskutojmë për gjenocidin serb ndaj shqiptarëve, nuk mund të mos e përmend masakrën e kushërinjve të mi – familjeve Berisha nga Suhareka, e cila i ngjanë masakrës së burgut të Dubravës. Sepse, edhe Berishët e Suharekës i rreshtuan, i futën në një lokal dhe i gjuajtën me bombë e pushka – deri sa të gjithë ranë për tokë, shumë fëmijë, gra shtatzëna, pleq e të rinj. Në mesin e tyre dhe profesori i Fakultetit të ndërtimtarisë, Hajdin Berisha, të cilit pushtuesi serb ia ndërpreu ëndrrat, ia ndërpreu ëndrrat për ndërtimin e Suharekës, ia ndërpreu ëndrrat për ndërtimin e Kosovës. Si po e gjykon Gramosi i vogël në luftë, sot student, i cili i shpëtoi masakrës së Suharekës por mbeti jetim, si shumë fëmijë të tjerë të Kosovës. Si po e gjykojnë të mbijetuarit e masakrës së Dubravës pritjen e një zyrtari të Serbisë i cili ka harruar se çka kanë bërë në Kosovë.

Edhe pse kanë kaluar disa vite, nënat ende po i kërkojnë bijtë e tyre, fëmijët, prindërit, nuset, bashkëshortet, motrat, vëllezërit. Andaj, kërkuarja falje ka qenë akt moral dhe qytetërim për këtë zotëriun nga Serbia për hir të viktimave, për hir të viktimave të masakrës së Dubravës, të

Suharekës, të Drenicës, të Jasharajve, të Raçakut, të Krushës së Madhe e shumë e shumë të tjerave.

E dimë që përparimi i dialogut me Prishtinën është shumë me rëndësi për Beogradin, i cili shpreson se deri në fund të këtij viti do të fitojë statusin e kandidatit për anëtarësim në Bashkimin Evropian. E dimë që çelësi i Beogradit për BE gjendet në Prishtinë, këtë e kanë dëshmuar edhe shumë deklaratatë zyrtarëve të BE-së, të cilët kanë thënë që çelësi i Beogradit për BE është Kosova. Por, a duhet që ne tua shtrojmë tepihun e kuq për anëtarësim në BE?

Prandaj, sipas mendimit tim, për hir të të rënëve për lirinë e Kosovës, me të është dashur të takohet vetëm kryenegociatorja – zonja Edita Tahiri dhe të kërkojë publikisht nga ai dhe çdo zyrtar tjetër që shkel tokën e Kosovës për të treguar civilizim. Për hir të këtyre masakrave të përmendura, duhet së pari të kërkojë falje, të kërkojë falje për të gjitha viktimat dhe dëmet që Serbia ia shkaktoi Kosovës gjatë luftës. Tek e fundit, shteti agresor, jo vetëm që duhet të kërkojë falje, por duhet bërë edhe dëmshpërblimin e luftës.

Në masakrën e Dubravës, ata që u flijuan, përjetuan një fund të tmerrshëm, ndërsa neve na shpëtuan nga një tmerr i pa fund. Derisa të marrim përgjigje, gjithmonë do të pyesim: ku është Ukshin Hoti? Autorin e falënderoj që na dha një libër, ku gjeneratat e ardhshme do të kenë material për të parë se sa e dhembshme ka qenë lufta e Kosovës për pavarësi. Ndërsa, një kopje nga ky libër duhet ruajtur: për Dick Martin! Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Pak fjalë, dua t'i them edhe unë.

Të nderuar deputetë,

Unë dola vetëm t'i them ca fjalë për një periudhë tepër të vështirë, tepër të dhembshme dhe gjithashtu shumë të padrejtë që i është bërë Kosovës, qytetarëve të saj.

Ne sot nuk duhet vetëm të debatojmë dhe të përmendim aktet e ndryshme të masakrave, që i ka ushtruar regjimi serb në Kosovë. Janë disa zhvillime dhe jo vetëm kohëve të fundit që na obligojnë t'ia përkujtojmë vetvetes dhe sigurisht jo vetëm vetvetes, por të gjithë atyre që pretendojnë të ndajnë drejtësinë dhe të na sjellin drejtësinë dhe demokracinë në Kosovë.

Nuk do të duhej që ne sot pas sa vitesh ta marrim në mbrojtje të drejtën tonë, kur është dashur më herët kjo çështje të zbardhej dhe kriminelët të përgjigjeshin para drejtësisë. Por, duke e parë këtë mungesë dhe këtë gatishmëri jo vetëm të institucioneve tona të brishta, por edhe a tyre që pretendojnë ta bartin demokracinë dhe sundimin e rendit në Kosovë, se duhet të veprojnë, se nuk kanë vepruar dhe se po veprojnë keq.

Për mua shkas dhe domosdoshmëri për debat janë përpjekjet që sa kohë po bëhen për të vendosur shenja të barazimit në mes veprës vërtet kriminale dhe viktimës.

Prandaj, mendoj që nuk ka institucion të sotëm në Kosovë dhe nuk do të duhej të kishte as institucione ndërkombëtare që janë në Kosovë dhe që kanë ardhur për ta vendosur sundimin e rendit dhe të ligjit në Kosovë, që nuk e dinë se cila është hierarkia e organizimit të krimit në Kosovë dhe se kjo hierarki nuk ka filluar dhe s'ka përfunduar dhe s'është ushtruar vetëm nga një kriminel, siç ka qenë Slobodan Millosheviqi. Kanë qenë institucione të tëra shtetërore. Bile, jo

vetëm shtetërore, por edhe akademike, edhe fetare që kanë qenë të organizuara dhe e kanë thirrur edhe popullin edhe institucionet shtetërore për të bërë krim dhe gjenocid në Kosovë.

Ne e dimë se edhe Partia Socialiste Serbe – SPS në të gjitha nivelet e saj nga niveli i Serbisë deri në nivele komunale kanë pasur njerëz të tyre që janë përgjegjës për të gjitha krimet që janë bërë në Kosovë, në vende të ndryshme natyrisht, veç e veç. Kanë qenë strukturat e pushtetit nga parlamenti i atëhershëm i Serbisë me gjithë ekzekutivin serb, si të nivelit të Republikës, ashtu edhe të krahinës autonome që ata e quajnë Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë. Gjithë struktura komanduese e ushtarakëve dhe policëve të Serbisë, që kanë qenë në të gjitha stacionet komunale, kudo në Kosovë, janë përgjegjës dhe ata njerëz kanë emër e mbiemër.

Në Kosovë janë bërë shumë masakra. Nga masakra e Qirezit, e Pokleikut, e Izbicës dhe mos t'i përmendi masakrat që janë bërë në komunën e Rahovecit, në Krushë, në Meje, në Gjakovë, në Pejë, në Vushtri, por edhe kudo tjetër. U fol edhe këtu për masakrën e dhembshme të Therandës.

Asnjë institucion, as vendor, as ndërkombëtar që 12 vite në Kosovë nuk është marrë për të hetuar cilët janë ata njerëz që janë përgjegjës, se çdo masakër i ka përgjegjësit e vet, i ka kriminelët e vet dhe ata kriminelë janë dhe shëtisin të lirë.

Në struktura të larta të SPS-it ka qenë edhe Ivica Daçiqi, që kohë më parë ka vizituar Kosovën. Një kriminel është kthyer në vendin e krimit. Do të thotë, vjen në Kosovë, në vend se ai të përgjigjej për politikën kriminale që ka udhëhequr partia e tij dhe shteti i tij.

U fol këtu se është i dhembshëm rasti i Ukshin Hotit. Është i dhembshëm, se ai ka qenë i burgosur dhe njerëzit që e kanë ekzekutuar atë kanë emër e mbiemër dhe askush s'është përgjigjur për këtë.

I dhembshëm është edhe rasti i Hafir Shalës, mjekut humanist nga Drenasi, që është marrë nga policia e atëhershme më 10 prill të vitit 1998 dhe kurrë e askush s'është përgjigjur se ku ndodhet ky njeri, kush e ka marrë dhe kush është përgjegjës për zhdukjen e tij.

Gjatë verës së vitit 1998, në Prishtinë është marrë veprimtari i Këshillit për Mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, Xhavit Haziri, dhe sot e asaj dite askush s'e di se çka ka ndodhur me të.

I përmenda këta emra, që janë tre emra të përveçëm, që janë rrëmbyer nga njerëzit e pushtetit dhe pushteti serb në asnjë kohë s'e ka njoftuar as familjen dhe askënd se çka është bërë me fatin e këtyre njerëzve. Dhe, kështu realisht, këtë fat e kanë pasur edhe shumë vetë të tjerë. Prandaj, ne mund të diskutojmë sa të duam, por ne duhet të kërkojmë nga Prokuroria e Kosovës që të merret me zbardhjen e çdo rasti dhe për të filluar ndjekjen e gjithë kriminelëve, janë apo s'janë në Kosovë. Është detyrë e prokurorisë. Po është detyrë edhe e EULEX-it dhe nuk mund ta pranojmë faktin se EULEX-i paska të drejtën për t'i ndjekur vetëm njerëzit që e kanë mbrojtur vendin e tyre, popullin e tyre dhe kanë luftuar për lirinë e vendit të vet. Ndërsa, për t'i ndjekur këta, ata kanë një bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Serbisë. Kjo ministri ka jo pak përgjegjësi për krimet që i ka bërë dhe dënimet që ua ka bërë shqiptarëve, edhe para luftës, edhe gjatë luftës, edhe aktakuzat që i ngritë pas luftës janë vepra kriminale të asaj ministrie. Dhe, EULEX-i si një trupë e Bashkimit Evropian, e ardhur në Kosovë për t'i ndihmuar institucionet e Kosovës në vendosjen e drejtësisë, shërbehet me aktakuza të ngritura nga ky dhe

ai regjim kriminal. Si ta quajmë këtë përpjekje të një mekanizmi të ardhur në Kosovë për të vendosur rendin dhe ligjin? Dhe, për çudi, nuk vendoset rendi dhe ligji, nuk vendoset drejtësia për t'i ndjekur njerëzit që vazhdojnë veprimtarinë kriminale në Kosovë. S'kemi asnjë zbardhje të veprave kriminale që janë kryer në Kosovë, qoftë të natyrës politike, qoftë të atyre ekonomike, qoftë kontrabandës dhe qoftë trafikëve të ndaluara. Dhe merren me një periudhë të lavdishme, e para së gjithash, të dhembshme të popullit shqiptarë dhe të shqiptarëve të Kosovës.

Unë mendoj që ky Parlament duhet të kërkojë nga Prokuroria, në rend të parë e Kosovës, e Republikës së Kosovës, nga prokuroria dhe prokurorët e EULEX-it të merren me ndjekjen e veprave kriminale dhe kriminelëve të vërtetë. Dhe vepra e kriminelëve të vërtetë mund të shihet në çdo fshat të Kosovës, se çdo fshat i Kosovës i ka varrezat e dëshmorëve, ka varrezat e martirëve, i ka varrezat e njerëzve të pafajshëm, të grave, pleqve, fëmijëve, që janë vepër e gjenocidit serb, një gjenocid që është ushtruar në Kosovë gati për një shekull të tërë.

Prandaj, kjo është ajo që ne duhet të ngrehim zërin dhe t'u kërkojmë atyre që t'i ndjekin kriminelët, jo njerëzit që kanë qenë viktimë, jo njerëzit që e kanë mbrojtur një popull të nëpërkëmbur. Dhe kjo duhet të jetë kërkesa jonë që të dihet fajtori i çdo masakre që është kryer në Kosovë, në çdo cep të saj, e janë kryer shumë masakra në Kosovë.

Është tepër e padrejtë të njolloset vepra e njerëzve për lirinë e vendit të vet, për lirinë e popullit të vet, e njerëzve që e kanë luftuar dhunën, që kanë luftuar kundër terrorit, kundër gjenocidit e spastrimit etnik.

Ne jemi vënë në pozitë të pabarabartë. Ne ndoshta kemi bërë një përpjekje që më shumë të merremi me të sotmen dhe të ardhmen tonë. Dhe dikush, realisht, e ka keqpërdorur këtë qëndrim dhe synim të mirë tonin. Prandaj, ne duhet të kërkojmë që të fillojë ndriçimi i çdo masakre që është bërë në Kosovë dhe të gjithë ata njerëz që i kanë bërë këto kanë emër e mbiemër. Prokuroria e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës e dinë kush ka qenë komandant i policisë në Drenas, kush ka qenë komandant i policisë në Rahovec, kush ka qenë komandat i policisë në Suharekë, kush ka qenë komandant i policisë... dhe ata janë një zinxhir qofshin si udhëheqës politik, qofshin si udhëheqës kriminelë të pushtetit policor dhe ushtarak – ata dihen, dokumentet janë, prandaj prokuroria e Kosovës nëse s'mund t'i sjellë ata për t'i dënuar, Prokuroria e Kosovës duhet të bëjë thjeshtë padinë kundër të gjithë atyre që janë përgjegjës dhe nëse faktori ndërkombëtar, në këtë rast EULEX-i do që të jetë në shërbim të rendit dhe të ligjit, le të vihet në mbrojtje të këtyre qytetarëve, të këtyre njerëzve që vërtet kanë dhënë shumë për vendin dhe popullin e vet. Ju faleminderit!

KRYESUESI HAVIT HALITI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Zoti kryesues i seancës,

Deputetë, kolegë të nderuar,

Ne sot po bisedojmë në disa nivele për një tragjedi - njërën prej masakrave të pashembullta që kanë ndodhur në Kosovë. Po them, është njëra, dhe nuk është e çuditshme që, meqë është vetëm njëra, masandej po përdegezohet problemi edhe në të tjera, për të arritur pa u sublimuar mirë te sistemi.

Është e natyrshme që kur bisedohet për një masakër të tillë, njerëzit flasin me emocione dhe kjo është plotësisht e natyrshme. Po, unë për veti nuk i pëlqej fjalimet retorike patetike të atyre që s'i

kanë emocionet, sepse ata që dëshmojnë, kurrë nuk flasin me patetikë dhe mund ta provoni gjithmonë. Pra, përpjekja është që arsyeshëm sot të bisedojmë për një temë që është shumë e madhe, shumë e rëndë.

Në diskutet tona politike të viteve të fundit kemi dëgjuar edhe në këtë foltore atë projektin, ta quajmë ne universal, për të mos thënë edhe klishezues – e po tash ne me të kaluarën nuk duhet të merremi, ne merremi me të ardhshmen. Kjo është formula më e padurueshme, më qesharake për një vend si ky i yni dhe për një popull si ky i yni.

Jo, jo, nuk duhet bash të harrohet asgjë dhe nuk duhet të falet asgjë. Sidomos nuk guxon të harrohet krimi dhe nuk guxon të falet krimi. Nëse në projektet e ashtuquajtura humanitare pajtimtare, që quhen gjithë njerëzore, mund të kërkohet një tip pajtimi, ai ndodh vetëm nëpërmes të dënimit të krimit. Të gjitha udhët tjera janë gënjeshtër dhe të pamundshme. Pra, nuk guxon të konfondohet, qysh ndodh këtu shpesh, falja dhe pajtimi. Janë dy kategori që s'kanë lidhje njëra me tjetrën. Te na edhe në të folurit e zakonshëm, edhe në këto raste konfondohen. Pra, krimi nuk harrohet, krimi nuk falet, krimi duhet të dënohet. Dhe, këtu afat nuk ka. Dikush e përmendi Wiesenthal-in e tjera. Absolutisht, s'ka afat.

Dhe, e dyta, ne po flasim këtu, domethënë, me kujtimet për ndodhitë, me përjetimet personale për ndodhitë dhe me obligimet që ka ky institucion dhe institucionet e Kosovës për ndodhitë. Më së pari krimet janë edhe individuale, në rastin tonë këtu, dhe në rastin e Dubravës dhe shumë raste të tjera krimi është i strukturuar. Nuk është problem i një njeriu që është i çmendur me kriminel. Ky është krim i strukturuar shtetëror dhe kjo kështu duhet të trajtohet.

E pra, nëse është krim i strukturuar shtetëror, dhe kjo është e vërtetë, dhe duhet të provohet, atëherë nuk është veç problemi i një prokurori, të Pejës u përmend këtu, a i Prishtinës a s'di i kujt, a i Kosovës. Shteti i Kosovës duhet të veprojë si shtet, në këtë rast. Dhe, të bëhet padi shtetërore e Republikës së Kosovës ndaj Serbisë për krimin dhe gjenocidin në Kosovë. Dhe këtu ne nuk kemi çka i shfajësohemi njëri-tjetrit.

Unë e dëgjova kryetarin e Parlamentit këtu, që është në ballë të institucionit më të lartë përfaqësues, ne kemi Qeveri, ne kemi kryetar shteti – kryetare shteti. Kurrkush, EULEX-i nuk vjen as s'mund ta ndalojë Kosovën të bëjë padi për gjenocid në Kosovë. Dhe nëse shkojmë ta pyesim atë, edhe mirë na e bëjnë nëse na ndalojnë, sepse do të thotë ti të drejtën tënde nëse nuk e ushtron, vetvetiu i jep të drejtë tjetrit të thotë - mos.

Pra, pika e reagimit institucional, jo për Dubravën, por për Dubravën dhe masakrat e tjera, duhet të organizohet me një padi shtetërore të Kosovës për gjenocid dhe krime lufte ndaj Serbisë, qysh e kanë bërë shtetet tjera. Ju e dini, Kroacia s'e tërheq. Ata bëjnë bisedime ndërshtetërore, po ftohemi – po nxehemi në raporte, por ata padinë s'e kanë tërhequr kurrë.

Kjo është ajo që duhet të bëhet në mënyrë institucionale. Tutje, mbeten ato që janë morale dhe njohëse. Unë në këtë pikë, e kam një të menduar specifik që e kam folur dy herë, në dy legjislatura të ndryshme.

Nuk mendoj që është produktive që këto situata shumë të dhembshme për Kosovën të interpretohen me pikëpamje politike që janë legjitime, mund me qenë të ndryshme, ose me

sensibilitete personale. Assesi! Të përpiqemi të shohim nga një largësi neutralizuese për ta parë problemin në thelbin e vet.

Pajtohem që të bëhen monumente për ndodhitë e rënda, që të mbahen në mend edhe në vendin e ngjarjeve. Po, unë edhe një herë po e përsëris. Unë mendoj se Kosova duhet të krijojë monumentin e kujtesës, po e them në njëjës, le të mbarohet kudo: Librin e kujtesës. Domethënë, të mbetet me vepër monumenti, dhe me shkrim, dhe me emra e me mbiemra të njerëzve që janë flijuar për këtë vend. Atëherë, do të kishim ditën e madhe të kujtimeve, ku çdokush përulet atë ditë dhe në mënyrën e vet saluton dhimbjen dhe ndodhinë. Kjo është edhe një herë që kap një kulturë popullore të kujtesës.

Dhe si instrument i gjithë këtyre është ajo që propozoi ministri i Drejtësisë. Po, po! Duhet të ketë institut që studion në permanencë ndodhitë – vrasjet e gjithë çka ka ndodhur në Kosovë dhe ajo është për të sublimuar arsyeshëm, me dëshmi të dhënat dhe gjithmonë do të mbetet dhe ajo që është kujtesë popullore e atyre që kanë provuar ferrin. Unë i ndjej! Unë i ndjej, se e pata provuar edhe vet qysh kaloi. Dhe ata janë kujtesa e gjallë që rri në mes jetës e vdekjes. Ajo është kujtesë që bëhet popullore. Prandaj, i ndjej posaçërisht.

Po, meqë isha me veprimin themelor shtetëror, unë edhe një herë po kujtoj. U përmend ky emri i këtij ministrit, këtij, ta quaj djali shpirtëror e luftarak, i Millosheviqit është ai, se si bir i tij është, qysh ta merrni. E pra, Kosova si shtet nuk ka nevojë këtu në Parlament fort edhe të përdegjëzojë mendimet personale. Le të dihet që nëse Kosova është shtet i pavarur, le të bëhet shtet sovran. Dhe nëse është shtet sovran, prej kryetares, e cila shpeshherë po thotë – jo unë s’prononcohem për probleme politike, e ka gabim se këtu funksion të mbretëreshës së Britanisë nuk ka, po ka të drejta e detyrime të jashtëzakonshme kushtetuese, pra prej kryetares, Qeverisë së Kosovës dhe Parlamentit tonë duhet thënë që ky është shtet i pavarur dhe s’ka ndarje të Kosovës dhe është keq që nuk thuhet në mënyrë unike, por thuhet përmes deklaratave kalimtare për shtyp, qoftë ai elektronik ose i ditës.

Këto institucione të Kosovës duhet thënë me një zë. Këtë masandej me një zë e bën edhe padinë e tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Time Kadrijaj!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në rrugëtimin drejt lirisë së Kosovës me shumë përpjekje e sakrifica shumë djem e vajza ranë në altarin e lirisë për të mos vdekur kurrë. Ky gjak i derdhur dhe qindra-mijëra jetë janë sot në themelet e shtetit të Kosovës dhe të së ardhmes të këtij populli. Vlerësohet se gjatë luftës së Kosovës forcat kriminale serbe vranë, ekzekutuan apo masakruan në forma më mizore rreth 14.000 shqiptarë, ku 90% prej tyre qenë civilë të pa armatosur, kryesisht gra, fëmijë, foshnje dhe pleq. Ndërsa, në anë të ndryshme të Kosovës janë dhunuar nga forcat militare dhe bandat shtetërore serbe afër 20.000 femra shqiptare. Ndërkaq, 3000 shqiptarë janë rrëmbyer dhe shumica prej tyre janë gjetur të vdekur nëpër varrezat masive në Serbi. Njësitë kriminale serbe, pas ekzekutimit të shqiptarëve gjatë tërë kohës janë përpjekur t’i fshehin gjurmët e krimeve duke varrosur e zhvarrosur disa herë trupat e shqiptarëve nga një vend në një vend tjetër ose duke i djegur dhe asgjësuar ato në mënyra të ndryshme.

Për më tepër, vlerësohet se gjatë luftës në Kosovë mars 1998 – qershor 1999 varrmihësit e Kosovës kanë shkatërruar dhe djegur pjesërisht ose tërësisht shumë vendbanime shqiptare, kanë shkatërruar dokumentet e identifikimit, letërnjoftimet e pasaportat, ndërsa pas përfundimit të luftës administrata pushtuese serbe ka sekuestruar dhe i dërguar në Serbi dokumentet e amzës, tapitë e dokumentet tjera të pronësisë private e kolektive të shqiptarëve.

Gjatë kohës së luftës në Kosovë ndodhën shumë masakra, si në Abri, Izbicë, Mejë, Krushë e Madhe, Reçak, Qyshk, Lubeniq, Suhareka dhe shumë masakra të tjera. Ndërsa, masakra e Dubravës për të cilën po debatojmë sot, është padyshim njëra ndër masakrat më të tmerrshme që njih historia.

Më 30 prill 1999 Burgu i Dubravës mbushet përplot me të burgosur shqiptarë të sjellë nga burgjet serbe dhe nga burgjet e Kosovës, qytetarë nga të gjitha anët e Kosovës. Qëllimi: skenari i përgatitur për masakrimin e tyre dhe akuzimi i NATO-s.

Në këtë kohë në Burgun e Dubravës kishte 1000 të burgosur. Grumbullimi i të gjithë këtyre të burgosurve në një vend paralajmëronte skenar të tmerrshëm, i cili më 22 maj u realizua në mënyrë më çnjerëzore.

Sipas të dhënave, në Burgun e Dubravës më 19-24 maj 1999, humbën jetën 150 të burgosur, kurse janë plagosur mbi 200 vetë, prej të cilëve mbi 120 rëndë. Në këtë burg gjendej edhe Ukshin Hoti. Më 17 maj 1999, do t'i mbushte 5 vite të vuajtjes së dënimit në burg. Ukshin Hoti u lirua më 16 maj 1999, domethënë të dielën, që është e pazakontë për administratën shtetërore të burgut që të punojë administrata dhe të lirojë të burgosur ditën e diele. Më tutje, askush nuk di se ç'ndodhi me Ukshin Hotin dhe me shumë të burgosur të tjerë. Një pjesë e kufomave të të masakruarve makineria ushtarake vrastare e Serbisë i varrosi më 25 maj 1999 në një varrezë masive në Rakosh, kurse një pjesë ish zhdukur me qëllim që të zvogëlonte përmasën e krimit dhe të fshihte mënyrën e ekzekutimit të tyre.

Të nderuar deputetë,

Kosova e ka paguar shumë shtrenjtë çmimin e lirisë. Po shtrohet pyetja, ku gjendet Kosova sot, a është kjo Kosova për të cilën luftuan djem dhe vajza më të dëshmuara atë kombit të radhitur në radhët e UÇK-së. A është kjo Kosova për të cilën u flijuan dëshmorët e kombit? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Mendoj që është koha për pauzë deri pas dreke, në orën 15:15.

#### Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Atëherë, të nderuar deputetë, po vazhdojmë me debatin. Në radhë është Xhevahire Izimaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Të respektuar mysafirë, ish të burgosur politikë nga masakra e Burgut të Dubravës, respekt edhe për kolegët që e kanë kaluar dhe janë të mbijetuar nga kjo masakër,

Ngjarjet nga 19 e 22 majit të vitit 1999 në Burgun e Dubravës tregojnë për detyrimin institucional të një kapërcimi kualitativ të hendekut ndërmjet të shkuarës dhe të ardhmes.

Konsolidimi institucional kërkon qasje të re vepruese në mënyrën e kalimit më të lehtë të këtij hendeku, e në këtë mes rol qenësor do të duhej të ketë trajtimi adekuat institucional për krimin në Burgun e Dubravës dhe krimet e masakrat tjera të karakterit masiv anekënd Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Të nderur qytetarë,

Dëshmitë mbi këto ngjarje tmerruese, por që tregojnë një realitet të ndodhur, tregojnë arsyeshmërinë e hapave të ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë për krijimin e Institutit të Drejtësisë dhe atij për Rrime Lufte.

Mendoj që diplomacia kosovare e ka nevojën e kuptimit të këtij kapërcimi në mënyrë që të mos shprehin ngurrimin e prezantimit të këtyre ngjarjeve tek homologët, por edhe opinionin ndërkombëtar karshi agresivitetit të paparë diplomatik serb, duke u prezantuar në rolin e viktimës.

Masakra në tri pavijonet e Burgut të Dubravës, masakra e Reçakut, e Studimes, e Mejës, e Krushës, e Izbicës, e tjerë – obligon institucionet vendore, por edhe shoqërinë mbarë kosovare për qasje të re dhe më fisnike për akterët e pësimit të tyre.

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se gjithash, këtu kam parasysh të gjithë të burgosurit politikë të cilët përjetuan tmerret e atyre ditëve të majit në Burgun e Dubravës, për të cilët duhet bërë trajtim e zgjedhje institucionale statusore në shoqëri.

Trajtimi adekuat institucional për këto ngjarje është testamenti më i mirë i cili siguron kalimin e vullnetshëm të zotërimeve të shkuara drejt të së ardhmes.

Deputetë të nderuar,

Ngjarjes në Burgun e Dubravës i duhet vënë emri i merituar, ndërsa shkaktarëve të atij krimi dhe ekzekutorëve të vrasjeve e plagosjeve të të burgosurve duhet dhënë dënim i merituar, për të bërë pra kapërcimin kualitativ të hendekut ndërmjet të shkuarjes sonë dhe së ardhmes tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Sevdije Lama!

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Po filloj fjalimin me përshkrimin e periudhës së përjetuar me fillimin e bombardimeve të NATO-s në Kosovë, në përgjithësi, e në veçanti përjetimin, frikën, trishtimin dhe tmerrin e qytetarëve shqiptarë të Gjakovës të përjetuar në pranverën e vitit 1999, të kryera me gjakftohtësi nga paramilitarë, ushtarë, policë dhe banorë fqinj serbë e malazezë të atëhershëm, të cilët ishin zbatues të politikës serbe për spastrim etnik të Kosovës.

Vuajtja dhe qëndresa e shqiptarëve të paarmatosur të Gjakovës dhe rrethinës së saj, në njëerën anë, dhe urrejtja, armiqësia dhe energjia e pashterur e njësiteve serbe, në anën tjetër, për të shkatërruar banesa, shtëpi, dyqane, lagje e fshatra të shqiptarëve, duke djegur pjesën më të madhe të qytetit, Çarshinë e Madhe, këtë vlerë të rëndësishme të kulturës materiale, duke plaçkitur çdo gjë, duke torturuar, masakruar njerëz të pafajshëm nëpër shtëpitë e tyre, duke i përzhënë nga shtëpitë dhe duke i dëbuar në Shqipëri. Ato ditë, e tërë pjesa perëndimore e qytetit e cila shtrihet rrëzë Kodrës së Çabratit, u zbraz nga banorët e saj të cilët u nisën në kolona të gjata për në Shqipëri, por të gjithë nuk e patën fatin të shkonin atje dhe të shpëtonin nga kthetrat e ferrit serb. Shumica e meshkujve u ndanë nga familjet e tyre, djemtë nga prindërit e motrat, burrat nga gratë dhe fëmijët e tyre. Në këto kolona civilësh të dëbuar, ata arrestuan shumë meshkuj, shumë prej të cilëve humbën çdo gjurmë, ndërsa nga 155, ata e krijuan grupin të ashtuquajtur “grupi i Gjakovës” i cili u arrestua me akuzën për terrorizëm dhe përjetoi masakrën e Dubravës së bashku me të burgosurit tjerë, ku gjithsej numri i tyre arriti në 960. Nga ky grup, 9 prej tyre u vranë në masakrën e Dubravës, duke iu bashkëngjitur numrit total të të vvarëve në 124. Pas kësaj, të mbijetuarit e masakrës së Dubravës, ashtu të dërmuar dhe shumica prej tyre të plagosur, u transferuan në burgjet e Serbisë. Fati i zi i këtyre njerëzve dhe shtegtimi i tyre nëpër të gjitha rrathët e ferrit serb, arriti deri te vendimi për fillimin e hetimeve KI Numër 201/989, të lëshuar me datën 23.12.1999, nga gjykata e qarkut të Leskovcit dhe akuzën e Prokurorisë publike të qarkut të Leskovcit, ku 143 vetë u dënuan me mbi 16 shekuj, përkatësisht me 1.632 vjet burg.

Po vazhdoj fjalimin me dy thënie të njerëzve të mëdhenj, e para nga Nelson Mandela: “Vetëm njerëzit e lirë mund të negociojnë, të burgosurit nuk mund të bëjnë marrëveshje. Liria jote dhe e imja nuk mund të ndahen”, si dhe të Martin Luter King: “Ne dimë nga përvoja e hidhur se shtypësi kurrë nuk ta ndanë lirinë vullnetarisht. Ajo duhet të kërkohet nga të shtypurit”. Për bëme të keqe kaq të madhe, të bërë nga kriminelët serbë, qëllimi është jo për të shkaktuar urrejtje, por për të kërkuar drejtësi. Në kontekst të asaj, kombi serb nëse dëshiron t’i bashkohet esencialisht botës së qytetëruar, e presin detyra të vështira. Ai duhet t’i thotë stop politikës hegjemoniste të mbështetur mbi elaboratin për zhdukjen e shqiptarëve. Në radhë të parë, ai duhet të denasifikojë shtetin dhe kulturën serbe. Hap i parë në këtë drejtim do të ishte që shteti serb t’i kërkojë zyrtarisht falje shqiptarëve për krimet shtetërore të bëra mbi ta dhe të fillojë kompensimin e dëmeve të shkaktuara me luftën e vet pushtuese. Përndryshe, asgjë e mirë nuk do të ndodhë derisa Serbia vazhdon që nga pozita e pafajshmërisë së vet të akuzojë dhe sanatozë shqiptarët.

Si përfundim, propozoj të formohet një komision parlamentar ad-hoc në bashkëpunim me EULEX-in, juristë, sociologë, neuropsikiatër, përfaqësues të burgosurve në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar, Këshillin për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, i cili obligohet të bëjë konstatimin e saktë të masakrës në Burgu në Dubravës, si dhe pasojat e ndodhura prej datës 19 deri 25 maj e tutje, detyra e të cilit do të ishte:

1. Konstatimi i saktë i numrit të të burgosurve në ditën e masakrës, të vvarëve, të plagosurve dhe të traumatizuarëve, të cilët përjetuan masakrën e Dubravës;
2. Identifikimin e kryerësve të këtyre veprave, e cila pa dyshim duhet të konstatohet se është gjenocid dhe të iniciohet procedurë penale ndaj tyre dhe të gjykohen nga gjykatat kompetente të Republikës së Kosovës me qenë se gjenocidi ka ndodhur në territorin e Republikës së Kosovës; dhe

3. Të obligohet Republika e Serbisë në kompensimin e dëmit, i cili është pasojë e gjenocidit, e kjo të jetë pjesë e bisedimeve që janë duke u zhvilluar në mes të dy shteteve.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Vjosa Osmani e ka fjalën!

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Katër konventat e Gjenevës dhe e drejta zakonore e luftës janë obligim për të gjitha shtetet në botë, pavarësisht a i ka nënshkruar ato apo jo, sepse kanë fituar karakterin jusk-ogens, pra karakterin e normës ndaj të cilës nuk lejohet derogimi dhe për të cilën këto shtete nuk mund t'i ikin përgjegjësisë.

Me masakrën e Dubravës Serbia ka shkelur parimet kryesore të këtyre konventave, ka përdorur robërit e luftës si mburojë të gjallë, ka trajtuar civilët si të burgosur të luftës derisa Konventa e Gjenevës për robërit e luftës parasheh që si kategori e të burgosurit të luftës mund të konsiderohen vetëm ata që kanë marrë pjesë në luftime e assesi popullata civile, ndaj robërve të luftës ka kryer të gjitha veprimet e ndalura me Konventën e tretë të Gjenevës si vrasjet, torturat dhe trajtimi i tillë i robërve të luftës që ka çuar deri te vdekja e tyre.

Pikërisht me këto veprime e shumë masakra të ngjashme, Serbia ka dëshmuar jo vetëm qëllimin e vet për krime lufte, por mbi të gjitha qëllimin e vet gjenocidal për shfarosjen e popullit shqiptar në Kosovë. Derisa kryerja e të gjitha këtyre krimeve është ende barrë në krahët e Serbisë për të cilën ajo do të duhej të kishte edhe përgjegjësi politike-juridike, si individuale për kriminelët që ishin të involvuar në ato krime, ashtu edhe përgjegjësi shtetërore.

Qeveria jonë ulet përballë po asaj Serbie që ende nuk ka kërkuar falje për asnjë nga këto krime. Është po kjo e njëjta Serbi që ka kryer vrasje e tortura mbi të burgosurit në Dubravë dhe në fund i ka përdorur ata si mburojë të gjallë. Është po kjo e njëjta Serbi, e cila, duke tentuar shfarosjen e popullit shqiptar në Kosovë ka vrarë dhjetëra mijëra civilë, ka shkatërruar 128.000 shtëpi dhe ka kryer veprime tjera që paraqesin shkelje të rënda të konventave të Gjenevës. Është po kjo e njëjta Serbi që nuk bashkëpunon me Tribunalin e Hagës për dorëzimin e kriminelëve të luftës. Është po kjo e njëjta Serbi që po vazhdon financimin e bandave kriminale në veri të vendit dhe është po kjo e njëjta Serbi me qëllimet po të njëjta ndaj Kosovës që masakrën e Dubravës e mbronte dhe arsyetonte në Tribunalin e Hagës nga Obrad Stefanoviq dhe tani i ka po të njëjtat qëndrime nga një Stefanoviq tjetër, i cili në Bruksel e edhe në Kosovë përfaqëson politikën mohuese serbe ndaj krimeve që i ka kryer në Kosovë, derisa Qeveria e Republikës së Kosovës nuk kërkon përgjegjësi për këto krime, as në Këshillin e Sigurimit, as në Bruksel, por përkundrazi, duke harruar historinë, rrezikon të na përsëritet ajo dhe të gjithë ata kriminelë që kanë kryer këto krime të mbesin pa u përgjigjur penalisht.

Nëse dëshirojmë që të ndryshojë qëndrimi i Serbisë ndaj Kosovës, ne duhet të fillojmë nga vetvetja dhe mos të tentojmë t'i fshijmë këto krime nga kujtesa e historia, duke ia fshirë kështu edhe Serbisë përgjegjësinë që e ka për këto krime sipas të drejtës ndërkombëtare. Derisa, fatkeqësisht, për momentin Kosova nuk mund të iniciojë rast në GJND, siç u tha nga disa deputetë, meqë është parakusht ligjor që të jesh anëtar i Kombeve të Bashkuara, përkrahim

fuqimisht përgatitjen nga Ministria e Drejtësisë për përkrahjen e dosjes, përgatitje e cila duhet natyrisht të fillojë nga tani edhe pse është pak vonë. Ne, si deputetë, e po ashtu edhe Qeveria e Kosovës nuk duhet ndalur së kërkuari që të kryhen hetimet dhe të procedojmë me këtë rast dhe për shumë masakra të tjera nga organet e drejtësisë, hetimet pra të procedohen nga organet e drejtësisë si në Kosovë, ashtu edhe në Tribunalin Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavinë, i cili e ka këtë mandat ligjor.

Megjithatë, nëse ne heshtim për këto masakra, nuk duhet të presim që të tjerët të kërkojnë dënimin e këtyre krimeve, të cilat nuk kanë afat të parashkrimit. Qytetarët e Republikës së Kosovës nuk mund dhe nuk janë të gatshëm të harrojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Të faleminderit! Deputeti Afrim Kasolli! Regjia, ju lutem deputetit Afrim Kasolli, mikrofonin!

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë nuk do të ndalem edhe aq shumë në përshkrimin faktografik të Masakrës së ndodhur në burgun e Dubravës, pasi këtu u tha në mënyrë shumë të qartë nga parafolësit tjerë. Por, ajo që është më brengosëse për këtë ngjarje, ka të bëjë me faktin se pse edhe pas kaq vitesh nuk ka ndodhur hetimi i akterëve të këtij krimi dhe kjo simptomatiksht tregon gjendjen e mjerë se ku është katandisur sistemi vleror, shoqëror dhe politik në Kosovë, në përgjithësi, ai juridik në veçanti. Pra indolencia e mekanizmave juridik për ta shqyrtuar dhe gjykuar këtë ngjarje në njëfarë mënyre e pasqyron kolapsin e strukturave politike, administrative dhe institucionale si ndërkombëtare ashtu edhe vendore, si dhe shpreh rrënimin e premisave të një shteti ligjor demokratik. Fillimisht duhet pohuar se kjo qasje nuk është një dukuri aksidentale dhe një rast i izoluar i kësaj shoqërie, sepse në këtë vend ka edhe raste të tjera të ngjashme që nuk janë hetuar dhe gjykuar krimet e ndodhura, por ajo buron nga konditat strukturore që janë etabluar në Kosovë që nga përfundimi i luftës dhe deri më sot dhe paradigma e këtij rendi ka qenë suspendimi i drejtësisë për hir të kriterëve politike, si dhe instalimi i atij modeli të njohur që teorikisht njihet si banaliteti i së keqes e që shprehet në atë formulën e njohur – të gjithë janë fajtorë.

Prandaj, edhe mungesën e procedimit për gjykim të këtij rasti, si dhe të tjera të ngjashme, duhet kundruar pikërisht si shprehje të këtyre fenomeneve që përgjithësisht si model e përmban brenda vetes virusin vetëshkatërrues të sistemit të drejtësisë, pasojat e të cilit jemi duke i vuajtur që sa kohë e me gjasë do t'i vuajmë edhe në vitet në vijim.

Pra, ky rast duhet të na ndërgjegjësojë mbi njërin nga shkaqet kryesore të krizës së përgjithshme brenda të cilit është kapërthyer kjo shoqëri tash e sa kohë. E para, kjo tregon se edhe pas kaq vitesh ne jemi duke u përballur me një drejtësi të munguar, e mungesa e drejtësisë e shpërfillë njërin nga parimet më të njohura të civilizimit perëndimor të artikuluar thuaja se në formë kategorike dhe trajtën e imperativit vleror se nuk ia vlen barra qiranë të jetohet në një botë ku mungon drejtësia. Pra, është pikërisht drejtësia ajo vlerë e cila i jep kujtim jetës dhe e bën atë që njeriu të hetojë me nder dhe dinjitet, kurse në mungesë të kësaj kjo është arsyeja që jeta në Kosovë vazhdon të mbetet e pakuptimtë dhe e pa shpresë për të gjallët dhe pa respekt institucional për të vrarët. Në këtë kontekst, ky aspekt shpreh edhe krizën e vetëdijes historike dhe politike në cilën është kapërthyer dhe zhytur politika zyrtare dhe institucionale e Kosovës. Paradoksalisht, me gatishmërinë e saj për të hyrë në gjithfarë lloj negociatash e duke bërë fjalë

për nevojën e një pajtimi gjoja historik ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve paraprakisht pa u vendosur dhe instaluar ende drejtësia për atë që ka ndodhur, kjo politikë e bën ofendimin tjetër moral ndaj këtyre viktimave.

Esencialisht, është nevojë imediate ndryshimi i kësaj strategjie, sepse vetëm duke kërkuar dhe promovuar drejtësi për të rënë para çdo aspekti tjetër, ne detyrohemi që ta ruajmë përjetësisht ekzistencën e tyre në mesin e të gjallëve dhe kështu veprimtaria e tyre do të mbetet në kujtesën e brezave të mëvonshëm. E dihet se kujtesa dhe drejtësia tradicionalisht janë konsideruar si themele qenësore për jetë të shëndoshë politike në një shoqëri, vlera të cilat këto fatkeqësisht sot janë përvertuar në vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Me thënë të drejtën, e kisha dilemën a të flas tash, pasi që u thanë shumë sende apo jo. Megjithatë, në emër të gjithë atyre bashkëvuajtësve të mi, më takon edhe të flas.

Dubrava, ky burg që mund të quhet kamp i përqendrimit, ku regjimi serb kishte mbledhur të burgosurit nga të gjitha kazamatet e Serbisë - shqiptarët pra, që vuanin dënimin në kohëzgjatjen, edhe kishte qëllime të caktuara, i mblodhi në Dubravë dhe sigurisht edhe në burgjet tjera, por në Dubravë definitivisht për një skenar të paracaktuar. Dhe nuk ishte rastësi që pikërisht këtu të ekzekutohen 150 të burgosur dhe të masakrohen me qindra të tjerë. Dhe shumë prej tyre që e përjetuan këtë masakër, edhe sot vuajnë nga sindromi postraumatik. Dubrava, që është një masakër që ka adresë dhe bartësit e kryerjes së masakrës, pasi që dihet se ishte institucion i Qeverisë së Serbisë, institucion që qeverisej nga persona të caktuar dhe iu dihen edhe emrat e gardianëve dhe policëve që ushtronin aty dhunën dhe terrorin.

Një heshtje shumë e gjatë e jona dhe e institucioneve ndërkombëtare, e jona ndoshta jo me insistim të mjaftueshëm, edhe pse përherë u insistua që të paktën të ruhet edhe ndërtesa e objektit, ashtu siç ishte pas masakrës, si monument që flet vet. Por, edhe kjo nuk ndodhi. Sot ka pak gjurmë nga ajo masakër.

Heshtja e UNMIK-ut dhe e institucioneve tjera ndërkombëtare ndoshta “në emër të pajtimit”, “të dialogut”, ose të një momenti kur do të na mund harresa, edhe pse dihet se harresa nuk i zhduk krimet.

Bombardimi i NATO-s mund të jetë një shkas, por dihet se ky bombardim nuk ishte gabim, kur dihej se në burgjet, siç ishte Dubrava dhe Lipjani, ekzistonin sistemet antiraketore, aty gjithashtu fshiheshin forcat militare në masë të madhe, qofshin ato edhe paramilitare, për mua janë krejt njësoj. Dhe, ky ishte rrezik i përhershëm edhe për të burgosurit, pra edhe vetë fakti.... Në një rast, do ta përmend një rast kur në Burgun e Lipjanit, sistemi antiraketor u prish, do të thotë u bombardua dhe pas gjashtë ose dhjetë ditësh u ndërrua me sistem të ri. Pra ekzistonte rreziku i përhershëm.

Burgu i Dubravës veçohet për shkak të shkeljes së veçantë të drejtave të njeriut dhe këtu për shkak të sjelljes ndaj të burgosurve, ndaj të plagosurve, ndaj të sëmurëve, ekzekutimi i të burgosurve dhe shumë shkelje të tjera të drejtave të njeriut, që i tha edhe kolegja ime në detaje.

Jam dëshmitare e sjelljes së gardianëve ndaj të plagosurve, kur ata nga Burgu i Dubravës u sollën në Burgun e Lipjanit, kur kordonët e gardianëve dhe të policëve po i prisnin ata me pendrek në dorë dhe me shumë fyerje, edhe pse të plagosurit ende i kishin gjurmët e gjakut dhe të plagëve të pa mjekuara.

Për torturat dhe sjelljet ndaj të burgosurve nuk është momenti dhe as vendi që të flasim, por sigurisht tani po na jepet një mundësi tjetër që këto t'i dëshmojmë. Pse të burgosurit u dërguan në Serbi si pengje të luftës, pikërisht atëherë pas lidhjes së marrëveshjes së Kumanovës, kurrë s'e kemi ngritur këtë çështje. Cili ishte qëllimi final i Serbisë për t'i marrë këto pengje. Në autobusët që po i bartnin, të plagosur kishte edhe femra. Unë mund të flas vetëm për një moment të torturës, kur trupat e këtyre femrave nga tortura kishin ngjyrën e rrobave të mia që i kam tani. Sigurisht, tortura edhe në kuadër të bartjes në Serbi po vazhonte, sikur që vazhdoi edhe pasi përfundoi lufta, kur ata u dënuan dhe kur burgjet u dogjën dhe nuk ishte një shkak qysh e prezantoi Qeveria e Serbisë, por sigurisht që shkak ishte të likuidohen të burgosurit shqiptarë, pasi që ata ishin pikërisht të njëjtit gardianë dhe eprorë që ishin në burgjet e Lipjanit dhe të Dubravës.

Këtë gjithashtu mund ta dëshmojë si dëshmitare kurdo që Qeverisë së Kosovës i duhen këto dëshmi. Drejtori i burgut të Dubravës shërbente në burgun e Pozharevcit, aty ku ishin shumica e të rinjve, do të thotë të burgosur politikë dhe shumë të rrezikuar. Ka mjaft elemente për ndërtimin e kallëzimit penal. Para katër vjetësh u dha një kallëzim penal, por çuditërisht ai ende ndodhet në sirtar. Ndoshta është mirë, sepse duhet plotësuar këtë kallëzim në një kallëzim ndaj Qeverisë së Serbisë për dhunën, terrorin dhe gjenocidin që ajo e bëri në Kosovë.

Sot ngriten çështje për të balancuar krimin, do të thotë shteti i Serbisë me shtetin të cilin e kishte okupuar dhe rrënuar tërë institucionet e tij, një shtet okupues ndaj një force mbrojtëse të Kosovës, siç ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Madje, ngritet një Dick Marty dhe akuzon Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në bazë të memoareve ose shënimeve të zonjës prokurore të Hagës, e cila ato shënime i mbështet në të dhënat e UDB-ës.

Kjo është, sikur thotë fjala e urtë, sepse Qeveria e Serbisë ka vepruar gjithnjë në stilin – t'iu them para se t'ma thonë. Prandaj, edhe unë mendoj se pikërisht ajo e akuzon Kosovën për krime të paparamenduara, për krime që mund t'i ketë bërë vet. Dhe këtë diskutim timin, e mbështes në varrezat masive të Batajnicës, pasi që dihet se atje u vranë dhe u morën kufomat, u grabitën dhe u varrosën, u bë përpjekje që ato të zhduken, të hidhen në lumë, të digjen, por u varrosën në fund në varrezat masive në një vend ku ushtroheshin forcat militare të Serbisë.

Tani dihet se, pas eskumimit të këtyre varrezave se këtu ka pasur edhe të gjallë, të ekzekutuar dhe të djegur. Pyes, ndaj këtyre viktimave të gjalla, mos ka ndodhur ajo që Serbia tani akuzon Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, sepse Serbia ka pasur mundësi, ka pasur institucione dhe shëndetësi të lartë, ka edhe sot që mund t'i shfrytëzojë organet.

Kërkoj nga Ministria e Drejtësisë dhe si përmbledhje ndoshta e këtij debati, që Ministria e Drejtësisë të ngritë akuzën e gjenocidit me këto fakte, ku do të përfshihet edhe Burgu i Dubravës në veçanti, në detaje. Kërkoj nga Ministria e Drejtësisë dhe UNMIK-u ose organet tjera që tani e zëvendësojnë, që të ketë ekzemplarin origjinal të eskumimit të varrezave në Batajnicë.

Si përfundim, unë i bashkohem akuzës së përgjithshme dhe pajtohem me diskutimin që e tha Sabri Hamiti: akuza nuk na ndanë në parti dhe në ata që morën dhe s'morën pjesë. Akuza do të

jetë akuzë e shtetit të Kosovës, kundër shtetit të Serbisë. Për ta ndërtuar paqen, paqja ndërtohet vetëm atëherë kur akuzohet kryerësi i krimit dhe këtë nuk e marrin përsipër ata që nuk kanë faj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Burim Ramadani e ka fjalën!

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara deputete e deputetë,

Duke dëgjuar edhe përjetimet e kolegëve tanë, s'ka se si s'na kujtohet se periudha e para 12 vjetëve ka qenë e mbushur me akte të organizuara kriminale e gjenocidiale dhe terroriste nga shteti i Serbisë kundër popullatës shqiptare në Kosovë. Pra, kemi pasur të bëjmë me një strategji të qartësuar, detajuar dhe të paramenduar nga shteti i Serbisë.

Tek e fundit, ne të gjithë e dimë se politikat fashiste të Millosheviqit nuk janë ideuar dhe nuk kanë filluar nga Millosheviqi. Ato kanë qenë strategji nacionale serbe kundër popullatës shqiptare në Kosovë për më shumë se një shekull.

E dimë që edhe para një shekulli shqiptarët etnikë nga Kosova i janë nënshtruar dhunës së mbretërisë serbe, menjëherë gjatë edhe shpërbërjes së perandorisë osmane, duke kujtuar këtu që qytetet lindore të Kosovës janë spastruar dhe në Kosovë janë vendosur refugjatët të cilët për më shumë se 100 vjet njihen si muhaxhirë.

I njëjti sundim, me të njëjtat qëllime, me të njëjtat metoda janë përdorur pothuaj se gjatë tërë shekullit të kaluar me synimin e vetëm që të ketë spastrim etnik të shqiptarëve nga Kosova. Kjo strategji që ishte përdorur edhe në rajonin e Nishit dhe Leskovës, është përdorur edhe në fund të shekullit të kaluar.

Të nderuar, i përmenda këto fakte shumë shkurtimisht vetëm për të rikujtuar edhe një herë se nëpër çfarë periudhe kemi kaluar, kush na i ka bërë këto dëme dhe domosdosmërisht për të parë veten se ku jemi sot. Absolutisht, mendoj se duhet të mbështesim edhe nisjen për paditjen e Republikës së Serbisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë për tentim gjenocidi në Kosovë dhe normalisht edhe gjykimin e secilit kriminel veç e veç. Dhe, vetëm pas dënimit të Serbisë, për bindjen time, mund të fillojë ajo që njihet si tejkalim final i konfliktit në mes shqiptarëve të Kosovës dhe shtetit të Serbisë.

Jemi dëshmitarë se gjatë këtyre muajve kemi dëgjuar deklarata të ndryshme të Qeverisë së Kosovës se me bisedime të tashme po tejkalohet konflikti në mes shqiptarëve të Kosovës dhe Serbisë ose shtetit të Serbisë dhe, për bindjen time, kjo është e pamundshme, të paktën për situatën në të cilën jemi dhe pa pasur drejtësi ose vendosje të drejtësisë për strategjinë nacionale që e ka pasur Serbia. Thjeshtë, në situatën që jemi sot, në Kosovë normalisht që, për bindjen time, po përballemi me goxha elemente paradoksale dhe shpesh edhe të pa ndershme. Thënë me një formë tjetër, tjetër po flasim e tjetër po veprojmë. Dhe, ja tri elemente që po dua t'i them:

Së pari, desha të them që Qeveria shkon në bisedime me Serbinë, ajo nuk e ka përkrahjen e shumicës shqiptare në Kuvend dhe të njëjtën kohë thotë se këto bisedime do ta përmbyllin konfliktin në mes shqiptarëve të Kosovës dhe shtetit të Serbisë.

Së dyti, në situatën ku jemi sot, luftëtarë e komandantë të Luftës çlirimtare të Kosovës përballen me procese gjyqësore brenda dhe jashtë vendit. E dimë që zoti Ramush Haradinaj është rindaluar në Tribunalin e Hagës, ndërsa në rastin e brendshëm, kemi Blerim Kuqin, i cili dënohet me 30 ditë burgim sepse refuzon të hyjë në lojërat politike të dikujt, qofshin brenda, qofshin jashtë vendit.

Dhe, së treti, këto ditë dalin njerëz tjerë, patriotë tjerë që flasin se kanë urdhëruar për vrasje ose për arrestime gjatë kohës së luftës brenda luftëtarëve të lirisë. Ne duhet të kontribuojmë për të zbardhur të vërtetën dhe ne të gjithë e dimë se e vërteta e dënon Serbinë, prandaj ky do të ishte apeli që do të doja të thosha tash, që e vërteta për të cilën ne duhet të kontribuojmë është ajo e vërtetë me të cilën duhet të dënohen ata që e kanë bërë agresionin, e që është Serbia. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Kurtan Kajtazi!

KURTAN KAJTAZI: I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Sot po debatohet për një temë tepër të ndjeshme, tepër mizore, një ndër veprat më të shëmtuara që okupatori serb i ka kryer në Kosovë gjatë luftës së fundit, për një vepër që ky Kuvend është dashur të ketë ndonjë seancë të veçantë ku do të diskutohej edhe për dhjetëra e qindra masakra të tjera që janë kryer kudo anembanë trojeve të Kosovës. Një ndër këto masakra është edhe masakra e Studimes, ku vetëm brenda dy orësh, në prani të nënave dhe fëmijëve janë vrarë dhe masakruar mbi 100 persona të moshave të ndryshme, madje edhe fëmijë dhe gra shtatzëna.

Po ashtu, po afrohet dita e 22 majit, 12 vjetori ku në po të njëjtën rrugë “22 maji” që për hir të tyre mban këtë emër, në Vushtrri janë rrëmbyer mbi 100 persona në prezencë të prindërve dhe fëmijëve të tyre, djem dhe vajza të përzgjedhur dhe po ashtu nga familje të përzgjedhura që sot e pas 12 vitesh nuk dihet asgjë për fatin e shumicës prej tyre, ndërsa një pjesë e tyre janë kthyer në arkivole.

Për masakrën e Dubravës, Studimes, Obrisë, Krushës, Çirezit dhe masakrave tjera në Kosovë, për personat e zhdukur kudo në Kosovë akoma drejtësia vendore dhe ajo ndërkombëtare e instaluar këtu, qoftë UNMIK-u më herët dhe qoftë tash EULEX-i, nuk e kanë kryer punën e tyre. Madje, po shkohet aq larg sa edhe përmes Parlamentit Evropian me njerëz si Dick Marty që sajojnë akuza mbi bazën e thashethemeve, nëpër kuluare e kafene po tentohet që para qytetarëve të Evropës të krijohet bindja se në Kosovë gjatë luftës serbët kanë qenë viktimat dhe jo qytetarët e pafajshëm shqiptarë. Po mbi bazën e thashethemeve dhe me tendencë të caktuar burgjet e Kosovës janë mbushur përplot me ushtarë të UÇK-së, ndërsa kriminelët e të gjitha këtyre masakrave sillen kudo të lirë.

Për shumicën e këtyre masakrave ka dëshmitarë të gjallë që i dini me emër dhe mbiemër kush janë kryerësit e masakrave, madje shumë institucione kanë përgatitur dosje për ta, prandaj institucionet ndërkombëtare të instaluara në Kosovë për hulumtimin e krimeve të luftës kanë arsye që pika kryesore e orientimit të tyre të jetë në këtë drejtim.

Pas debatit dhe pas konkluzave që do të nxirren nga ky debat, mendoj se bashkësia ndërkombëtare do të duhej ta shqyrtojë partneritetin me Serbinë deri sa kryekriminelët dhe kriminelët jetojnë të lirë dhe nuk dalin para gjyqit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Elmi Reçica e ka kërkuar fjalën, e ka një propozim të mirë, ndoshta!

ELMI REÇICA: Përshëndetje, i nderuar kryesues,  
E kam një propozim për hir të racionalizimit të punës. Propozoj që të hidhet në votim që t'i shkurtojmë diskutimet në pesë minuta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë edhe unë jam dakord, besoj se edhe grupet parlamentare, dhe ta bëjmë pesë minuta diskutimin. Megjithatë, po votojmë formalisht. Janë edhe 12 të paraqitur, a jeni për ta bërë 5 minuta diskutimin? OK, në rregull, shumica janë.

Atëherë, regjia, 5 minuta është diskutimi. Fjalën e ka deputetja Lumnije Morina!

LUMNIJE MORINA: I nderuar kryesues i Kuvendit,  
Ministër,  
Të nderuar deputetë,  
U bënë gati 12 vjet që nga përfundimi i luftës dhe plaga e masakrës së burgut të Dubravës mbeti e pa mbyllur.

Nuk u trajtua asnjëherë krimi shtetëror serb mbi të burgosurit e këtij burgu, të cilët sipas ligjeve të luftës duhet të ishin kategori e mbrojtur. Se ka qenë e planifikuar mirë nga Serbia një masakër e tillë, tregon fakti se një herë i largojnë nga Kosova të gjithë të burgosurit politikë, gjoja për shkak të sigurisë së tyre, por prapë i kthejnë për të realizuar atë çfarë kanë planifikuar.

Qeveria e Serbisë i shfrytëzoi bombardimet e NATO-s si alibi për të kryer më pas masakrën mbi të burgosurit në burgun e Dubravës. Secila pjesë e Kosovës i ka të mbijetuarit e kësaj masacre, të cilët janë dëshmi e asaj se çfarë ka ndodhur.

Edhe komuna e Ferizajt i ka të mbijetuarit e masakrës së Burgut të Dubravës, disa prej të cilëve kanë qenë edhe të plagosur, disa prej të cilëve edhe nuk i kanë mbijetuar kësaj masacre.

Që nga momenti i arrestimit, të burgosurit politikë shqiptarë janë keqtrajtuar nga organet e hetuesisë, por edhe nga policët në mënyrën më mizore.

Të nderuar deputetë,  
Dua të përmend me këtë rast konstatimin e Natsha Kandiqit, drejtuese e Fondit për të Drejtën Humanitare, për 13 të burgosurit politikë të komunës së Ferizajt, e cila thotë, po citoj: "Grupi i Ferizajt njihet si grupi më i torturuar në ish Jugosllavinë që nga Lufta e Dytë Botërore". Konstatimi i saj bazohet në faktin se me torturë mizore u mbytën nga pushteti serb të burgosurit politikë Rexhep Bislimi e Cen Dugolli. Ndërsa për fatin e avokatit të këtij grupi Alishefik Spahiu, i cili ngriti padi penale kundër sigurimit të shtetit serb për shkak të keqtrajtimit të këtij grupi gjatë hetuesisë, ende nuk dihet. U arrestua nga punëtorët e sigurimit shtetëror serb dhe ende rezulton si i zhdukur.

Të nderuar deputetë,

Në Tribunalin e Hagës lufta e drejtë e popullit shqiptar po ndëshkohet duke u iniciuar procedura penale për luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me dëshmitarë të koduar si x e y, ndërsa rastet e shumta të gjenocidit serb antishqiptarë të dëshmuara me dëshmitarë jo të koduar, por me emër e mbiemër e me adresë, nuk po ndëshkohen.

Konsideroj që përgjegjësit e krimeve duhet të dalin para drejtësisë dhe këtë drejtësi duhet ta vendosin institucionet e Kosovës. Ka fakte mendoj të mjaftueshme që të dëshmohet se gjenocidin mbi popullin shqiptarë Serbia e ka bërë në mënyrë institucionale duke i shfrytëzuar mekanizmat e saj shtetërorë, ushtrinë, policinë dhe burgjet.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Halit Krasniqi, a është këtu. Po, urdhëroni!

HALIT KRASNIQI: I nderuar kryesues,

I nderuari ministër,

Të nderuar dhe të respektuar kolegë deputetë,

Iniciativa e deputetit Nait Hasani për masakrën e Dubravës, nga e cila ka mbijetuar dhe është dëshmitar i kësaj masakre, është një ide e qëlluar.

Masakra e Dubravës është një ngjarje e rëndë që ka adresë dhe në këtë adresë duhet të kërkohet ndëshkimi i gjithë protagonistëve që urdhëruan dhe që zbatuan krimin. Gjithashtu, duhet të kërkohet përgjegjësi për të gjithë ata që urdhëruan dhe zbatuan të gjitha krimet dhe masakrat që i bënë në Kosovë.

Të gjitha familjet e të vrarëve në mënyrë mizore dhe të gjithë të plagosurit, nuk mund të kompensohen materialisht në asnjë formë. Por, edhe kompensimi duhet të kërkohet dhe kjo duhet të ndodhë, ndërsa për të zhdukurin në Burgun e Dubravës, magjistër Ukshin Hotin duhet të insistohet me çdo kusht, në çdo takim me përfaqësuesit serbë, që të bëhet informacioni i plotë për fatin e tij. Këtë insistim duhet ta manifestojmë në mënyrë institucionale dhe jo këtë temë ta trajtojë vëllai i tij këtu deputetë, apo motra e tij kudo dhe kurdo. Ukshin Hoti nuk i takon familjes së tij, tanimë, as vëllait, as motrës, madje as fëmijëve të tij, të cilëve nuk kishte mund t'iu përkushtohet plotësisht në masë të duhur, sepse ndërgjegjja e tij kishte bërë një kërcim kualitativ shumë të lartë, duke besuar thellësisht se vetëm një angazhim maksimal dhe tejet i vendosur në maksimën e tij -bëre ose vdis- sjell perspektivë për këtë vend dhe për këtë popull, me përkushtim dhe vendosmëri në rrugën e qëndresës për të ndërtuar fortesën e lëvizjes çlirimtare me devotshmëri i gatshëm për flijime për të lindur këtë popull si feniksin.

Të nderuar e të respektuar kolegë deputetë,

Nëse vazhdojmë të tolerojmë autorët e krimeve në të kaluarën tonë të hidhur dhe tragjike, do të ndeshemi në vazhdimësi me pasojat që do të prodhojnë ata. Unë do t'i ilustrtoj telegrafikisht vetëm dy shembuj nga shumë prej tyre.

Njëri nga dëshmitarët në njërin nga gjykimet për motive të kohës së luftës, është një kriminel që ka ushtruar dhunë e tortura dhe është i implikuar në vrasje në burgun e Pejës në vitet '80 dhe dëshmitarët që kanë parë me sy janë të gjallë.

Ndërsa, rasti tjetër që do të duhej të dënencuhej dhe të ndëshkohej nga forca e ligjit për dhunë dhe tortura që ka ushtruar, po në burgun e Pejës me kolegun e parë, pas luftës ka qenë njëri nga protagonistët e nëntokës së një shërbimi, i cili është i identifikuar me një adresë politike, në të cilën adresë ka depërtuar dhe falë indiferencës sonë.

Krimi nuk bën të heshtet dhe kriminelët nuk duhet të lirohen e të amnistohen në heshtje. Kriminelët e masakrave, të vrasjeve, të djegieve dhe dhunimeve në gjitha viset e Kosovës, si dhe ata që kanë ushtruar torturë nëpër burgje në kohë dhe hapësirë të ndryshme, duhet të ndëshkohen nga forca e ligjit. Kjo të shërbejë edhe si formë leksioni për të ardhmen, për të gjitha kohët dhe për çfarëdo rrethanash që mund të kalojmë si vend dhe si popull. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Suzan Novobërdaliu e ka fjalën!

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuara familje të të vrarëve dhe të plagosurve të burgut të Dubravës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Sot, gati pas 12 viteve të masakrës në burgun e Dubravës, Kuvendi i Kosovës po diskuton për një nga plagët më të rënda të kohës së luftës. 12 vite dhe ende nuk janë gjykuar ata që bënë vrasje të planifikuara, 12 vite, ende nuk kemi të gjykuar për shkatërrimin e pronës publike dhe private të këtij vendi. 12 vite pas lufte, nënat tona ende nuk e dinë se ku i kanë më të dashurit e tyre.

12 vite janë shumë, zonja dhe zotërinj deputetë, prandaj sot ju bëj thirrje që të mbështesim këtë iniciativë të deputetit Nait Hasani dhe të bëjmë të gjitha përpjekjet ligjore dhe politike që të mbyllem plagët e luftës.

Masakra e Dubravës është njëra nga masakrat më të mëdha që nga pas Luftës së Dytë Botërore, e ndodhur në rajonin e Evropës. Edhe pse kemi një padi penale të ngritur në vitin 2001 në Gjykatën e Qarkut në Pejë, ajo lëndë, si shumë lëndë të tjera ka mbetur diku në sirtar, ndërsa fajtorët ende lëvizin të lirë pa e marrë dënimin e merituar.

Këto ditë kam takuar të mbijetuarit e kësaj masakre dhe të shumë masakrave tjera të ndodhura anembanë Kosovës dhe shumë familjarë të të zhdukurve të luftës. Si deputete e kam shumë vështirë që të arsyetoj këtë Kuvend sepse në këtë drejtim, fatkeqësisht, është bërë shumë pak.

Rasti i Dubravës është njëri prej rasteve më të lehta për të gjykuar, sepse është lehtë e verifikueshme se kush kanë qenë planifikuesit, urdhërdhënësit dhe ekzekutuesit e kësaj masakre.

Prandaj, i bëj thirrje Qeverisë së Kosovës, konkretisht Ministrisë së Drejtësisë që të bëjë çdo gjë që është e mundur që ta kontaktojë... me qëllim që të mblidhen fakte dhe këto fakte t'i paraqiten drejtësisë vendore dhe asaj ndërkombëtare.

Nuk mund të relaksohen marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë pa gjykimin e fajtorëve dhe dëmshpërblimit të viktimës.

Kolegë deputetë,

Është koha e fundit që t'i thirremi arsyes dhe zërit të të vrarëve dhe të plagosurve të Burgut të Dubravës, fajtori të nxirret para drejtësisë dhe të marrë dënimin e merituar.

Më lejoni që për fund të bëj edhe një thirrje, që të zbardhet fati i profesorit Ukshin Hoti, për të cilin ka dëshmi edhe nga organizatat ndërkombëtare që është i liruar nga burgu, por në dalje është marrë peng nga forcat paramilitare të Serbisë. Është e turpshme që ende nuk kemi informacion për një nga intelektualët më të mëdhenj shqiptar.

Kam besim të plotë tek ministri i ri që do të angazhohet maksimalisht, duke ditur përkushtimin e tij dhe njohjen profesionale që ka për krimet e luftës. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputeti Hashim Deshishku e ka fjalën!

**HASHIM DESHISHKU:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë, kolegë,

Kosova në luftën e fundit ka përjetuar shumë masakra ndaj popullatës civile, kryesisht gra, fëmijë, pleq – duarthatë. Mirëpo, masakra në Burgun e Dubravës është krejtësisht diçka tjetër. Ngjarje jo vetëm që ka tmerruar Kosovën dhe kosovarët por tërë botën e civilizuar, madje edhe atë që e pranon luftën, por edhe rregullat e saj. Të masakruarit nuk ishin fëmijë, pleq e gra, por meshkuj të rritur, të pjekur, por ishin të arrestuar apo të kidnapuar kudo nëpër Kosovë. Ishin të burgosur e të internuar, por edhe në rrethana të luftës ata në bazë të drejtës dhe konventave ndërkombëtare gëzonin mbrojtje nga cila do palë e përfshirë në luftë. Kjo nuk ndodhi në Burgun e Dubravës, ku me datën 22 maj 1999 u vranë të paktën 150 vetë dhe u plagosën mbi 200 vetë.

Aty për një moment gardianët u dëshmuan se nuk janë roje të burgut, por janë eskadroni i vdekjes. U pa se të burgosurit, të kidnapuarit dhe të internuarit më nuk ishin njerëz që i mbron çdo ligj i luftës, por mish për top. Nisi me veprimtarinë e devotshme dhe intelektuale të kohës Ukshin Hoti. Ai u zhduk po në këtë burg, apo te dera e tij. Kjo edhe sot mbeti e pa qartë, kurse ne, shoqëria kosovare, institucionet e Kosovës dhe bota e civilizuar e humane nuk bënë aq sa duhet për të, për të mos thënë asgjë.

Për të ende nuk foli drejtësia, kurse familja, ne dhe e tërë shoqëria kosovare as që e dimë se çfarë ndodhi me heroin e Kosovës. E dimë vetëm se ai nuk ndodhet në mesin tonë.

Për masakrën e Dubravës, për fat të mirë ka plotë dëshmitarë të gjallë. Rrëfimet e tyre rrëqethëse mbushin faqet e gazetave dhe minutat në mediat elektronike. Rrëfimet janë tronditëse për secilin njeri që ka sadopak ndjenja humanizmi, tregojnë për njerëzit e maskuar kudo nëpër ambientet e burgut, në bodrume, në banjo e tualete, nëpër puseta e kthina të ndryshme ku ata përpiqeshin që të fshihen nga hordhitë që sjellin vdekjen. U vranë në mënyrën më mizore dhe bizare. Vrasja deri sa ata ishin në rresht, tregon se masakra ishte e planifikuar, ndërsa skelet e ngritura enkas për vrasësit, po ashtu dëshmojnë për lojën e përgatitur mbi njerëzit e pa mbrojtur.

Ka edhe shumë e shumë detaje që dinë ata që përjetuan këtë masakër, ku disa janë edhe në mesin tonë në Parlament. Po përjetimet e tyre nuk është dashur e as që duhet të mbesin vetëm rrëfime për mediat, apo temë për debatin e tryezave të ndryshme.

Çfarë bënë institucionet e Kosovës për zbardhjen e kësaj masakre dhe që arkitektët dhe ekzekutuesit e saj të dalin para drejtësisë? Për fat të keq, këtu kemi dështuar. Rezultatet janë shumë afër zeros, mos të themi, nën zero.

Është për respekt puna dhe angazhimi që për këtë rast bën Këshilli për të Drejtat e Njeriut në Prishtinë, Shoqata e ish të Burgosurve Politikë, por kjo nuk mjafton, nuk mjaftojnë as dosjet e tyre me plot intervista, dëshmi e dokumente.

Rasti duhet të hapet brenda institucioneve të drejtësisë, por vetëm në Kosovë apo në Hagë, e kurrësi në Beograd.

Sado që ky rast kurrë nuk harrohet e as që vjetërsohet, është momenti i fundit që pikërisht nga kjo sallë dhe nga përfaqësuesit e popullit të kërkohet hapja e procesit, zbardhja e së vërtetës dhe nxjerrja në bankën e zezë e kreatorëve dhe ekzekutuesve.

Me këtë nuk duam të ndikojmë apo të dirigjojmë punën e institucioneve të drejtësisë, mirëpo bëjmë një hap më shumë drejtë të së vërtetës dhe të drejtës. Këtë e kemi obligim dhe detyrë si ndaj popullit, ndaj familjeve të të rënëve, e posaçërisht ndaj martirëve dhe heronjve të masakruar në Burgun e Dubravës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!  
Deputeti Fadil Demaku e ka fjalën.

FADIL DEMAKU: Ju faleminderit, nënkryetar!  
I nderuar ministër,  
Të nderuar deputetë,  
Propozimin e deputetit Nait Hasani, për debat parlamentar për masakrën në burgun e Dubravës, e marr nga arsyetimi ku tregon për kalëzimin penal që është dorëzuar më 19 janar 2007, pranë Prokurorisë Publike të Qarkut në Pejë, e që nuk është ndërmarrë asgjë deri me tani.

Masakrat që kanë ndodhur në Kosovë gjatë luftës mbi popullatën civile të paarmatosur, është dashur të trajtohen shumë më herët dhe atë në formë të vazhduar, me përgjegjësinë më të madhe nga institucionet e vendit, e sidomos ato që janë përkatëse dhe të specializuara. Masakrat e shkaktuara kanë pasur urdhëruesit dhe zbatuesit, ata janë diku dhe duhet të gjenden se ku janë. Duhet ngritur kallëzime penale për të gjitha krimet që ka bërë pushtuesi, e natyrisht duhet të punohet me përkushtimin më të madh në ato që janë të ngritura deri më tani. Të stimulohen organet e specializuara që të gjenden fajtorët e të përballen me drejtësi. Është i domosdoshëm përsheptimi i veprimeve ligjore që do t'i kontribuojnë të ardhmes sonë si rajon brenda Bashkimit Evropian. Strukturat demokratike të shoqërisë sonë të sotme, natyrisht nuk kanë mundur t'i ndalin masakrat të cilat kanë ndodhur 12-13 vjet më parë, por ne duhet të bëjmë atë që sot varet nga ne në përputhje me ligjet në fuqi që kriminelët të vihen para drejtësisë.

Debati për masakrën e burgun e Dubravës, le të jetë një shkak më tepër i vetëdijesimit të gjitha segmenteve të shoqërisë sonë për krimet që kanë ndodhur. Deri me tani, është krijuar përshtypja se janë stimuluar me çdo kusht hetime në forma të programuara e në funksion të baraspeshave politike. Janë iniciuar raste specifike për qëllime të caktuara, duke u përdorur e kaluara nga perspektiva e tanishme në arsyetim të veprimeve të tashme politike, që në dukje janë shfaqur si favorizuese për një pjesë e diskriminuese për pjesën tjetër.

Të gjithë jemi dëshmitarë për masakrat e ndodhura gjatë luftës në Kosovë. Unë po përmend disa që kanë ndodhur në komunën time, siç janë masakra e Pokleikut e Abrisë, në lagjen Delijaj, e Çikatovës, e Vërbovcit, e Shtuticës, e Likoshanit e tjerë, si dhe shumë të tjera në

gjithë Kosovën, që tani më dihen. Përmasat e këtyre masakrave, kishin vënë në lëvizje gjithë diplomacinë perëndimore e cila rezultoi atëherë edhe me ndërhyrjen ushtarake në Kosovë. E për absurdin e kohës, sot 12-13 vjet më vonë ende asgjë nuk është bërë që kriminelët të dalin përpara drejtësisë.

Nuk e di, nëse po e përdor shprehjen e duhur, por deri tani nuk ka pasur sponsorisues të asnjë lloji për t'i hetuar ato masakra mbi popullatën tonë të pafajshme, bile edhe mediumet u kanë dhënë pak hapësirë përvjetorëve të tyre. Arsyet pothuaj se tani më janë të njohura. Por, një gjë është e qartë, duke u sqaruar sa më mirë me të kaluarën, pa ngarkesa, do të ndërtojmë të ardhmen e qëndrueshme në rajonin tonë. Ju faleminderit!

*Drejtimitin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti*

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Ju lajmëroj që me rend fjalën do ta marrin: Gëzim Kelmendi, Salihe Mustafa, Hydajet Hyseni, Ramiz Lladrovci dhe Behar Selimi. Këta janë, tjerë nuk ka.

GËZIM KELMENDI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

I nderuari ministër,

Kolegë deputetë të nderuar,

Familje të vrarëve dhe të burgosurve në burgun e Dubravës,

Padyshim se kjo ditë e 19 majtit, na kujton atë ditë kur u ushtrua krim dhe masakër mbi ata të burgosur, të cilët ishin të arrestuar dhe burgosur vetëm për hir të së vërtetës. Ato ditë, ato krime mbi ta, të cilët në shpëtim, në tentim për të shpëtuar jetën e tyre, qoftë në kuzhina, qoftë në fushë sporti, qoftë në pavijone, nuk gjeten se vetëm se vdekjen dhe krimin e gjallë para syve të tyre.

Është për t'u lavdëruar qëndrimi burror stoik i të gjithë atyre që përjetuan atë masakër, duke përfshirë këtu edhe kolegët, deputetë të nderuar: Hasanin dhe Aliun, dhe të gjithë ata që nuk janë këtu me neve sot, si Maki Begolli, Nasim Gullashin dhe të gjithë të tjerët të cilët qëndruan në mënyrë burrore kundër atij krimi. Data, maji i '99, është një datë e cila na kujton shumë. Vetë fakti, pas atij krimi dhe transporti i tyre për në burgjet e Serbisë, është një tjetër, një plan strategji e hartuar nga Qeveria e Serbisë për asgjësimin e tyre.

Vlen të përmendet edhe fakti se ata u detyruan dhe të nënshkruajnë deklaratat se kinse vrasja e tyre është bërë në mënyrë të qëllimshme nga aeroplanët ushtarak të NATO-së, dhe një fakt që argumenton këtë, është edhe ekspozimi i trupave të pajetë të masakruarave në burgun e Dubravës kinse këta u vranë nga bombardimet e NATO-së, e jo nga terrori serb. Duhet gjithashtu të ve në pah zhdukjen dhe, që ende nuk dihet asgjë për fatin e magjistratit Ukshin Hoti, i cili është një njeri i kompletuar me vlera intelektuale, i cili me besim t fuqishëm stoik dhe burror, në drejtësinë e Zotit të madhëruar, qëndroi i panënshtruar ndaj torturave serbe.

Unë si deputet në Parlamentin e Kosovës, kërkoj nga institucionet vendore, njëherit edhe ndërkombëtare që ta zbardhin, të merren me hetimet e të gjitha atyre krimeve që u bënë ato ditë. Njëherit, krahas kësaj, një kujdes të veçantë duhet trajtuar edhe institucionet e Kosovës për të gjithë ata të mbijetuar në Burgun e Dubravës, ata të burgosur të cilët sot kanë mbetur pa tretman dhe përkujdesje nga institucionet tona. Kërkoj që të bëhet një pilot -projekt, të

mbështetet dhe të përkrahen fuqishëm ata të cilët kanë nevojë për mbështetje morale, sociale dhe shëndetësore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Hydajet Hyseni, po më duhet se nuk është këtu.

Salihe Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Zëvendëskryeministër,

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dubrava ishte njëri nga aktet më barbare që shteti serb bëri ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Dubrava ishte më shumë se kamp përqendrimi, ishte më shumë se masakër, ishte më shumë se tmerr i paparë në Evropën e re.

Sot 12 vjet pas luftës, kemi nevojë më shumë se sa të thurim fjalime të bukura, të shohim realisht atë se çfarë në të vërtetë ndodhi në Dubravë. Ta kemi të faktuar qartë jo vetëm krimin, por edhe kriminelët që e ndërtuan dhe e realizuan Dubravën. Kemi nevojë për një hetim të hollësishëm, të saktë dhe profesional, të gjithë atij tmerrit që njerëzit tanë përjetuan. Kemi nevojë të nderojmë ata që u nënshtruan atij tmerrit dhe të dëgjojnë qartë zërin e tyre.

Po më shumë kemi nevojë të nderojmë ata që iu nënshtruan atij tmerrit dhe të dëgjojnë qartë zërin e tyre. Por, më shumë kemi nevojë të dimë se çka në të vërtetë ndodhi dhe këtë do ta dimë vetëm ekzekutuesit dhe projektuesit e tmerrit të Dubravës, dalin para drejtësisë.

Drejtësia ndërkombëtare ua ka borxh këtë të gjallëve që i shpëtuan atij tmerrit. Drejtësia ndërkombëtare me shumë ua ka borxh të vdekurve në Dubravë, atyre që mizorisht e pa shpresën e shpëtimit u ekzekutuan e nuk ishin bile as robër lufte por të burgosur. Drejtësia ndërkombëtare në rend të parë ia ka borxh këtë drejtësisë, sepse kjo ka ndodhur në Evropë, në kontinentin e lirisë dhe demokracisë. Domosdoshmërisht institucionet tona dhe ne këtu, në këtë Parlament, nuk guxojmë ta lëmë atë që ka ndodhur në Dubravë në nivel deklaratah e fjalimesh politike, por duhet gjetur rrugët dhe format nga institucionet e hetuesisë, ato të drejtësisë, por edhe nga ato politike që të faktohen të gjitha ato që kanë ndodhur në Dubravë, që të identifikohen kriminelët dhe që të shtyhet para procesi i vënies së tyre para drejtësisë.

Të gjithë nuk mund të mos e lëmë pa e përmendura me këtë rast profesor Ukshin Hotin, fati i të cilit ende mbetet i pazbardhur. A kemi mundur të bëjmë të gjithë së bashku edhe më shumë në këtë drejtim? Dua me këtë rast të përmend një emër të madh të lirisë që ra në Dubravë, dëshmorin e kombit, gjeneralmajor Abdullah Tahirin, komandantin e parë të Zonës operative të Karadakut, njeriun që vendosi konturat e luftës për liri të UÇK-së në Anamoravë, njeriun vizionar e jashtëzakonisht i guximshëm që hapur në tubimet politike në Gjilan, fliste për UÇK-n dhe nevojën e masivizimit të saj. Ai hapur propagandonte luftën për liri, ndaj fundi i erdhi në Dubravë, edhe pse jam e bindur me më shumë dëshirë do të vdiste në fushën e betejës.

Abdullah Tahiri dhe të gjithë ata që përfunduan si heronj në Dubravë, nuk kërkojnë asgjë nga ne. Ne kemi nevojë që t'i sqarojmë vetës sonë atë që ndodhi, jo për të parë pas të kaluarën, por për të mos e harruar kurrë më atë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete,  
Deputeti Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: I nderuar nënkryetar,  
Zëvendëskryeministër,  
Ministër, që dole përjashta,  
Të nderuar deputetë,

Në cilësinë e mbështetjes të iniciativës së zotit Nait Hasni, dëshiroj të theksoj se ka qenë politikë e Serbisë për dëmtimin fizik, politik dhe ekonomik të vendit dhe popullit tonë. Në çdo rast, njerëzit në burgje janë të siguruar nga shteti që i mban dhe jo e kundërta.

Njerëzit tanë, në këto burgje kanë qenë njerëz që kanë dashur liri dhe që nuk e kanë dëmtuar asnjë popull apo vend, por kanë qenë partnerë të ndërkombëtarëve të NATO-së dhe SHBA-së.

Në botën moderne, edhe terroristët mbahen dhe trajtohen mirë në burgjet e lere më njerëzit ë kërkojnë liri. Këtu u tha gjithçka, prandaj unë ju falënderoj me kaq.

KRYESUESI: Edhe unë ju falënderoj, zoti deputet!  
Fjalën e ka deputeti Behar Selimi. Këta që paraqiten më vonë, unë nuk i kam regjistruar. Deputeti Selimi, është edhe Bekim Haxhiu.

BEHAR SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryesues!  
Nuk e besoj se mund të them diçka më shumë nga që u tha këtu, prandaj nuk diskutoj. E mbështes iniciativën.

KRYESUESI: Ju faleminderit!  
Deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryesues,  
I nderuar Kabinet qeveritar,  
Të nderuar deputetë,  
Masakra e Dubravës është e veçantë jo vetëm për mënyrën barbare të shfaqjes të epsheve kriminale të atyre me petk gardianësh, por edhe për guximin dhe humanizmin e shfaqur të të burgosurve shqiptarë të cilët kur po përballeshin me barbarinë serbe, kishin forcë dhe kuraje e humanizëm për të ndihmuar njëri-tjetrin. Në Dubravë po përballeshin dy botëra të ndryshme, ajo barbare me atë humane.

Krimi i kryer në burgun e Dubravës, ka adresë që nga ministri i atëhershëm i Drejtësisë, drejtori i burgut dhe gardianët e atëhershëm me emër e mbiemër.

Të nderuar deputetë,  
Po sikur kriminelët ta arrinin qëllimin e tyre barbar, t'i vrisnin të gjithë të burgosurit, po sikur i nderuari deputet Nait Hasani, të mos ishte gjallë, kush do të merrte këtë iniciativë? Andaj, sot e ngrita çështjen e miratimit të Ligjit për vlerat e luftës si çështje imediate, kur ndërrimi i vendeve të viktimës me agresorin është bërë pothuaj se normale. Në këtë kohë kur në Burgun e Dubravës janë ekzekutuar mbi 150 të burgosur, u kushtohet vëmendje edhe rëndësi edhe dyshimeve mbi 6 apo 5 të burgosur në burgjet e UÇK-së. Paramendoni, sot 12 vjet pas përfundimit të luftës, i kushtohet vëmendje më e madhe 5 të dyshuarave apo të burgosur, të

cilët disa prej tyre edhe ish- drejtorë burgjesh, se sa atyre të pafajshëm, të ekzekutuar në Burgun e Dubravës. Fatkeqësisht, që edhe mediat tona nuk i kushtojnë një rëndësi të veçantë masakrës e cila ka ndodhur në Dubravë dhe në veçanti masakra e Dubravës nuk ka arritur të kalojë edhe përmasat e kufijve në aspektin e paraqitjes të kësaj masakre edhe në instancat e larta ndërkombëtare.

Prandaj, e mbështes iniciativën e deputetit Nait Hasani, duke shpresuar që sa më shpejtë, ata që e kryen këtë masakër, të përballen me drejtësinë. Ju faleminderit!

### Diskutim i bashkangjitur

LATIF GASHI: I nderuari kryetar!

I nderuari kryeministër,

Zëvendës kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sa kohë duhet prituri, që bota demokratike të kuptojë të vërtetën për masakrën e Dubravës dhe të masakrave tjera mbi popullin tonë të ushtruara nga ana e ish pushtetit okupues serb.

Pse misionet ndërkombëtare që ishin kompetente nuk e morën asnjë veprim konkret juridik hulumtues tani 12 vjet, për ndriçimin e këtyre masakrave dhe akuzimin e kryerësve të këtyre masakrave?

Pse drejtësia ndërkombëtare përdori dhe po përdor standarde të dyfishta kur është fjala për iniciimin dhe ndarjen e drejtësisë?

Pse këta kryerës të këtyre masakrave edhe pse dihen me emër dhe mbiemër kurrë nuk shkuan në përgjegjësi?

Pse ndaj shqiptarëve qenë aq rigoroz duke u ndikuar edhe nga akuzat e Konstruktura, padrejtësisht u mbajtën dhe po mbahen nëpër burgje brenda dhe jashtë Kosove?

Të nderuar deputetë;

Sot në Kuvendin e Kosovës po debatohet për masakrën e Dubravës në të cilën u vranë mbi 120 të burgosur shqiptarë dhe u plagosën mbi 350 të tjerë, gjithsej u maltretuan mbi 950 të burgosur, shumica nga ta të burgosur politikë, të cilët me fillimin e luftës në Kosovë u transferuan nëpër burgje tjera në Serbi.

Burgu i Dubravës u shndërrua në një bazë ushtarako-policore serbe nga e cila u organizua dhe u kryen edhe shumë masakra tjera mbi popullatën civile shqiptare.

Me fillimin e bombardimeve të NATO-s, ministri i drejtësisë në koordinim me organet tjera të aparatit shtetëror serb dha urdhër që të burgosurit shqiptarë nga burgjet e Serbisë të kthehen në burgun e Dubravës. Për rreth këtyre ambienteve vendosi teknikën ushtarake me të cilën sulmoi aeroplanët e forcave ushtarake të NATO-s, veprime këto që e detyruan NATO-n të bombardojë ambientet e këtij burgu, si pasojë mbetën disa të burgosur të vrarë. Ky skenar i vrasjes me paramendim të të burgosurve shqiptarë, nuk përfundoj me kaq. Forcat policore dhe ato ushtarake serbe nga data 19 maji deri me 24 maj të vitit 1999 vazhduan realizimin e skenarit të vrasjes të të burgosurve duke i rreshtuar në poligonet e ngushta dhe duke shti në ta nga muret e larta të këtij burgu.

Të nderuar deputetë,

Edhe sot, pas 12 vjetëve, janë gjurmët e plumbave dhe gjurmët e gjakut në betonin e shëtitoreve të këtij burgu që dëshmojnë se ku ishin të burgosurit dhe nga cilat pozicione u shti në ta, si dhe fatmirësisht disa nga ta i mbijetuan asaj masakre të cilët dëshmojnë përjetimet e tyre. Edhe sot të burgosurit gjatë shëtitjeve nëpër këto poligone, kursehen të shkelin mbi këto gjurmë gjaku dhe gjurmë plumbash edhe pse nga organet kompetente të UNMIK-ut nuk ishte lejuar të merrej asnjë masë për mbrojtjen e këtyre vendeve në shenjë respekti për të rënët.

Kjo masakër dhe shumë masakra tjera, e dëshmojnë projektin shtetëror serb për gjenocid mbi popullatën civile shqiptare. Qeveria e Kosovës, ditë më herët ka marrë një vendim për mbledhjen e fakteve mbi masakrat dhe dëmet tjera të shkaktuara nga Serbia.

Kërkojmë që në këtë drejtim të merren veprime konkrete edhe nga organet kompetente të EULEX-it. Ju faleminderit!

*Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti*

KRYESUESI: Sipas Rregullores, deputetët e kanë kryer debatin. Propozuesi i debatit nëse dëshiron ta marrë fjalën lidhur me rekomandimet e mundshme. Zoti Hasani, e keni fjalën!

NAIT HASANI: Ju faleminderit, kryesues!

Përshëndes zëvendëskryeministrin, ministrat!

Falënderoj deputetët, kolegët për fjalën, për angazhimin për debatin që bëmë, që bashkërisht këtë pikë mjaftë të ndjeshme, të dhimbshme, të tmerrshme, ndoshta edhe më e rënda që ka mundur të jetë dhe të prezantojmë ato çfarë ka ndodhur atje, në burgun e Dubravës.

Unë edhe një herë mund dhe dua ta falënderoj NATO-n për luftën në Kosovë, sepse shteti serb na vrau. Burgu i Dubravës nuk është Guatenamo, siç e kanë cituar në disa media, as Qekenfan, Burgu i Dubravës është, ishte Aushvic, Mathauzen ku u vranë dhe u masakruan shqiptarët.

Unë ju falënderoj për angazhimin e juaj dhe kërkoj që të votohet rekomandimi të cilin e kemi prezantuar, e keni secili.

E Lexoj rekomandimin dhe kërkoj në votim.

Kuvendi i Kosovës kërkon nga organet e gjyqësisë që t'i përshpejtojnë veprimet ligjore, duke ndërmarrë veprime të hetimeve ndaj atyre kryerësve të krimeve dhe të ngritë aktakuzë me qëllim të gjyqimit të kriminelëve të luftës me rastin e masakrës së Dubravës dhe të masakrave të tjera.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në vazhdim kërkojmë deklarinimin me votim për miratimin e rekomandimeve lidhur me masakrën në burgun e Dubravës, të datës 19 deri më 25 maj të vitit '99, gjatë luftë në Kosovë.

Konstatoj se në sallë janë 67 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë, tani.

Konstatohet që me 61 vota “për”, 4 “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi rekomandimet lidhur me masakrën në burgun e Dubravës, të datës 19 deri me 25 maj ’99 gjatë luftës në Kosovë.

Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

## **6. Miratimi i Propozim - rregullore për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit.**

Komisioni për Legjislacion, ka hartuar Propozim- rregulloren për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit parlamentar për Legjislacion. Nuk është. Zëvendësi nuk është paraqitur. ...

Tani kryetarët e ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të PDK-së nuk ka të paraqitur.

Në emër të LDK-së, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit shumë!

Ashtu siç e keni edhe Raportin me rekomandime, Komisioni për Legjislacion, ka formuar Komisionin apo grupin punues për të hartuar Rregulloren për zgjedhjen dhe për shkarkimin e Avokatit të Popullit, dhe të zëvendësve të Avokatit të Popullit. Ne e njoftojmë Kuvendin se këto rregulla kanë buruar dhe e kanë bazën juridike në ligjin për Avokatin e Popullit dhe ne e ftojmë Kuvendin dhe deputetët t’i votojnë. Ju faleminderit shumë.

KRYESUESI: Ju faleminderit,

Nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Ju faleminderit, kryesues!

Definimi i rolit dhe përgjegjësi të secilit zyrtar të zgjedhur apo emëruar në institucionet e vendit, është në dobi të rritjes së efikasitetit, përgjegjësisë dhe transparencës në punë.

Në këtë funksion edhe Rregullorja për zgjedhjen dhe shkarkimi e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij, si dokument parimisht është në dobi të institucionit të Avokatit të Popullit, sepse ende jemi dëshmitarë të shumë paqartësive që kanë një pjesë të institucioneve dhe zyrtarëve që udhëheqin apo punojnë në ato, për sa i përket ushtrimit të mandatit të tyre, meqë jemi edhe dëshmitarë të emërimeve dhe largimeve nga puna të zyrtarëve të ndryshëm në kuadër të Qeverisë apo të institucioneve tjera, duke mos respektuar procedurat kur ato ekzistojnë, apo duke shkelur standardet dhe të drejtat kur këto procedura mungojnë apo nuk janë të qarta.

Ajo që është re rëndësishme të rregullat e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, është që personi ose procesi i selektimit të përzgjedhjes, të jetë korrekt, të shmangen ndërhyrjet politike dhe që të jetë person kredibil që gëzon respekt të qytetarët. Edhe pse në këtë rast kemi të bëjmë me Rregulloren për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij, nuk

mund të mos përmend një çështje që e trajton kjo rregullore që ka të bëjë me numrin e zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Derisa në pikën 2 të nenit 133 të Kushtetutës shkruan, që Avokati i Popullit ka një ose më shumë zëvendës, Ligji për Avokatin e Popullit parasheh të jenë 5 zëvendës- avokat, që për një vend si Kosova, ky është një numër i madh dhe vetëm sa e bën më jo funksional këtë institucion po ashtu edhe ngarkon shumë buxhetin e shtetit. Pra, duhet të shikohen mundësitë që decidivisht të përcaktohet me Kushtetutë dhe numri i saktë i zëvendësve të Avokatit të Popullit, megjithatë, ne jemi që këtij institucioni t’ia lehtësojmë funksionimin e tij përmes kësaj rregulloreje, andaj edhe do ta votojmë në favor të miratimit të tij, por është e nevojshme që të njëjtët t’i krijohen hapësirat e përshtatshme ligjore, në mënyrë që të ushtrojë misionin e tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe në bazë të rekomandimeve të Komisionit për Legjislacion, Grupi Parlamentar i Aleancës, do të votojë për miratimin e kësaj rregulloreje, duke besuar se kjo e qartëson edhe e lehtëson funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar Koalicioni Kosova e Re, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re, e mbështet rregulloren në fjalë. Kjo është një dokument që e kompletion tashmë infrastrukturën ligjore edhe për zgjedhjen edhe për funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit, është një dokument që i ka munguar Kuvendit të Kosovës, në veçanti, pas miratimit të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe gjithsesi Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re do ta mbështesë këtë rregullore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar SLS dhe Grupi Parlamentar “6+”, nuk kanë të paraqitur.

Deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë personalisht jam për një sistem plotësisht tjetër të zgjedhjes së Avokatit të Popullit, pra jam për zgjedhjen e tij drejtpërdrejt nga populli me vota. Institucioni i Avokatit të Popullit është një institucion i ri edhe në vendet e tjera dhe me demokraci të zhvilluar, por edhe në këto vende, ky institucion ka rezultuar si i nevojshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit është mjaft i rëndësishëm, sepse shërben si një monitorues i sjelljes së institucioneve me qytetarët dhe shërben për zgjidhjen e konflikteve të cilat, në rast se nuk do të ekzistonte ky institucion, do të përfundonin në gjykatë. Në rastin e Kosovës, pra është edhe një lehtësim për punën e gjykatave të stërngarkuara. Për këtë arsye, ky Kuvend

duhet të angazhohet për t'i siguruar një pavarësi sa më të madhe këtij institucioni. Deri tani, kjo pavarësi e Avokatit të Popullit vazhdon të mbetet e brishtë dhe një zgjidhje e drejtpërdrejtë nga populli do të ishte mënyra më e mirë për të siguruar integritet në vendimmarrje, pra përfaqësuesit e këtij institucioni.

Kam parasysh këtu edhe dështimin në problemet e mëdha që u paraqiten në mandatin e kaluar të Kuvendit, ku zgjedhja e Avokatit të Popullit dështoi plot tri herë, pikërisht për arsye politike. Për sa i përket rregullores që kemi para vetes, unë i kam dy vërejtje konkrete. Në pikën 4, të nenit 5 ku thuhet: “Nëse është e domosdoshme paneli rekrutues, mund të zgjerohet listën e ngushtë dhe të intervistojë kandidatë shtesë”. Siç thotë një fjalë: “djalli fshihet në detaje”, nuk besoj se kjo është një pikë që duhet toleruar.

Ndërsa, në nenin 11 thuhet se votimi i 5 zëvendësve të Avokatit të Popullit, duhet të bëhet në bllok. Unë mendoj që kjo nuk është në rregull sepse të pestë këto personalitete duhet të votohen një nga një, pasi nuk mund t'i fusim të gjithë në një thes. Sidomos jam e preokupuar për zgjedhjen e njërit prej zëvendësve të Avokatit të Popullit, i cili do të merret me zbatimin e Ligjit për qasje në dokumentet zyrtare. Vendet e tjera, këtë mision si të thuash, e kanë në agjenci të posaçme dhe të pavarur e cila merret me zbatimin e këtij ligji që, në raste kur ka konflikt mes institucioneve dhe qytetarëve apo gazetarëve, mundësojnë që këta, njerëzit që i kërkojnë pra, qytetarë apo gazetarë apo kushdo qoftë, ua mundësojnë qasjen në dokumentet zyrtare. Andaj, mendoj se duhet ndryshuar edhe kjo pikë dhe të votohet për secilin person. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!  
Deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Ju faleminderit, kryetar!  
Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Po mendoj që vërejtje time sa i përket, në parim e mbështes domethënë Rregulloren për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit, mirëpo, tek neni 9 dhe pikat 4 dhe 5, mendoj që për shumë çështje, domethënë që mos të zvarritet në kohë të caktuar zgjedhja e Avokatit të Popullit, neni 4, do të duhej, mendoj sipas mendimit tim të ishte që me shumicën kur janë dy kandidatë, të merren me shumicën e votave të kandidatëve që janë në konkurrencë, jo shumica e votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ngase pastaj edhe më vonë i kemi në nenin 5, nëse kandidati i mbetur me shumicën e votave, atëherë konkursi përsëritet. Prandaj, mendoj që neni 5 do të duhej shlyer në tërësi, ndërsa tek neni, po mendoj te alineja 4 e nenit 9, atëherë do të duhej të ishte vetëm shumicën e votave të deputetëve të pranishëm.

Më vjen mirë që edhe kolegët të tjerë kanë mendime të ndryshme, mirëpo askund në botë nuk ka diku që zgjedhet drejtpërdrejt, domethënë, nga qytetarët. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Propozimi është i Komisionit për Legjislacion. Me gjithë respektin, që e dëgjova propozuesen më herët dhe tani, mua më duhet ta qesë në votim propozimin e Komisionit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, tani.  
Në sallë janë 61 deputetë.

Ju faleminderit!

Konstatohet se me 57 vota “për”, miratohet, 2 abstenime, dhe asnjë “kundër” miratohet Rregullorja për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit, zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Pika e shtatë e rendit të ditës.

Nuk e di a ka kush propozime a jo?

Atëherë, me gjithë kontestimet që kanë qenë në kohë lidhur me mënyrën se si po përzgjidhen këta dhe nuk respektohet fuqia politike, unë sipas ligjit duhet të procedoj.

**7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Media për formimin e Komisionit ad-hoc për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media**

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ka shqyrtuar kërkesën e Komisionit të Pavarur për Media për emërtimin e anëtarëve të Këshillit të këtij Komisioni, dhe Kuvendit i ka paraqitur propozimin për formimin e Komisionit ad-hoc.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, Idriz Vehapin që të paraqesë raportin me rekomandime.

Xhevahire Izmaku, në vend të kryetarit.

XHEVAHIRE IZMAKU: Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 62.1, 67, 71.1 dhe 71.4 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 maj 2011, shqyrtoi listën e propozuar nga Komisioni i Pavarur për Media, për emërtimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

**R E K O M A N D I M**

- Të formojë Komisionin ad-hoc për emërimin e 4 anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

**A r s y e t i m**

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 11 maj 2011, shqyrtoi listën e propozuar nga Komisioni i Pavarur për Media, për emërimin e 4 anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, të datës 21 mars 2011.

Në bazë të nenit 4.4 e) të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, Kuvendi i Kosovës formon Komisionin ad-hoc. Anëtarët e Këshillit janë emëruar nga Kuvendi në mandat 2 vjeçar konform nenit 5.2, nën a) të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetimin dhe mandati i tyre ka skaduar më 15 dhjetor 2010.

Kryetar i Komisionit, Idriz Vehapi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në bazë të nenit 4. pika 4 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, Transmetim, mes tjerash, thuhet: Komisioni ad-hoc i Kuvendit, duhet të përbëhet nga një përfaqësues i secilës parti që është e përfaqësuar në Kuvend.

Komisioni duhet të debatojë jo publikisht për të zgjedhur në konsensus 4 anëtarë të Këshillit nga shoqëria civile. Zgjedhja duhet të reflektojë barazinë gjinore, përfaqësimin e komuniteteve në Kosovë, si dhe aftësinë dhe ndershmërinë që e kërkon një rregullator i transmetimit.

Mbi këtë bazë, i ftoj partitë politike të përfaqësuara në Kuvend që të paraqesin emrin e përfaqësuesit të tyre në këtë Komision. Partia Demokratike, kënd propozon? A Blerta do ta bëjë propozimin?

Blerta, e ke fjalën të propozosh në emër të Partisë Demokratike.

BLERTA DELIU: Ju faleminderit, kryesues!

Sot ne duhet të vendosim për Komisionin ad-hoc, i cili do të bëjë përzgjedhjen e 4 emrave nga lista, prej 8 sa janë gjithsej për anëtarë të Këshillit të Pavarur të Mediave. Kjo listë është dërguar në Kuvend, më 1 nëntor, ndërkaq ne jemi në mes të muajit maj dhe në ndërkohë është në përfundim e sipër drafatligji për KPM-në.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, ka nevojë për konsulta shitesë dhe propozon shtyrjen e kësaj çështjeje që të trajtohet në seancën e radhës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Ismet Beqiri, seanca ka filluar, pika ka filluar, jeni vonuar.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse është fjala për nga një propozim, konsideroj se nuk ka asnjë arsye të shtyhet dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtar të këtij komisioni, propozon zonjën Lirije Kajtazi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i Lëvizjes” Vetëvendosje” ke e ka? Kush flet?

Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Ju faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, propozon deputeten Alma Lama, si anëtare të Komisionit ad-hoc. Prandaj, ne jemi dakorduar edhe në Komisionin për Arsim, që kjo çështje të kryhet sot dhe nuk e shohim të arsyeshme që të shtyhet për një seancë tjetër. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka Burim Ramadani, lidhur me propozimin.

BURIM RAMADANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe ne besojmë që nuk ka nevojë për shtyrje. Grupi Parlamentar i Aleancës e propozon deputeten Teuta Haxhiu, për anëtare të Komisionit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Koalicioni Kosova e Re, Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re, anëtar në Komisionin ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, e propozon deputetin Jeton Sforcën.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar SLS, a ka propozim? Deputeti Saviq e ka fjalën.

VESIMIR SAVIĆ: Poštovani predsedavajući Skupštine,

Dame i gospodo,

Narodni poslanici,

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke predlaže člana Saša Đokić.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Subjekti KDTP, nuk ka propozim KDTP-ja

Subjekti JSL, nuk ka.

Vakat, nuk ka,

PDAK, nuk ka,

NDS, nuk ka,

BSDAK, nuk ka,

IRDK, nuk ka.

KRYESUESI: Po ua shpjegoja, sa here t'ua shpjegoj. Jo, jo, e dinë e dinë.

Nuk ka çka, subjekti PAI, nuk ka.

Subjekti SDKIM. Lus sekretariatit e Kuvendit të mos shkruaj më shkurtesa kështu, por i kanë emrat këta dhe në shqip, le të shkruaj fjalë për fjalë qysh janë partitë. Kurrkush nuk mund t'i mbajë në mend të gjitha këto.

Subjekti GIK, nuk ka.

Subjekti PREBK, nuk ka.

Atëherë, unë mendoj që ne kemi nevojë për një konsultë shtesë ose partitë në seancën e ardhshme le t'i propozojnë të vetët.

(Ndërhyrje e Sabri Hamitit: A bën dy fjalë?)

KRYESUESI: Fol ti, nuk ka problem. Po e dinë ata se unë e sqarova Sabri, secili subjekt politik që është në Parlament, jo koalicion, nuk është fjala për koalicion, por secili subjekt politik ka të drejtë ta ketë një anëtar në këtë Komision. Unë, më sa po e shoh, në sallë deputetët nuk kanë qenë të informuar ose subjektet nuk kanë qenë sa duhet të informuara dhe po mendoj se më mirë është ta shtyjme për seancën e ardhshme të miratohet kjo dhe pastaj e rregullojmë. Do të thotë tri partitë i kanë dhënë kandidatët e tyre: Lidhja Demokratike, Lëvizja "Vetëvendosje" dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Partia Demokratike jo. Të tjerat të gjitha, asnjë nuk e kanë dhënë, prandaj, unë nuk kam çka të diskutoj më.

Vazhdojmë. Shtyhet për seancën e ardhshme për nesër, në qoftë se ka propozim.

Pika e tetë e rendit të ditës.

## **8. Shqyrtimi i Propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e organit përzgjedhës të pavarur për zgjedhjen e anëtarit në organin shqyrtues të Prokurimit Publik**

Qeveria e Kosovës, ia ka parashtruar Kuvendit propozim- vendimin për emërtimin e një anëtarit në organin shqyrtues të Prokurimit Publik, ndërsa Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që Kuvendit t'i propozojë anëtarët e Organit përzgjedhës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që Kuvendit t'i propozojë anëtarët e organit përzgjedhës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka propozuar tre gjykatës të cilët do të përbëjnë organin përzgjedhës të pavarur për emërimin e anëtarit në organin shqyrtues të Prokurimit Publik.

Ju i keni lexuar, por po ua përsëris emrat të cilët janë:

1. Shukri Sylejmani, gjyqtar - Gjykata Supreme e Kosovës,
2. Nehat Idrizi, gjyqtar - Gjykata e Qarkut në Prishtinë, dhe
3. Rasim Rasimi, gjyqtar - Gjykata e Qarkut në Gjiilan.

Pra këta duhet ta japin vlerësimin, nuk kanë për t'u zgjedhur.

Në qoftë se dëshirojnë kryetarët e grupeve parlamentare, mund të deklarohen, në qoftë se jo, vazhdojmë me votimin. Nuk është paraqitur askush. Sa deputetë janë në sallë, ju lutem? Në sallë janë 72 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë, tani.

Ju faleminderit!

Konstatohet që me 60 vota "për", 9 abstenime, asnjë "kundër" Kuvendi miratoi propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me organin përzgjedhës të pavarur për emërtimin në organin shqyrtues të prokurimit publik.

Pika e nëntë e rendit të ditës:

## **9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2010**

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ka shqyrtuar Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina për vitin 2010, dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Gjithashtu, Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar këtë raport dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Ftoj kryetarin e Komisionit funksional Nait Hasani, për arsyetimin e Raportit me rekomandime.

Zoti Hasani, e ka fjalën!

NAIT HASANI: Përsëritje kryesues!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Bujqësi, e ka shqyrtuar Raportin dhe ka vendosur që t'i vijë Kuvendit për miratim ky raport. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk ka ndonjë propozim, ndonjë diskutim për këtë çështje.

Kryetarët dhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit parlamentar të PDK-së, deputeti Njazi Idrizi. Ju lutem, paraqituni me kohë që mos t'ju kërkoj tash me sy.

NJAZI IDRIZI: I nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Rëndësia e aktiviteteve të Zyrës të Rregullatorit të Ujërave dhe Mbeturinave, qëndron në forcimin e bazës institucionale për afrimin e shërbimeve kualitative dhe me kohë në fushat për të cilat ajo është, i bart përgjegjësitë, duke siguruar mbrojtjen e ambientit, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe rritjen e besimit të qytetarëve.

Të gjitha këto objektiva, duhet të arrihen duke afaruar në tregun e konkurrencës së lirë me mjete financiare të gjeneruara nga aktivitetet e saja. Aktualisht, kjo nuk mund të arrihet për shkak të mundësive të kufizuara të përkrahjes institucionale, inkasimit të ultë, mungesës së teknologjive të reja, mungesës së politikave subvencionuese, interesimit të vogël të partnerëve dhe donatorëve potencial.

Këto janë të këqijat të cilat po i përcjellin këtë institucion edhe për një kohë. Janë vërejtur përmirësime në inkasim, në shërbimet e ujësjellësit për rreth 3% e cila rritje është simbolike, por mbi të gjitha është inkurajues. Po ashtu ka përmirësim në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit të cilat nxitën që të marrin pjesë në të gjitha hallkat e zinxhirit të planifikimit dhe implementimit të projekteve. Edhe shembujt e mirë, të suksesit janë duke u stimuluar dhe afirmuar me qëllim që t'u bëhen krahë këtyre sukseseve.

Borxhet ndaj Zyrës së Rregullatorit të Ujërave, faturimi dhe dorëzimi i faturave të konsumatorëve, kualiteti i ujit, ankesat e qytetarëve, efikasiteti i stafit janë sfida të identifikuar të cilat duan përkushtim për t'u zgjidhur.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, sipas përgjegjësiave të veta ligjore, vitin e kaluar për herë të parë e ka bërë auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Zyrës së Rregullatorit të Ujërave dhe të Mbeturinave.

Sipas vlerësimit të auditorit, zyra e Rregullatorit, e ka shpenzuar 92% të buxhetit. Sipas limiteve të përcaktuara nga ky Kuvend, me rastin e miratimit të tij, pasqyrat financiare janë në pajtim me procedurat dhe përgjegjësitë që kanë qenë të harmonizuara me kërkesën e udhëzimit administrativ mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore.

Nga raporti i auditorit konstatohet, po ashtu se Zyra e Rregullatorit, ka bërë disa shkelje të cilat kanë të bëjnë me pasaktësi në regjistrimin e vlerës së pasurisë, inkasimin e ulët të hyrave, blerjen me parane në dorë, pa procedura të prokurimit, mos regjistrimin e të hyrje-daljeve në depo, servisimin dhe mirëmbajtjen pa kontrata, pa rregullsi të menaxhimit dhe të rekrutimit të

stafit. Janë dhënë rekomandime që kanë të bëjnë me gjetjen e auditorit të cilat duhet të merren parasysh.

Menaxhmenti i Zyrës së Rregullatorit, ka pranuar të gjitha gjetjet dhe është zotuar që të punojë për evitimin e tyre.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, ka marrë vendim që me rekomandimet e dhëna, këtë ta votojë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Ali Sadria.

ALI SADRIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së, e ka shqyrtuar këtë raport dhe ka pasur privilegjin sepse, siç tha edhe kolegu përpara këtij organi i është bërë për herë të parë auditimi i pasqyrave financiare dhe kemi pasur material të bollshëm për të parë rezultatet, gjegjësisht lëshimet dhe i rekomandohet që në të ardhmen të jenë sfida dhe preokupim i tyre. Megjithëse, merr notën kaluese, megjithatë ka disa lëshime të cilat duhet theksuar patjetër. Regjistrimi i pasurisë nuk është në harmoni me dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë sferë. Në takimin që kemi pasur ku është ballafaquar Zyra e Auditorit Gjeneral edhe Këshilli i Pavarur për Ujëra dhe Mbeturina, janë diskutuar në hollësi të gjitha lëshimet dhe janë marrë të gjitha masat që të njëjtat të mos përsëriten.

Çështje tjetër që vlen të ceket sa i përket faturimit të ujit, ata qëndrojnë mirë, mirëpo te mbeturinat është një koeficient tepër shqetësuese ajo është vetëm 12%, janë thanë shumë masa dhe rekomandime se çfarë duhet të veprojnë që në të ardhmen të njëjtat të mos përsëriten.

Te regrutimi i stafit ka shumë lëshime, dosje të pakompletuara, regrutime me kualifikime joadekuate dhe në procedura jo të rregullta.

Në prokurim po ashtu ka disa lëshime dhe janë dhënë rekomandime se të njëjtat t'i përmirësojë. Shumëçka në variantin e dytë ka afuar se i ka përmirësua por mbeten edhe më tutje sfida që ai duhet të përballët me to.

Çështja e auditimit të brendshëm është një çështje në vete që ata kanë marrë po ashtu përgjegjësi se do ta rregullojnë. Pra, përgjithësisht ka notën kaluese, por ka edhe shumë vërtetje dhe presim që të njëjtat të reflekton dhe në afatin e paraparë atje ai duhet t'i prezantojë si çështje që i ka tejkalua. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar "Vetëvendosje", deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: të nderuar deputetë,

Raportin e Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe mbeturina, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Planifikim Hapësinor dhe Mjedis e ka procedua më tutje dhe po ashtu i kemi

dhënë edhe vërejtjet. Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje do ta votojë këtë raport duke prezantuar në vijim vërejtjet.

Në bazë të shifrave që shohim në raport del se në përgjithësi në vitin 2010 kemi një përmirësim të lehtë të shërbimeve për ujësjellës dhe mbeturina e kjo në sy të parë duket pozitive dhe në fund të na bënë dhe të shpresojmë edhe në fund se po shkojmë duke u përmirësuar shërbimet publike për qytetarët.

Por ngritja e lehtë në performancën tejet të dobët në funksionimin e këtyre shërbimeve e që këtë e kanë të qartë edhe ata të Zyrës së Rregullatorit edhe të gjithë qytetarët, në fakt nuk është një zgjidhje. Dhe mua për këtë në raport do të duhej të shihnim edhe rekomandime të nevojshme që do të ndihmonin legjislativin dhe në përgjithësi shërbimet për përmirësim të gjendjes.

Në raport shumë pak trajtohen komunat e banuara me serbë në veriun e Kosovës dhe në pjesët tjera të Kosovës, disa vetëm përmenden dhe disa as që nuk përmenden edhe këto do të duhej të trajtoheshin sidomos problemet dhe pengesat konkrete çdo herë dhe jo vetëm që ato të nënkuptohen me arsyetimin që nuk kemi qasje atje si Zyra e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina e po ashtu edhe për kompanitë e Ujësjellësit Regjional dhe kompani tjera. Pa të dhëna për këto pjesë të Kosovës, ky raport nuk paraqet gjendjen reale të shërbimeve në terren. Duhet të bëhet publike që Qeveria e Serbisë ndau 13 milionë euro për furnizimin me ujë në komunën në veri dhe këto investime ajo po i bën në mënyrë krejt të pavarur nga Prishtina. Kompanitë e ujësjellësve atje nuk licencohen nga Zyra e Rregullatorit e të tjerë, ndërsa kur bëhet fjalë për funksionimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe të mbeturinave ajo që bie në sy kudo në vizita të mundshme nëpër komuna dhe në përgjithësi në vështirimin që mund t'i bëhet funksionimit në përgjithësi të këtyre shërbimeve, është niveli i ta qajmë i mesëm në funksionimin e sistemit të shërbimeve publike e që është menaxhimi në nivel regjioni, nivel ky që në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike i merr kompetencat e komunave dhe i vendos në nivel regjional. Kësisoj shërbimet publike në këtë nivelin e mesëm e pësuat në vazhdimësi degradimin dhe duke mos ofruar shërbimet e nevojshme të qytetarëve dhe rrjedhimisht duke u shndërruar në plotësisht jo funksionale.

Menaxhimi regjional është ambienti perfekt për elementet e korruptuar pasi ky nivel arrin t'i fshihet kontrollit qendror nga ministria e po ashtu edhe të kontrollit të pushtetit lokal e i cili në fakt çdo ditë e në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarë dhe nga këto shërbime e ndikojnë drejtpërdrejt funksionimin e pushtetit lokal.

Është shumë e qartë që në zanafillën e tij krijimi i nivelit të menaxhimit të tillë e kishte edhe për bazë privatizimin e ndërmarrjeve publike të cilat më lehtë shiten ashtu të organizuara në nivel regjional pasi janë më të mëdha dhe më pak në numër. Po ashtu degradimi i këtyre ndërmarrjeve vetëm se sa do ta lehtësonte shitjen e tyre pasi do të arsyetohet me atë se nuk janë funksionale. Kjo politikë ndaj ndërmarrjeve publike i ka rrënjët nga koha e UNMIK-ut e ajo që më së mirë në atë kohë funksiononte pra në kohën e UNMIK-ut ishte pra pikërisht privatizimi, edhe sot po vazhdohet në një politikë të tillë. Menaxhimi regjional vazhdon, vazhdon se është profitabil për shumë që punojnë atje, për kompetenca, tenderë sa të duash dhe kontroll fare pak dhe në fund natyrisht të privatizohen me që nuk funksionojnë.

Komunat që janë më të vogla lihen anash në kompanitë regjionale, për shembull tek menaxhimi i mbeturinave me që kemi deponi vetëm në nivel regjional edhe shërbimet e kanë të vështirë të arrijnë te komunat e vogla e lerë më që këto shërbime të arrijnë tek fshatrat.

Komuna e Deçanit edhe pse synon të pavarësohet nga menaxhimi regjional e ka të vështirë dhe po thuaj të pamundshme të funksionojë pasi deponia ku ata detyrohen të hedhin mbeturinat është në komunën e Klinës dhe kjo rezulton në mosfunksionim të këtyre shërbimeve.

Menaxhimi i shërbimeve gjithmonë duhet shikuar nga prizmi i funksionimit në raport me nevojat e qytetarit dhe jo nga prizmi i privatizimit. Në raport tek pjesa e shpenzimeve bie në sy rritja, pjesa e brendshme e shpenzimeve bie në sy rritja aspo dyfishimi i shpenzimeve të Zyrës për vitin 2010, në krahasim me vitin 2009, te çështjet e furnizimeve, shërbimeve teknike dhe ato të pijeve e drekave e të tjerë, e që në rritje të tilla normalisht këto rritje qëndrojnë bashkë me rritjen e mos punës dhe rënien e efikasitetit.

Në Kosovë kudo nëpër ndërmarrje kemi borde gjithandej. Borde me shumë anëtarë bordesh, me rroga të mëdha dhe me shpenzime të shumta përcjellëse, e me vetura e të cilat janë duke u shtuar sidomos së voni. Zyra do të duhej t'i mbikëqyrte këto e jo të fillonte t'u përngajë.

Nga tabela F16 te performanca e përgjithshme sektorit të shërbimit të ujësjellësit shihet se kemi një trend të vogël negativ për ujin e pafaturuar dhe kemi rritje të vogël të teksteve të dështuara të kualitetit të ujit, sidoqoftë këta tregues mund të jenë tregues për keqësimin në vazhdim ... Kemi po ashtu rritje të ankesave të konsumatorëve të ujit dhe numër tejet të vogël të ankesave të zgjidhura që i bie të jetë rreth 20%.

Në raport përveç organogramit do të duhej të figuronte edhe struktura profesionale e stafit aktual, respektivisht të tregohet përgatitja profesionale e stafit një për një.

Nga Zyra e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina kërkojmë shumë më shumë dinamikë t'i identifikojë problemet, të japë rekomandime dhe jo vetëm të kufizohet në monitorime që përfundojnë në një raport vjetor, do të donim të shihnim raport më të pasur dhe gjallëri në të ardhmen të kësaj zyre. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Time Kadriaj.

TIME KADRIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina dhe ka konstatuar se raporti është veç figurativisht mirë i hartuar dhe aspak përmbajtjesor. Aleanca do të votojë këtë raport me shpresë se me nxjerrjen e Ligjit të ujërave do të rregullohen përgjegjësitë në mes nivelit lokal dhe qendror në mënyrë që të arrihet efikasiteti i punës në të mirë të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Aleanca Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për zëvendëskryeministren dhe ministren që është prezent këtu sot në seancë edhe për deputetë,

Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re ka shqyrtuar Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina për vitin 2010, dhe në esencë duke marrë parasysh gjendjen faktike në terren, rekomandon tek ky rregullator që gjendja të përmirësohet dhe të jetë çdo gjë në të mirë të qytetarëve të Kosovës, si për ujëra dhe për mbeturina. Në parim e përkrah raportin për vitin 2010. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar SLS, deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem, gospodine predsjedavajući!

Gospodo ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je razmatrala godišnji izveštaj Regulatora za vode i otpatke za 2010. godinu, i smatramo da je ovaj izveštaj pozitivan i u tom smislu mi ćemo u načelu podržati ovaj izveštaj. Naravno, mi se slažemo sa prethodnim govornicima koji su dali svoje primedbe i neke preporuke, naročito akcentiram na izlaganje gospodina Ali Sadriua, koji je istovremeno i predsednik Komisije za nadzor javnih finansija koji je dao jako precizne i dobre preporuke sa kojima se slažemo.

Naravno, ja bih samo dodao da u delu gde postoji fakturisana a ne naplaćena potraživanja od strane javnog preduzeća, mi smo smatrali i dali predlog da bude pristupačnije plaćanje, odnosno način plaćanja da bude preko banaka pošto se često dešava da inkasanti dolaze na vrata koja su zatvorena iz ovih ili razloga, pa prema tome nije u mogućnosti da korisnik plati svoj dug. U tom cilju smatramo da će doći do poboljšanja naplate i samim tim i da jaćanja budžeta Kosova.

Naravno, u to ime naša Parlamentarna grupa će podržati ovaj godišnji izveštaj. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa „6+“ glasaće za Raport godišnjeg izveštaja Regulatora za vodu i otpatke, i pored evidentiranih anomalija za koje smo sigurni da će se popraviti, jer ovaj regulator izvršava svoj obaveze onako kako prepisano i ispunjava zakonske obaveze koje proizlazi iz Zakona o menadžiranju javnih finansija i odgovornosti.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Teuta Haxhiu:

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse nga kolegia u tha që Aleanca do ta përkrahë raportin, unë ta ngre një shqetësim nga Kompania Rajonale e Ujitjes “Radoniqi- Dukagjini” e cila përballet me vështirësi dhe probleme të mëdha.

Kompania Rajonale e Ujitjes- shoqëria aksionare ofron ujë për ujitjen e tokave bujqësore në perimetrin e sistemit të ujitjes për komunat Gjakovë, Rahovec, Prizren.

Kompania Rajonale e Ujitjes “Radoniqi” Dukagjini me seli në Gjakovë është liderë në Kosovë si për nga cilësia ashtu edhe për nga sasia e ujitjes së tokave bujqësore. Përkundër shërbimeve të vazhdueshme të kësaj kompanie për fermerët e shumë të tri komunave ajo vazhdon të jetë në gjendje të rëndë dhe gati të papërballueshme.

Sipas të dhënave që kam vetëm gjatë zezonës së ujitjes në vitin 2010 menaxhmenti i kësaj kompanie ka ofruar shërbime për rreth 5500 hektarë me shtrim të prodhimtarisë deri më tash trefishë me mbi 4000 familje fermerësh.

Aktivizimi i këtij sistemi mundëson aktivizimin në sezonën e ujitjes të mbi 30 mijë njerëzve që në mënyrë direkt ndikon në zbutjen e papunësisë. Kompania ka planifikuar që edhe gjatë vitit 2011 të ujis të njëjtën sipërfaqe me tendencë të rritjes së këtyre sipërfaqeve. Sa për dijeni kompania sa i përket anës teknike ka dy sisteme të ujitjes, sistemi modernë i ujitjes Radoniqi i ndërtuar në vitet 1980 – 85 dhe sistemi i ujitjes Dukagjini i ndërtuar rreth viteve 63 – 65.

Sistemi i Radoniqit është një sistem modern i projektuar dhe i ekzekutuar të punojë sipas kërkesave të bimëve dhe shumë funksionalë por parcelat e vogla çka është karakteristike e gjendjes reale në Kosovë. Ky sistem ofron ujë mbi 24 orë pa ndërprerje gjatë tërë sezonit të ujitjes të gjitha sipërfaqeve bujqësore mbi 5500 hektarë. E gjithë infrastruktura e ujitjes e të dyja sistemeve është shtrirë në sipërfaqe bujqësore në tri komuna Rahovec, Prizren dhe Gjakovë në gjatësi prej 1500 metra gypa nëntokësorë. Kjo infrastrukturë është ndërtuar nga materialet e importuara nga vendet e Bashkimit Evropian. Një pjesë e madhe e këtyre gypave sot nuk prodhohen dhe janë jashtë standardit të tanishme. Gypat kryesorë janë të importuar nga Norvegjia dhe sipas informatave që kam kompania ka bërë përpjekje në eliminimin e avarive me forcat e veta në mënyrë që fermerëve të ju ofrojë shërbime sa më cilësore.

Prandaj, kostoja e lartë e mirëmbajtjes si dhe niveli jo i kënaqshëm i pagesave nga ana e fermerëve e ka sjellë kompaninë në një situatë mjaftë të pavoritshme. Në praktikën e vendeve evropiane për shembull në Francë ku ekzistojnë disa kompani të ngjashme me kompaninë rajonale të ujitjes Radoniqi Dukagjini është Qeveria ajo që i mbështetë dhe i përkrah këto kompani. Me qenë se aktiviteti i kompanisë është sezonal dhe inkasimi edhe ashtu i ulët bëhet një herë në vit kompania nga muaji janar deri në muajin gushtë ka të hyra minimale të cilat nuk mjaftojnë as për shpenzimet e përditshme operative.

Kompania rajonale në fjalë në vitin 2009 dhe 2010 ka ngritur padi në vlerë prej 365 mijë e 59 euro ndaj disa fermerëve si borxhli të mëdhenj por fatkeqësisht gjykatat tona deri më sot kanë realizuar vetëm 300 euro çka sipas zyrtarëve të kompanisë vetëm taksa gjyqësore i kanë kushtua 356 euro.

Sipas analizës që është bërë nga këta ekspertë kompania deri në fund të vitit 2011 për ti mbuluar shpenzimet për rritjen e 5500 hektarëve nevojiten edhe 125 mijë euro. Pa mbulimin e këtyre shpenzimeve kompania nuk do të ketë mundësi të mbijetojë, kështu që në mënyrë të drejtpërdrejtë rrezikojnë të mbesin pa ujitje 550 hektarë tokë bujqësore në Rrafshin e Dukagjinit përkatësisht në komunat e sipërpërmendura.

Në këtë raport tek përgjegjësitë kryesore të Zyrës së Rregullatorit të Ujërave dhe Mbeturinave përmendet edhe miratimi i kushteve për shlyerjen dhe borxhet e vjetra dhe në këtë pikë unë kisha pyet se çfarë ka bërë kjo zyrë- asgjë. Me një fjalë Kompania rajonale Radoniqi- Dukagjini ballafaqohet me këto probleme: infrastrukturën e ndërtuar para 30 apo 50 vjetëve e cila shumë e dobët, mos efikasiteti i gjykatave në zgjidhjen e lëndëve, shkalla e ulët e pagesave, mundësia teknike e pamundur të aplikohen shkyçje individuale, mbështetja jo e duhur institucionale edhe çmimi shumë i lartë për blerjen e ujit për ujitje.

Sipas informacionit që kam kompania në fjalë i është drejtuar me shkresë Ministrisë për Zhvillim Ekonomik dhe Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural. Prandaj, konsideroj që është çështje urgjente mbështetja financiare për këtë kompani, sepse në të kundërtën edhe një herë po e potencojë të rrezikohen të mbesin pa ujitje 5500 hektarë pronë e 4000 familjeve me mbi 30 mijë banorë të Komunës së Gjakovës, Rahovecit dhe Prizrenit.

Ne mendojmë se duhet ndahen më shumë mjete pra investime kapitale në kompanitë për rehabilitimin e infrastrukturës ujëtare si dhe të rritet efikasiteti i gjykatave dhe i lëndëve gjyqësore të këtyre kompanive, t'u jepet përparësi në mënyrë që zbutet situata brenda tyre.

Gjithashtu duhet të shikohet mundësia që taksat për ujitje të grumbullohen nga vetë komuna sepse janë komunat ato që ballafaqojnë më së pari me problemet e qytetarëve pastaj vjen edhe niveli qendrorë.

Ndërmarrja hapa urgjent në këtë drejtim është para së gjithash në funksion të krijimit të kushteve për prodhimtari intensive sidomos me perime, kulturë, punësim sezonal të punëtorëve në bujqësi, shtim të fondit të blektorisë, rritje të kapacitete prodhuese industriale e të tjera. Në kohën kur tregu vendor është përplot me produkte të importuara nga jashtë, prandaj, investimi në këtë veprimtari mund të thonë zëvendësimin e produkteve të importuara me produkte vendore dhe nuk kemi pse të frikohemi siç po ndodh edhe ministrat tanë që po frikohen t'i thonë stop importimit nga Serbia, sepse po të investohet në këto kompani dhe në sektorin e bujqësisë, atëherë ne do t'i hapim shumë dyer për qytetarët tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka të paraqitur të tjerë.

Konstatoj që në sallë janë 67 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani: Faleminderit!

Konstatoj se me 67 vota "për", 2 abstenime dhe asnjë "kundër", Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2010.

Vazhdojmë me pikën e radhës.

**- Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin përfunduar më 31 dhjetor 2010**

Komisioni funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar, më falni, në qoftë se doni e shtymë për nesër me qenë se ka shumë, si të doni, këto të tjerat mund t'i shqyrtojmë më shpejtë. Domethënë jeni dakord që këtë pikë ta shtymë për nesër në mëngjes. Jo seanca nesër vazhdon se i kemi edhe dy raporte. A po thoni që seancën ta ndërprejmë krejt. Jo, po i

shqyrtojmë, i kemi edhe 2 – 3 raporte që mund t'i shqyrtojmë shpejtë dhe besoj që s'ka nevojë edhe për diskutime të gjata, por këto ashtu kështu po miratohen, janë më shumë formale se sa. Pra po vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës. Shefi i Grupit Parlamentar tha po e shtymë për nesër.... po dy nuk jeni ju tash.

Komisioni funksional për Mbikëqyrjen e Financave publike ka shqyrtuar raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Fillojmë me diskutimet.

Kryetari i Komisionit funksional, Ali Sadriu, e ka fjalën për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Në bazë të nenit 3 të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm( ZAP) raporton për të gjitha raportet e rregullsisë. Në bazë të fushëveprimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, bazuar në nenin 82.2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në mbledhjen e mbajtur më 26 prill 2011 shqyrtoi Raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin përfundimtar 31 dhjetor 2010. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin përfaqësues të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Komisionit të Pavarur të Mediave.

Raporti i auditimit të KPM-së nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ngriti një numër çështjeve që shqetësojnë për të cilat ndajmë theks të veçantë.

1. Nuk është shpalosur përdorimi i fondeve nga Komisioni Evropian,
2. 118 mijë e 80 euro janë paguar si kompensim në kuadër të shërbimeve kontraktuese dhe janë përdorur jashtë qëllimit dhe dedikimit të memorandumit të hartuar në mes të Komisionit Evropian, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Këshilli të Pavarur të Mediave.
3. Pasqyrat fikse të shpalosura janë të nënvlerësuara për shumën 259 mijë e 205 euro dhe të gjeturat tjera.

Komisioni vlerëson se të gjeturat e Zyrës së Auditorit janë të gjetura të cilat duhet të adresohen dhe për këto të gjetura duhet të ndërmerren veprime konkrete për përmirësimin e tyre. Komisioni rekomandon miratimin e këtij raporti me rekomandime, e theksoj me rekomandime.

Me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të rekomandimeve, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka rekomanduar që të detyrohet Këshilli i Pavarur i Mediave që brenda afatit 60 ditë të paraqes një raport në rishikimin dhe masat e marrura në evitimin e këtyre të gjeturave.

Komisioni ka konstatuar se disa të gjetura të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm janë edhe si pasojë e mosfunksionimit të Këshillit të Pavarur për Media, sepse këshilli ka për momentin vetëm 2 anëtarë dhe nuk ka qenë kompetent ose nuk ka pasur kuorum për marrjen e masave në shfrytëzimin e buxhetit në mënyrë racionale.

Mund të shtoj edhe këtë se presim ne nga reflektimi që ata do të japin në veçanti për mos shpalosjen e grandit prej një milion dhe mund t'ju njoftoj po ashtu se garant për mirë procesin ose mirë përdorimin e këtij grandit ta quajmë në këtë formë, garant ka qenë Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe ndërkohë ka pasur lëshime që janë në kundërshtim me ligjin. Prandaj, në afatin prej 60 ditë do të shohim se çfarë po reflektojnë ata dhe të marrim hapa të tjerë, përndryshe kjo është një shifër që na brengosë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Unë dua t'ua tërheq vërejtjen deputetëve, mos të votojnë në emër të huaj, nuk dua të përmend emra. Konstatimi është që 2 vota kanë votuar për tjetërkënd në sallë. Prandaj, mos e bëni më këtë gabim, sepse nuk është mirë dhe duhet të marrim masa ndaj atyre që e bëjnë këtë veprim edhe një herë. Ne kemi mbikëqyrje, kemi servijim të Kuvendit, kështu që nuk ka nevojë, dy vota më pak, dy vota më shumë nuk qojnë peshë në miratimin e raportit.

Vazhdojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar zëvendëskryeministër,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2010.

Raporti ka të bëjë me auditimin e rregullsisë të pasqyrave financiare të KPM-së. Për shkak të gjeturave të mëdha raporti ka opinion të kundërt, çka do të thotë se pasqyrat financiare të KPM-së në përgjithësi nuk pasqyrojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Të gjeturat kryesore në Raportin e auditimit të KPM-së, të cilat konsiderohen çorientuese janë: KPM nuk ka shpalosur në pasqyrat financiare përdorimin e fondeve nga Komisioni Evropian, në vlerë prej një milion euro. Prezantimi i rrugëve dhe pagesa në vlerë prej afro 200 mijë euro në të njëjtën kohë 118 mijë euro janë paguar si kompensim në kundërshtim me memorandumin e mirëkuptimit lidhur me përdorimin e këtyre fondeve ku sipas memorandumit në mes të KPM-së dhe Ministrisë së Financave, këto mjete kanë qenë të dedikuara për pagesën e ekspertëve të jashtëm e jo të punëtorëve të KPM-së, siç ka vepruar në këtë rast KPM-ja.

Dhe pasuritë fikse të shpalosura në pasqyrat financiare janë nënvlerësuar për afro 250 mijë euro. Po ashtu auditori ka konstatuar se KPM ka dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Nuk ka arritur të bëjë një ndarje adekuate të detyrave dhe përgjegjësi ku në shumë raste ka munguar llogaridhënia. Të gjitha këto tregojnë se KPM gjatë vitit 2010 nuk kishte arritur të krijojë një sistem efikas dhe efektiv të menaxhimit financiar.

Auditori ka dhënë disa rekomandime për Komisionin e Pavarur për Media dhe ne presim që ato rekomandime të zbatohen nga ana e KPM-së. Nga e gjithë kjo që u cek më lart, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah raportin e auditimit të lëshuar nga Zyra e Auditorit Gjeneral me rekomandime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Unë vetëm ta shtoj këtë se jo vetëm për këtë këshill të pavarur, por edhe për këshilla tjera të pavarura të cilët i përgjigjen, është mirë jo vetëm për këtë këshill të pavarur, por edhe për këshilla tjera të pavarura të cilët i raportojnë drejtpërdrejt Kuvendit, është mirë që auditori edhe pse është kategori kushtetuese edhe ai e përcakton formën e auditimit, t'i sugjerohet si Kuvend që këtyre t' u bëhet auditim i performancës e jo i rregullsisë, t' ju sqaroj atyre të cilët nuk merren me këtë çështje. Auditimi i pasqyrave financiare të rregullsisë paraqet domosdoshmërinë që i kërkon ligji mbi raportimin, jep formën, por jo edhe përmbajtjen brenda. Auditimi i performancës është një auditim i gjerë dhe lëshohet në detalizim në shkaqet e gjetjes së asaj gjendje.

Me që u ngrit çështja e keqmenaxhimit në veçanti për pagesat e anëtarëve të Këshillit, mund t' ju shtoj këtë se ky proces ka filluar në vitin 2009 dhe mandej gjatë vitit 2009 për vitin 2010, Komisioni i Bashkësisë Evropiane ofron një donacion prej një milion euro për financimin e shërbimeve kontraktuese. Vazhdon Këshilli i Pavarur i Mediave edhe më tutje t'i financojë anëtarët e këshillit për këto shërbime. Kjo është në kundërshtim me memorandumin të cilin e ka nënshkruar e thashë edhe më herët, por për mua është përgjegjës sa është Këshilli i Pavarur në këtë drejtim, është edhe Ministria për Ekonomi dhe Financa, sepse ajo është garant se duhet zbatuar ai memorandum, çka do të thotë se nuk është dashur të lëshohen këto pagesa, të tjerat u thanë dhe nuk do të doja që të zgjas. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, deputetja Alma Lama, e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, e thotë fare qartë se pasqyrat financiare në përgjithësi nuk pasqyrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë. Përmenden së paku dy pika ku ka pasaktësi në raportim dhe të cilat ngërthejnë shumat më të mëdha të parave që ky institucion ka pasur në menaxhim. Pra nuk është shpalosur përdorimi i fondeve nga Komisioni Evropian, në vlerën prej një milion euro si dhe prezantimi i rrogave dhe pagave në vlerë prej 202 mijë euro, ku në të njëjtën kohë 118 mijë euro u janë paguar si kompensim në kundërshtim me qëllimet e memorandumit të mirëkuptimit lidhur me përdorimin e këtyre fondeve. Këto dy pika mjaftojnë për të mos e miratuar këtë raport, pasi duke miratuar, pavarësisht nga vërejtjet që jep Komisioni dhe Parlamenti, po krijohet një traditë shumë e keqe jo vetëm në këtë rast. Institucionet të cilat po sjellin raporte në Kuvend po ndihen shumë komode pas pavarësisht se çfarë shkruhet në këto raporte, Kuvendi po i miraton. Kjo mënyrë e të votuarit duhet të marrë fund, raportet të kthehen dhe të shkruhen ashtu siç duhet, sepse shteti nuk ndërtohet me stilin hë se kalon, hë se i kemi votat.

Ne si Kuvend në këtë mënyrë dështojmë të luajmë rolin mbikëqyrës që na takon dhe institucionet devijojnë nga koncepti i llogaridhënies. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Bali Muharremaj.

BALI MUHAREMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Gjatë vlerësimit të detajuar të Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2010 e audituar nga Zyra e Auditorit Gjeneral, kemi vlerësuar në mënyrë të hollësishme, janë konstatuar disa parregullsi të gjetura në raport.

Unë mendoj bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit për të dhënë opinion nëse pasqyrat financiare kanë në tërësi nuk përmbajnë deklaramë të gabuara të rëndësishme dhe janë të përgatitura në pajtim me legjislacionin përkatës dhe standardet e kontabilitetit ndërkombëtar.

Bazuar në informacionet e shpalosura në Raportin e auditorit gjeneral, opinionet për pasqyrat financiare tregojnë qartë se propozimi i transaksioneve marrë në tërësi nuk është i drejtë i cili rrit rrezikun e gabimeve materiale, mosfunksionimin efikas të menaxhimit të rrezikut dhe mosfunksionimin e kontrollit në menaxhim efikas të drejtë dhe transparent të parave publike. Edhe pse Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike gjatë shqyrtimit të raportit të pasqyrave financiare që përfundojnë me gjendjen 2010, gjatë analizimit të raportit dhe të mbështetura në të gjeturat konkluzionet dhe rekomandimet e konstatuara ka ardhur në përfundim që para Kuvendit të Republikës së Kosovës t'i adresohet Komisionit të Pavarur për Media me rekomandime të cilat edhe unë i pranoj.

Të gjeturat kryesore sipas auditorit gjeneral janë: Komisioni i Pavarur për Media nuk kishte mundur të arrijë të sigurojë një mjedis efikas të kontrollit për menaxhim të buxhetit dhe shpenzimeve si dhe përgjegjësinë e deleguar dhe llogaridhënia menaxheriale nuk kishte qenë efikase sa duhet. Pasqyrat financiare nuk paraqesin një pasurim të drejtë për gjithë transaksionet e prezantuara në pasqyrat financiare të cilat rrisin rrezikun në gabimet materiale.

Mos shpalosja e një milion euro si pagesë nga pala e tretë me pasqyrat financiare po ashtu rrit rrezikun për një menaxhim jo efikas ekonomik dhe transparent të këtyre të hyrave.

Ndarja e fondit për hartimin e strategjisë dhe digjitalizimin janë përdorur për dhënien e pagesave shtesë të punonjësve të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe nuk janë përdorur për qëllime të caktuara sipas marrëveshjes së arritur e cila po ashtu rrit rrezikun e mos përmbushjes së objektivave të përcaktuara me hartimin e strategjisë për digjitalizim nga ekspertët e jashtëm dhe mos pajtueshmëria e pagesës si pagë shtesë për të punësuarit të Komisionit të Pavarur të Mediave ku kanë marrë përafërsisht 60%.

Mos aplikimi i procedurave të prokurimit në pajtueshmëri me Ligjin e prokurimit rrit rrezikun në, që paraja publike mos të shfrytëzohet në mënyrë transparente, efikase, rrit rrezikun e mostrajtitimit të barabartë të operatorëve ekonomik, diskriminim apo favorizim.

Ne, si grup Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kërkojmë që edhe vërejtjet tona të inkorporohen në reduktimet e dhëna nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe rekomandojmë që Komisioni i Pavarur për Media të hartojë të detajuar një plan të veprimit strategjik në të cilin plan duhet të përcaktohen bartësit dhe afatet për jetësimin e rekomandimeve të dhëna nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe atë në afat prej 60 ditësh. Faleminderit!

KRYESUESI: faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Grupi parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re i mbështet rekomandimet e Komisionit përkitazi me rekomandimet lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2010, por gjithashtu shprehim shqetësimin tonë që ky institucion vepron në tërësi kundër rregullave ligjore. Nuk ka pothuaj se asnjë pikë e të gjeturave të auditorit e cila nuk flet për parregullsitë në zbatimin e ligjit të Komisionit të Pavarur për Media dhe konsiderojmë se kjo materie do të duhej t'u shkojë edhe autoriteteve tjera, në mënyrë që të shikohet se sa janë tejkaluar kompetencat ligjore dhe çfarë pasojash do të duhet bartin këtu bartësit e këtyre institucioneve. Kuvendi i Kosovës natyrisht nuk mund t'i kalojë këto dokumente nëse flasin për parregullsi të shumta dhe shkelje ligjore dhe në anën tjetër të mos jepë sanksionime ndaj atyre që veprojnë kundër ligjit.

Vetëm po të shihni këtu, po thuaj se nuk ka asnjë pikë në të cilën auditori nuk gjen tejkalim ose keqpërdorim të ligjit. Unë po përmend vetëm një thotë: Në kontratën furnizim me material hargjues kemi vërejtur se mallrat nuk janë pranuar në përputhje me specifikacionin teknik të kontratës, respektivisht janë pranuar mallra edhe me çmime dhe karakteristika të ndryshme në raport me çmimet dhe karakteristikat e kontraktuara. Sipas kësaj bie që udhëheqësit e këtij komisioni i japin vetes të drejtë që të veprojnë në kundërshtim me ligjin dhe konsideroj se tashmë të gjeturat e autorit do të duhej të kalojnë në institucionet e tjera të cilat e kanë për detyrë të hetojnë zbatueshmërinë e ligjit në vend dhe të ndërmarrin masa ndaj të gjithë atyre që veprojnë në kundërshtim me ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të SLS-në, nuk është paraqitur askush. Shtypni ju lutem, deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Izvinjavam, mislim da je bio pritisnut...!

Što se tiče Parlamentarne grupe Samostalne liberalne stranke, mi ćemo podržati ovaj Izveštaj revizije finansijskih pregleda Nezavisne komisije za medije. Naravno, slažemo se sa prethodnim govornicima koji su na veoma precizan način obrazložili nedostatke i preporuke. Ovom prilikom želimo da pohvalimo Komisiju za nadzor javnih finansija, koja je našla sve ove nedostatke i preporučila Skupštini da obrati pažnju na njih, a naročito Nezavisne komisije za medije, date su preporuke da to što u skorijem roku ispravi. Mi stavljamo poseban akcenat na plan realizacije, odnosno rokove za adresiranje preporuka Kancelarije glavnog revizora, jer smatramo da je to veoma bitna konstatacija, inače složićemo se sa svima da postoji alarmantno stanje u ovoj instituciji što se tiče menadžiranja budžeta i ostalih stvari koje su spomenute od prethodnih govornika. Mi ćemo podržati ovaj izveštaj i u to ime ja vas pozdravljam. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+” Albert Kinolli.

ALLBERT KINOLLI: Faleminderit!

I nderuar zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar këtë raport në mënyrë të detajizuar dhe këtë raport do ta miratojë, por me rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media për vitin e përfunduar 2010. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka tjerë të paraqitur.

Vazhdojmë me votimin e Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor 2010.

Konstatohet se në sallë të pranishëm janë 67 deputetë.

Lus regjistrin dhe deputetët të bëhen gati për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit!

Konstatohet se me 51 vota “për”, 11 vota “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin përfundimtar, më 31 dhjetor 2010.

Tani unë jam në një situatë pak si të palakueshme, sepse kjo pika e dhjetë mu ka përzier më parë me letra. Shumica ishin që ta shtyjmë për nesër. Ka kërkesa të vazhdojmë sonte. Këtu nuk janë as kryetari i Komisionit funksional, Arben Gashi, as s’është kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj dhe nuk di a i kanë përfaqësuesit e tyre a s’i kanë këtu që flasin në emër të tyre?

Vazhdojmë me tjerat, pastaj nëse na mbetet kohë po e kryejmë edhe këtë më shpejtë.

Një herë u vendos për afërsisht ashtu, po Grupi Parlamentar i PDK po kërkon sot ta kryejmë, kështu që, ishte gabimi im se më kaloi nga kjo.

Atëherë, vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë, pastaj e qesim të dhjetën, me qëllim që nesër të...

Çka u bë, s’ka diskutime?

Vetëm kryetari i Grupit Parlamentar mund të flas.

Në emër të Grupit, okej, vazhdo, për procedurë, mund të më kritikosh që e kam kaluar.

Fajalën e ka Sala Berisha.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, kryesues!

Është shumë e kuptueshme që jemi lodhur të gjithë mbas një debati shumë të mundimshëm dhe të domosdoshëm dhe pak më parë në emër të Grupit Parlamentar, përfaqësuesi ynë kërkoi që të ndërpritet seanca dhe të shtyhen të gjitha pikat për nesër, ndërsa si duket ndodhi një keqkuptim, ashtu po dëshirojmë ta kuptojmë dhe u kalua- Shqyrtimi i Raportit të Antikorrupsionit dhe vazhduam me pika të tjera. Për hir të procedurës, e di që prapë po e përsëris, jemi të lodhur dhe sipas Rregullores së Punës së Kuvendit nuk ka mundësi të ndryshohet rendi i ditës, pa i nënshtrua një votimi të seancës. Dhe, tani po kërkoj ose ne pajtohemi të vazhdojmë këtë seancë, t’i kthehemi pikës ta shqyrtojmë, se është raport i punës, nuk është raport financiar, andaj nuk ka arsye që mungon këtu Komisioni i Buxhetit, aspak s’është e arsyeshme, sepse është raport i punës, nuk është raport financiar, ose t’i kthehemi pikës që e tejkaluam, ose ta ndërprejmë seancën e të vazhdojmë me pika tjera nesër. Faleminderit!

KRYESUESI: Si ta keni dëshirën ju, për mua e vazhdojmë ose e ndërpresim, nuk kam ndonjë problem. Me këtë unë veç ju sqarova që duhet obligativisht t’ua jap fjalën dy kryetarëve të komisioneve dhe asnjëri s’janë këtu. Nuk e ndërpreva për shkak të asaj, por mu duk që të gjithë ishin dakord që të shtyhet kjo pikë për më vonë. Çka keni menduar, ju jeni 27 deputetë tash këtu dhe secili keni nga një mendim dhe tre deri tash keni thënë mendime të ndryshme, mos harroni! Prandaj, merruni vesh kush flet në emër të Grupit Parlamentar dhe çka flet.

Atëherë, e shtyjmë seancën për nesër në orën 10:00.

## **Vazhdimi i seancës, më 20.5.2011**

### **Drejton seancën: nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti**

KRYESUESI: Mirëmëngjesi, të gjithëve!

Ju lus që t'i zëni vendet!

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 19 maj 2011, për pikat e mbetura: 10, 12, 13, 14,15 dhe 16.

Në sallë nuk ka nevojë për ta filluar debatin që të thuhet prezenca, shpresoj që do të vijnë të tjerët.

Fillojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës-

#### **10. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit për vitin 2010**

Në sallë 40 deputetë janë.

Komisioni funksional për Legjislacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar raportin e punës së Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit për vitin 2010 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin e punës së Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit për vitin 2010 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Dua t' ju njoftoj që është raporti për Agjencionin Antikorrupsion, raportin e saj dhe nuk është për çështje tjera, prandaj mendoj që s'ka nevojë të shpërndaheni në diskutime të pafund siç po ndodh herë pas here në Parlament.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional, Arben Gashi. Nuk është.

Kryetarja e Komisionit për Financa nuk është.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të PDK-së, deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Zoti kryesues,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike në parim e përkrah këtë raport dhe preferojmë që të kalojmë në këtë seancë.

KRYETARI: Faleminderit shumë!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pavarësisht sugjerimit që të jem të shkurtër dhe ta diskutojmë raportin, unë besoj që ky Parlament duhet ta praktikojë që në rastin kur shqyrton dhe aprovon raportet e institucioneve të pavarura të shikojë punën e këtyre institucioneve përtej raportit.

Së pari, ta shohim a është e vërtetë ajo çka shkruhet në raport?

E dyta, ta shohim se a e kanë kryer punën e tyre si duhet, sepse këto institucione financohen prej buxhetit të Kosovës, dhe

Së treti, të shohim se a kanë pengesa këto institucione për të bërë punën e tyre?

Raporti pasqyron punën njëvjeçare të Agjencisë Kundër Korrupsionit, në këtë raport janë përfshirë aktivitetet e kryera dhe të ndërmarra nga Agjencia Kundër Korrupsion gjatë kësaj periudhe, të cilat janë paraqitur sipas fushave që mbulon secili departament.

Raporti paraqet 201 raste të procedura në institucionet kompetente për ndërmarrjen e hetimeve penale. 528 persona të identifikuar dhe 19 raste prej tyre Agjencia Kundër Korrupsion nuk ka arritur që t'i identifikojë personat konkret, por thuhet se numri i personave të dyshuar për korrupsion gjatë vitit 2010 shkon deri në 650.

Duhet të theksojmë se sipas raportit Qeveria prin në rastet e korrupsionit dhe kjo gjë duhet të thuhet zëshëm. Ne pyesim se kush janë këta 650 persona, shoqëria dhe ne duam emra, çka po ndodhë me këta persona, apo i lëmë ne t'i gëzojnë parat e përfituara në mënyrë të paligjshme? A duhet agjencia t'ju shkojë deri në fund rasteve dhe a po bashkëpunojnë organet e rendit dhe ligjit me Agjencinë Kundër Korrupsion?

Për 88 informata të dërguara në prokuroritë kompetente, Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka marrë informata me pas se çka ka ndodhur. Ne presim dhe duhet t'i obligojmë prokuroritë që ta informojnë Agjencinë Kundër Korrupsionit, për të gjitha rastet, kështu që kjo e fundit të mund të raportojë se çka ka ndodhur me rastet që ka ngritur.

Raporti paraqet raste të shpeshta të shkeljes së ligjit të prokurimit publik, ku favorizohen operatorë ekonomik të cilët nuk ofrojnë ofertat më të mira duke dëmtuar kështu interesin e përgjithshëm të qytetarëve të Kosovës. Një rast i tillë u përmend nga kolegu ynë Armend Zemaj dhe ku për penj kirurgjik ka fituar tenderi i cili ka qenë 400 mijë euro më i shtrenjtë se oferta më e lirë.

Këtu përmendet edhe falsifikim i dokumenteve, përdorim i emrave fiktiv vetëm i ekspertëve vetëm sa për të fituar tenderë. Drejtori i Agjencionit, Hasan Preteni, pas publikimit në një konferencë me gazetarë pat thënë se korrupsioni në Kosovë nuk po luftohet në masën e duhur. Zoti Preteni më tej shtoi se vlera totale e dëmit që i është shkaktuar buxhetit të Kosovës nga veprimet korruptive supozohet të jetë mbi 10 milionë euro, por në këtë pikë ne nuk pajtohemi, sepse mendojmë se kjo shifër është shumë herë më e madhe.

Agjencia ka nevojë për mbështetje juridike, legjislaturë complete dhe më shumë kompetenca. Kjo agjenci raporton se 14 raste janë mbyllur gjatë vitit 2010 vetëm se Agjencioni Kundër Korrupsion nuk ka pasur kompetenca në bazë të ligjeve në fuqi që të merret me këto raste. Por, a duhet t'i vihet gjithë faji këtij institucioni? Unë besoj se jo, së pari ekzekutivi duhet ta luftojë korrupsionin nga brenda dhe njëkohësisht të mbajë duart larg institucioneve që e luftojnë korrupsionin.

Për më tepër ne të gjithë deputetët e qytetarët e Kosovës e kemi obligim që ta luftojmë korrupsionin që të bashkëpunojmë me institucionet.

Në këtë pikë unë mendoj se Agjencia Kundër Korrupsionit mund të bëjë më tepër përmes kampanjave për vetëdisimin e qytetarëve, për shembull shumë pak qytetarë e dinë se agjencia ka një numër pa pagesë ku mund të raportohen rastet.

Kolegë të nderuar,

Unë mendoj se agjencia duhet të raportojë pse jo edhe më shpesh pasi kemi të bëjmë me dukurinë më negative që e ka përfshirë shoqërinë tonë.

Ne jemi legjislatura e katërt dhe ja kemi borxh kësaj shoqërie përfundimin e legjislacionit kundër korrupsionit. Ne duhet ta bëjmë ligjin për konfiskimin e pasurisë së paligjshme, ne duhet të mos jemi të mëshirshëm për ata që keqpërdorin paranë publike e që për disa është bërë pjesë e punës së përditshme.

Rekomandimet e Agjencisë Kundër Korrupsionit duhet të merren shumë seriozisht, sidomos plotësimi i kornizës ligjore, ndryshimi i Ligjit për prokurim publik, ndryshimi i Kodit Penal të Kosovës, sidomos shtimi i nenit ku mosdeklarimi i pasurisë ose deklarimi i rrenë të konsiderohen si vepra penale.

Të nderuar,

Korrupsioni në Kosovë nuk po luftohet sa duhet. Korrupsioni në Kosovë edhe kur luftohet bëhet në baza krejt partiake duke mos pasur shumë për qëllim luftimin e korrupsionit sa dëmtimin e imazhit të një institucioni apo partie. Unë besoj se pa korrupsion ne do të kemi më shumë vende pune, do të kemi potencialisht më shumë investitorë, me pak varfëri dhe do të jemi një shoqëri më e dinjitetshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Po e diskutojmë raportin e Agjencionit Kundër Korrupsionit në kohën kur korrupsioni ka arritur nivelin më të lartë dhe është shtrirë në të gjitha nivelet e qeverisjes, sa që për qytetarët fjala qeveri dhe fjala korrupsion nuk ka dallim përmbajtjesor, pasi që nënkuptojnë njëra-tjetrën.

Nga raporti për vitin 2010 Agjencioni Kundër Korrupsionit më shumë merret me paraqitjen e organo-gramit të stafit dhe detyrave se sa me esencën e misionit që ka. Nga ky raport mund të shihet që ky agjencion suksesin më të madh e ka në konsolidimin e tij si institucion, se sa në punën që është dashur ta kryejë me shumë përgjegjësi.

Funksionimi i këtij institucioni shihet se është i varur me vullnetin e Qeverisë, çështjet si buxheti, stafi, kompetencat dhe ushtrimi i tyre nga Agjencioni Kundër Korrupsionit, tregojnë se deri sot ky më shumë ka qenë si plotësim i një standardi të kushtëzuar nga faktori ndërkombëtar se sa një institucion që e parandalon dhe e lufton seriozisht korrupsionin.

Në bazë të këtij raporti, 430 qytetarë që do t'i quaja të guximshëm, kanë paraqitur raste të aferave korruptive në Agjencionin Kundër Korrupsionit gjatë vitit 2010, ku prej tyre për vetëm 139 është gjetur bazë e mjaftueshme dhe kanë filluar hetimet. Gjersa, po sipas këtij raporti, dëmet që këto veprime korruptive i sjellin buxhetit të vendit, janë mbi 10 milionë euro që për t'ju afruar të vërtetës do të duhej shumëzuar së paku me dhjetë.

Ky është një sinjal që qytetarët i japin jo vetëm Agjencionit Kundër Korrupsionit, por sidomos Qeverisë se korrupsioni tanimë është bërë pjesë e pashkruar e detyrave dhe përgjegjësisë në institucionet e shtetit. Tha qytetarë të guximshëm, duke marrë për bazë presionin e vazhdueshëm që pushteti ushtron mbi qytetarët përmes formave që tanimë mbajnë vulën e Qeverisë Thaçi.

E pamë këtyre ditëve po ashtu edhe në seancën e djeshme se si po vërsulen kryeministri, së bashku me ministra, zyrtarë qeveritarë ndaj Lëvizjes “Vetëvendosje” vetëm për shkak se ne bëme publike një kontratë që i vjen era korrupsionit.

KRYESUESI: Të lutem e kemi raportin për Agjencionin Kundër Korrupsionit, e keni të drejtën kur të doni të thirrni debat për tjetër gjë.

ALBULENA HAXHIU: Po jam duke diskutuar për korrupsionin... Në rregull. Raporti përfshinë edhe pjesën e mos deklarimit të pasurisë nga disa zyrtarë, ndaj të cilëve janë marrë masa ndëshkuese në të holla nga 1000 deri 300 euro, të cilat masa më vonë janë ulur në shuma qesharake, të cilat vetëm sa mund ta rrisin numrin e mos deklarimit të pasurisë apo të deklarimit të rrejshëm të saj. Pra, është lënë në moralin e tyre që ta deklarojnë apo jo pasurinë dhe nëse gjykimi moral ka mbetur forma e vetme që korrupsioni të parandalohet, atëherë merreni me mend se sa do t’i ndalë marrja apo turpi zyrtarët qeveritarë nga aferat korruptive.

Pjesa më e dobishme në raport mund të them se është ajo e rekomandimeve të cilën duhet marrë seriozisht Kuvendi, pasi që shumë nga çështjet e rekomanduara kanë të bëjnë me hartimin e ligjeve si dhe ndryshimet dhe plotësimet që duhet bë në ligjet e aprovuara më parë, si Ligji për prejardhjen dhe konfiskimin e pasurisë, Ligji kundër mafias, amendamenti i Ligjit për prokurimin publik, ndryshimet në Kodin Penal.

Ky raport na lenë ta kuptojmë korrupsionin si dukuri që nuk ka strukturë që paraqitet aty- këtu spontanisht, gjersa jo vetëm degët, por edhe rrënjët kanë filluar t’i dalin në sipërfaqe.

Të pajtohesh me atë që është arritur deri më tani në luftën kundër korrupsionit do të nënkuptonte dorëzimin para luftës ndaj korrupsionit, do të nënkuptonte fitore për vjedhësit, keqpërdoruesit. Pavarësisht funksionimit të gjymtë të Agjencionit Kundër Korrupsionit, lëvizja “Vetëvendosje” do t’i vazhdojë përpjekjet e saj për të demaskuar e çrrënjësuar këtë dukuri dhe ata që fshihen pas saj e që sot janë në petkun e politikës institucionale të të gjitha niveleve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar AAK, deputetja Donika Kadaj- Bujupi.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Derisa ne po diskutojmë për Raportin e Agjencionit Kundër Korrupsionit, prapë po na përsëritet e njëjta, mungon Qeveria, tash ajo zero tolerancë ndaj korrupsionit e krimit e po më duket po fillon edhe po mbaron fushatë edhe sa herë që tema duhet të trajtohet në Kuvend dhe në institucione ata, ose nuk janë këtu ose edhe kur janë nuk marrin përgjegjësi.

Korrupsioni u tha edhe më herët në Kosovë po vazhdon të jetë në shkallë tepër të lartë dhe alarmuese. Po ajo çka është më keq disi ka filluar të legalizohet, sepse të gjithë po e dimë që ekziston, disa po e kundërshtojmë dhe po e kritikojmë, disa po zgjedhin të heshtin që po tingëllon si një pranim, mirëpo, ata që janë përgjegjës, në fakt Qeveria e Kosovës, mungon edhe në seancë kur diskutohet për këtë raport. Kjo është arsyeja që çdo përpjekje e cילו

mekanizëm dhe në këtë rast edhe të Agjencionit Kundër Korrupsionit për të bërë diçka në këtë drejtim, mbështetet fuqishëm nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Kjo është arsyeja që do ta mbështesim edhe këtë raport edhe pse kemi disa shqetësime tona lidhur me raportin, do të thotë raporti është shumë përshkrues, përshkruhen paragrafë të shumtë ku thuhet që ka pasur aktivitete në këtë drejtim, po disi mungojnë veprimet. Domethënë thotë, është diskutuar, është rishikuar plani, është bërë monitorimi i mediave e të tjerë e të tjerë, mirëpo mungojnë ose janë të pakta veprimet konkrete konform mandatit që ka ky agjencion e që është zbulimi dhe hetimi i rasteve korruptive.

Ne me këto sugjerime të cilat do t'i përcjellim do të thotë për agjencionin edhe me shkrim, do ta votojmë këtë raport, mirëpo konsiderojmë që Kuvendi dhe gjithë deputetët e këtij Kuvendi, pa përjashtim duhet të angazhohemi shumë më fuqishëm, në mënyrë që mekanizmat e pavarur të cilët me shumë sfida dhe sakrifica bëjnë punë të vogël në këtë drejtim, të fuqizohen nga ky Kuvend, të kemi një kontroll më të madh mbi punën, mos punën, veprimet korruptive të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nëse dëshirojmë të shohim progres në këtë vend. Ne të gjithë po e shohim se gjithçka në Kosovë po mungon, po mungojnë investimet si pasojë e korrupsionit tepër të madh, investitorët serioz kanë ikur, sepse u janë kërkuar para për të investuar në Kosovë, u janë kërkuar përqindje, do të thotë nuk ka një ambient të mirëfilltë për investime në vend. Kjo po pasohet me varfërinë e cila po rritet, me mungesën e vendeve të punës dhe me degradimin e shtetit.

Prandaj, konsideroj dhe kërkoj që ky Kuvend në ditët në vazhdim të merret dhe të veprojë konkretisht në fuqizimin e Agjencionit Kundër Korrupsionit dhe agjencioneve tjera të pavarura të cilat do të bëjnë punën e tyre. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Edhe unë ju ftoj kush ka argumente për këto çështje le t'i adresojë në prokurori menjëherë, është mirë dhe e ndihmon edhe luftën kundër korrupsionit.

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Raportet e Agjencionit Kundër Korrupsionit çdo vit janë më të mira dhe i plotësojnë kriteret e raportimit, vlen që të përgëzohen për punën e tyre dhe të njëjtën e përkrahim.

Është e vërtetë që agjencioni ka rritur performancën e saj në të gjitha drejtimet, por fatkeqësisht raportet ndërkombëtare nuk flasin për ulje të korrupsionit.

Bazuar në shumë studime ky fenomen është kompleks dhe si i tillë kërkon qasje komplekse dhe institucionale, edhe pse po bëhen përpjekje të mëdha që të forcohen institucionet e rendit dhe të ligjit, prapë kemi pak prokurorë dhe gjykatës që të mund të merren me të gjitha rastet e korrupsionit në Kosovë.

Në drejtim të gjykatave, Qeveria ka bërë një hap të mirë sa i përket mandatit të dytë e që është i përjetshëm për gjyqtarët. Në këtë mënyrë gjykatësit punën e tyre mund ta kryejnë me pavarësi të plotë.

Është e domosdoshme siç theksohet edhe në raport që të plotësohet baza ligjore me të gjitha ligjet e nevojshme. Miratimin e Ligjit anti- mafia si dhe amendamentimin e ligjeve që janë në fuqi e që janë më detajisht të përshkruara në këtë raport.

Nga Qeveria e Kosovës është e ngritur një task-forcë për ta luftuar korrupsionin, por nuk janë siguruar nde kushtet e punës, sidomos kërkesa e tyre që ka të bëjë, të jenë të siguruar nga Policia e Kosovës. Kjo task-forcë duhet të jetë plotësisht funksionale dhe t'i kryejë detyrat për të cilat edhe është formuar.

Për fund do të sugjeroj agjencionin që të jetë më tepër prezent në media, ta inkurajojë qytetarin që t'i denoncojë rastet e korrupsionit, sepse në luftimin e kësaj dukurie negative, përpos institucioneve duhet të involvohen të gjithë qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Uvaženi svi,

Parlamentarna grupa Samostalna liberalne stranke je razmatrala Izveštaj o radu Kosovske agencije protiv korupcije za 2010. godinu i smatramo da je pozitivan i u tom smislu mi čemo glasati za isti. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka të tjerë të paraqitur nga grupet parlamentare, në emër të grupeve.

Deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë do të flas shkurt edhe me siguri për deputetët e legjislaturës së kaluar do të jetë një përsëritje e asaj që kam thënë më herët.

Fillimisht duhet thënë se Agjencioni Kundër Korrupsionit për atë që ka marrë si mandat, po vazhdon ta e rritë kualitetin e performancës së vet edhe me siguri se do ta votojmë raportin. Sidoqoftë, gjatë kohës kur ne po bisedojmë për raportim, kur po diskutojmë, në kohën kur po diskutojmë edhe për agjencionin, nganjëherë po lihet përshtypja thuaj se ne do të thotë Kuvendi i Kosovës, politika e ka krijuar Agjencionin Antikorrupsion që ta luftojë korrupsionin e ne që të relaksohemi. E vërteta është se ne e kemi krijuar, është e vërtetë, Kuvendi e ka krijuar Agjencionin Antikorrupsion, në mënyrë që të na ndihmojë neve që ta luftojmë korrupsionin e jo që ata ta luftojnë e ne mos ta luftojmë, kjo është esenca fillestare.

Çështje tjetër është, çështja e punës së Agjencionin në aspektin strukturor të luftës kundër korrupsionit. Deri më tani më tepër kemi një subjektivizim, do të thotë, mbledhje të informacioneve për pasurinë e politikanëve, zyrtarëve të lartë, po ju them politikanë pak si me qëllim, por zyrtarëve të lartë, kjo pasuri që grumbullohet raportohet diku dhe kjo është një punë të cilën mund ta kryejë një drejtori, një zyre për grumbullimin e pasurisë. Unë mendoj sikur edhe më përpara se agjencioni duhet ta shtrijë veprimtarinë e vet edhe të sillet si agjencion, në mënyrë që çkado që propozon Qeveria dhe që voton Kuvendi, ta ketë edhe një mendim të agjencionit sikur që e marrim mendimin e Agjencionit për Integritet Evropian, i cili thotë ky legjislacion është në harmoni me *acquis communautaire* ose nuk është, ashtu edhe Agjencioni

Antikorrupsion të fillojë të mendojë në aspektin strukturor të luftimit të korrupsionit dhe të na tregoj neve se një legjislacion ose një vendim ose një strategji a ka elemente të cilat hapin dyer për korrupsion apo jo, apo ndoshta edhe të na sugjeroj që të mos kalojmë në legjislacion? Në atë fazë e cila me siguri nuk është përfundimtare dhe nuk është më e sofistikuar se që ndodhë diku tjetër, Agjencioni Antikorrupsion do të fillonte t'i ndihmonte Kosovës që në aspektin strukturor ta luftojë korrupsionin.

Dhe e fundit çka desha të them sot është, ne po dëgjojmë diskutimet që donë të fillojnë ta konfiskojnë pronën e krijuar në mënyrë të paligjshme, ka me qenë goxha zor se krejt prona e deklaruar është zor të vërtetohet, po ajo e paligjshmja është e padeklaruar, ose, ose edhe në emër krejt dikujt tjetër edhe nuk e di duhet këqyrë krejt Kosovën, krejt të afërmit edhe krejt kushërinjtë t'i shohim se çfarë pasurie kanë që të mund t'u biem në fije. Faleminderit!

**KRYESUESI: Faleminderit!**

Nuk ka tjerë të paraqitur.

Konstatoj se në sallë janë 84 deputetë.

Duhet ta votojmë tani Raportin. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani: Faleminderit!

Konstatoj se me 68 vota “për”, 3 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin e punës së Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit për vitin 2010.

Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës,

## **12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Energji, për vitin 2010**

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2010, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2010 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional, s'është.

Deputetja Teuta Sahatqija, është në emër të Komisionit.

**TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!**

Kryetari është i zënë, nuk ka mundësi për këtë të prononcohet, por raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë e kemi shqyrtuar në Komision. Ka qenë një raport në të cilin ka pasur diskutime të shumta që janë trajtuar çështje të ndryshme dhe pyetje të ndryshme.

Si Komision Parlamentar për Zhvillim Ekonomik e kemi marrë parasysh që ky raport mund të sillet në Kuvend dhe kemi rekomanduar si Komision që raporti të aprovohet prej deputetëve. Faleminderit!

**KRYESUESI: Faleminderit!**

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, nuk ka të paraqitur.

Në emër të grupeve parlamentare, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Berat Buzhala.

**BERAT BUZHALA:** Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kemi qenë edhe në Komision, unë mendoj që duhet ta aprovojmë raportin, por jo edhe punën e këtij bordi, ky është një raport jashtëzakonisht konkret, mirëpo është fatkeq mund ta quaj. Këtu janë konstatuar me përpikëri të gjitha dështimet edhe të Bordit edhe të Korporatës Energjetike të Kosovës. Kemi të dhëna që janë dëshpëruese, po mendoj edhe 11 vjet pas përfundimit të luftës, ja vlen t'i përmend vetëm disa konstatime që i ka bërë ky bord prej gjithë rrymës së prodhuar që i prodhojnë kapacitetet tona energjetike, 24% e rrymës edhe më tutje vidhet, është humbje komerciale që shënohet, 17% tjera janë humbje teknike për shkak të vjetërsisë së kapaciteteve dhe të rrjetit të distribucionit edhe termocentraleve. Pra, kemi të bëjmë me 41% të rrymës e cila vidhet ose humbet në rrjetë. Ndërsa, prej pjesës së mbetur të tyre edhe 14% nuk paguhet. Kemi të bëjmë mbi rreth 60% të rrymës e cila nuk paguhet, prandaj unë nuk shoh se si mund të ketë një presporitet të Korporatës Energjetike të Kosovës.

Një çështje me rëndësi është edhe politikat e mbrapshta të blerjes së rrymës, të cilat gjithashtu kalojnë përmes bordit. Në vitin 2010, mesatarisht megavati është blerë 70 euro, ndërsa është shitur 20 euro, kemi të bëjmë me një dallim prej 50 euro për megavat në blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike. Kjo tregon se nuk ka kurrfarë kujdesi, sepse blerjet dhe shitjet bëhen në mënyrë ad-hoc dhe nuk ka kurrfarë kujdesi menaxherial.

Një çështje tjetër që është jashtëzakonisht me rëndësi është e të cilën ne e kemi ngritur në Komision, është politika diskriminuese që bëhen nga bordi dhe të cilat janë aprovuar prej bordit. Madje, është fjala për planin A,B,C të reduktimeve të energjisë elektrike, në komision e kemi pyetur Përparim Kabashin, anëtar i bordit se është diskriminuese kjo, ai thotë në një mënyrë është diskriminuese. Prandaj, unë nuk shoh se si mund një bord t' i aprovojë politikat diskriminuese, pa marr parasysh se çfarë të mirash mund të sjellë ajo politikë diskriminuese, kjo është njëjtë sikur ne në Kuvend të aprovojmë ligje diskriminuese për hir një të mire të caktuar.

Prandaj, unë e konsideroj që ky raport ja vlen të votohet, të aprovohet, mirëpo puna që u bë prej këtij bordi edhe ndoshta prej bordeve të tjera, janë jashtëzakonisht të dobëta. Faleminderit, shumë!

**KRYESUESI:** Faleminderit!

Grupi Parlamentar i LDK-së, deputetja Teuta Sahatqija.

**TEUTA SAHATQIJA:** Faleminderit, kryesues!

Zyra e Rregullatorit të Energjisë është një autorit shumë i rëndësishëm për rregullimin e ambientit në sektorin e energjisë, prandaj raportin e ZRE-së, në Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar me shumë kujdes.

Raporti ka të dhëna dhe informata të shumta për sektorë të ndryshëm të energjisë, shënime, vendime për vendime, gjendjen dhe probleme me të cilën ballafaqohet ky sektor në Kosovë.

Sa i përket tarifave, ne vetëm mund të përshëndesim vendimin e ZRE-së për mos rritjen e tarifave sepse besojmë se ka mjaftë hapësirë për përmirësimin e performancës e jo që ajo të bëhet përmes rritjes së tarifave.

Viteve të fundit jemi ballafaquar me mungesën e ngrohjes kualitative apo të mungesës totale të ngrohjes nga ana e ngrohësve publike. Kjo tregon se kësaj veprimtarie duhet t'i qasemi me vëmendje të shtuar për ta rregulluar këtë veprimtari në mënyrë që të jetë rentabile.

Në lidhje me këtë duhet të bëjë definimin e qartë të kompetencave, lokale dhe qendrore, kompetencat për menaxhimin, sigurimin e subvencioneve, infrastrukturën e nevojshme ligjore për trajtimin e borxheve të mbledhura dhe posaçërisht të punohet në projektin e lidhjes së ngrohësve të Prishtinës me termocentrale, sepse ajo e vetmja ka këtë mundësi.

Sa i përket liberalizimit të tregut të energjisë apo energjive alternative, nga raporti i ZRE-së shihet se gjatë vitit 2010 janë lëshuar tri licenca fillestare dhe një përfundimtare për ndërtimin e gjeneratorëve të rinj me erë.

Ambienti energjetik në Kosovë përbëhet prej operatorit publik, por edhe hyrjen e operatorëve të rinj privat për përdorimin e energjive tjera të reciklueshme për krijimin e energjisë, operatorëve të cilët duhet inkurajuar në aspektin e krijimit të ambientit biznesor më të përshtatshëm në Kosovë. Nga kjo ka përfitime nga licenca, por edhe zvogëlim të importit siç kemi parë që paguhet me çmim shumë herë më të lartë se sa eksporti ndonëse i rrallë.

Sa i përket KEK-ut dhe subvencionimeve është koha e fundit që KEK-u të jetë kompani rentabile dhe të mos ketë nevoja për subvencionime apo për kredi. Kur flasim për KEK-un aty duhet patjetër të përmenden edhe humbjet edhe një sasi shumë e madhe e humbjeve të rrjetit e cila gjithmonë shkon në dëm të atyre paguesve të rregullt dhe në ndihmë të atyre të cilët nuk paguajnë.

Nga raporti kemi parë që Serbia ende vazhdon që të menaxhojë largpërçuesit interkonektiv dhe kjo sjell humbje për buxhetin e Kosovës dhe sjell humbje në përgjithësi në sektorin e energjisë në Kosovë, duke pasur parasysh që Serbia për çfarëdo transiti nëpër Kosovë nuk paguan për transit, pasi që i menaxhon largpërçuesit interkonektiv.

Gjithashtu çështja e shkyçjeve kolektive ka qenë çështje për të cilën është diskutuar dhe mendojmë që duhet të gjendet një zgjidhje e duhur në mënyrë që të mos dënohen paguesit e rregullt.

Sa i përket raportit, raportin do ta votojmë por presim që raporti i ardhshëm të jetë i liruar prej shumë problemeve të cilët patëm rastin t'i shohim në këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Lëvizja “Vetëvendosje” ka shqyrtuar Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike dhe konsiderojmë që ky raport të pasqyrojë qartë gjendjen për sa i përket furnizimit dhe shpërndarjes

së energjisë elektrike këtu në Kosovë, dhe konsiderojmë që edhe pa e lexuar këtë raport secili qytetar pak a shumë e di se cila është gjendja me furnizim me energji elektrike në Kosovë, për shkak se ballafaqohemi përditë me probleme të cilat vinë nga rrjeti i energjisë.

Ne konsiderojmë që dështimet në tërë sektorin e energjisë këtu në Kosovë janë dështime të cilat goxha shumë ndikohen nga politika dhe nga mungesa e vullnetit politikë për ta zgjidhur çështjen e energjisë në Kosovë, tash e 12 vjet, po flas pra për secilën qeveri jo për këtë të fundit.

Natyrisht që këto ndikime të politikës në këtë sektor kanë shkaktuar një gjendje kaotike dhe konsideroj që një prej arsyeve për këtë që edhe siç u pa edhe këtu nga parafolësi, pra është që të arsyetohen planet për sektorin e energjisë për të ardhmen e Kosovës, që të arsyetohet ky privatizim i egër për sektorin e energjisë dhe shkapërderdhja e këtij sektori, plan ky të cilin po synon ta zbatoj Qeveria e Kosovës.

Për sa i përket raportit Lëvizja “Vetëvendosje” konsideron që raporti duhet votuar pikërisht për shkak se paraqet këtë gjendje të mjerë në mënyrë reale dhe ky raport dhe raporte tjera që vinë nga kjo fushë duhet të jenë raporte të cilat na i hapin sytë për rëndësinë që ka sektori i energjisë dhe po ashtu për intervenime që duhet të kemi për të mirën në të. Faleminderit!

KRYEUSEI: Faleminderit!

Koalicioni Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrin dhe dy ministrat që janë prezent sot me neve,

Përshëndetje për të gjithë deputetë,

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2010, duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila në nenin 142 parasheh këto agjencione dhe rregullatorë ekonomik të pavarur, mund të them se Raporti i Zyrës së Rregullatorit është raport i cili në mënyrë reale paraqet gjendjen në sektorin e energjisë.

Duke marrë parasysh se të gjitha kompetencat e Zyrës së Rregullatorit janë të parapara në bazë të ligjit të Zyrës së Rregullatorit këtu shihet mjaftë qartë sa janë humbjet në Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës. Zyra e Rregullatorit ka për obligim të sqarojë çështjen e humbjeve në sektorin e energjisë.

Kemi standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike ku duhet cekim se Korporata Elektroenergjetike akoma subvencionohet nga buxheti i Kosovës, nga taksapaguesit e Kosovës dhe njëkohësisht akoma i përball qytetarët e Kosovës me reduktime të energjisë elektrike. Në raport thuhet mjaftë qartë si është gjendja e korporatës në vitin 2010 dhe sa subvencione kanë shkuar për import të energjisë dhe me çfarë çmime është importuar energjia elektrike në Kosovës. Tregon rritjen në prodhim dhe konsumim, që do të thotë se sa është rritur prodhimi, ndërsa prapëseprapë konsumi i energjisë elektrike është rritur edhe më shumë se sa që është rritur prodhimi.

Në total mund të them se gjithë raporti është një raport shumë i mirë ku paraqet edhe çështjen e energjisë termike, do të thotë çështjen e ngrohjeve. Mirëpo, çështjet e kompetencave të ndërmarrjeve publike të cilat menaxhohen nga Qeveria dhe të ndërmarrjeve në nivel lokal, ato duhet të ndahen shumë qartë kush kujt i jep llogari, atëherë në bazë të këtij raporti ne si Kuvend

dhe si deputetë duhet të kërkojmë nga ministri i Zhvillimit Ekonomik një raport të saktë nëpërmes njësisë së monitorimit të ndërmarrjeve publike për çështjen e taksave të qytetarëve të Kosovës, të dihet kah shkojnë të hollat që jepen për import të energjisë elektrike dhe për çështjen e kredive të cilat buxheti i Kosovës i jep korporate.

Çështja e bllok- tarifave shihet mjaftë qartë si është pasqyruar këtu dhe njëkohësisht edhe unë nga ky vend e falënderoj Zyrën e Rregullatorit për marrjen e një vendimi për mos ngritjen e tarifave, duke marrë parasysh se ne akoma që 10 vjet pas luftës e subvencionojmë KEK-un nga buxheti i Kosovës.

Dhe çështja e planit A,B,C, këtu duhet t'i kërkojmë prapë ministrit për Zhvillim Ekonomik, zotit Besim Beqës, që nëpërmes njësisë së monitorimit të kërkojë nga KEK-u të mos bëhet diskriminimi i qytetarëve të Kosovës në shkëputjen e energjisë elektrike në grup ose secilit konsumator veç e veç.

Koalicioni për Kosovë të Re i jep dritën e gjelbër këtij raporti të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe njëkohësisht i falënderojmë për punën e tyre që e kanë bërë për vitin 2010. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Më falë Donikë, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së deputetja Donika Kadaj- Bujupi.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës konsideron që raporti është përpiluar prej profesionistëve, është i kornizuar mirë, i strukturuar, mirëpo nuk pajtohem me të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë raport sigurisht, nuk pajtohem aspak me politikat energjetike të kësaj Qeverie, të Qeverisë Thaçi, të cilat janë në kundërshtim me konceptet zhvillimore të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Janë disa pika të cilat kanë degraduar komplet sistemin energjetik e të cilat janë pasqyruar edhe në raport, do të thotë është zvarritur dhe është vonuar linja me Shqipërinë, prandaj vazhdon të importohet energjia nga Republika Srpska. Mandej, planifikimet në të dy sektorët edhe të ngrohjes edhe në sektorin e energjisë elektrike, janë larg prej asaj se si duhet të jenë, do të thotë kemi një dështim në menaxhim në të dy sferat edhe në Termokos edhe në KEK. Kjo është arsyeja pse vazhdojmë të paguajmë tepër shtrenjtë rrymën që importohet që e blejmë dhe ta shesim tepër lirë rrymën e cila na tepron gjatë kohës së verës.

Mirëpo janë edhe disa pika të tjera të cilat na shqetësojnë tej mase, do të thotë deri sa ne flasim për apo Qeveria Thaçi në vazhdimësi krekoset për ushtrimin e masave të reciprocitetit me mallrat e Serbisë, ne kemi një raport i cili thotë që edhe kësaj radhe në ndërmarrjet e licencuara gjatë vitit 2010 është licencua edhe ndërmarrja Api Energia Doo Beograd do të thotë një ndërmarrje nga Serbia. Atë çka e kam thënë dje rreth sektorit të energjisë, rreth vonësive të ndërtimit të Termocentralit Kosova e Re dhe rreth kompanive të cilat janë të parakualifikuara, njëra prej tyre është do të thotë vjen nga India, po e përsëris edhe tani do të thotë me kompaninë që vjen nga Serbia e keni këtu në raport. Pse duhet ne në vazhdimësi të mbështesim, pse duhet Qeveria Thaçi në vazhdimësi të licencojë kompaninë nga Serbia, t'i përkrahë ato që të marrin para nga qytetarët e Kosovës, sepse dihet që importi i rrymës bëhet përmes subvencionimit nga Kuvendi i Kosovës? Do të thotë derisa tregu është i lirë ka edhe kompani të tjera nga vende të tjera të cilat janë përkrahëse të zhvillimit dhe të Republikës së Kosovës dhe jo do të thotë kjo në këtë rast. Unë nuk e di as me cilat vula, me çfarë marrëveshje, nuk e besoj që kompania në fjalë i është

nënshtuar do të thotë ekzistencës së shtetësisë së Republikës së Kosovës, mirëpo kjo do të jetë një arsye shtesë që Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do të kërkojë sqarime.

Thashë që edhe në fillim do të thotë raporti është përpiluar prej njerëzve shumë profesionistë, prandaj është i hartuar mirë. Në parim do të mbështetet, mirëpo do të kërkojmë informata shtesë për veprimet e ndërmarra e që më tepër lidhen me konceptet dhe do të thotë politikat energjetike të Qeverisë Thaçi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputetja Biserka Kostić.

BISERKA KOSTIČ: Hvala gospodine predsjedavajući!

Poslanički klub Samostalne liberalne stranke kroz aktivne učešće svoje članova u Komisiji za infrastrukturu, industriju, trgovinu i ekonomski razvoj pažljivo razmotrila godišnji izveštaj regulatora za energetiku za 2010. godinu tim podržava i glasaće za usvajanje .. izveštaja jer smatra da su ispunjene adekvatni uslovi za njegovu usvajanje. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+” Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6” e ka shqyrtuar këtë raport të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, i cili është evidente se ka hapësirë për shqetësime dhe në radhë të parë për furnizimin me energji elektrike dhe menaxhim dhe sidomos kur janë në pyetje shqycjet kolektive, ku në mënyrë të padrejtë dhe diskriminuese dënohen edhe qytetarët të cilat janë parapagues të rregullt.

Grupi Parlamentar “6” do ta votojë këtë raport duke besuar se do të merren parasysh këto shqetësime tona dhe rekomandime të cilat dolën nga diskutimet e kolegëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

E ke krye, pasi s’ka tjerë të paraqitur po t’i jap dy minuta.

E ka fjalën Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: Desha ta bëj një sqarim për problemin që e ngriti zonja Kada rreth kompanisë serbe Alpish ne kemi biseduar në Komision, ka qenë pyetja ime drejtuar bordit pse është licencuar kjo kompani? Bordi siç dihet nuk është Qeveria, nuk është Hashim Thaçi, bordi është i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, anëtarët e bordit janë zgjedhur ma moti edhe ata janë atje. Ata kanë dhënë sqarime që kësaj kompanie iu ka vazhduar kontrata. Kjo kompani Alpish, që është kompani serbe ka pasur kontratë më herët ajo ka licencë për transit të energjisë elektrike të cilën Kosova e blen prej vendeve të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka tjerë të paraqitur.

Vazhdojmë me votimin e Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2010.

Konstatohet se në sall janë 84 deputetë prezentë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani: Faleminderit!

Konstatohet se me 78 vota “për”, një “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratohet Raporti vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2010.

Kalojmë në pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës.

### **13. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2010**

Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në pajtim në dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2010, dhe Kuvendi i ka rekomanduar për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2010, dhe Kuvendi i ka rekomanduar për miratim.

Sipas Rregullores në emër të Komisionit funksional kryetari apo dikush tjetër, kush e ka fjalën? Deputetja Teuta Sahatqija, e ka fjalën, në emër të Komisionit.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!

Në emër të Komisionit e pastaj flas në emër të LDK-së.

Përsëri Komisioni e ka trajtuar me shumë vëmendje Raportin e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, për vitin 2010, në fakt ka qenë një kohë ku janë trajtuar shumë raporte me shumë vëmendje dhe në bashkëbisedim me deputetët e Komisionit prej të gjitha partive jemi pajtuar që ky raport është i vlefshëm që të dërgohet në Kuvend për miratim.

Prandaj, si Komision parlamentar për Zhvillim Ekonomik, u rekomandojmë deputetëve që të votojnë Raportin e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, s’ka të paraqitur në emër të Komisionit.

Vazhdojmë me përfaqësues të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Sala Berisha- Shala.

SALA BERISHA SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje Kabinet qeveritarë,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje Raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2010. Autoriteti i Aviacionit Civil është funksional që nga 1 janari i vitit 2009, dihet që këto kompetenca më herët kanë qenë të ushtruara nga UNMIK-u përmes Zyrës së Rregullatorit të Aviacionit Civil.

Pra, Autoriteti i Aviacionit Civil themelohet nga Ligji për aviacionin civil si agjenci e pavarur rregullatore përgjegjëse për rregullimin e sigurisë së aviacionit dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. Autoriteti i Aviacionit Civil është vetëm njëri nga autoritetet publike me përgjegjësi dhe funksioni në fushën e aviacionit civil në vendin tonë.

Ky autoritet ka bashkëpunuar ngushtë me institucione të tjera përgjegjëse për aviacionin civil në Republikën e Kosovës, në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës i shtetit të funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

Autoriteti ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me të cilën merr përsipër asistimin e personelit të kësaj ministrie në fushën e sigurimit të aviacionit civil.

Vlen të përmendet që paraqitet edhe në raport se Autoriteti i Aviacionit Civil ka qenë mjaftë aktiv në bashkëpunimin ndërkombëtar në aviacionin civil duke përfshirë bashkëpunimin me BE-në, shtetet anëtare dhe shtetet e rajonit.

Përfaqësuesit e këtij autoriteti kanë marrë pjesë në iniciativat e bashkëpunimit rajonal në fushën e aviacionit. Këtu përfshihet pjesëmarrja e këtij autoriteti në mbledhjet e organizuara nga Komisioni Evropian në kuadër të projektit të implementimit të marrëveshjes mbi hapësirën e përbashkët evropiane të aviacionit dhe në takimet e organizuara nga Agjencia Evropiane e Sigurisë të Aviacionit.

Vlen të përmendet se në raportin e progresit ka shënuar trendë shumë pozitiv sa i përket punës së këtij autoriteti.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet dhe ftoj të gjithë deputetët që ta mbështesin këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra, zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe anëtarët e Grupit Parlamentar të LDK-së në Komisionin funksional kanë shqyrtuar po thuaj se në detaje Raportin e punës së Autoritetit të Aviacionit Civil, ku janë marrë edhe sqarime të duhura nga ana e përfaqësuesve të këtij institucioni.

Kemi përshtypje se ky institucion është konsoliduar mjaftë mirë përkundër sfidave që ende mbetin në këtë fushë të rëndësishme së posaçme jo vetëm nga aspekti i zhvillimit ekonomik të vendit, por edhe nga aspekti i sigurisë së udhëtimit.

Nga raporti mund të shihet se aktivitetet kanë qenë të gjithanshme si në kompletimin e infrastrukturës ligjore përmes nxjerrjes së një numri rregulloresh në përputhje me Ligjin mbi aviacionin civil si dhe transpozimin e direktivave evropiane, kryerjen e inspektimeve dhe auditimeve për të garantuar që operimet e aviacionit civil janë në përputhje me standardet në fuqi, bashkëpunimi me institucionet në vend dhe atyre jashtë vendit si dhe pjesëmarrës me iniciativat e bashkëpunimit rajonal.

Megjithatë, ne shohim që ende mbeten sfida në këtë fushë përkundër asaj se disa prej tyre janë të natyrës objektive. Autoriteti i Aviacionit Civil do të duhej që aktivitetin e tij ta sfidojë në

fushën e shqyrtimit të aplikacioneve për operatorët ajrorë të certifikuar, në mënyrë që besojmë se do të ndikojë drejtpërdrejtë në tregun e fluturimeve. Ne jemi të gjithë dëshmitarë se çmimet e fluturimeve janë të papërballueshme për shumicën e qytetarëve tanë, përkundër asaj që statistikatat tregojnë rritje të numrit të udhëtarëve në Aeroportin e Prishtinës dhe të njëjtat janë në nivel shumë më të lartë se në vendet e tjera.

Në këtë rrafsh ne vlerësojmë miratimin nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil të propozimit të Aeroportit të Prishtinës për miratimin e ... për kompanitë ajrore që hapin linja të reja.

Po ashtu duhet të insistohet edhe më tutje që në bashkëpunimin me KFORI- të lirohet hapësira e lartë ajrore mbi Kosovë, shfrytëzimi i së cilës do të rezultojë me përfitime të konsiderueshme financiare për vendin tonë si dhe në hapjen e dy korridoreve të reja ajrore që lidhin Kosovën me Shqipërinë dhe Malin e Zi. Natyrisht, duhet të punohet me ngritjen e kapaciteteve me teknologji dhe trajnim shtesë për ofrimin e shërbimeve për kontrollin e trafikut ajrorë në hapësirën e lartë ajrore.

Në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare posaçërisht duhet të sforcohet aktiviteti i Autoritetit të Aviacionit Civil për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me BE-në, gjegjësisht të nënshkruajnë arazhmane punuese me Agjencinë Evropiane të Aviacionit Civil dhe të bëhemi të barabartë me autoritetet homologe të vendeve tjera të Ballkanit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Agim Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULETA: Zoti kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht dua të them se Raporti i punës së Autoritetit të Aviacionit Civil është një raport i shkruar mirë, i konceptuar dhe prezantuar para nesh, në përputhje me standardet e raportimit.

Raporti pasqyron një aktivitet të ngjeshur në kompletimin e akteve nënligjore që rrjedhin nga Ligji për aviacionin civil dhe implementimin e këtij legjislacioni. Dihet se mbikëqyrja e sigurisë së aviacionit është një aktivitet shumë i rëndësishëm dhe kërkon profesionalizëm dhe nivel të lartë të ekspertizës së personelit.

Në raport thuhet se autoriteti ka personel kompetent dhe profesional, mirëpo nuk specifikohet përgatitja e atyre profesionale, do të thotë a ka pilotë, a ka inxhinierë të aviacionit, kontrollorë të trafikut ajrorë e të tjerë?

Një vërejtje tjetër që do të mund t’ia drejtonim këtij raporti është mungesa e hollësive të mjaftueshme lidhur me aktivitetet rreth normalizimit të hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës. Aty thuhet që hapësira e lartë ajrore që mbyllet për trafikun ajror komercial, por është e raportuar përciptazi për aktivitetet drejt hapjes së kësaj hapësire. Një nevojë që del nga raporti në fjalë është që Qeveria të insistojë në ngritjen e kapaciteteve të shërbimit të navigacionit ajror të Republikës së Kosovës, në mënyrë që ky shërbim të jetë plotësisht i gatshëm për përgjegjësitë shtesë. Edhe pse nuk është pjesë e përgjegjësisë së autoritetit të aviacionit civil, duam të theksojmë nevojën urgjente që Qeveria të sjell për miratim në Kuvend Ligjin për themelimin e agjencisë së shërbimeve të navigacionit ajror.

Gjatë analizës që i kemi bërë këtij materiali ne si Grup Parlamentar kemi vërejtur me kënaqësi bashkëpunimin e ngushtë midis Autoriteteve të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Ky bashkëpunim ka përfshirë edhe pjesëmarrjen e inspektorëve të Autoritetit të Aviacionit civil të Kosovës në inspektimin e aktiviteteve të Aviacionit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe anasjelltas.

Gjithashtu është me rëndësi që Autoriteti i Aviacionit Civil të vazhdojë më me intensitet punët për hapjen e korridorit ajror me Republikën e Shqipërisë, në këtë mënyrë do të shkurtohej rruga midis Prishtinës dhe Tiranës, por edhe midis Prishtinës dhe aeroporteve tjera në Evropë. Kjo do të reflektohej patjetër edhe në uljen e çmimit të biletave.

Është evidente që autoriteti i aviacionit civil ka qenë mjaftë i suksesshëm në kryerjen e detyrave që ja përcakton ligji. Kemi vërejtur që edhe Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2010 thotë se Kosova ka pasur një progres të theksuar në aviacionin civil.

Anën tjetër pozitive të raportit në shqyrtim është pjesa financiare, ajo është shumë e hollësishme dhe fatkeqësisht jo të gjitha raportet që na vijnë në Kuvend për miratim përmbajnë hollësi të tilla, të cilat na japin një pasqyrë të qartë të shpenzimeve të parasë publike.

Si përfundim Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do të votojë për miratimin e këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kuleta!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni që ta përgëzoj megjithatë Autoritetin e Aviacionit Civil për një raport të mirë, strukturuar edhe të konceptualizuar mirë, megjithëse në disa raste ka narracion të tepruar, megjithatë është prej raporteve më të mira që i kemi parë si strukturë edhe si informatë deri më tash në këtë legjislaturë. Pa dashur t'i përsëris qëndrimet ose deklaratat e kolegëve tjerë, duke e ditur faktin se Kosova nuk është anëtare e barabartë e familjes ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil, megjithatë do të duhej që të kishte pak më shumë informata rreth zbatimit ose fazës së zbatimit të marrëveshjes të hapësirës së përbashkët evropiane të aviacionit, e cila sikurse që thuhet në raport është nënshkrua në vitin 2006, por deri tash edhe në raport thuhet se ka pasur arritje domethënëse, por nuk janë qartësuar se për çfarë arritje bëhet fjalë edhe në cilën fazë.

Realisht mbetet implementimi i kësaj marrëveshje dhe duhet të them qartë se nuk duhet të kënaqemi asnjëherë pse asnjë prej vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk e ka arritur ta kalojë zyrtarisht fazën e parë zbatimit të kësaj marrëveshje, por duhet ta kemi të qartë prej autoritetit të aviacionit civil se në cilën fazë, cilat janë problemet dhe pamundësitë për ta zbatuar këtë marrëveshje.

Është e qartë se Autoriteti i Aviacionit Civil ka pasur përfaqësim goxha të mirë në marrëveshjet, ose negociimet për marrëveshjet bilaterale, megjithëse gjatë raportit është theksua tepër shpesh se paska qenë pjesë e delegacionit për marrëveshjen bilaterale me Zvicrën dhe Turqinë. Normalisht që bashkëpunimi me shtetet veç e veç e fuqizon edhe e mundëson zhvillimin më të mirë të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Megjithatë vërejtja ime kryesore ka të bëjë me një prej detyrave që e ka autoriteti, ose një prej përgjegjësiave kryesore që ka të bëjë me ofrimin e këshillave edhe propozimeve konkrete, mes tjerash edhe për Kuvendin e Kosovës. dhe në këtë raport realisht nuk shihet asnjë propozim konkret nga Autoriteti i Aviacionit Civil për Kuvendin e Kosovës, megjithëse shumë shpesh përmendet fakti ose nevoja e harmonizimit ligjor me standardet e Bashkimit Evropian, por a do të duhej që të kishte konkretizim të kësaj nevoje dhe propozime të qarta për Kuvendin e Kosovës.

Normalisht, Grupi parlamentar i Aleancës do ta mbështetë, pra do të votojë për këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, deputeti Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e ka shqyrtuar Raportin e Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2010.

Raporti është në harmoni me ligjin për aviacionin civil nga i cili dalin detyrimet dhe përgjegjësitë e këtij autoriteti dhe si agjenci e pavarur dhe rregullatori i pavarur është ngarkuar me rregullimin e aspekteve të sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror, ku nënkupton miratimin e tarifave për shfrytëzimin e shërbimeve që ofrojnë këta operatorë. Nëse ndalem te zhvillimi dhe miratimi i tarifave, atëherë mund të themi se ka akoma probleme për arsye të hapësirës ajrore, ku dihet mjaftë mirë se Kosova është në këtë pikë dhe në bisedime të cilat po zhvillohen për arsye se kemi një gjatësi më të madhe ajrore dhe për këtë arsye qytetarët e Kosovës përballen me tarifatat edhe më të larta.

Në rast se e marrim në esencë shqyrtimin e këtij raporti, atëherë Autoriteti i Aviacionit Civil mund të lavdërohet për punën e tij ku lëvdata ka marrë edhe nga raporti i progresit dhe njëkohësisht ne si Kuvend duhet të përkrahim edhe anën e infrastrukturës ligjore çka i nevojitet këtij autoriteti edhe në bazë të Kushtetutës në rast se është nevoja për arsye se i gjithë raporti është i punuar në mënyrë shumë profesionale dhe e qetë gjendjen faktike në të cilën ndodhet hapësira ajrore e Kosovës.

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e përkrah këtë raport. Ju faleminderit!

KRYESUESI: faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq.

BISERKA KOSTIĆ: Hvala, gospodine predjedavajući!

Poslanički klub Samostalne liberalne stranke i ovaj godišnji izveštaj je pažljivo razmotrio. Smatra da je godišnji izveštaj Autoriteta civilnog vazduhoplovstva jedan od najboljih izveštaja koji je prošao kroz funkcionalnu komisiju. Da ne bi se ponavljalo što su prethodne kolege već rekle, izveštaj je jako kvalitetno urađen i sveobuhvatan, samim tim da relativno kratko autoritet postoji.

Poslanički klub Samostalne liberalne stranke podržava usvajanje ovog godišnjeg izveštaja i samim tim svi članovi stranke će glasati za njegovo usvajanje. Hvala!

KRYESUESI: faleminderit!

Grupi Parlamentar “6+”, deputeti Fikrim Damka.

FİKRİM DAMKA: Teşekkür ederim Sayın Meclis Başkanı yardımcısı,  
Sayın Bakanlar ve Milletvekilleri

Sivil Havacılık Ajansının raporunu incelediğimizde, dikkatimizi çeken hususların başında harcama kalemleri gelmektedir.

Özellikle yaklaşık olarak 30 personelin istihdam etmesine karşı, 100.000 Euronun ülke dışı yolculuklara ve eğitimlere harcanması çok büyük bir tutar olarak görülmektedir.

Ayrıca ofislere alınan mobilyanın 50.000 Euro gibi bir rakamda olması şaşırtıcıdır.

2011 yılında bu harcamaların minimize edileceğini umut ederek, 6+ Parlamento Grubu olarak raporu desteklemekteyiz. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje,

Përshëndetje ministrit Mujota,

Raporti i aviacionit është raport me mjaftë të dhëna financiare, marrëveshje dypalëshe, inspektimin e fluturakeve, burimeve njerëzore, shënime për fluturime, vendet në të cilat më së shpeshti udhëtohet prej Kosovës, me një fjalë është një raport me mjaftë informata.

Vlen të theksohet ashtu si parafolësit tjerë që është inkurajuese që në Raportin e progresit së paku kemi diçka që na inkurajon e ajo ishte përmirësimi, siç thuhet aty, se gënjë në punën e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Gjithashtu, edhe unë dëshiroj t'i bashkëngjitëm kërkesës që hapësira e mbikalimeve mbi 9 kilometra, e cila sot nuk menaxhohet prej autoriteteve kosovare, që të niset negocimi, që të niset iniciativa prej Qeverisë, prej Ministrisë që kjo hapësirë të kalojë në menaxhimin e Kosovës.

Duke pasur parasysh që mbikalimet prej rreth 425 deri 450 euro të cilat ndodhin çdo ditë në Kosovë dhe për të cilat në vendet tjera paguhet nga 100 euro, shihet që dëmi për Kosovën në ditë shkon diku rreth 45 mijë euro, prandaj, mendoj që është mjaftë e vlefshme, përveç aspektit politik të fuqizimit tonë si shtet, por edhe të aspektit financiar të fuqizimit material nga kjo hapësirë që edhe ashtu është hapësirë e Kosovës.

Çmimet e biletave prej aviokompanive janë jashtëzakonisht të larta, ndonëse kuptuam prej autoritetit të aviacionit civil që kanë filluar edhe fluturimet me Llonkos, po përsëri ato jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë janë çmime jashtëzakonisht të larta të cilat e rëndojnë buxhetin e udhëtarëve të Kosovës dhe duhet të jenë temë për të cilën duhet të punohet konkretisht në uljen e çmimit të biletave.

Unë desha të ngre edhe një çështje tjetër. Kosova sot i ka dy aeroporte, e ka aeroportin kryesor, Aeroportin e Prishtinës, i cili menaxhohet nga autoritetet kosovare. Por, në të njëjtën kohë Kosova e ka edhe një aeroport tjetër, Aeroportin e Gjakovës, të komunës së Gjakovës, aeroport i ndërtuar nga Qeveria italiane dhe dëshiroj edhe një herë të shfrytëzoj rastin që të falënderoj Qeverinë italiane që e ka sjell këtë pasuri të madhe në territorin e Kosovës. Ky aeroport vazhdon të jetë nën administrimin e KFORR-it italian. Aeroporti i Gjakovës i plotëson 100% standardet teknike të cilat kërkohen prej një aeroporti, janë standardet profesionale, standardet ndërkombëtare që janë 100% të plotësuara dhe ky aeroport duke pas parasysh që nuk ka infrastrukturën ta quaj luksoze për fluturimet luksoze, mund të shfrytëzohet si aeroport dytësor, si aeroport për Lloko sflaj, për çmime të ulëta, për kargo për aeroport sportiv. Prandaj, kërkojmë që Qeveria dhe Ministria konkretisht dhe na vjen mirë që është ministri këtu, që t'i nisë bisedat për bartjen e kompetencave të autoritetit të menaxhimit të këtij aeroporti në autoritet tona.

Jemi në dijeni që kushtet në këtë vit janë shumë më të ndryshme dhe që ekziston mundësia që Aeroporti i Gjakovës në fund të jetë aeroport në menaxhimin në kompetencën tonë, në kompetencën e Qeverisë tonë edhe pse jo edhe të komunës së Gjakovës, edhe pres që kjo iniciativë t'ia nisë.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar ministri Mujota.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Vërtet unë e çmoj shumë angazhimin e secilit deputet në shqyrtimin që i ka bërë këtij raportit të Autoritetit të Aviacionit Civil. Ndaj plotësisht pikëpamjet me ju që ky autoritet ka bërë një punë shumë të madhe, por natyrisht që ka edhe shumë punë tjera për të bërë. Dhe, është e rëndësishme se jemi të koordinuar plotësisht në kuadër të hartimit të politikave për autoritetin civil të aviacionit, dhe natyrisht ky autoritet po i kryen detyrat e veta sipas obligimeve që i ka dhënë Kuvendi i Kosovës.

Unë dua të tërheq vëmendjen në dy çështje që u ngritën në këtë rast që kanë kuptimin po ashtu pozitiv.

Është e rëndësishme se Projektligji për themelimin e Agjencionit për Shërbimin e Navigacionit është në hartim e sipër dhe në afatin 3 mujor Kuvendi i Kosovës do të ketë mundësi ta miratojë dhe me këtë do të ndihmojmë edhe më tepër këtë autoritet që t'i kryejë detyrat e veta.

Dhe njëkohësisht meqë kemi të bëjmë me diskutimin e ardhshëm edhe për një autoritet tjetër atë të hekurudhave edhe për të dua t'ju njoftoj që tani se ligji është i përgatitur dhe shpejt do të procedohet në Qeveri dhe në Kuvend.

Çështja e hapësirës ajrore si çështje delikate do të thosha në një kuptim është fakti se hapësira ajrore e Kosovës në kuptimin e shfrytëzimit komercial është një çështje që duhet të diskutohet në nivele të ndryshme dhe do të marrin pjesë shumë aktorë, duke pasur parasysh autoritetin e

KFOR-it, përkatësisht NATO-së mbi hapësirën ajrore dhe tashmë iniciativat kanë filluar mund t'ju siguroj se kanë filluar, debati ka shkuar deri në nivel që tregon se kjo do të ketë një zgjidhje të shpejtë dhe Kosovës do t'i kthehen shumë përgjegjësi në kuptim të kontrollit ajror.

Ndërsa, për çështjen natyrisht Kosovës kur të them nënkuptoj edhe me zgjedhjen e operatorit dhe marrëveshjes që do të ekzistojë mes aktorëve për operatorin që do ta përzgjedhin. Besoj që të kemi një operator të përmasave dhe të standardeve evropiane.

Ndërsa, çështja e Aeroportit të Gjakovës, që deputetja Teuta Sahatqija ka ngritur në këtë rast, është një çështje që, po ashtu, Autoriteti i Aviacionit Civil ka bërë një njoftim se ka pasur disa diskutime dhe është e rëndësishme që të ketë Kosova një aeroport alternativ, por duhet të shihen edhe aspektet tjera financiare dhe aspektet tjera të infrastrukturës, në mënyrë që në kohën e duhur të përgatitemi si Qeveri si vend që të marrim një pjesë ose tërësisht autoritetin mbi këtë aeroport. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Atëherë vazhdojmë me votimin raportit vjetor të autoritetit të Aviacionit civil për vitin 2010.

Konstatohet se në sallë janë 66 deputetë,

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, tani.

Ju faleminderit!

Konstatohet që me 63 vota "për", 1 abstenim, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2010.

Pika e katërmëdhjetë e rendit të ditës.

#### **14. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Autoritetit Rregullativ të hekurudhave për vitin 2010.**

Po, po, zotit Beqiri, fjalën!

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti kryesisë.

Do të doja të dija si mbeti çështja e propozimeve të Komisionit ad-hoc. Ne i dhamë disa propozime, mbeti që, në mos të gabohem, sot t'i japin partitë tjera, prandaj mos të mbetet gjysmë kjo. Ne e filluam, mbeti që edhe Partia Demokratike edhe të tjerët t'i japin dhe të kompletohet ai komision ad-hoc që mos të zhagitet puna. Nëse është e mundshme, nuk shoh asnjë arsye kjo të mos bëhet. Ishte pika e shtatë, mos gabofsha, në rend dite dhe. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ne biseduam sot para se të hyjmë këtu në mbledhje. Ka mbetur që të gjithë së pari t'i dërgojnë emrat, mos të luajmë kështu para mediave dhe para kamerave që po na përcjellin, para qytetarëve. Të gjitha partitë që janë në Parlament, pa marrë parasysh se a janë grupe parlamentare a jo, sipas Ligjit duhet të sjellin nga një përfaqësues në këtë komision. Kështu thotë ligji, pa marrë parasysh kush sa pajtohet me këtë çështje. Prandaj, në qoftë se janë të gjitha partitë dakord, le t'i dorëzojnë tek sekretaria dhe pastaj i procedojmë me shpalljen publike të emrave të tyre.

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në pajtim me dispozitat e Rregullores së punës, ka shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar për Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional. Nuk është. Nënkryetarja Teuta Sahatqiu e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIU: Ju faleminderit, kryesues!

Gjithashtu, Raporti për Hekurudha ka qenë një raport i cili është shqyrtuar në komisionin parlamentar. Raport në të cilin janë bërë shumë pyetje dhe shumë sugjerime dhe në bazë të diskutimeve dhe miratimit të deputetëve, si Komision parlamentar për Zhvillim Ekonomik, kemi proceduar, kemi menduar se duhet të procedohet në Kuvend dhe të aprovohet si raport. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, nuk është. Vazhdojmë me grupet parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputetja Sala Berisha Shala.

SALA ABERISHA SHALA: Ju faleminderit kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe ky raport vjetor është njëri nga raportet vjetore që janë të obliguara nga autoritetet e pavarura t'i raportojnë Kuvendit në bazë të Kushtetutës. Grupi Parlamentar e ka analizuar këtë raport. Ajo që vlen të përmendet është se ky Autoritet për herë të parë i raporton Kuvendit. Me Ligj është i themeluar, Ligji është nxjerrë në vitin 2008, ndërsa miratimi i këtij autoriteti nga ana e Kuvendit është bërë diku në vitin 2010.

Si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështesim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Ju faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Raporti që po shqyrtojmë, në masën më të madhe reflekton punën në konsolidimin e këtij organi, e që ka të bëjë me kompletimin e stafit, takimin me institucione të ndryshme si dhe përpjekjet për implementimin e ligjit në këtë fushë.

Raporti përshkruan çështje organizative të vetë Autoritetit dhe shumë pak na jap informata për çështje që janë në kompetencë të tij, duke filluar nga licencat, certifikatat e sigurisë dhe lejet, nxjerrjen e rregulloreve për marrjen e tyre, miratimin e pajisjeve hekurudhore lidhur me sigurinë dhe nxjerrjen e rregullave mbi të, kryerjen e inspeksioneve të sigurisë, hetimin e fatkeqësive, si dhe mbikëqyrjen, ofrimin e informatave dhe bërjen e rekomandimeve Qeverisë dhe Kuvendit për këtë fushë.

Ne presim që ky institucion të konsolidohet sa më shpejtë që është e mundur dhe të fillojë të merret seriozisht me rregullimin e këtij sektori shumë të rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë. Ne jemi të vetëdijshëm për mungesën e infrastrukturës ligjore pasi që Ligji në fuqi mbi hekurudhat më shumë merret me rregullimin e çështjeve administrative të funksionimit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, se sa me rregullimin e raporteve ekonomike të cilat do ta bënin këtë sektor shumë më atraktiv për investime. Është e pakuptueshme që vetëm në vendin tonë transporti i mallrave me hekurudhë është më i shtrenjtë se transporti rrugor, që paraqet sinjal të qartë se duhen masa konkrete të riorganizimit rrënjësor të hekurudhave të Kosovës, që ato të bëhen konkurruese në tregun e transportit të mallrave, që të bëjë përfundimin e ndarjes së infrastrukturës dhe operimit, proces i filluar që në vitin e kaluar.

Po ashtu, në raport nuk kemi kurrfarë informatash sa i përket funksionimit të hekurudhave në veri të vendit, e që integrimi i plotë i menaxhimit të hekurudhave është parakusht për zhvillimin e këtij sektori.

Duke marrë parasysh kohën shumë të shkurtër të funksionimit të këtij institucioni, LDK do ta aprovojë, megjithatë do ta aprovojë raportin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputeti Afrim Hoti

AFRIM HOTI : Ju faleminderit, kryesues!

Grupi parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2010. Nuk ka ndonjë vërejtje të veçantë, Prandaj në parim këtë raport e voton. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të AAK-së, deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Ju faleminderit, kryesues!

Edhe tri vjet, do të thotë pas hyrjes së Ligjit në fuqi, shihet qartë se ende nuk është funksionalizuar Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave dhe ajo që duhet thënë qartë, është se raporti është plotësisht jo profesional dhe është goxha çudi si komisioni funksional e ka kaluar dhe e ka rekomanduar të vijë në Kuvend. Besoj se do të duhet thjeshtë të fillojë të mësojë për të shkruar, sepse një raport i tillë nuk mund t'i dërgohet Kuvendit të Kosovës, me këtë përbërje, me këtë strukturë dhe me këto lloj formulime që kanë ndodhur, me aktivitetet mujore të cilat janë përfshirë në raport për të cilat vetëm nuk shihet, vetëm krejt çka mungon ose sa kafe janë pirë gjatë aktiviteteve mujore. Përndryshe, një prej shembujve është, për shembull, se në qershor krejt aktiviteti i qershorit është se është përgatitur shpallja e konkursit.

Domethënë, kjo është vërtet joprofesionale të shkruhet një raport i tillë. Përndryshe, ne e dimë se gjendja në hekurudhat e Kosovës është jashtëzakonisht e rëndë edhe rrjeti hekurudhor i Kosovës, tash shekullin XXI, garant është më i keq se në Kongo në vitin 1870, edhe e dimë që problemet janë bartur, por sipas këtij raporti, ne nuk shohim në asnjë element se ku janë problemet, pse nuk janë zgjidhur dhe si duhet të zgjidhen sipas këtij Autoriteti Rregullativ. Shohim qartë se madje as licenca për shoferët e lokomotivave nuk janë dhënë prej shpalljes së pavarësisë, domethënë prej vitit 2008, por mbi të gjitha nuk shohim dhe nuk përmendet fare

se si trenat e Serbisë hyjnë në territorin e Kosovës dhe kjo, realisht të themi, nuk guxon të shmanget në raportet e tilla sepse nuk kemi nevojë të frikohemi që t'i themi se cilat janë problemet kryesore.

Ka edhe formulime komplet kontradiktore. Për shembull, në faqen e dytë të raportit, falënderohet Qeveria për përkrahje, ndërsa në faqen 25 thuhet se janë, autoriteti është i brengosur që nuk ka përkrahjen e duhur. Do të thotë, ka një kontradiktë të plotë të formulimit. Ne e kuptojmë se ky është raportimi i parë i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për Kuvendin e Kosovës. Rekomandimi ynë për Autoritetin është të mësohet të shkruaj dhe pasi është raporti i parë, megjithatë ne do të abstenojmë. Ju faleminderit!

*Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti*

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit parlamentar të Koalicioni Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Koalicioni për Kosovën e Re ka shqyrtuar Raportin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2010.

Duke marrë parasysh se ky raport i Autoritetit të Hekurudhave duhet të jetë në koherencë me Ligjin për hekurudhat në Republikën e Kosovës dhe duke marrë parasysh se Ligji për hekurudhat ka ardhur me pakon e presidentit Ahtisari, atëherë ka mangësi të mëdha edhe në ligj. Deputeti nga LDK-ja i potencoi çështjet e këtij Ligji që nuk japin mundësinë se si të bëhet zhvillimi ekonomik përmes hekurudhave, potencon çështjen e formimit të Autoritetit të pavarur të hekurudhave, përgjegjësitë, funksionin dhe çështjen më esenciale, si duhet të vijë deri te zhvillimi i operatorëve ekonomik të hekurudhave, nuk potencon dhe për këtë arsye ne duhet të marrim parasysh edhe përvojën e këtij Bordi të Hekurudhave, i cili është Bord i ri.

Raporti në përgjithësi është raport përshkrues, mirëpo presim që raporti i ardhshëm për vitin 2011 dhe ky Kuvend të insistojë të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për hekurudha, në të mirë të operatorëve të tjerë të hekurudhave dhe zhvillimin e hekurudhave si aset kryesor për zhvillim ekonomik dhe Bordi i këtij autoriteti, në raportin e vitit 2011, të jetë raport ashtu siç duhet të jetë dhe Grupi Parlamentar për Kosovën e Re i jep përkrahje për arsye se janë për herë të parë duke raportuar në Kuvendin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit të SLS-së, deputetja Biserka Kostiq.

BISERKA KOSTIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je i ovaj godišnji izveštaj Regulatornog autoriteta železnica pažljivo je razmotrila. Iako su u Funkcionalnoj komisiji ukazane određene preporuke i kritike za ovaj Izveštaj, u nameri da 2011. godina bude mnogo kvalitetnija i sveobuhvatnija što se izveštaja tiče, ali svakako će podržati izglasavanje ovog istoimenog izveštaja u ime cele stranke. Ovaj Izveštaj će biti podržan. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar “6+”, deputeti Fikrim Danka.

Teşekkür ederim Sayın Meclis Başkanı yardımcısı,  
Sayın Bakanlar ve Milletvekilleri  
Demiryolları Düzenleme Kurumu raporunu incelediğimizde, bu kurumun yeni olmasını gözönünde bulundurarak, ilk önce çok iyi hazırlanmadığını ve harcama kalemlerinden 60.000 Euronun ayrıntılı bir şekilde açıklanmadığını gördük.  
Demiryolları Düzenleme Kurumunun 2011 yılında daha iyi bir rapor hazırlayacağını tahmin ederek, 6+ Parlamento Grubu olarak raporu destekliyoruz. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Tash fjalën e ka deputeti Kurtan Kajtazi, është i fundit.

KURTAN KAJTAZI: Ju faleminderit, nënkryetar!  
Të nderuar ministra,  
Të nderuar deputetë,  
Desha t'i shkoqis disa çështje që janë me rëndësi për Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave për Qeverinë e Kosovës dhe për vetë hekurudhat e Kosovës.

Është zbatimi i vendimit të Qeverisë i marrë në shkurt 2010, që ka të bëjë me shuarjen momentale të ndërmarrjes Hekurudhat e Kosovës dhe krijimin e ndërmarrjeve të reja sipas Ligjit mbi Hekurudhat në fuqi, si dhe Rregullativën evropiane. Plotësimi i bazave ligjore me anë të Ligji të ri, sipas raportit, është duke u draftuar, e tha edhe vetë ministri dhe përkrahja e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave nga ana e Kuvendit nëpër të gjitha komisionet funksionale.

Sa i përket çështjes së zbatimit të vendimit të Qeverisë mbi formimin e dy ndërmarrjeve të reja, dua të theksoj se ky vendim është marrë me qëllim që sektori hekurudhor të hapet sipas kërkesës së ekonomisë së tregut. Me qenë se situata momentale që kemi në realitet paraqet një monopol në sektorin e Hekurudhave të Kosovës, e mbajtur nga një ndërmarrje e vetme publike, që janë hekurudhat e Kosovës.

Zbatimi i vendimit të Qeverisë sa më parë do të krijonte hapësirë për ofrues tjetër të shërbimeve hekurudhore, si dhe do të krijonte fushëveprim të mjaftueshëm për Autoritetin Rregullativ Hekurudhor, që të marrë në zbatim një pjesë të kompetencave ligjore të tij, që për momentin janë të përqendruar në hekurudhat e Kosovës.

Po ashtu, dua të theksoj se përveç që kjo çështje është në harmoni të plotë me planet zhvillimore të Qeverisë deri në vitin 2014, kjo çështje është edhe një pjesë në Raportin e progresit dhe nuk do të duhej të ishte si punë e pakryer në këtë vit në Raportin e progresit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!  
Nuk ka të tjerë që donë të flasin. Në sallë kemi 62 deputetë. Vazhdojmë me votimin e Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2010.  
Ju lutem, të bëheni gati, edhe teknika. Votojmë, tash.  
Konstatoj se me 53 vota “për”, 7 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Autoritetit të Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2010.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

### **15. Shqyrtimi i Raportit të punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2010**

Komisioni Funksional për Legjislacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores të punës, ka shqyrtuar Raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Për Komisionin Funksional, flet Behar Selimi. Deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Ju faleminderit!

Po flas në cilësi të zëvendëskryetarit të Komisionit për Legjislacion.

Por njëkohësisht, meqë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike nuk ka mendim ndryshe nga rekomandimi i Komisionit, dhe me autorizimin e Grupit Parlamentar të PDK-së, flas edhe në emër të grupit parlamentar.

Komisioni për Legjislacion, duke vepruar në pajtim me Ligjin për Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe me Rregullën 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2011, e ka shqyrtuar Raportin e punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2010, dhe vendosi që t'i rekomandojë Kuvendit të Republikës së Kosovës, që të shqyrtohet dhe të miratohet Raporti i punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2010.

Grupi parlamentar i PDK-së e mbështet rekomandimin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Selimi!

Për Komisionin për Buxhet dhe Financa, a do të flasë dikush? Nuk ka të paraqitur. Atëherë, kalojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Për PDK-në, zoti Selimi e tha mendimin. Për LDK-në, flet Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Ju faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i LDK-së ka shqyrtuar Raportin e Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2010. Raporti kryesisht ndalet në aktivitetet e Institutit që kanë të bëjnë me trajnimet e organizuara për gjymëtarë dhe prokurorë, megjithatë është me rëndësi se kjo është vetëm gjysma e mandatit që i takon këtij Instituti, sipas ligjit. Ligji për themelimi e Institutit Gjyqësor të Kosovës parasheh edhe rolin e këtij institucioni në zhvillimin e planeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për një gjyqësi efektive, efikase dhe të paanshme, si dhe kryen veprimtari tjera profesionale të karakterit kërkimor për zhvillimin e gjyqësisë në Kosovë, pra jo vetëm rolin e tij në ngritjen profesionale dhe trajnimin e gjymëtarëve dhe prokurorëve. Megjithatë, i gjithë raporti tregon vetëm për punën e këtij Instituti në këtë pjesën e ngritjes profesionale të gjyqësisë.

Sipas raportit, pjesa dërmuese e punës të raportuar ka të bëjnë me trajnime, pra me programe arsimimi për gjyqtarë dhe prokurorë. Edhe pse ka këtë mandat ligjor, Instituti Gjyqësor ende nuk ka arritur të iniciojë apo zbatojë projekte kërkimore që do të ndikonin në zhvillim e

gjyqësisë, e aq më pak të zhvillojë plane afatmesme apo afatgjata që do të ndikonin në rritjen e efektivitetit dhe të paanshmërisë në Gjyqësor.

Për më tepër, është evidente që disa nga pengesat për punën e këtij instituti paraqiten për shkak të Ligjit që e rregullon punën e tij. Në radhë të parë, ky Ligj duhet të ndryshohet që të reflektojë statusin e Kosovës si shtet i pavarur, sepse Ligji ende figuron ashtu si është miratuar në kotë të UNMIK-ut dhe i referohet edhe prezencës e rolit të përfaqësuesit të UNMIK-ut në Institut, si dhe kompetencave të PSSP-së.

Për ndryshime të tilla dhe të tjera që janë të nevojshme për këtë Ligj, përveç rolit të Qeverisë, është me rëndësi edhe instituti të luaj një rol më aktiv, gjithnjë duke pasur parasysh mandatin që e ka me ligj dhe të kërkojë që këto ndryshime të iniciohen sa më shpejtë për të siguruar punën më efektive në institut.

Gjithashtu, ideja për themelimin e Akademisë Gjyqësore, e cila ekziston në të gjitha vendet e rajonit e më gjerë, edhe pse është prezantuar para disa vitesh, asnjëherë nuk është elaboruar dhe nuk janë ndërmarrë hapa konkret në këtë drejtim nga Instituti, gjithnjë duke pasur parasysh rolin e Institutit në zhvillimin e gjyqësorit, me qëllim të ngritjes të efikasitetit dhe paanshmërisë, po e theksoj, ky Institut duhet të iniciojë pjesëmarrjen e gjyqtarëve në procesin e hartimit të ligjeve. Ajo që në gjuhën juridike quhet qëllim i hartuesit, mund t'u shërbej jashtëzakonisht shumë gjyqtarëve që ta kenë shumë më të lehtë interpretimin e ligjeve, gjithnjë duke pasur informata për procesin e hartimit të tyre. Kjo praktikë zbatohet jo vetëm në vendet e rajonit, por edhe në të gjitha vendet që njihen për nivel më të lartë të sundimit të ligjit dhe efektshmërisë dhe gjyqësorit.

Sa i përket trajnimeve të kryera nga ky Institut, është jashtëzakonisht me rëndësi të bëhet një përshtatje më e madhe e këtyre trajnimeve me nevojat e gjyqtarëve, që ata i identifikojnë si probleme gjatë punës në praktikë, si dhe përshtatjen e këtyre trajnimeve me ligjet e reja në fuqi. Pikërisht për këtë arsye, është esenciale marrja e rekomandimeve konkrete nga gjyqtarët lidhur me vështirësitë që ata i hasin gjatë punës së tyre.

Instituti Gjyqësor i Kosovës, duhet të luaj rol më aktiv në caktimin e agjendës së trajnimeve, duke dalë edhe vetë me propozime konkrete, propozime këto që duhet të jenë rezultat i analizave që i marrin për bazë rekomandimet e gjyqtarëve, jo vetëm të pranojë rekomandimet që vinë nga jashtë. Jam shumë e sigurt që të gjithë partnerët dhe donatorët të cilët e kanë mbështetur IGJK-në gjatë këtyre viteve, janë të interesuar që trajnimet që ata i ofrojnë dhe financojnë të kenë rezultate konkrete e jo thjeshtë të kryejnë një detyrë që e kanë të shkruar në letër, e cila nuk rezulton në zhvillimin dhe rritjen e efikasitetit në gjyqësi dhe nuk merr për bazë nevojat praktike të Kosovës.

Për më tepër, Instituti Gjyqësor duhet të bëjë analiza lidhur me atë se në cilat fusha ka më së shumti mangësi në Kosovë dhe këto t'i reflektojë në programin e trajnimeve. Janë një sërë fushash që janë lënë anash, për shembull, e para është e drejta komerciale apo tregtare, e cila është fusha me zhvillimin më të mangët në Kosovë dhe fatkeqësisht mungesa e njohurive nga kjo fushë, në gjyqësorin tonë po i kushton shumë komunitetit të bizneseve dhe në përgjithësi zhvillimit ekonomik të Kosovës.

E dyta, është fusha e pronësisë intelektuale. Përkundër një numri të vogël të trajnimeve në këtë fushë, mangësitë në zbatimin e ligjeve nga kjo gushë janë evidente dhe fatkeqësisht përmenden edhe si një ndër sfidat kryesore në Raportin e progresit për vitin 2010, sa i përket sundimit të ligjit.

E treta, janë metodat alternative për zgjidhjen e kontesteve, të cilat janë zhvilluar në masë të madhe në të gjitha vendet e rajonit edhe si metoda paragjyqësore për zgjidhjen e kontesteve, që me rekomandimin e vet gjyqtarëve zhvillohen brenda lokaleve të gjykatave. Këto metoda ndikojnë në masë të madhe në zvogëlimin e volumit të punës të gjykatave dhe rritjen e efektshmërisë së punës së tyre, mbi të gjitha në rritjen e nivelit të sundimit të ligjit.

Përfundimisht, duhet të rritet numri i trajnimeve që kanë të bëjnë me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut dhe instrumentet tjera ligjore ndërkombëtare që kanë aplikushmëri të drejtpërdrejtë në Kosovë, siç parashihen në Kushtetutën e Republikës.

Ne, si Grup Parlamentar i LDK-së, përkundër të gjitha këtyre vërejtjeve që i përmenda, do ta përkrahim Raportin e punës për vitin 2010, për këtë Institut, duke pritur që Instituti Gjyqësor i Kosovës të marrë parasysh të gjitha këto rekomandime për punën e tyre gjatë vitit 2010, gjë që ne do ta përcjellim rregullisht, në mënyrë që mos të përsëriten mangësitë e vitit 2011.

Një propozim që u dha dje nga deputeti Ali Sadriu, është që ky Kuvend ta shohë mundësinë që si Institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e punës agjencioneve të pavarura, ta bëhet edhe auditimi i performancës, e jo vetëm auditimi i rregullsisë, si masë për shtimin e efikasitetit të punës së agjencioneve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", deputetja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Ju faleminderit, kryesuese!

Grupi parlamentar i lëvizjes "Vetëvendosje", e ka analizuar Raportin e Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2010. Pjesë me rëndësi e këtij raporti janë aktivitetet që kanë të bëjnë me përgatitjen e kuadrove të reja për të cilat është në nevojë sistemi i drejtësisë në vend.

Ne e çmojmë dhe e mbështesim punën dhe angazhimin e punëtorëve të këtij instituti në procesin e freskimit të sistemit gjyqësor me kuadro të reja, edhe pse sfida mbetet funksionimi i pavarur i sistemit të drejtësisë, me çka edhe ballafaqohen që në fillim këto kuadro.

Ajo se çka është shqetësuese në këtë institut, është numri shumë i vogël i stafit, i punëtorëve dhe buxheti me të cilin ky institucion operon, e që në këtë vit është shumë më shumë më i vogël se vitet e kaluara. Pra, duket qartë se është i pamjaftueshëm për të përmbyllur ciklin e kompletimit me kuadro të sistemit të drejtësisë, me gjyqtarë dhe prokurorë.

Mbetet për t'u bërë më shumë nga ky Institut në kryerjen e veprimtarive të tjera profesionale, sidomos në atë të hulumtimeve, pasi që edhe e ka në mandat, sikundër që duhet rishikuar dhe avancuar misionin e këtij Instituti për shkak të arriturave që ka pasur, duke i përkrahur iniciativat për ta transformuar këtë institut në Akademi Gjyqësore, duke u bazuar në praktikat

më të suksesshme në botë, pa pasur nevojë që të themelohet në akademi e tillë, ashtu siç kemi dëgjuar nga Ministri i Drejtësisë ditëve të mëparshme.

Si përfundim, Lëvizja “Vetëvendosje” do të votojë në favor të këtij raporti, duke bërë përpjekje që në të ardhmen t’i ngrisin kapacitetet për ushtrimin të misionit ashtu siç duhet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Për të mos e zgjatur më tepër, disa çështje të cilat u thanë edhe nga parafolësit vlejnë edhe për Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Ne e kemi themeluar këtë institut, në mënyrë që t’i ndihmojë sundimit të Ligjit në Kosovë, përkundër të arriturave dhe mendojmë se edhe Qeveria e Kosovës duhet të kujdeset pak më shumë që ky institut ta kryejë punën e vetë, për çka edhe është themeluar. Në cilindo variant, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë rekomandimin e komisionit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar Kosova e Re, deputetja Suzana Novobrdaliu.

SUZANA NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Raportin e Institutit Gjyqësor të Kosovës. Mendon se Instituti Gjyqësor i Kosovës ka arritur suksese në punën e tij. Rezultatet e arritura janë përgatitja profesionale mbi 140 kandidatë të ri për gjyqtarë e prokurorë, nga të cilët 53 tashmë janë emëruar dhe ushtrojnë me shumë sukses funksionin e gjyqtarit, apo prokurorit, ndërsa pjesa tjetër pritet të përfundojë trajnimet dhe procedurat për emërimin gjatë vitit 2011, me çka edhe pritet të plotësohen vendet e lira të mbetura nga procesi i emërimit dhe i riemërimit.

Ka pasur bashkëpunim të mirë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe institucionet tjera relevante të sistemit të drejtësisë. Ka pasur rritje të vazhdueshme të aktiviteteve edhe pse e njëjta rritje nuk është manifestuar në buxhetin e Kosovës, në kuadro dhe staf, organizim të shumë trajnimeve të specializuara dhe përgatitje të programeve me qëllim të zbatimit të ligjeve të reja për sistemin gjyqësor. Vëmendje të veçantë duhet t’i kushtohet trajnimeve që lidhen me drejtësinë e Bashkimit Evropian, të cilat janë edhe parakusht për integrimin e Kosovës.

Gjatë punës së tyre, ata kanë hasur edhe në pengesa të cilat janë për kryerjen e punës së tyre, që është buxheti i pamjaftueshëm, numri i vogël i të punësuarve, akomodimi joadekuat, do të thotë mungesa e objektit për zhvillimin e veprimtarive. Mirëpo, sido qoftë, ne mendojmë dhe propozojmë që Qeveria e Kosovës duhet më shumë ta përkrah këtë institucion. Këtë raport ne do ta përkrahim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar SLS, Jasmina Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem!

Ono što je očigledno iz samog Izveštaja je to da je Institut tokom 2010. godine, najviše uložio napore i sredstava iz budžeta u usavršavanje obrazovanja kadrova Instituta. Da bi smo primenu tog stečenog znanja videli u 2011. godini, Parlamentarna grupa SLS će podržati ovaj izveštaj. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi parlamentar “6+”, Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Nakon analiziranja godišnjeg Izveštaja Kosovskog instituta za pravosuđe, Parlamentarna grupa „6+“ mišljenja je da je isti vrlo temeljan u pogledu informacija na koje se odnosi i pokazuje aktivnosti i sve druge pozitivnosti dosadašnjeg funkcionisanja, programa obuke za pravosudno obrazovanje sudija i tužioca i napretke postignute u oblasti publikacija važnih radova izveštaja za pravosudne aktere. Zbog svega navedenog, odluka grupe je da podrži izveštaj u načelu.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nuk ka tjerë të paraqitur. Në sallë janë 70 deputetë.

Vazhdojmë me votimin e Raportit vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2010.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, tani.

Konstatohet që me 64 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2010.

Vazhdojmë me pikën e gjashtëmbëdhjetë dhe të fundit të rendit të ditës, që është:

**16. Debatë parlamentare lidhur me bashkëpunimin e Republikës së Kosovës me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Lladrovci, të mbështetur edhe nga deputetë të tjerë**

Deputeti Ramiz Lladrovci dhe grupi i deputetëve nënshkruar ka parashtruar në Kuvend kërkesën për debat parlamentar lidhur me bashkëpunimin e Republikës së Kosovës me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in, në veçanti shqyrtimin e rasteve të ngritura nga Republika e Serbisë pranë institucioneve në fjalë për qytetarët dhe zyrtarët më të lartë shtetëror të Republikës së Kosovës.

Sipas Rregullores, i pari e ka fjalën deputeti Ramiz Lladrovci, në cilësinë e propozuesit i paraqet arsyetimet e kërkesës për debat.

RAMIZ LLADROVCI: Ju faleminderit, nënkryetar!

I nderuari nënkryetar,

I nderuari zoti kryeministër, ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Me iniciativën time dhe me përkrahjen njëzëri të deputetëve të tjerë, kam kërkuar nga Kryetari i Kuvendit që të futet për trajtim në Kuvend bashkëpunimi i Republikës së Kosovës me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in dhe, në këtë kuadër, trajtimin e statusit të fletë-arresteve të ngritura nga Republika e Serbisë pranë institucioneve në fjalë për qytetarët dhe zyrtarët më të lartë shtetërorë e politikë të Republikës së Kosovës.

Në Kosovë ekziston një zyrë ndërlidhëse me INTERPOL-in, që udhëhiqet nga UNMIK-u, kurse në përbërje të saj janë edhe Policia e Kosovës dhe ajo e EULEX-it. Kjo zyrë është themeluar në bazë të Rezolutës 1244 të Kombeve të Bashkuara, e cila me Kushtetutë bartë çdo marrëveshje të UNMIK-ut, nëse nuk e rregullohet ndryshe.

Policia e Kosovës është themeluar në vitin 1999, po ashtu me vendim të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe do të duhej të ketë të paktën një marrëveshje strategjike me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in, siç e kanë Kroacia, Shqipëria dhe disa vende të tjera.

Bashkëpunimi i EULEX-it me Policinë e Kosovës është në të mirë të EULEX-it, sepse për një informatë, të cilën Policia e Kosovës mund ta sigurojë për dy minuta, asaj të EULEX-it i duhen javë të tëra.

Qëllimi i ngritjes së kësaj çështjeje për debat parlamentar, është që të nxiten institucionet relevante të Kosovës për të bërë kërkesën që Kosova të anëtarësohet në INTERPOL dhe EUROPOL, institucione këto të respektuara dhe të rëndësishme të veçantë.

INTERPOL-i është organizata më e madhe ndërkombëtare në botë e policisë, e themeluar në vitin 1923 dhe me 188 vende anëtare. EUROPOL-i, i krijuar në vitin 1992, me Traktatin e Maastricht-it, përfshinë 27 shtete anëtare të BE-së dhe ka për qëllim parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar.

Me qene se gjatë një viti, midis Kosovës dhe INTERPOL-it trajtohen afërsisht 1200 raste, interesi i Kosovës nga anëtarësimi në këto institucione policore do të ishte shumë i madh dhe në funksion të rritjes së nivelit të sigurisë. Pas shpalljes së pavarësisë, Republika e Kosovës është e aftë t'i marrë mbi vete përgjegjësitë e saj në fushën e sigurisë edhe në kuadrin e bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Po theksoj se në bazë të Nenit 4 të Kushtetutës së INTERPOL-it, autoritetet përkatëse qeveritare të çdo vendi, që dëshiron të bashkohet me INTERPOL-in, duhet të dorëzojnë një kërkesë për anëtarësim te Sekretari i Përgjithshëm. Anëtarësimi, pastaj, do të jetë subjekt i miratuar, i miratimit të kërkesës nga shumica prej dy të tretave të Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOL-it.

Kërkoj që sa më parë të dorëzohet kërkesa për anëtarësim, sipas procedurës respektive që e ka kjo organizatë e sigurisë. Në këtë drejtim duhet kërkuar ndihmën e miqve tanë si BE dhe SHBA, do të jetë me e lehtë dhe me e shpejtë.

Nenit 3 të Kushtetutës së INTERPOL-it, i cili është i njohur edhe si "klauzolë e neutralitetit", është rreptësisht e ndaluar për organizatën që të ndërmarrë ndonjë ndërhyrje apo veprim të karakterit politik, ushtarak, fetar apo racor.

Serbia, duke qenë anëtare e këtyre mekanizmave të respektuar, vazhdimisht ka manipuluar me ta, duke bërë propagandë dhe shpikje dosjesh për shtetasit e Republikës së Kosovës, e motivuar politikisht dhe në funksion të ruajtjes së politikës millosheviqiane kundër shqiptarëve dhe kundër Kosovës si shtet.

Nëse ata janë për sundimin e ligjit, nëse janë për një rajon më stabil dhe më bashkëpunues, nëse janë të përkushtuar për bashkëpunim Evropian në fushën e drejtësisë, nuk do të duhej të kishte asnjë kundërshtim për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL dhe EUROPOL. Shpresoj që duhet të kishte këtë qëndrim pozitiv, modern dhe bashkëpunues.

Nëse Serbia e kundërshton këtë bashkëpunim, kuptohet që janë të interesuar vetëm për paragjykimet, për tensione dhe kundërshtim etnik, me politikë raciste, nacionaliste, të korruptuar dhe shqetësuese të trashëguar nga Miloseviqi.

Ne ndonjëherë jemi dëshmitarë të arrestimeve dhe përndjekjeve nga ana e INTERPOL-it edhe të bartësve politikë të Kosovës, nëpër shtete të ndryshme, mbi bazën e këtyre fabrikimeve nga shteti serb, edhe pse të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që këto veprime janë në kundërshtim të plotë me legjitimitetin dhe integritetin e bartësve të institucioneve të Kosovës, dhe në kundërshtim me parimet bazë të sovranitetit institucional të vendit.

Paralelisht me këtë, nga institucionet relevante të fushës së sigurisë së Kosovës dhe ato të EULEX-it, dhe nga ky Kuvend kërkoj që të sqarohet njëherë e përgjithmonë statusi legal i dosjeve të shpikura, të ngritura nga ana e Serbisë kundër ish-pjesëtarëve të UÇK-së dhe bartësve të funksioneve publike në Kosovë, të cilat janë të deponuara në INTERPOL dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë të fushës së sigurisë.

E deklaroj këtu përpara Jush se këto dosje nuk janë në funksion të drejtësisë, por janë dosje politike, për të vazhduar luftën kundër Kosovës me metoda tjera dhe për të denigruar luftën e lavdishme të popullit tonë për lirinë e vendit dhe të Ushtrisë Çlirimtare të tij.

Në këtë kuadër, pra, një herë e përgjithmonë duhet që de jure të kërkohet nga INTERPOL-i të mos i pranojë këto dosje të trashëguara nga MUP-i i regjimit të Millosheviqit, që po përsëriten edhe nga ai i Tadiqit.

Në rastet kur Serbia i lëshon fletë arrestet përmes INTERPOL-it për shtetas të huaj, siç është rasti i Kosovës, ekziston një vendim i kësaj organizate policore ku thuhet: “kur një shtet kërkon nga INTERPOL-i që të vendosë një RED NOTICE (Wanted Person) person në kërkim, dhe ky person është shtetas i huaj, kurse krimi ka të bëjë me krime lufte, atëherë shteti nga i cili vjen i dyshimi mund të ankohet dhe, nëse ankohet brenda 30 ditëve, atëherë RED NOTICE nuk do të publikohet.

Sikur Policia e Kosovës të kishte qasje në linkun e INTERPOL-it, do të mund të reagoonte me shpejtësi dhe përmes Ministrisë së Drejtësisë do të mund të bënte ankimimin me kohë për shtetasit e saj, dhe në këto raste INTERPOL-i nuk do të mund të aktivizonte në linkun e tij një RED NOTICE.

Anëtarësimi i Kosovës në INTERPOL, do t'i ndërpriste të gjitha mundësitë e shantazhimit dhe të manipulimit të këtij institucioni të respektuar dhe do të mbronte nderin dhe integritetin e qytetarëve dhe të institucioneve tona.

Si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, theksoj bindjen se Kosova do jetë një anëtare e denjë e INTERPOL-it dhe EUROPOL-it dhe në funksion të jetësimit të parimeve fundamentale, që janë luftimi i të gjitha formave të krimit, terrorizmit, rritja e sigurisë publike, duke ndikuar kështu në paqen dhe në stabilitetin e rajonit.

Për t'u anëtarësuar në EUROPOL duhet te bëhet një kërkesë formale nga MPB-ja të Kosovës, por është kusht që ta pranojnë të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian.

Republika e Kosovës deri me tani ka marrëveshje bashkëpunimi ndërpolicor me shtatë shtete. Kosova duhet të bëjë marrëveshje bashkëpunimi me shtetet veç e veç, e sidomos me ato vende të cilat na kanë pranuar si shtet, dhe të shkëmbejmë informacione përmes tyre me EUROPOL-in dhe INTERPOL-in.

Në gjashtë shtetet e rajonit është formuar një zyrë, e cila është në shërbim të fushës së bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zbatimit të ligjit, që quhet ILECU. Edhe Kosova është duke bërë përpjekje që të hapë një zyrë të tillë, e cila do të mundësonte një bashkëpunim më të mirë në fushën e zbatimit të ligjit.

Të nderuar deputetë,

Siç thamë edhe me lartë, Kosova nuk është e lidhur me linkun e INTERPOL-it në asnjë pikë kufitare, ndaj në Kosovë mund të hyjnë kriminelë nga më të ndryshmit. Është e domosdoshme që Kosovës t'i mundësohet lidhja me linkun e INTERPOL-it dhe anëtarësimi sa më i shpejtë në këtë organizatë. Shtrirja e linkut të INTERPOL-it, do të shërbente për sigurinë dhe stabilitetin e vendit tonë dhe të rajonit në përgjithësi. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti Lladrovci!

Përfaqësuesi i Qeverisë nuk është këtu që të thotë diçka. Kryetari i Komisionit funksional për Punë të Brendshme e Siguri, zoti Ahmet Isufi, a e dëshiron fjalën në emër të komisionit?

AHMET ISUFI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Inicimi i debatit për ndalesat që bëhen nga INTERPOLI, është një inicim i drejtë për arsye se kemi që 12 vjet me radhë ndalim të personave, qoftë qytetarë të zakonshëm, qoftë personalitete të cilat vërtet mbahen në vijat kufitare të cilat janë maltretim për të gjithë ata që udhëtojnë jashtë Kosove.

Kjo mënyrë e veprimit duhet të ndalet për arsye se ka nevojë që Ministria e Punëve të Brendshme dhe Qeveria të iniciojnë inkuadrimin në INTERPOL dhe EUROPOL dhe njëkohësisht të ndërpriten veprimet të cilat iniciohen nga shteti serb me dosje të cilat janë të trilluara dhe që ndikojnë në maltretimin e qytetarëve të Kosovës. Prandaj, në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, kërkojmë që sa më shpejt të bëhet kërkesa dhe përmes institucioneve relevante të kryhet kjo punë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani grupet parlamentare e kanë fjalën. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah iniciativën e deputetit Lladrovci dhe e inkurajon një debat të përqendruar në temën e cila është specifike, pra temë e bashkëpunimit

me organizatat ndërkombëtare në fushën e rendit dhe të ligjit, INTERPOL-it dhe EUROPOL-in, sikundër edhe fokusuar në kërkesat që Republika e Serbisë, shtet fqinjë i drejtohet INTERPOL-it me emra të përveçëm të Republikës së Kosovës, që edhe juridikisht është e papranueshme.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike konsideron se bashkëpunimi me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in është i rëndësishëm dhe është në funksion edhe të rendit dhe të ligjit në Kosovë, për më tepër ne konsiderojmë se bashkëpunimi me këto organizata ndërkombëtare është në funksion të parandalimit dhe të luftimit edhe të krimit ndërkombëtar, pra sa është me interes për Kosovën, po aq edhe për shtetet anëtare të INTERPOL-it dhe të EUROPOL-it.

Ne i vlerësojmë përpjekjet e deritanishme që janë bërë nga institucionet përkatëse të sektorit të brendshëm dhe të sektorit të drejtësisë për të vendosur bashkëpunim edhe formal me këto organizata dhe njëkohësisht kemi mirëkuptim për vështirësitë e anëtarësimit. Megjithatë, i çmojmë posaçërisht përpjekjet që janë bërë në nivelin operacional policor të drejtuesve aktual të Policisë për vendosjen apo themelimin e një drejtorie të veçantë për bashkëpunim me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in. Ata meritojnë që të respektohen për përpjekjet e tyre konkrete. Megjithatë, mendojmë se përpjekjet për bashkëpunim, e sidomos përpjekjet për të hequr listën me emra të përveçëm të Republikës sonë, kanë qenë shumë të përgjithshme dhe jo të fokusuara. Prandaj, shpresojmë dhe kërkojmë që në këtë drejtim të ketë përpjekje konkrete dhe përpjekjet konkrete Grupi Parlamentar i konsideron një komunikim të drejtpërdrejtë të Qeverisë së Republikës së Kosovës me drejtorinë e Zyrës ligjore të INTERPOL-it, duke e anashkaluar UNMIK-un, i cili aktualisht është menaxher i Zyrës të INTERPOL-it në Kosovë. Kjo konsiderohet kesi soji sepse Zyra e INTERPOL-it shumë më tepër iu ka shërbyer shteteve të veçanta prej nga vijnë ata drejtues të asaj zyre dhe shumë më tepër i ka shërbyer edhe Republikës fqinje, Serbisë, se sa që i ka shërbyer vendit tonë. Prandaj, është pak edhe e pakuptueshme që ajo zyrë akoma vazhdon të menaxhojë, ndërkohë që si rrugë e mesme ka mundur të jetë që Zyra të menaxhohet prej përfaqësuesve të EULEX-it, bashkë me pjesën ekzekutive të Policisë së Kosovës. Pra, shpresojmë që kjo do të ndodhë shpejt dhe do të adresohet formalo-juridikisht kërkesa INTERPOL-it që të hiqet ajo listë me ato kërkesa, sepse asnjë shtet nuk ka të drejtë që të kërkojë listën e të kërkuarave të jenë shtetasit e shtetit tjetër për krimet të supozuara që kanë ndodhur në shtetin tjetër. Domethënë, edhe juridikisht është e padrejtë, prandaj shpresojmë që një letër do t'i drejtohet shumë shpejt INTERPOL-it me sqarimet përkatëse se ata emra dhe ato kërkesa janë për arsye politike dhe pengojnë lëvizjen e lirë, kur dihet sidomos që në shumicën, shumica e atyre sot janë në institucione të Kosovës dhe pengimi i tyre për qarkullim të lirë e vështirëson edhe përfaqësimin e shtetit tonë në organizata dhe në forume ndërkombëtare.

Ne kërkojmë, gjithashtu, që debati të orientohet rreth rekomandimit dhe që rekomandimi të përcillet dhe të kërkojë një lloj afati për raportim të Ministrisë të Punëve të Brendshme se çka është ndërmarrë në fushën e kësaj që ne po kërkojmë sot.

Ju inkurajoj sërish për një debat, në emër të Grupit Parlamentar, një debat më të përqendruar rreth kësaj teme dhe gjithsesi krejt e natyrshme, e qartë, në fund të shprehim gatishmërinë për votimin e rekomandimit të iniciativës së deputetit Lladrovci. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar LDK, nuk ka të paraqitur. Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zotërinj deputetë,

Në temën e ngritur rreth bashkëpunimit të mundshëm të Kosovës me INTERPOL-in dhe me EUROPOL-in, ne për fat të keq do të jemi të detyruar që fillimisht të flasim si pasojë rreth raporteve që ka krijuar Serbia me INTERPOL-in në dëm të Kosovës dhe të shqiptarëve.

Si pasojë e moskrijimit të raporteve të Policisë dhe të institucioneve të Kosovës me policitë dhe shtetet e Evropës, institucionet përkatëse të Kosovës e shohin vetëm Policinë e EULEX-it si INTERPOL – EUROPOL, gjë që nuk është ashtu.

Nuk do shumë mend që të dihet se në çfarë shkalle të bashkëpunimit me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in gjendet Kosova edhe për shkaqe të njohura tanimë. Por sidoqoftë, situata në të cilën kemi përfunduar, e nxjerrë qytetarin e Kosovës në pozita të tilla që edhe për INTERPOL-in dhe EUROPOL-in, është e padefinueshme për shkak të mosefikasitetit të institucioneve tona për t'i zgjidhur shumë probleme procedurale juridike dhe politike, moszgjidhjen e të cilave Serbia po e shfrytëzon sa herë që i duhet asaj.

Tashmë Serbia i aktivizon edhe i rifreskon sa herë që t'i duhen listat me emra të qytetarëve të Kosovës si të ndjekur për krime lufte dhe me këto lista e futë në lajthitje sa herë të doje INTERPOL-in, EUROPOL-in dhe policitë e shteteve të ndryshme mike.

Si shumë herë më parë, ngjashëm ka ndodhur edhe në kohët e fundit, kur Serbia i ka rifreskuar këto lista, duke i përsëritur kërkimet për shumë shqiptarë si të kërkuar për krime lufte që nga koha e Millosheviqit në Serbi. Por, edhe ky rifreskim e ka një shkas. Serbia i ka rifreskuar edhe njëherë listat e të kërkuarave të saj shqiptarë për shkak se ne ia kemi rifreskuar apetitet e saj shoviniste mbi Kosovën, duke pranuar të negociojmë me të. Ajo i rifreskon listat, e ne ia rifreskojmë ambiciet.

Prandaj, jo rastësisht Serbia e riaktivizoi këtë iniciativë pikërisht në kohën e raundit të katërt të negociatave me Editën. Me të drejtë ne mundemi të ngrehim edhe një hipotezë, që Serbia eventualisht edhe mund t'i përdorë këto lista në tavolinën e bisedimeve edhe mundet eventualisht që t'i tërheqë përkohësisht, si shenjë tolerance dhe si shenjë lëshimi pe në negociata. Ndoshta edhe mund të tërheqë fare deri në ndonjë amnisti dhe negociatorët kosovarë do të rikthehen si fitimtarë që e detyruan Serbinë t'i tërheqë listat e sapo dërguara të të kërkuarave shqiptarë në INTERPOL dhe EUROPOL.

Me siguri se kjo do të shënohet si e arritur e kosovarëve në negociata. Madje kjo lojë veç sa po vazhdon të intensifikohet nga pala serbe. Por, ne nuk duhet as të kërkojmë e as të presim që Serbia t'i tërheqë këto lista, por ne duhet që në bashkëpunim me INTERPOL-in, EUROPOL-in dhe mbështetje relevante t'ia pamundësojmë Serbisë që të ketë këso mundësish që t'i përdorë mekanizmat ndërkombëtar të sigurisë për nevojat e veta politike antishqiptare.

Kjo duhet të ndodhë me urgjencë para se këso iniciativash të Serbisë t'i kenë efektet e tyre negative. Por, le të ndalem pak se kush janë këta njerëz që Serbia ua ka dërguar emrat e tyre në INTERPOL, pra kë e kërkon Serbia. Sa për ironi, dje në këtë Kuvend, në pikën e pestë të

rendit të ditës, në 12 vjetorin e saj, u debatua për masakrën në Burgun e Dubravës. Në këtë masakër viktimat e vrarë e të torturuar ishin kryesisht të burgosur politik, robër lufte. Pra, Serbia sot i kërkon pikërisht ata të cilët ishin në të njëjtat aktakuza me ata që i masakroi e i torturoi në Dubravë, në Nish, në CZ, në Pozharevc, në Mitrovicë të Sremit e kudo nëpër burgjet e Serbisë. Pra, shumë nga të kërkuarit e Serbisë sot në INTERPOL, nuk kanë akuza tjera përveç atyre të ngritura para masakrës së Dubravës, përkatësisht në proceset gjyqësore të vitit 1996, 1997, 1998. Serbia po i kërkon nga INTERPOL-i ata që nuk mund t'i dërgojë në Dubravë në të '97 as të '98, por po i kërkon tash që t'i dërgojë ndoshta në ndonjë Dubravë të re. Por, edhe në rast se Serbia eventualisht do t'i tërheq këto fletë arreste nga INTERPOL-i si kompromis në negociatë, unë si njëri nga të dënuarit në mungesë nga këto gjykata serbe që nga koha e Millosheviqit, përkatësisht si i gjykuar në mungesë dhe dënuar me 20 vite burg, në vitin 1997, nuk do të pranoj asnjëherë faktin që Serbia të më falte e as të më amnistonte në tavolinën e negociatave dhe në asnjë rrethanë tjetër.

Pra, nuk duam që Serbia të na fal për atë se ne kemi luftuar kundër saj. Përkundrazi, ne kur nuk do t'ia falim Serbisë atë çfarë ka bërë mbi popullin shqiptarë të Kosovës. As unë e as ndonjë shqiptarë që i dhimbset gjaku i bashkombasve të vet, që i dhimbset çdo pëllëmbë e vendit të vet, nuk do t'ia falë Serbisë për atë çfarë ka bërë mbi Kosovën dhe mbi shqiptarët.

Kemi dëgjuar shpeshherë qoftë këtu, qoftë kudo tjetër që Serbia duhet të kërkojë falje për atë çfarë ka bërë mbi shqiptarët dhe mbi Kosovën. Po, Serbia duhet të kërkojë falje, e ne nuk duhet t'ia falim, ne nuk duhet t'ia falim përderisa Serbia nuk është e dënuar për krime që ka bërë mbi Kosovën. Pra, edhe unë sot nuk po kërkoj që Serbia me vullnetin e saj t'i tërheqë këto lista emrash të kërkuara nga INTERPOL-i, por po kërkoj nga Kosova dhe institucionet e saja që të bashkëpunojë me INTERPOL-in, me EUROPOL-in dhe me shtetet tjera mike për t'ia pamundësuar Serbisë të luaj këso lojërash, që edhe si të tilla nuk ngelin pa pasoja. Kosova duhet të dijë t'i mbrojë qytetarët e vet. Në lista të kërkuarish dhe të akuzuarish të Policisë dhe Drejtësisë së Kosovës do të duhej të ishin ata që ia shkelin sovranitetin e Republikës së Kosovës dhe Kushtetutën e saj sot, e jo t'i presim ata me qilim të kuq në institucionet e shtetit, të cilin ata e luftojnë dhe po vazhdojnë ta luftojnë.

Pra, ja ku jemi sot në 12 vjetorin e masakrës, që Serbia e bëri në burgun e Dubravës, Serbia kërkon përmes INETERPOL-it t'i plotësojë listat e të kërkuarve dhe t'ua bashkëngjes atyre që i vrau në burgun dhe i torturoi në burgun e Dubravës.

I dërguari i Serbisë vjen në Prishtinë dhe mbron kushtetutën serbe që e sheh Kosovën si shtet të Serbisë, Qeveria rrah shqiptarët që protestojnë kundër të dërguarit të Serbisë dhe prapë se prapë Serbia po vazhdon të mbetet temë për shqiptarët dhe për Kosovën. Në këtë situatë, është nevojë e ngutshme që institucionet përkatëse të Kosovës të bashkëpunojnë me shtetet e veçanta dhe me INTERPOL-in dhe me EUROPOL-in që në listën e të kërkuarve të jenë kriminelët e vërtetë që po vazhdojnë ta vrasin shtetësinë e Kosovës e të heqin dorë me urgjencë nga listat e të kërkuarve të Millosheviqit.

Pra, kërkojmë nga institucionet përkatëse të Sigurisë dhe Qeverisë të Kosovës që të bashkëpunojnë me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in deri në anëtarësimin e Kosovës në këto institucione shumë të rëndësishme të sigurisë ndërkombëtare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet dhe përshëndet nismën e deputetit Lladrovci për këtë debat. Është e qartë dhe besoj që secili njeri e di se këto lloj fletë-arreste që po freskohen e rifreskohen prej Republikës të Serbisë, kanë karakter plotësisht politik dhe agresor ndaj Kosovës, sikurse edhe ndaj vlerave që ka ngritur Kosova gjatë periudhave të kaluara të rënda që i ka pasur. Normalisht, kjo kërkon një reagim dhe një inicim të reagimit të fuqishëm nga institucionet e Kosovës të cilat kanë marrë kompetencën për të bërë këtë punë që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, pra që nga viti 2008 dhe deri me tash nuk kemi parë reagime ose inicime të shpejta të institucioneve të Kosovës.

Është e qartë se me mandatin që e ka tashmë EULEX-i, nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut, sa i përket bashkëpunimit ose ndërlidhjes me INTERPOL-in në veçanti, është e qartë se EULEX-i nuk do të duhej që të marrë pronësinë sikurse UNMIK-u, nuk duhet të ketë pronësinë në ndërlidhjen me INTERPOL-in, por kjo të kalojë menjëherë tek institucionet e Kosovës, tek Policia e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, sepse tek e fundit është edhe një argument tepër i fuqishëm që shumë shpesh jemi mësuar të dëgjojmë prej ndërkombëtarëve se ka të bëjë me pronësinë vendore të proceseve në Kosovë për institucionet e Kosovës. Nëse kërkojmë pronësi vendore për institucionet e Kosovës, kjo është një prej elementeve kryesore ose një prej fushave kryesore për të cilat duhet të matet performanca edhe efektshmëria, po ashtu edhe funksionimi i institucioneve të Kosovës, pra, në lidhje me aspektin e ndërlidhjes me INTERPOL-in, por po ashtu edhe me EUROPOL-in.

E vërteta është se të gjitha argumentet, Qeveria e Kosovës, institucionet e Kosovës dhe Kosova i ka për të kundërshtuar fuqishëm dhe pamundësuar ose për të zhbërë këto lloj dosjesh që janë dorëzuar në INTERPOL nga Republika e Serbisë shumë vite më parë dhe po rifreskohen edhe më tutje dhe këto argumente duhet të përmbledhen në një dokumentacion të plotë që duhet të formulohet ose të hartohet nga Qeveria e Kosovës dhe duhet të koordinohet nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe menjëherë të fillojë një lobim i fuqishëm në vendet anëtare të INTERPOL-it nga institucionet e Kosovës.

Ne kemi, pra Qeveria e Kosovës tashmë ka disa zyrtarë të lartë që merren me çështjen ose thonë që merren me çështjen e lobimit për shtetin e Kosovës dhe ky është një aspekt për të cilën këta zyrtarë duhet ta kenë parasysh që duhet të llobojnë sa më fuqishëm tek vendet anëtare të INTERPOL-it, për shkak se është e qartë se nuk ka nevojë të jetë ose nuk është e domosdoshme që të jetë anëtare e OKB-së për të qenë pjesë e INTERPOL-it, pra të bëhet aplikacioni për anëtarësim në INTERPOL ku e dimë se janë 2/3 e vendeve ato që vendosin, pra prej 188 shteteve anëtare në INTERPOL, Kosovës i duhen 126 vota pro, që normalisht nuk është çështje e lehtë dhe duhet ta pranojmë këtë, por lobimi i institucioneve të Kosovës, në bashkëpunim me shtet mike, ashtu sikurse ka thënë edhe deputeti Lladrovci në nismën e tij. Pra, ky bashkëpunim duhet të jetë shumë i ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me shtetet e fuqishme të Bashkimit Evropian, por po ashtu edhe me shtetet e rajonit.

Ekziston në INTERPOL një komision i veçantë që quhet Komisioni për Kontrollin e Dosjeve të INTERPOL-it dhe kjo do të duhej të jetë adresa kryesore e Republikës së Kosovës, Qeverisë së Kosovës për të dorëzuar gjithë dokumentacionin që vërteton se dosjet e dorëzuara nga

Republika e Serbisë kanë karakter plotësisht politik agresor dhe po ashtu edhe motive etnike për të cilat është e qartë se si janë ndërtuar ato dosje.

Pra, Komisioni për Kontrollin e Dosjeve të INTERPOL-it duhet të jetë adresa të cilës duhet t'i drejtohet me lobim dhe me qartësim të dokumentacionit nga ana e Qeverisë së Kosovës.

E dimë fare qartë se ky debat ose për bindjen tonë ky debat është për t'ia rikujtuar edhe një herë Qeverisë së Kosovës për punën që nuk është duke e bërë dhe, normalisht, edhe rekomandimet të cilat janë të përfshira në këtë nismë në një formë ose tjetër kanë këtë pikë vështrimi, pra një detyrë të cilën Qeveria e Kosovës e ka dhe duhet ta bëjë sa më shpejtë që është e mundur.

Ne e mbështesim fuqishëm këtë nismë dhe rekomandimet dhe propozojmë që në kuadër të këtyre rekomandimeve të kërkojmë nga Qeveria e Kosovës që në fund të qershorit, pra Ministria e Punëve të Brendshme në fund të qershorit menjëherë të informojë Kuvendin e Kosovës për nismën ose për iniciativën e kërkuar nga Kuvendi i Kosovës, të cilën duhet ta bëjë Ministria e Punëve të Brendshme. Pra, në fund të qershorit të na vijë ministri i Punëve të Brendshme dhe të na shpjegojë se a është kompletuar dokumentacioni dhe ku është procedura. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar Koalicioni Kosova e Re, Suzana Novobrdaliu.

SUZANA NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, kryesues!

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah iniciativën për debat të deputetit Ramiz Lladrovci, këtë duke marrë parasysh se autoritetet e institucioneve të Serbisë vazhdojnë me agresivitet destruktiv në raport jo vetëm me mosnjohje të statusit dhe institucioneve të Republikës së Kosovës, por edhe me shkeljen flagrante të të drejtave themelore të njeriut, ndër to edhe kufizimin e lirisë së lëvizjes.

Duke vazhduar me regjim të vjetër, me metoda dhe mjete të shpifjeve, shantazheve dhe denoncimeve të padëshmuara, që janë në kundërshtim me etikën e luftës kundër krimit, ata sjellin në lajthim edhe bashkësinë ndërkombëtare dhe veçanërisht organizatat ndërkombëtare në zbulimin e krimit si INETERPOL-i dhe EUROPOL-i që të shpall fletë arrestime të llojeve të ndryshme.

Fletë arrestimet jo vetëm që maltretojnë autoritetet e Prishtinës, por edhe dëmtojnë rëndë imazhin e INTERPOLL-it, pasi që arrestimet apo ndalesat bëhen me kërkesa të pabaza dhe ilegale të Serbisë dhe në emër të INTERPOL-it. Me këto veprime Serbia bënë keqpërdorim të të drejtave që i takojnë si anëtare e INTERPOL-it dhe kjo çështje duhet të trajtohet me seriozitet nga vendet anëtare.

Është e papranueshme që deri më tani nuk ka pasur reagime nga institucionet përgjegjëse të Kosovës, nga Policia e Kosovës, Policia e EULEX-it, nga Prokuroria, gjykatat. Të gjitha këto institucione, në vend që të reagojnë, futen nën gëzhgjë pa kurrfarë interesimi për bashkëpunim të mirëfilltë me drejtësinë penale ndërkombëtare.

Për shkak të pasivitetit të institucioneve përgjegjëse, kjo ka ndodhur në të kaluarën. Ka gjasa atë ndodhë edhe tash, edhe në të ardhmen, kur Republika e Serbisë, nga janari i vitit 2011, vazhdon që përmes INTERPOL-it t'i rifreskojë fletë arrestimet e reja për 150 pjesëtarë të UÇK-së. E dimë që nga viti 2001, për të njëjtit vazhdimisht ka përsëritur kërkesat.

Autoritetet në nivele të larta, në këto institucione gjer më tani nuk janë angazhuar që të zhvillojnë bashkëpunimin deri në nivele të formës të asocimit dhe të anëtarësimit. Pyes: A ka Policia e Kosovës dhe Policia e EULEX-it, zyre ndërlidhëse të INTERPOLIT me oficerët ndërlidhës dhe çfarë funksioni dhe kompetence kanë në raport me kërkimin e personave, sendeve dhe informacioneve? A duhet edhe më tej të diskriminohemi ne si qytetarë legjitim të Kosovës dhe të jemi në frikë të vazhdueshme se në çdo kalim kufitar mund të ndalohemi, të prangosemi, të arrestohemi, të paraburgosemi dhe në fund të ekstradohemi nga shpifjet e vazhdueshme të autoriteteve të Republikës të Serbisë? Cilat masa duhet të ndërmarrë dhe nga kush duhet të kërkojë ndihmë qytetari legjitim i Republikës së Kosovës në raste ndalimi, arrestimi dhe ekstradimi. Si është e mundur që autoritetet tona kompetente edhe pas tri vite nga shpallja e pavarësisë, asnjëherë të mos t'i shfrytëzojnë mjetet juridike, të mos ankohen për asnjë fletë-arresti të shpallur nga INTERPOL-i, duke e ditur se kërkesat e Serbisë nuk kanë bazë dhe nuk janë legale, e sidomos duke marrë për bazë faktin se kërkesat mund të dërgohen vetëm nga shteti ku shkelet ligji e jo të dërgohen nga një shtet për shtetin dhe shtetasin e huaj. Pra, në rastin konkret Serbia mund të lëshojë fletë-lëshime vetëm për shtetasit e vet kur ta shkelin ligjin në territorin e Serbisë, e jo për shtetasit kosovar duke pretenduar me shpifje të ndryshme se është shkelur ligji në Kosovë pra në territorin e huaj e jo të vet.

Krejt në fund, dua të jep këto rekomandime:

Që në sesionin e radhës, në muajin shtator të vitit 2011 të Asamblesë së përgjithshme të INTERPOL-it Qeveria e Kosovës të bëjë kërkesë zyrtare për aderim në INTERPOL dhe meqë arrestimet me motivet politike janë ilegale dhe në kundërshtim me Kushtetutën e INTERPOL-it, Policia e Kosovës në përmjet Zyrës ndërlidhëse zyrtarisht të kërkojë nga INTERPOL-i që t'i shpërfillë kërkesat e Serbisë që kanë të bëjnë me arrestime të pa baza dhe ilegale për personalitete kosovare të cilat janë në listë nga viti 2001. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Janë do edhe para 2001. Grupi Parlamentar SLS, nuk ka të paraqitur. Grupi Parlamentar "6+", Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Parlamentarna grupa "6+" podržava inicijativu za saradnju Republike Kosova sa INTERPOL-om i EUROPOL-om i smatramo da je jedna takva saradnja neophodna za našu zemlju, odnosno za građane i najviše državne zvaničnike Republike Kosova. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Zoti kryesues,  
Kolegë deputetë,

Kërkesa për këtë debat ka ardhur shpejt dhe shpejt është vë në rend dite të Kuvendit dhe mua më duket që shpejtësia ka qenë e jashtëzakonshme.

Unë për vete, si nënkryetar Kuvendi dhe anëtar i Kryesisë, edhe atje jam përpjekur të kërkoj shpjegime plotësuese sepse kërkesa ka qenë tepër, tepër elementare. Bile ka qenë një ide që të

pritet edhe pak në mënyrë që kërkuksi i debatit të shtrojë argumente më shumë për deputetët, të jetë më konkret, të ketë edhe argumentime.

Kërkesa e tashme është me një frazë elementare që lypet bashkëpunimi i Republikës së Kosovës me këto organizata të forta ndërkombëtare të policisë. Në anën tjetër kemi veç një arsyetim, po s'kemi rekomandime. Prapë kemi një përsëritje ku thuhet që është mirë të bëhet bashkëpunimi dhe tutje prapë, në pikën 2, duke pasur parasysh kërkesat e vazhdueshme të Republikës së Serbisë për lëshim të fletë-arresteve thuhet: të qytetarëve, të zyrtarëve të lartë të Republikës së Kosovës, është formulimi, dhe i konsiderojmë si çështje për shqyrtim. Çfarë dua të them? Jam ende në situatën që e kisha në mbledhje të Kryesisë. Kur bëhen këto debate për të qenë të dobishme, për të pasur efekt, nëse hyn në lojë Kuvendi i Republikës së Kosovës, që është organ shumë i rëndësishëm, është mirë që paraprakisht të specifikohen kërkesat, të diskutohen dhe të dihet qëllimi ku duhet të arrijmë. Nëse është qëllimi elementar vetëm që ta inkurajojmë Qeverinë, me dikastere që i ka të fushës, që të bashkëpunojë, ky është një apel elementar dhe këtë Qeveria e di. Unë besoj që s'ka nevojë të mbledhet Kuvendi t'i thuhet Qeverisë – ju zotërinj, provoni ta kryeni punën për çka jeni të zgjedhur.

Unë dëgjova formulimin, një formulim preciz të zotit deputet Selimin që tha: përpjekje për bashkëpunim të mundshëm. E mua më duket që ky diskutim sot është pak a shumë ai – bashkëpunim i mundshëm, që do me thënë ne nuk kemi koordinata të mundësisë konkrete të bashkëpunimit.

Ne dëgjuam edhe një polic të karrierës këtu të Kosovës që foli, po ai ishte më jo konkret se gjithë të tjerët. Domethënë, ai që duhej t'i dinte më mirë punët, është më jo konkret në bankat e Parlamentit.

Është elementare nëse bisedojmë për një problem, të dihet ajo listë, pse s'është ajo listë. Ai që e ka bërë kërkesën, është dashur listën emër për emër si dokument i hapët, a jo gjysmë i hapët apo i hapët, në Kuvend t'i jepet në dosje çdo deputeti. Atëherë, nuk kemi nevojë ne të flasim në mënyrë të përgjithësuar - janë ndjekje politike, s'janë ndjekje politike. Nëse janë politike, ky është ky, ky, ky. Sepse, është problem të thuhet janë rreth kaq. Nuk ka rreth, se çdo njeri është një njeri me emër e mbiemër dhe këtu s'ka shifra, ka identitete. Thuhet janë kaq, dhe me emër e mbiemër, ndryshe është problem të diskutohet se diskuton veç në parim, diskuton në përgjithësi. Problemet janë konkrete.

Nëse janë qysh thuhet këtu, emra të Qeverisë, këtu po thuhet, zyrtarë të lartë, unë nuk di cilët janë se s'i kam emrat, atëherë prapë është absurd të thuhet Qeveria s'po punon, nëse është e implikuar. Është e pamundshme Qeveria të jetë në listë dhe mos të punojë që të fshihen ata emra, se është absurd. Nuk ka arsye, po mendoj, nëpërmes të institucioneve ndërkombëtare të fushës.

Prandaj, kjo është një domosdo, konkretizimi i materies për çka bisedohet në bankat e Kuvendit. Kjo është domosdo, se masandej ne s'kemi shans edhe të marrim përfundime.

Unë dëgjova edhe një formulim tjetër, që ndoshta është momenti që do të bisedohet edhe për këtë problem në bisedimet me Serbinë. Ndoshta, po kjo më, teknikë më s'është. Kjo më s'është çështje teknike, mbajeni në mend dhe mos të bëhemi si njerëz që s'dimë çka po themi këtu dhe çka po kërkojmë. Kjo më... praktike a qysh po iu thonë këtyre. Se unë e mbaj qëndrimin tim që me Serbinë çështje jo politike s'ka shans të bisedohen. Po meqë Kuvendi ka thënë që ka dhe

Qeveria po thotë që ka, nëse bisedohet për këtë materie, në mënyrë implicite ose eksplicite, s'ka më, kaloi pragu i çështjeve teknike.

Unë po kthehem edhe një herë, pra, te çështja. Edhe tash nuk e kam shumë të argumentuar... Unë po i drejtohem tash paraqitësit të kërkesës, konkretisht, po edhe të tjerëve. Çka ne sot këtu, se u përmend edhe EULEX-i, keni kujdes, EULEX-i qysh bashkëpunon. Ai është grup që bashkëpunon 100%, veç mos harroni se EULEX-i thotë - ne jemi neutral ndaj statusit. Mos i harroni formulimet. Ai thotë - ne jemi neutralë ndaj statusit. Nuk lufton për statusin as në këtë kuptim të drejtave të qytetarit të Republikës së Kosovës karshi EUROPOL-it dhe këtij tjetrit më lartë që është – poli tjetër. Domethënë, është problemi se duhet të jemi ne këtu në këto banka shumë serioz dhe, unë po them, të përpiqemi tash nga kjo iniciativë çka mund të japë Kuvendi, çka mund të rekomandojë.

Edhe një herë po them, bashkëpunim të mundshëm, e ajo e mundshëm është aq sa janë të zotët dikasteret konkrete të Qeverisë së Republikës së Kosovës që të bashkëpunojnë me këto organizata. Çdo gjë tjetër është dëshirë.

Unë e dëgjova një deputete që u përpoq t'i bëjë do rekomandime, po edhe ajo në nivel lutjess ishte, a, dëshirash. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e kanë deputetët, sipas paraqitjes. Deshe diçka Ramiz për të shtuar apo po e le për fund? Në qoftë se ke diçka në formë replike, mund ta marrësh fjalën, në të kundërtën, e ke në fund, pas diskutimeve mund ta marrësh fjalën. Sipas radhës, deputetja Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: I nderuari kryesues,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Konsideroj se Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet më shpesh të trajtojë tema të tilla të qëlluara dhe konkrete, siç është edhe iniciativa e deputetit Ramiz Lladrovci.

Unë e mbështes këtë iniciativë dhe ftoj edhe kolegët tanë deputetë nga të gjitha grupet parlamentare që t'i tejkalojnë dallimet politike dhe ta mbështesin anëtarësimin e Kosovës në dy prej mekanizmave më të rëndësishëm ndërkombëtar të drejtësisë – INTERPOL-in dhe EUROPOL-in.

Konsideroj se është më se e nevojshme që të diskutohet për dosjet politike të deponuara vazhdimisht nga Serbia në INTERPOL dhe në EUROPOL kundër ish pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe zyrtarëve të lartë të shtetit të Kosovës, aq më tepër kur edhe 12 vjet pas përfundimit të luftës luftëtarët e lirisë, veprimtarë të çështjeve kombëtare me fletë arreste të Serbisë mund të ndiqen, të ndalohen, të arrestohen në çdo shtet të botës dhe më pas i dorëzohen autoriteteve të Serbisë.

Është i turpshëm rasti i Sinan Morinës nga Rahoveci, i cili që 1 vit e gjysmë po mbahet nga autoritetet mike të Republikës së Kroacisë, në burgun e Dubrovnikut me vendimin gjyqësor të instancës më të lartë që duhet t'i dorëzohet autoriteteve të shtetit serb. E lidhur me këtë rast do të dëshiroja të di se çka ka bërë ambasadori ynë i akredituar në Kroaci lidhur me sqarimin e këtij rasti. Aq, më tepër, një gjë e tillë mund t'iu ndodhë të gjithë qytetarëve të Kosovës, madje duke parë veprimet e shtetit serb, nuk do të ishte çudi që në listën e tyre të ndjekjes, dorëzuar

INTERPOL-it të gjendeshin edhe kolegët tanë deputetë nga komuniteti serb, të cilët janë pjesë e institucioneve të Kosovës. Kjo nga se Serbia ka qenë vazhdimisht aktive në propagandë dhe në shpifje në këtë drejtim. Në sajë të këtyre shpifjeve, sot kemi një mal akuzash politike me tendencë njollosjen e luftës së pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për liri që nga gjykatat vendore e deri në Tribunalin e Hagës.

Së fundmi, ishte edhe skandali ndërkombëtar i ashtuquajtur i tregtisë me organe dhe raporti famëkeq i Dick Martyt.

Të nderuar deputetë, përfundimisht konsideroj se iniciativa e deputetit Lladrovci duhet të gjejë mbështetje të të gjithë neve në këtë Kuvend, pa dallim, dhe ajo duhet të zgjerohet edhe më tej si nismë për mbrojtjen e vlerave të luftës në të gjitha format. Angazhimi konkret për hyrjen në INTERPOL dhe EUROPOL është veç hapi i parë i marrë në këtë drejtim dhe ju ftoj në përkrahje të iniciativës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca!

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,  
Së pari, raporti i Republikës së Kosovës me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in është problem i shtetësisë së vendit tonë, të pakompletuar.

Raporti ynë me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in është po sikur raporti me OKB-në dhe BE-në. E kemi OKB-në në Kosovë si UNMIK, por nuk e kemi Kosovën në OKB dhe e kemi BE-në në Kosovë si EULEX, po nuk e kemi Kosovën në BE.

Nëse kihet parasysh se si i referohet autoritetit politik të Kosovës INTERPOL-i, atëherë kuptohet se atë e njeh vetëm si UNMIK. Pra, mandati i INTERPOL-it në Kosovë rregullohet me Rezolutën e INTERPOL-it Numër 10, AG/2002, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e INTERPOL-it në seancën e 71-të në tetor të vitit 2002. INTERPOL-i po ashtu kishte memorandum bashkëpunimi me UNMIK-un, si mision i OKB-së.

Kur Serbia u anëtarësua në INTERPOL në shtator të vitit 2001, ekzistonte si shtet përbrenda entitetit Republika Federale e Jugosllavisë. Prej shkurtit 2003 ky entitet federal, siç dihet, e ndërroi emrin në atë që u quajt Serbia dhe Mali i Zi dhe ashtu e njohu edhe INTERPOL-i, kurse, kur në vitin 2006 u shkëput Mali i Zi, INTERPOL-i fatkeqësisht e njeh Serbinë si suksesore të asaj që më parë ishte Serbia dhe Mali i Zi. Kjo është arsyeja pse Mali i Zi aplikoi për anëtarësim në INTERPOL pa pavarësimin e tij. Pra, në shtator të vitit 2006.

Pyetja kryesore që duhet të shtrohet nga ne këtu është se çfarë raporti ka INTERPOL-i në shpalljen e pavarësisë së kushtëzuar të Kosovës sipas planit të Ahtisarit? Siç dihet, Kosova nuk ka aplikuar në anëtarësim në INTERPOL edhe pse ish ministri Fatmir Xhelili, që tash është edhe deputet këtu, pat thënë se do të aplikojë për në INTERPOL dhe në EUROPOL në prill të vitit 2009, gjë që nuk pati ndodhur më pastaj.

Sa i përket INTERPOL-it, kjo edhe mund të ndodhë, por sa i përket EUROPOL-it, dihet tashmë se anëtare mund të jenë vetëm vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Eventualisht ne mund të kemi nënshkrim të Memorandumit të Bashkëpunimit me EUROPOL-in.

Gjithsesi anëtarësimi në INTERPOL nuk është vetëm problem i shtetësisë, sepse, u tha edhe këtu, nga 188 vende anëtare të INTERPOL-it ka edhe anëtarë të cilët nuk janë anëtar të Kombeve të Bashkuara. Pra, 11 nga anëtarët e INTERPOL-it nuk janë anëtarë të Kombeve të Bashkuara, kështu që edhe Kosova mund të aplikojë për anëtarësim në INTERPOL.

Por, ajo që mbetet problem, është neni 4 i Kushtetutës së INTERPOL-it, sepse aty thuhet që anëtarësimi mund të bëhet vetëm në 2/3 e vendeve, që janë anëtare të INTERPOL-it, e siç dihet, shumica e këtyre vendeve nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës.

Çështje po ashtu me rëndësi për INTERPOL-in mbetet kundërthënia e urdhër-arresteve në mes autoriteteve politike ndërkontestuese. Për shembull, shumica e të kërkuarve nga INTERPOL-i në Kosovë janë të tillë, në të vërtetë në sajë të vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, apo të vendimeve të gjykatave, ka edhe raste të gjykatave komunale. Por ata shqiptarë që kanë probleme me ndalesat e INTERPOL-it jashtë vendit, janë përball me situata të tilla vetëm pse INTERPOL-i është shërbyer me urdhër-arreste të Serbisë, siç i pati ndodhur, për shembull, Agim Çekut në Slloveni, në Hungari, në Kolumbi dhe së fundi në Bullgari.

Në një qëndrim të INTERPOL-it në mars të vitit 2006, u specifikua se INTERPOL-i edhe pse e përditëson vazhdimisht bazën e tij të të dhënave për personat e kërkuar, ai nuk mund t'i zhbëjë vendimet e gjykatave shtetërore. Pra, ato vendime mbesin.

Sa i përket EUROPOL-it, kjo organizatë e sheh Kosovën, fatkeqësisht, si një prej vendeve kryesore nëpër të cilën kalojnë vijat e krimit të organizuar, posaçërisht ardhja e heroinës prej Azisë drejt Evropës Perëndimore. Kjo për arsye të shtetit të dobët dhe kontrollit jo të mirë të kufijve.

Në raportin e fundit të EUROPOL-it për vitin 2011, i publikuar do të thotë në vitin 2011, shkohet madje deri aty sa të njolloset Ushtria Çlirimtare e Kosovës, duke e lidhur atë me krimin e organizuar dhe me drogë, në këtë raport, do të thotë të vitit 2011.

EUROPOL-i definitivisht duhet të heq dorë nga përpjekjet, po sikur të Serbisë, për devijimin e motivit të drejtë dhe qëllimit të shenjtë të Ushtrisë tonë Çlirimtare.

Nëse EUROPOL-i ka të dhëna për aktivitete kriminale të personave të caktuar në ditët e sotme me emër e mbiemër, qofshin ata edhe politikanë e figura publike, le të japë fakte e le të publikojë emra. Por, ne e kundërshtojmë rreptësisht tendencën që të njolloset Ushtria Çlirimtare e Kosovës, si dhe lufta jonë popullore me kushedi çfarë pretendimesh për krime individuale prej të cilës natyrisht se ka përgjegjësi personale aty.

Duke dashur ta stigmatizojë UÇK-në përmes emrave të përveçëm për anonim për EUROPOL-in, EUROPOL-i merr pozicionin e Serbisë. I bëjmë thirrje EUROPOL-it të mos spekulojë me qëllim të dëmtimit të Kosovës, por të identifikojë për specifikimin e përgjegjësisë. Prandaj, nja tri rekomandime do të mund të ishin:

E para, që INTERPOL-i dhe EUROPOL-i të mos i marrin parasysh urdhër-arrestet e Serbisë që kanë të bëjnë me qytetarët e Kosovës, për arsye se Serbia përveç se Kosova, do të thotë, është e pavarur nga Serbia, Serbia ka pretendime territoriale, pushtuese dhe destabilizuese ndaj Kosovës. Kështu, që urdhër-arrestet e saj nuk duhet të merren parasysh.

E dyta, është që INTERPOL-i dhe EUROPOL-i të mos merren me diskualifikime të luftës tonë çlirimtare, por të merren me atë që e kanë kompetencë dhe obligim. Pra, me krimin e organizuar, me pastrimin e parave, me kontrabandën, me trafiket e paligjshme e të tjera.

Dhe, në fund, këto institucione të merren edhe me krimin e organizuar ndërkombëtar në Kosovë, që këtu nuk u tha fare. Siç dihet, për shkak se shumë administratorë ndërkombëtarë edhe nga vendet e BE-së kanë imunitet nga ligji, me rastin e veprimeve kriminale ata nuk mund të ndiqen penalisht nga shteti i Kosovës për shkak se këta politikanë tanë na e kanë sjellë planin e Ahtisarit, i cili ua siguron këtë imunitet punëtorëve ndërkombëtarë. Por, pikërisht ky imunitet nga ligji hap mundësi të mëdha të keqpërdorimit, siç ishte rasti i Xho Treshlerit nga Gjermania atëherë, i cili pati ikë nga Kosova me 4 milion e gjysmë euro.

Pra, këto do të ishin nja tri rekomandime për INTERPOL-in dhe EUROPOL-in. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fadil Demaku!

FADIL DEMAKU: Faleminderit, nënkryetar i Parlamentit!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

EUROPOL-i bashkëpunimin me Kosovën e ka përmes EULEX-it në Prishtinë, raportet e ngjashme janë edhe me INTERPOL-in përmes UNMIK-ut.

Policia e Kosovës aktualisht bashkëpunon me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in me një lloj ndërmjetësimi ta quaj dhe ky raport ka krijuar vite të tëra shumë mjegull në këtë segment. Sa më shpejt të bëhet krejt çka është e mundur nga Republika e Kosovës për demaskimin e propagandës së vazhduar serbe që ka filluar shumë vite më parë e që vazhdon ende për kriminalizimin e luftës së UÇK-së, në këtë rast duke ndërhyrë në lojën përmes këtyre organizatave policore. Vazhdimisht janë shpikur dosje nga Serbia për pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me nxitjen e Serbisë ato figurojnë akoma në lista të INTERPOL-it. Për më keq, kërkohen ata si shtetas të Serbisë dhe me denoncim nga vetë Serbia. Kjo është krejtësisht e pa pranueshme.

Për ta mënjeluar këtë, duhet angazhim direkt i institucioneve tona sepse përtej të drejtës individuale të gjithë këtyre emrave që figurojnë aty nëpërkëmben vetë institucionet e Republikës së Kosovës në raport me bashkësinë ndërkombëtare. Duhet të lidhim marrëveshje bashkëpunimi të mirëfilltë, të vendosen kontakte direkte jo përmes UNMIK-ut që roli i tij në proces tanimë po thuaj se i takon së kaluarës, e as përmes EULEX-it që gjithashtu si garantues i sigurisë roli i tij është zbehur shumë.

Ne duhet të kemi qasjen në informatat e INTERPOL-it dhe informatat tona që i kemi t'i plasojmë vetë në INTERPOL. Kjo do të ishte rruga e duhur.

Ne i respektojmë konventat ndërkombëtare, por ne ta përfaqësojmë veten tonë si shtet e jo të na përfaqësojnë të tjerët aty. Ne duhet të vazhdojmë kontaktet bilaterale me të gjitha shtetet anëtare aty dhe të angazhohemi maksimalisht në plotësimin e gjitha standardeve që kërkohen nga ne.

Me angazhimin e Qeverisë, nëse nuk gabohet, pritet që Policia e Kosovës të hapë drejtorinë për bashkëpunim ndërkombëtar për rend dhe ligj, përgjegjësia e saj do të jetë bashkëpunimi me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in.

Hapja e kësaj drejtorie shihet si hap për përmbushjen e kriterëve për anëtarësim në këto organizata të mëdha policore. Kjo është mundësia reale për ndërmarrjen e hapave konkretë në rishikimin e atyre listave të fabrikuara nga Serbia që shumë janë bërë në vitet e 90-ta në raport me zhvillimet kohore të cilat kanë pasuar më vonë, nga sot mund të duken edhe si qesharake.

Institucionet përmes mekanizmave të vetë duhet të mbrojnë interesat e qytetarëve tanë kudo që ata ndodhin. Sekretari i përgjithshëm i INTERPOL-it kohë më parë, në një deklaratë, thotë se “shqiptarët nuk janë aq të rrezikshëm sa shkruhet e flitet në disa media”, por ne do t’i tregojmë botës demokratike se jemi qytetarë evropian, me kulturë perëndimore që njohim dhe respektojmë të gjitha ligjet. Faleminderit!

*Drejtimin e seancës e merr zoti Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit*

KRYESUESI: Faleminderit, zoi deputet! Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Unë kisha përgatitur një fjalim tjetër, por meqë në shumë segmente u përmendën këtu, unë do të jem pak më i shkurtër dhe duke analizuar që mosqenia e Republikës së Kosovës në këtë institucion më të lartë në INTERPOL, është një çështje që i jep hapësirë domosdo Republikës së Serbisë që të bëjë dosje për qytetarët e Republikës së Kosovës në përgjithësi dhe për shqiptarët në veçanti. I kam treguar edhe ato dosjet të cilat i ka formuluar ka mbi dy dekada, tri dekada të cilat veprojnë me theks të veçantë politik, Serbia, duke shfrytëzuar këtë mungesë tonën arrin që Kosovën ta paraqes para institucionit më të lartë botëror me një fizionomi negative dhe kriminale, si dhe para botës, po ashtu dhe rrjedhimisht janë edhe raportet të cilat sot sillen për trafikime të ndryshme e që de-fakto në praktikë statistikisht nuk qëndrojnë të tilla qoftë nga krimi i brendshëm ose nga krimi i eksportuar nga jashtë.

INTERPOL-i po ashtu nuk duhet t’i besojë vërtetësisë së Serbisë për çështje të qytetarëve të Republikës së Kosovës, sepse në këtë mënyrë nuk e njeh realitetin e ri në Republikën e Kosovës. Dhe, rrjedhimisht edhe sigurinë si dhe segmentet e sigurisë së Republikës së Kosovës nuk i njeh dhe nuk i aksepton, prandaj në këtë mënyrë ne mendojmë që qasja që iu ka bërë kësaj kërkesë përmes deputetit zotëriut Ramiz Lladrovci, është një çështje e cila duhet të jetë shqetësuese jo vetëm për Qeverinë e Republikës së Kosovës, por duhet të jetë për gjithë segmentet e sigurisë vendore, që janë, dhe ndërkombëtare, sepse ne jemi duke ndërtuar institucionet e Kosovës dhe përfaqësimi i Republikës së Kosovës në INTERPOL duhet të jetë vendimmarrës e jo i paraqitur nga Republika e Serbisë për qytetarët e Republikës së Kosovës. Prandaj, edhe çështja që argumentet janë të pa fund, të cilat e demantojnë prezantimet e Serbisë që shfrytëzon edhe hapësirën juridike të Rezolutës 1244, mirëpo megjithatë ekzistojnë edhe hapësira tjera të cilat përmes EULEX-it, përmes zyrave ndërlidhëse të cilat ekzistojnë këtu mund të fuqizohet dhe mund të çohet një mesazh që institucionet ndërkombëtare janë vërtetë të interesuara që ta stabilizojnë sigurinë në Kosovë, që përmes aktiviteteve dhe bashkërendimit me institucionet e gjyqësisë, me institucionet e hetuesisë, do të japin një figurë reale të Kosovës e jo të ketë emra

politikë në lista të INTERPOL-it. Ne jemi për të bashkëpunuar edhe ne me INTERPOL-in për ato figura të cilat kemi të drejtë edhe ne nesër të paraqesim në INTERPOL për figurat kriminale të cilat kriminalizojnë ose e kanë cenuar sigurinë në vend dhe janë të arratisur ose gjenden në strehim diku tjetër.

Prandaj, plotësisht e përkrah qëndrimin e zotit Lladrovci dhe shpresoj që në një takim të cilin Komisioni për Siguri dhe bashkërisht edhe institucionet tjera të Qeverisë me EULEX-in të bëjnë këtë rezolutë të cilën do ta paraqet si në pika pak më të zgjeruara deputeti Lladrovci, t'i drejtohet Zyrës qendrore të INTERPOL-it dhe të ketë një përgjigje për të cilën Kuvendi duhet të njoftohet. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Valbona Dibra!

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përkrah iniciativën e deputetit Ramiz Lladrovci për çështjen e ngritur në Parlament, çështje kjo e cila ia vlen të ngritet në Parlamentin e Kosovës.

Është më se e domosdoshme bashkëpunimi i Republikës së Kosovës me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in, për faktin se Serbia ka kërkesa të vazhdueshme për lëshimin e fletë-arresteve ndërkombëtare pranë institucioneve në fjalë për qytetarët e Kosovës dhe zyrtarët e lartë shtetërorë të Republikës së Kosovës.

Është shumë e pa dinjitetshme që nga këto akte të cenohet dhe degradohet liria e lëvizjes së lirë të qytetarëve dhe zyrtarëve të lartë shtetërorë të Kosovës, sa herë që ata udhëtojnë jashtë vendit. Emrat që e përbëjnë atë listë janë të njohur për qytetarët e Kosovës, për kontributin e dhënë për Kosovën dhe janë emra shumë kredibilë dhe njihen si hero të gjallë të Kosovës.

Është shumë banale, merreni me mend, është shumë banale se kërkesat e Serbisë përmes flet-arresteve në INTERPOL, do të thotë Serbia ka lëshuar kërkesë për flet-arrest për Rifat Jasharin. Pak i duket çka ka bërë dhe ka vrarë 56 anëtarë të familjes së tij, si dhe shkatërrimin e gjithë pasurisë së tij dhe duke mos u mjaftuar me kaq ajo e ka lëshuar edhe një flet-arrest për bacën Rifat dhe familjarët e tij. Kjo dëshmon se Serbia e Tadiqit është po ajo Serbia e paraardhësit të tij, Slllobodan Millosheviqit.

Prandaj, duke pasur parasysh kjo që u tha më lartë, dhe kërkesën e të gjithë kolegëve të mi deputetë, kërkoj që sa më shpejt që është e mundur edhe Kosova të anëtarësohet në këto organizata të rëndësishme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Nait Hasani!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje ministër,

Përshëndetje kolegë deputetë,

Iniciativa për listat e zeza, të bardha, të kuqe, të verdha të Serbisë që i ka vendosur dhe po i vendosë vazhdimisht apo po i ripërtërinë, nuk është një gjë e re po është e re që institucionet e Kosovës nuk e kanë marrë atë vendim që duhet ta marrin me kohë.

Në këtë ka pjesë edhe misioni ndërkombëtar në Kosovë, që iu ka mundësuar që pikërisht ky mision në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me organet e Serbisë, me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me të gjithë ata që nuk i kanë ndalë por iu kanë ndihmuar të ri freskojnë për çdo dy, apo tri vjet. Ky është një presion i Serbisë që u bëhet qytetarëve të Kosovës me lista të ndryshme, lista të viteve të pasluftës, ndërsa politika e udhëheqjes zyrtare me përgjegjësitë politike është veprim i ulët politik i Serbisë, të thuhet për terrorizëm.

Edhe Policia e Kosovës, unë mendoj, duhet të vendosë në listat e saj të kërkuarve të gjithë ata individë që kanë bërë krime në Kosovë. Duhet të vendosen të gjithë ata që kanë bërë krime në Kosovë gjatë luftës, sepse çdo masakër u përmend edhe dje, kemi edhe fakte, kemi dëshmi të mjaftueshme, sepse çdo masakër i ka kriminelët e vet dhe për gjithë këta kriminelë duhet të kërkohej nga shtetet që së paku e kanë njohur Kosovën, të futen në listat e tyre këta kriminelë që të ndalohen dhe të ekstradohen në Kosovë. Sepse duke e luftuar krimin në krijim të siguri dhe ndërtojme shtet ligjor.

Kolegët e thanë, e tha edhe iniciuesi i kërkesës për debat, e tha edhe deputeti Rexhep Selimi që ata që s'kanë mund t'i çojnë në Dubravë e t'i ekzekutojnë, kërkojnë edhe një herë t'i çojnë në Dubravë. Kërkoj që pikërisht kjo iniciativë të merret seriozisht nga Kuvendi dhe nga Qeveria dhe të vendoset që nëpër këto mekanizma ndërkombëtarë të hiqen këto lista, të mbyllet ky proces, po të vëhen në lista pikërisht ata që kanë bërë krime në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zotni deputet! Deputeti Afrim Hoti e merr fjalën!

AFRIM HOTI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Vetëm pak ditë më parë Sekretari i përgjithshëm i INTERPOL-it Ronald Noble ka deklaruar se Kosova mund të bëhet anëtare e INTERPOL-it. Për ne nuk është e rëndësishme se a është Kosova anëtare e OKB-ës apo e Bashkimit Evropian, ka thënë zyrtari i INTERPOL-it. Kjo më le mua të kuptoj se Qeveria e Kosovës nuk ka bërë përpjekje të duhura deri tani për tu anëtarësuar në këtë organizatë sepse nga kjo deklaratë kuptojmë se nuk paska qenë aq e vështirë. Kur them përpjekjet, kam parasysh se është çështje diplomacie, sepse nevojiten 2/3 e votave dhe duke pasur parasysh se lufta ndaj krimit pa kufi është interesi i përbashkët, nuk besoj se do të kishte qenë aq e vështirë. Është e çuditshme kjo mungesë interesi duke pasur parasysh se shumë figura publike, këtu përfshirë edhe kryeministrinë, janë bërë prej e informacioneve të gabuara që shteti serb i ka dërguar në INTERPOL. Shpesh është dashur ndërhyrja ndërkombëtare për të zgjidhur këtë problem.

Kanë ndodhur shumë ngjarje juridike në favor të shtetit të Kosovës prej vitit 1999. Mjafton të përmendim edhe ndihmën e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në favor të pavarësisë së Kosovës. Këto informata do të duhej të ishin dërguar sepse edhe vetë fletë-arrestet kanë motivacion politik.

Në rast se bëjmë një hulumtim të shkurtër në mision dhe mënyrën se si funksionon INTERPOL-i do të kuptojmë se ai është një institucion që i raporton vazhdimisht të dhënat e po kështu edhe bashkëpunimin me shtetet dhe organizatat e ndryshme. Është dështim edhe yni por edhe i institucioneve ndërkombëtare që kanë administruar këtu për gjendjen aktuale. Në tetor të vitit 2004 Asambleja e Përgjithshme adaptoi një Rezolutë ku thuhet se me të mund të bashkëpunojmë me vendet anëtare, organizata ndërkombëtare, gjykatat ndërkombëtare dhe organizatat jo

qeveritare me një përpjekje të përbashkët për të parandaluar gjenocidin, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, të hetojë dhe ngre akuza për të dyshuarit që kanë kryer krime të tilla e tjera.

Nga ana tjetër, është ... po ashtu se në vend që të lëshohen fletë-arreste ndërkombëtare për kriminelët serbë të luftës që i kanë duart e përlyera me gjak, në Kosovë ata lëvizin të lirë, madje edhe pa viza, ndërsa ne si shtetas të Kosovës duhet të frikësohemi nëse ndërmarrim udhëtim se emrat tanë mund të figurojnë në lista të INTERPOL-it si terroristë të shpallur nga Millosheviqi dhe pasuesit e tij. Në të shkuarën ka qenë UNMIK-u ai që shkëmbente informacione me INTERPOL-in në emër të Kosovës. Ndërkohë ne nuk kemi informacion nëse Qeveria e ka përgatitur infrastrukturën e brendshme dhe çfarë ka bërë për të siguruar votat e nevojshme për anëtarësim në INTERPOL dhe EUROPOL.

Edhe për sa i përket EUROPOL-it pavarësisht se aty janë anëtarë vetëm vendet e Bashkimit Evropian, kjo nuk do të thotë se nuk bashkëpunon edhe me vendet jo anëtare të BE-së. Ky bashkëpunim është bazuar gjithmonë në një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet EUROPOL-it dhe atij vendi.

Këshilli i Bashkimit Evropian vendos se me cilin vend jashtë Bashkimit Evropian mund të bashkëpunojë apo të lidhë marrëveshje. Në listën e EUROPOL-it përveç vendeve anëtare të Bashkimit Evropian shihet se kjo organizatë ka bashkëpunim të ngushtë me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi e Serbinë si dhe me 25 vende të tjera në botë, po ashtu jo anëtare të BE-së, përfshirë këtu edhe Zvicrën dhe Turqinë. Edhe pse Kosova nuk figuron në listën e EUROPOL-it për bashkëpunim të ngushtë, për shkak të zhvillimeve në Kosovë në aspektin e krimit të organizuar kjo organizatë policore evropiane i kushton vëmendje të rëndësishme bashkëpunimit me Kosovën, por përmes misionëve ndërkombëtare në rajon, sidomos përmes EULEX-it në Prishtinë, e duke qenë se është kështu, pra EULEX-i është partneri i tyre në Kosovë, atëherë është dashur të informohet se në Kosovë krime lufte ka kryer Serbia, se për një pjesë të këtyre krimeve janë gjykuar edhe në Hagë pavarësisht se nuk është ndëshkuar ashtu si duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotni deputet! Deputeti Fatmir Xhelili e merr fjalën!

FATMIR XHELILI: Faleminderit kryesues!

Përshëndetje! Përshëndetje për ju, ministrin dhe të nderuar kolegë deputetë!

Besoј se tema të cilën e ka ngritur kolegu Lladrovci është temë me vend, mirëpo gjatë diskutimeve janë duke u përzier pak tezat dhe jemi duke biseduar për dy çështje.

Nuk është problemi të INTERPOL-i dhe nuk është problemi të EUROPOL-i, të dy këto organizata shumë serioze në drejtim të bashkëpunimit për luftimin e krimeve dhe llojeve të krimeve të ndryshme, të krimeve të organizuara dhe ndjekësit të tyre të cilët kërkohen për shkak të veprave të ndryshme penale, është krejt në rregull.

Janë dy organizata shumë serioze të cilat kanë rregulloret dhe kushtetutën e tyre, gjegjësisht kushtetutat e tyre për pranim të anëtarëve të ri në këto organizata.

Përfaqësuesi i INTERPOL-it i cili ka qenë në Kosovë dhe ka thënë se Kosova do të mund të anëtarësohet në INTERPOL, është e vërtetë. Ne do të mund të anëtarësohemi në INTERPOL

atëherë kur 2/3 e anëtarëve të INTERPOL-it do të pranojnë që Kosova të jetë anëtare e INTERPOL-it. Gjithashtu edhe do të pranohemi edhe në EUROPOL ku të gjithë anëtarët e Bashkësisë së EUROPOL-it të pranojnë që Kosova me qenë pjesë e EUROPOL-it.

Faktikisht, vështirësitë e pranimit të këtyre dy organizatave e dëshmon më së miri edhe tentimi i EULEX-it për t'u kyçur drejtpërdrejt me linkun në INTERPOL, ka qenë e pamundshme dhe për atë arsye ende funksionon zyra e UNMIK-ut për ndërlidhje me INTERPOL-in që të mund edhe Kosova të ketë qasje te të dhënat e INTERPOL-it apo INTERPOL-i të marrë informacione prej Policisë së Kosovës për çështjet të cilat lidhen për aktivitetet joligjore të qytetarëve të Kosovës apo tjerët që kanë zhvilluar aktivitet joligjor në Kosovë.

Është shumë e vërtetë që ka edhe disa anëtarë të INTERPOL-it që s'janë anëtarë të Kombeve të Bashkuara, mirëpo ka edhe anëtarë të Kombeve të Bashkuara, shtete fatkeqësisht që nuk janë anëtarë të INTERPOL-it.

Esenca e ngritjes së këtij debati të Lladrovciit e kuptoj se kanë qenë fletë arrestet për qytetarët dhe personat e Kosovës, që Serbia ka ngritur dosje politike për zhvillimin e aktivitetit kombëtar dhe çlirimtar gjatë përgatitjes për luftë dhe gjatë zhvillimit të luftës çlirimtare të Kosovës. Këto edhe fillimisht pas luftës i ka botuar në libër që e kanë quajtur "Libri i bardhë" dhe për të gjithë ata qytetarë ende figurojnë fletë-arrestet që i ka lëshuar në INTERPOL dhe shtetet të cilat janë anëtare të INTERPOL-it janë të obliguara që me i ndaluar personat kur gjenden në territorin e atyre që janë anëtarë të INTERPOL-it dhe në njëfarë mënyre edhe ato shtete janë në pozita shumë të palakueshme se e dinë që në bazë të obligimeve që kanë me marrëveshje ndaj INTERPOL-it duhet me i ekstraduar në shtetet prej nga është ngritur fletë-arresti, kurse në esencë edhe ata e dinë që diçka nuk është në rregull me ato fletë arreste, se janë fletë arreste politike.

Besoj se rekomandimet nga ky debat duhet me shkuar në drejtim të Ministrisë së Drejtësisë për me përgatitën një dosje për të gjithë ata që konsiderohet se janë vetëm fletë-arreste politike për qytetarët tanë dhe t'i diskutojë me INTERPOL-in përmes Zyrës së Policisë tonë që e kemi të ndërlidhur me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in apo me shtetet në veçanti. Kjo është e vetmja formë dhe mundësi për të ndikuar në këtë formë si shtet dhe në të ardhmen me punuar Ministria e Jashtme sa më shumë në drejtim të fitimit të njohjeve të reja që edhe ata të jenë përkrahës të ardhshëm të shtetit tonë për me u anëtarësuar në INTERPOL dhe në EUROPOL. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zotni deputet! Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues,

Zoti ministër,

Të nderuar kolegë,

Tashmë u thanë shumica e gjërave që do të duhej të thuheshin këtu në këtë debat të thirrur, që synimin kryesor e ka shqetësimin e qytetarëve tanë te shfrytëzimi i disa organizatave të rëndësishme të sigurisë nga ana e pushtetit serb për t'i nxjerrë në lista të zeza disa njerëz që praktikisht nuk kanë të bëjnë asgjë me thyerjen e ligjit këtu në vendin tonë.

Është e vërtetë se jemi ballafaquar me këto raste dhe po ashtu është e vërtetë që Serbia e ka shfrytëzuar qenien e saj anëtare e këtyre organizatave në mënyrë të njëanshme dhe ka shfrytëzuar të drejtën që të ketë të drejtë t'i bëjë këto fletë-arreste ose t'i nxjerrë këto lista në këto organizata.

Ne duhet të shohim çka mund të bëjmë në këtë drejtim. E para, deri sa ne nuk jemi anëtarë të këtyre organizatave duhet të vazhdojmë përpjekjen për me qenë pjesë e EUROPOL-it dhe INTERPOL-it dhe në të njëjtën kohë duhet të bëjmë një lobim më të fuqishëm, qoftë në aspektin politik, qoftë në aspekte tjera në mënyrë që ta zbehim ose ta nxjerrim jashtë këtë ndikim ose këtë keqpërdorim nga ana e pushtetit serb të këtyre organizatave.

Me vetë faktin që për disa raste kur kemi pasur arrestime të qytetarëve tanë, kemi bërë ndërhyrje politike dhe kanë ndërhyrë shtete të cilat janë pjesë e këtyre organizatave, nënkupton dhe arsyeton faktin që këto janë veprime politike aspak të sundimit të ligjit që bëhen nga pushteti serb.

Cili është argumenti kryesor për të cilin ne duhet ta marrim për të qenë pjesë e këtyre organizatave? Unë mendoj që, ajo që është esenciale, luftimi i krimit të organizuar. Ne kemi sfida kryesore nga ana e BE-së dhe e miqve tanë që kemi probleme me sundimin e ligjit. Kjo i thuhet të gjitha shteteve të regjionit dhe njëkohësisht nuk na lejojnë të jemi anëtarë të mekanizmave që janë kryesorë për ta luftuar krimin në regjion, bashkërisht. Nuk ka asnjë shans nëse nuk jemi pjesë e këtyre mekanizmave ta luftojmë suksesshëm krimin e organizuar. Pra, për këtë fakt, ne duhet të na lejohet që të jemi pjesë e këtyre organizatave. Por me qenë se kjo që u tha më herët nga kolegët është pjesë e procedurave të votave, atëherë na duhet një lobim dhe na duhet një angazhim shumë më i madh i institucioneve tona gjithandej pavarësisht të cilit nivel vjen.

Në plan të parë, ne duhet ta mbështesim, ta inkurajojmë Policinë e Kosovës në procesin e anëtarësimit në këto organizata. Duhet ta inkurajojmë po ashtu në reagime të shpejta dhe në dokumentim, bashkë me organet tjera të drejtësisë në këto organizata në mënyrë që të mos ndodhë që ne të merremi me pasojat. Pra, le të bëhet një argumentim i shpejtë, edhe nga ana e policisë, nga ana e organeve të drejtësisë politik. duke e marrur një shembull në të kaluar, në mënyrë që të mos ndodhë deri sa ne të jemi pjesë e këtyre organizatave të na ndodhë që ndokush nga njerëzit tanë qoftë përfaqësuesit e institucioneve ose qytetarë të thjeshtë të ndalet njëanshëm nga këto organizata diku derisa udhëton jashtë në shtetet tjera.

Mbetet ende shumë për tu bërë. Mos harroni që anëtarësimi nuk është vetëm kriter i votave, ka një numër të madh të standardeve që ne duhet t'i arrijmë si mekanizma dhe duhet t'i arrijmë. Duhet ta mbështesim Policinë e Kosovës dhe Ministrinë e Brendshme në arritjen e këtyre standardeve që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve, me pajisje, e tjera, por gjithsesi të theksojmë se pa qenë pjesë e përbashkët e këtyre institucioneve ne nuk mund ta luftojmë krimin, ne nuk mund të jemi bashkë me gjithë tjerët në procesin e integriteteve, në procesin e arritjes së standardeve dhe në këtë mënyrë po ashtu nuk do të lejojmë që një shtet tjetër ta keqpërdorë këtë anëtarësim për çështje krejtësisht politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën!

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Jam i sigurt se shumica e asaj që është dashur të thuhet, është thënë, por megjithatë dëshiroj të theksoj se kjo çështje sa është politike është edhe çështje legale. Aspektet politike tanimë janë të qarta, Serbia vazhdon të përsërit vazhdimisht kërkesat të INTERPOL-i dhe këtu s'ka asgjë të re. Serbia ka fabrikuar akuza ndaj liderëve të Kosovës, ndaj personaliteteve të shquara të Kosovës dhe ajo duke shfrytëzuar anëtarësinë të kjo organizatë vazhdon t'i përtërijë këto për të penguar....

Për mendimin tim këtu problemi nuk është shumë tek qëllimet e Serbisë dhe pretendimet e Serbisë, por shtrohet pyetja çfarë mund të bëjmë ne dhe çfarë mund të bëjnë institucionet ndërkombëtare që e kanë formuar këtë organizatë. Mendoj se tek organizatat ndërkombëtare sidomos tek shtetet që janë anëtare dhe e kanë njohur Republikën e Kosovës, ai është një obligim politik, besojë dhe obligim legal karshi njohjeve që i kanë bërë Republikës së Kosovës të ndikojnë që të zbulohet prapavija e këtyre kërkesave sepse prapavija e tyre nuk është e natyrës kriminale por krejtësisht e natyrës politike. Për shkak se këto janë fabrikime politike dhe mendoj se krahas institucioneve vendore që duhet të angazhohen në këtë drejtim në radhë të parë shtetet e Bashkimit Evropian që janë anëtare të kësaj organizate duhet të përdorin autoritetin politik e të tregojnë se këto janë fabrikime politike. Kurse institucionet vendore pa dyshim brenda kapaciteteve legale që kanë, brenda mundësive që kanë, në radhë të parë Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme duhet të përdorin krejt autoritetin që të kërkohet që këto lista të mos freskohen në mënyrë automatike, mos të freskohen pa u shqyrtuar dhe të spastrohen sepse akuzat janë kryesisht politike dhe nuk kanë të bëjnë asgjë me çështje politike.

Natyrisht se kjo kërkesë e Parlamentit assesi nuk bie ndesh me politikat evropiane për luftimin e krimit të gjitha formave, sepse Kosova është e përcaktuar për luftimin e krimit të vërtetë, jo të konstruksioneve dhe fabrikimeve politike dhe natyrisht duke bërë kërkesë që këto lista të mos hartohen sipas kriterëve politike dhe të përdoren autoritet ndërkombëtare dhe ato vendore që kjo çështje të mos jetë pengesë për lëvizjen e lirë të përfaqësuesve institucional dhe përfaqësuesve politikë të Kosovës ne duhet përmes mekanizmave vendorë, përmes politikave vendore të luftojmë krimin sepse luftimi i krimit, siç është përcaktuar dhe është ndër agjendat apo ndër prioritetet e veçanta të Qeverisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Dhe, deputetja Sala Berisha-Shala e ka fjalën!

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje ministra,

Kolegë deputetë,

Pothuaj se u përfshinë të gjitha shqetësimet rreth kësaj pike. Unë konsideroj që nuk është shumë e rëndësishme, ndoshta formulimi i pikës si i tillë qysh është debat parlamentar lidhur me bashkëpunimin e Republikës me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in sa është e rëndësishme çështja e cila po debatohet.

Edhe unë konsideroj se iniciativa e deputetit Lladrovci duhet të gjejë mbështetjen e të gjithë neve në Kuvend pa dallim subjekteve politike, sepse mendoj që ne duhet t'i ikim logjikës së thënies se një gjarpër që nuk më kafshon mua rrnoftë 100 vjet. Konsideroj se nuk janë shumë të rëndësishëm emrat e përveçëm në listën e INTERPOL-it dhe EUROPOL-it sepse këto dy kolege deputete e përmendën dy emra dhe konsideroj që shumë më i rëndësishëm është fenomeni si fenomen që Serbia të bëjë listë të një shteti tjetër përkatësisht shtetit tonë dhe konsideroj që reagimi ynë duhet të jetë unik sepse kemi obligim institucional të debatojmë të rekomandojmë dhe të kërkojmë nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me këtë çështje po edhe

me çështje tjera që janë shumë të rëndësishme, konsideroj se duhet t'i tejkalojmë të gjitha ngjyrimet politike dhe mendoj se ky debat është mëse i nevojshëm dhe debatet e tilla duhet të na bëjnë të gjithëve t'i tejkalojmë disa ngurtësi politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja deputete! Fjalën e ka ministri i Brendshëm, zoti Bajram Rexhepi.

BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Ministër,

Të nderuar deputetë,

Kërkoj falje që pak me vonesë erdha për arsye se kishim takim me presidentin e Komisionit Evropian dhe jam i befasuar për të mirë që 9 pika kanë shkuar shumë më shpejt se sa që kemi pritur, deri sa vimë te pika 16. Unë desha vetëm t'i bëj disa shpjegime ligjore edhe pse sigurisht në diskutime janë bërë shpjegimet e çështjes së anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL dhe EUROPOL dhe do të provoj të jem sa më i shkurtër.

Anëtarësimi mund të arrihet pas një kërkesë dhe aprovimit të 2/3 të anëtarëve të Asamblesë Gjenerale të cilat janë 188. Asambleja gjenerale është mekanizimi kryesor vendimmarrës. INTERPOL-i drejtohet nga sekretari gjeneral momentalisht Ronald Keneth Noble, shtetas amerikan, i cili është duke shërbyer në mandatin e tij të dytë.

Deri më tani ka pasur një kërkesë formale për anëtarësim. Kërkesa është bërë nga ministri i Punëve të Brendshme me datën 31 maj 2010 dhe në shtator të po njëjtit vit, e kemi marrur përgjigjen ku neve na kërkohet një lloj pyetësori se sa na kemi përparuar me i plotësuar edhe kriteret teknike, pra nga rrafshi politik e kanë kthyer në rrafshin teknik që edhe ajo është e domosdoshme me i plotësuar për me pas shans për anëtarësim, ndërsa edhe një herë e përsëris se anëtarësimi mund të bëhet vetëm me përkrahjen e 2/3 të Asamblesë Gjenerale të INTERPOL-it.

Përfitimet nga ky anëtarësim do të jetë luftimi i krimit, shumë më efikas, qasja në data-bazën e përgjithshme të INTERPOL-it, gatishmëria për bashkëpunim ndërkombëtar.

Situata aktuale, momentalisht komunikimi me INTERPOL koordinohet përmes Zyrës së INTERPOL-it në Kosovë ku operojnë 6 zyrtarë të Policisë së Kosovës, 4 zyrtarë të UNMIK-ut dhe 8 zyrtarë të EULEX-it.

Praktika tregon se për raste të caktuara kjo zyrë ka qasje në data-baza të Policisë dhe në anën tjetër Policia e Kosovës kërkon asistencë për raste të caktuara. Vetëm të ju informoj se edhe më tutje INTERPOL-i është nën ombrellën e UNMIK-ut, ende nuk është e transferuar as te EULEX-i se le më te institucionet tona.

Aktualisht Policia e Kosovës bashkëpunon me vendet e rajonit në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit por edhe mbi bazën e parimit të reciprocitetit. Për deri sa nuk arrihet anëtarësimi i plotë në INTERPOL, fokusi ynë duhet të jetë në kërkesën e përfshirjes së Kosovës në shërbimet që i ofron INTERPOL-i, siç janë: qasja në leximin e listës së personave që kërkohen, qasja në data-baza të dokumenteve të humbura, qasja në 24 orë të data-bazës 7 ditë në javë, rra, permanent. Në një fazë të mëvonshme mund edhe të mendohet për modalitete se si edhe Kosova të raportojë krimet e ndryshme dhe t'i sqarojë procedurat e futjes së të dhënave në data-baza të INTERPOL-it.

Sfidë mbetet lëshimi i fletë arresteve nga Serbia për shtetas të Republikës së Kosovës. Këto fletë-arreste disa prej tyre të lëshuara edhe me Red Notice, pra në vi të kuqe, janë të natyrës politike dhe si të tilla janë në kundërshtim edhe me vetë Kushtetutën e INTERPOL-it, përkatësisht me nenin 3 të kësaj kushtetute ku thuhet: është rreptësisht e ndaluar për organizatën të ndërmarrë çfarëdo intervenimi ose aktiviteti me karakter politik, ushtarak, religjioz ose racial. Pra, kjo keqpërdoret nga Serbia, në këtë rast.

Bashkëpunimi me EUROPOL.- EUROPOL-i është agjencion i zbatimit të ligjit, i Bashkimit Evropian që merret me inteligjencë kriminale. Misioni i këtij mekanizmi është përmirësimi i efikasitetit dhe të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve anëtare në parandalimin dhe luftimin e çdo forme serioze të krimit të organizuar dhe terrorizmit ndërkombëtar.

EUROPOL-i nuk është institucion ekzekutiv, por më shumë koordinues.

EUROPOL-i ka marrëveshje strategjike dhe operacionale me vende të shumta mirëpo për shkaqe politike ende nuk ka një marrëveshje të tillë me Republikën e Kosovës.

Sidoqoftë, ne jemi duke bërë përpjekje që të instalojmë bashkëpunimin me EUROPOL, përmes ndonjë vendi anëtarë si Austria, Gjermania, Franca, e tjerë, me të cilat vende Republika e Kosovës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi policor në mënyrë që ne të shkëmbejmë informacione dhe të kërkojmë raporte kthyesë. Muajin e kaluar një delegacion i Policisë së Kosovës ka vizituar EUROPOL-in në selinë qendrore në Hagë ku ka shfaqur gatishmërinë që Policia e Kosovës të jetë burim primar dhe kryesor në shkëmbimin e informatave me EUROPOL-in.

Tashmë jemi në finalizim të përgatitjeve për hapjen e zyrës për bashkëpunim ndërkombëtar në zbatimin e ligjit si pjesë e projektit ILEK-u, të përkrahur nga Bashkimi Evropian dhe implementuar nga Austria, me ndihmën po ashtu edhe të Gjermanisë dhe Sllovenisë. Kjo zyrë do të hapet me datë 22 qershor 2011.

Funksionalizimi i zyrës së ILEKU në kuadër të Policisë së Kosovës do të forcojë bashkëpunimin e agjencive të zbatimit të ligjit të Republikës së Kosovës në mekanizmat ndërkombëtar si INTERPOL-i, EUROPOL-i, EURO-JAS, FRONTEX, SEKI-CENTER e tjerë.

Unë jam pak i informuar edhe me propozimet që do të dalin, ndoshta si konkluzione dhe i përkrahim ato institucione tona, duhet të bëjmë ankesë te shtetet që na kanë pranuar ndaj fletë-arresteve politike që i lëshon Serbia dhe ta respektojnë atë nenin 3 të Kushtetutës së tyre, në mënyrë që të hiqen nga lista. Ju e dini që disa shtete në marrëveshje bilaterale i respektojnë kërkesat tona, disa nuk i respektojnë, prandaj ka një laramani dhe me një angazhim të përbashkët mendoj se kjo mund të bëhet gradualisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti ministër!

Fjalën e merr, fjalën përfundimtare, paraqitësi i kërkesës për debat, deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sa për sqarim për nënkryetarin, Serbia më 25 janar ka lëshuar fletë-arreste të reja dhe ka rifreskuar listën e fletë-arresteve të vjetra politike ndaj kryeministrit, kryeparlamentarit, ministrave, deputetëve, drejtorëve të policive, drejtorëve në FSK dhe qytetarëve tjerë që kanë qenë aktivë në Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, prandaj zyra ligjore e INTERPOL-it i ka dhënë një afat Serbisë që deri më 25 maj të dorëzojë të gjitha dosjet e këtyre kërkesave që i ka bërë për fletë-arreste Serbia nga INTERPOL-i.

E falënderoj edhe ministrin për informatat shtesë që na i dha këtu, që ne i kishim mangu deri më tani dhe si propozues i kësaj pike të rendit të ditës, e kam nderin që pas debatit të zhvilluar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe kontributet, i jap këto

## REKOMANDIME

1. Qeveria e Republikës së Kosovës sa më parë të plotësojë dokumentacionin e duhur pasi që ministri na e dha informacionin se kanë bërë një kërkesë dhe unë nuk kam pasur informacion, për anëtarësim pranë sekretarit të Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOL-it sipas procedurës respektive që e ka kjo organizatë e sigurisë, institucion ky i respektuar dhe i rëndësishëm së veçantë.

Në këtë drejtim duhet kërkuar ndihmën të miqve tanë, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë nga Sekretari i Përgjithshëm i INTERPOL-it, me seli në Lion, që Zyra ndërlidhëse e saj në Kosovë, që udhëhiqet nga UNMIK-u dhe themeluar nga Kombet e Bashkuara e që ka në përbërje të saj, siç tha edhe ministri, Policinë e Kosovës dhe Policinë e EULEX-it t'i kalojë në shërbim të plotë Policisë së Kosovës.

Përfaqësuesit e UNMIK-ut në këtë zyrë të kalojnë në cilësinë e këshilltarit, të këshilltarëve të Policisë së Kosovës deri në pranimin e saj zyrtar në institucionin e INTERPOL-it.

3. Qeveria e Republikës së Kosovës t'i kërkojë sekretarit të Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOL-it që Policia e Kosovës të ketë qasje në linkun e INTERPOL-it dhe ta shtrijë atë në gjitha pikat kufitare.

4. Qeveria e Republikës së Kosovës të bëjë marrëveshje bashkëpunimi policor me shtetet veç e veç, e sidomos me ato vende të cilat na kanë pranuar si shtet dhe të shkëmbejnë informacione përmes tyre me INTERPOL-in dhe EUROPOL-in.

Unë kam menduar edhe një pikë të rendit të ditës, edhe një konkluzë dhe rekomandim, që e tha ministri se Zyra e ILEKU-t do të hapet më 22 qershor, prandaj nuk ka nevojë të jetë si rekomandim.

Anëtarësimi në INTERPOL dhe EUROPOL kishte me qenë mirë për besimin e qytetarëve dhe për shtetin e tyre kosovar dhe mirë për besimin e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë gjithashtu.

Vetëm duke vepruar sa më shpejt në këtë drejtim, si Qeveria ashtu edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës do ta kryejë një obligim që kemi ndaj vendit në rrafshin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar, për një imazh më të mirë të shtetit të Kosovës dhe për demaskimin e propagandës së vazhdueshme të Serbisë dhe përpjekjeve të saj për kriminalizimin e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe bartësve të saj.

Në të njëjtën kohë veprimi në këtë drejtim dhe pranimi i Republikës së Kosovës në këta mekanizima të rëndësishëm ndërkombëtarë të sigurisë do të jetë edhe formësim dhe forcim i mëtejshëm i pranimet të Republikës së Kosovës në botë.

Kërkoj, dhe besoj se edhe ministri i Drejtësisë e ka plotësuar dokumentin për ta dërguar në Zyrën ligjore të INTERPOL-it në Lion, por kërkoj që ta shpejtojë pasi që deri më 25 maj Serbia duhet t'i dorëzojë dosjet për të gjitha ato kërkesa që i ka bërë, edhe për ato që kanë qenë të vjetrat edhe për këto që i ka rifreskuar dhe në rast se ato kalojnë në zyrën ligjore do të mbesin deri në mars të 2013. Faleminderit për kontributin!

KRYESUESI: Zotërinj deputetë, dhe zotërinj ministra të pranishëm, Mujota që është gjithë dhe i vetmi që rri gjithë, dhe ministri i Brendshëm. Po, më i rregullti ti gjithë ke qenë.

Pika e rendit të ditës: Debati parlamentar që e ka ngrehur deputeti Ramiz Lladrovci bashkë me një grup tjetër deputetësh, u shter.

Ne dëgjuam përfundimisht edhe një shpjegim, sepse në debat gjithë dalin shpjegimet, në kuptimin e urgjencës dhe mirë bërë që e the, sepse lidhet më një 25-sh. Kjo është mirë, do të thotë. T'i kemi të qarta sendet.

E dyta, në këto debate të këtilla, zakonisht mund të propozohen tekste rekomanduese, po edhe nuk mund të propozohen. Në rastin konkret, ne dëgjuam nga paraqitësi i kërkesës për debat deputetin Lladrovci, një tip përfundimi, unë do të thosha më shumë, se qysh i pash, formulimet nuk janë shumë precize, ka edhe tekst instruktiv brenda shumë, po si intencë do të thosha, ne mund t'i votojmë sepse, unë sa dëgjova kujdesshëm, është pak a shumë e njëjta gjë që thotë edhe ministri Rexhepi dhe paraqitësi. Pra, unë ju thërras që këto t'i quaj përfundime, më saktë, të këtij diskutimi se sa rekomandime të kuptimit klasik, që do t'i përcillen Qeverisë për punën në këtë lëmi, t'i votojmë.

Në sallë kemi 64 deputetë. Unë ju lus që t'i votojmë këto përfundime të diskutimit. Votojmë tash:

Me 60 vota "për", 1 "kundër" dhe 4 "abstenime", Kuvendi miratoi Rekomandimet e parashtruara nga deputeti Ramiz Lladrovci.

Faleminderit! Shihemi në mbledhjet tjera!

Përgatiti:

**Njësia e Transkripteve**